

KLSH ANALIZA VJETORE 2011



INTOSAI



Tiranë, 2012

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHTETIT**

**KLSH
ANALIZA VJETORE 2011**

Tiranë, 2012

Titulli :
KLSH: Analiza Vjetore 2011

Redaktor:
Bedri Çoku

Art design:
Kozma Kondakçiu

Seria: Botime KLSH
01/2012

© Mundësohet përdorimi i materialeve të këtij botimi,
kundrejt citimit të burimit, KLSH.

ISBN:978-9928-159-01-04

Shtypur në shtypshkronjën “Mirgeeralb”
Tiranë, 2012

Hyrje

Në realizim të misionit të tij kushtetues për të informuar Kuvendin dhe publikun dhe në bazë të Deklaratës së Limës (ISSAI 1) të vitit 1977, e konsideruar Kushtetuta e Institucioneve të Auditimit më të Lartë, e cila shprehet se "Institucioni i Auditimit më të Lartë duhet të ketë fuqi dhe të drejta të raportojë dhe publikojë gjetjet e tij të rëndësishme dhe të veçanta gjatë gjithë vitit", Kontrolli i Lartë i Shtetit nis një kolanë botimesh KLSH.

Kjo kolanë vjetore, e cila do të pasurohet nga viti në vit, do të pasqyrojë reformat që ka nisur KLSH për të thelluar auditimin financiar dhe kthyer vëmendjen tek auditimi i performancës, punën e stafit të tij për të luftuar në sistem korrupsionin dhe për ta parandaluar atë. Nga ana tjetër, kolana do ta njohë audituesin dhe publikun e gjerë me institucionet evropiane të auditimit suprem dhe me standardet e përditësuara të INTOSAI-t.

Edicioni i parë i kolanës "KLSH: Raporti Vjetor 2011" përmban informacion të detajuar për auditimet e kryera gjatë vitit 2011, si dhe një analizë pune të kryer në prani të medias dhe të shoqërisë civile, nga departamentet e auditimit të KLSH, me raportime dhe diskutime të hapura.

*"Experientia mutua omnibus prodest" * është moto e organizatës që përmbledh 191 institucione më të larta të auditimit në botë dhe kryefjala e bashkëpunimit mes këtyre institucioneve me njeri-tjetrin dhe me partnerët e tyre të natyrshëm publikë në vendet përkatëse. Kjo moto do të na udhëheqë ne në punën tonë.*

Gjetjet dhe sugjerimet nga raportimet dhe diskutime e këtij libri përbëjnë bazën për planifikimin e auditimeve të institucionit gjatë këtij viti dhe në vitet në vijim.

Bujar LESKAJ



** Në latinisht, "Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë" - Moto e INTOSAI, organizata ndërkombëtare e institucioneve më të larta të auditimit*

PROJEKT-IDE

KLSH-Institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar të vendit



Paraqitur pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë nga z. Bujar Leskaj, kandidat i nominuar nga Presidenti i Republikës Prof. Dr. Bamir Topi me Dekret Nr. 7163 datë 17 nëntor 2011 për Detyrën e Kryetarit të KLSH-së.

*Komisioni për Ekonominë dhe Financat
në Kuvend*

Përmbajtja:

- 1. Vizion koherent për KLSH, mbi bazën e eksperiencave më të mira të vendeve të BE-së dhe respektimit rigoroz të standarteve ndërkombëtare të kontrollit INTOSAI*
- 2. Thellim i realizimit të misionit të KLSH në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike*
- 3. Përmirësim i metodologjisë së kontrollit, duke kthyer vëmendjen tek auditimi i performancës, krahas rritjes së efikasitetit të auditit financiar*
- 4. Realizim i sinergjizimit të politikave dhe veprimeve me strukturat e tjera shtetërore të së njëjtës fushë, si me Departamentin e AntiKorrupsionit pranë Kryeministrit, me Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit dhe me Drejtorinë e Inspeksionit Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe, në veçanti me*

Prokurorinë e Shtetit, duke ruajtur pavarësinë e KLSH si organi më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar

5. Intensifikim i konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH 2012-2018, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj Kuvendit, si një detyrim kushtetues

6. Vendosja e bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademikë të auditit të financave publike, si dhe me organizata profesionale të kontabilitetit dhe të fushave të tjera të ekonomisë

7. Intensifikimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e larta të kontrollit të vendeve të BE-së, të vendeve të rajonit dhe në veçanti me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës

8. Zhvillim i burimeve njerëzore të KLSH në nivelin e parametrave të kërkuar nga INTOSAI dhe në përputhje me sfidat integruese të vendit

9. Përmirësim i transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse të interesuara për bashkëpunim

Hyrje

Të nderuar zotërinj deputetë,

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë dt 02.06.2011 e ka vlerësuar Kontrollin e Lartë të Shtetit si një institucion që ka realizuar objektivat e veprimtarisë kontrolluese, duke e shtrirë atë në një numër më të madh subjektesh e veprimtarish, që ka rritur cilësinë dhe efektivitetin e kontrolleve të kryera, duke përmirësuar kontrollin për zbatimin e legjislacionit (f. 1, Rezoluta).

Në një linjë me këtë vlerësim tuajin, besoj se të gjithë biem dakord që sfidat e kohës së sotme janë akoma dhe më kërkuese dhe e vendosin KLSH përballë një sprove të madhe. Disiplina buxhetore dhe financiare e administrimit publik është bërë përparësi absolute sot në botë. KLSH në rolin e tij si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar në vend, sidomos i kontrollit të performancës së administrimit dhe financave publike, mbart një përgjegjësi të spikatur për miradministrimin e pronës shtetërore dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, nëpërmjet një kontrolli të përdorimit të burimeve në mënyrë ekonomike, me efektivitet dhe efikasitet.

Thellimi i reformimit të tij është i domosdoshëm edhe në këndvështrimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dt. 02.06.2011 për përmirësimin e punës së KLSH, të cilat kërkojnë përdorimin më gjerësisht të metodologjisë bashkëkohore të kontrollit, rritjen e cilësisë, konsolidimin e bashkëpunimit me strukturat e tjera shtetërore dhe rritjen e bashkëpunimit me organet e drejtësisë.

Bazuar në rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, në objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2009-2012, në objektivat e Strategjisë dhe Planit të Veprimit Anti-Korrupsion 2008-2013 të qeverisë Berisha, si dhe në kërkesat e Rezolutës më të fundit të INTOSAI në Kongresin e saj në nëntor 2010, po parashtoj mendimet e mëposhtme në formën e një projekt-ideje për drejtimit kryesorë të reformimit të mëtejshëm të KLSH, në cilësinë e kandidatit për Kryetar të tij.

Ky projekt do të marrë formën e plotë të një strategjie afatgjatë në konsultime të mëtejshme me ju, Kuvendin e Shqipërisë dhe me specialistë të KLSH-së dhe jashtë tij, nëse Ju si deputetë do të jepni miratimin tuaj kushtetues për Dekretin e Presidentit të Republikës Prof. Dr. Bamir Topi, të cilin gjej rast ta falenderoj për vlerësimin e lartë të treguar ndaj meje. Po ashtu, në hyrje të kësaj paraqitjeje, dëshiroj të falenderoj Grupin Parlamentar të PD-së dhe Kryeministrin Prof. Dr. Sali Berisha për mbështetjen sot në këtë proces dhe gjatë gjithë karrierës sime.

1. *Vizion koherent për KLSH, mbi bazën e eksperiencave më të mira të vendeve të BE-së dhe respektimit rigoroz të standarteve ndërkombëtare të kontrollit INTOSAI*

KLSH do ta formatojë punën, duke e organizuar atë sipas parimeve të deklaratave INTOSAI të Meksikos (2007) dhe të Johannesburgut (2010), sipas praktikave më të mira të institucioneve simotra në vendet më të përparuara të Bashkimit Europian dhe e mbështetur tërësisht në kornizën e plotë kushtetuese dhe ligjore të vendit.

Në punën e tij, KLSH mund dhe duhet të pasqyrojë pesë parimet kryesore të një qeverisjeje të mire: transparencën, përgjegjshmërinë, efikasitetin, pjesëmarrjen dhe koherencën në veprime. Për ta kryer këtë, KLSH mund dhe duhet të realizojë më fuqimisht standardet ndërkombëtare të kontrollit, si dhe Deklaratat më të fundit të miratuara nga INTOSAI në dy kongreset e saj në Meksiko 2007 dhe në Afrikën e Jugut 2010, duke thelluar përmbajtjen e deklaratës së Limës të vitit 1977.

Deklarata e Meksikos konsolidoi tetë parimet e pavarësisë së Institucioneve të Larta të Kontrollit si më poshtë:

- 1. Ekzistenca e një kuadri të përshtatshëm dhe efektiv kushtetues/statutor/ligjor dhe zbatimi de fakto i tij*
- 2. Pavarësia e drejtuesve dhe anëtarëve të Institucionit të Lartë të Kontrollit(SAI), duke përfshirë sigurinë e rezidencës dhe imunitetin ligjor në kryerjen normale të detyrave të tyre*
- 3. Një mandat mjaftueshmërisht të gjatë dhe liri e plotë në kryerjen e funksioneve të SAI*
- 4. Akses të pakufizuar ndaj informacionit*
- 5. E drejta dhe detyra të raportojnë në punën e tyre*
- 6. Liria për të vendosur për përmbajtjen dhe kohën e raporteve të auditimit dhe për t'i publikuar dhe shpërndarë ato*
- 7. Ekzistencën e mekanizmave efektivë që ndjekin rekomandimet e SAI*

8. *Autonomi financiare, menaxheriale/administrative dhe pasja e burimeve të duhura njerëzore, materiale dhe monetare.*

KLSH duhet të tregojë profesionalizëm dhe integritet në respektimin e këtyre standardeve ndërkombëtare bazë. Ai duhet të thellohet sidomos në zbatimin e kërkesave të Nenit 163 të Kushtetutës dhe në zbatimin e Parimit të Tretë të Deklaratës së Meksikos , i cili kërkon që SAI të fuqizohen për të kontrolluar:

- *përdorimin e parasë publike, të burimeve ose asetëve nga një mbajtës ose përfitues i tyre, pavarësisht nga natyra ligjore e tyre;*
- *mbledhjen e të ardhurave që duhet t'i shkojnë qeverisë ose institucioneve të tjera publike;*
- *ligjshmërinë dhe rregullsinë e llogarive të qeverisë ose institucioneve të tjera publike;*
- *cilësinë e menaxhimit dhe raportimit financiar; si dhe*
- *përdorimin e burimeve në mënyrë ekonomike, eficienten dhe efektivitetin e qeverisë ose institucioneve të tjera publike.*

Edhe FMN në Kodin e tij të Praktikave të Mira mbi Transparencën Fiskale në vitin 2007 kërkon që politikat dhe rolet menaxheriale të sektorit publik të jenë të qarta dhe të njohura nga publiku. “*Financat dhe politikat publike duhet gjithashtu të jenë subjekt i kontrollit nga një strukturë kombëtare auditimi, e pavarur nga ekzekutivi*” (Pika 4.3.1 e Kodit).

Nga ana tjetër, Marrëveshjet e Johaneshburgut (të njohura edhe si Deklarata e Afrikës së Jugut mbi Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Lartë) në Kongresin e nëntorit 2010 të INTOSAI janë njësoj të rëndësishme për KLSH-në, sepse përqëndrohen në vlerën dhe përfitimet nga Institucionet e Larta të Kontrollit, si dhe në sfidat e kohës. INTOSAI ka miratuar në këtë kongres një plan strategjik 2011-2016 me 6 përparësi:

1. *Siguro pavarësinë e Institucioneve të Larta të Kontrollit (SAI)*
2. *Zbato standardet ndërkombëtare të përmirësuara të miratuara në Kongresin e 2010-ës*
3. *Fuqizo ndërtimin e kapaciteteve të SAI*

4. *Trego vlerën dhe përfitimet nga SAI*

5. *Çoje më tej luftën kundër korrupsionit*

6. *Rrit komunikimin INTOSAI (mes vendeve anëtare)* “(Deklarata e Afrikës së Jugut, nëntor 2010),

përparësi të cilat i gjykoj se mund dhe duhet të jenë pjesë e planeve strategjike të KLSH-së për periudhën 2012-2018.

KLSH duhet të përsosë metodologjinë e punës së tij drejt realizimit të një metode auditimi të bazuar gjithnjë e më shumë në vlerësimin e riskut, ç’ka do të rriste eficiencën dhe do të kursente burimet që aktualisht shpenzohen gjatë auditimeve tradicionale. Ai duhet të përqëndrohet në kualifikimin dhe specializimin e audituesve të vet (specializim sipas llojeve të auditimeve dhe sipas sektorëve) duke përmirësuar trajnimin dhe duke vendosur një sistem të edukimit të vijueshëm në vendin e punës.

Kërkesat e Ligjit organik të Buxhetit dhe të Ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, si dhe ligje të tjera të cilat plotësojnë procedurat e administrimit të pronës shtetërore dhe të raportimit financiar, do ta fokusojnë më mirë punën e KLSH në vlerësimin e mënyrës së administrimit dhe të përdorimit të burimeve.

Duke vlerësuar, ashtu si dhe ju përpjekjet dhe punën e deritanishme të KLSH në zbatimin e planit të tij strategjik të zhvillimit 2009-2012, dëshiroj të theksoj se kërkesa e përmbajtur aty për rregullime të mëtejshme ligjore për sigurinë e kryetarit të KLSH-së, me arësytimin se nuk është i mbrojtur mjaftueshëm nuk qëndron. Në këndvështrimin tim, gjykoj se korniza kushtetuese dhe ligjore është tejet e përshtatshme dhe mbrojtëse për veprimtarinë e Kryetarit.

Në kuadër të fokusit të rritur të luftës kundër korrupsionit dhe në respektim të ndjeshmërisë dhe pritshmërive të opinionit publik, një nga veprimet e mija të para do të jetë kërkesa për dorëzimin e imunitetit si kryetar i KLSH.

Objektivat e paarrtura të Planit Strategjik 2009-2012 të KLSH-së do të mbarten në Planin e ri të Zhvillimit të KLSH-së 2012-2015, që do të ndërtohet

mbi përparësitë e rezolutave më të fundit të INTOSAI në Meksiko dhe në Afrikën e Jugut, duke realizuar Prioritetin e Tete te 12 Rekomandimeve të Komisionit European ndaj Shqipërisë, të përmbajtur në Progres Raportin e KE-së për vitin 2011 për thellimin e luftës ndaj korrupsionit, sipas të cilit “*kërkohet të tregohet një zbatim eficient i strategjisë dhe planit të veprimit antikorrupsion*” (Progres Raporti i KE-së për Shqipërinë 2011, f. 28).

Nga ana tjetër, Marrëveshja e Stabilizim Asocimit me BE shtron detyrën: “*Bashkëpunimi mes Palëve do të përqëndrohet në fushat prioritare që lidhen me legjislacionin e Komunitetit në fushat e kontrollit financiar të brendshëm publik (KFBP) dhe auditimit të jashtëm. Palët do të bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar një sistem efikas të KFBP (Kontrolli i Financiar i Brendshëm Publik) dhe sisteme të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuar botërisht si edhe me praktikat më të mira të BE-së*” (Neni 90 i MSA).

Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2012-2015 do të jetë produkt i një bashkëpunimi dhe diskutimi shumë të gjerë me ju anëtarë të Kuvendit, me të gjitha palët e interesit dhe mbi të gjitha, rrjedhojë e një diskutimi në publik, me publikimin e tij si draft në website-in e KLSH dhe në të gjitha rrjetet sociale.

Intensifikimi i përdorimit të metodave bashkekohore të teknologjisë së informacionit do të jetë një nga instrumentat bazë të rritjes së performancës së punës së KLSH dhe do të lehtësojë kontrollet e kryqëzuara të transaksioneve financiare.

2. Thellim i misionit të KLSH në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike

KLSH gjatë viteve të fundit është perpjekur të japë kontributin e tij për zbulimin dhe evidentimin e korrupsionit dhe abuzimeve në shumë nga institucionet shtetërore të kontrolluara. Megjithatë, të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se ai jo gjithmonë ka qenë i suksesshëm, si për dobësi të vete Institucionit, ashtu dhe për arsye të tjera. Në këtë aspekt, ngelet ende shumë për të bërë. Funkzioni parandalues i KLSH ndaj korrupsionit dhe abuzimit, nëpërmjet analizës së

riskut dhe kontrolleve të bazuara mbi këtë analizë, si dhe auditi i performancës kanë lënë gjithashtu shpesh herë për të dëshëruar. Për kushtet ku sot zhvillohet ekonomia jonë, mes presioneve të forta nga kriza dhe vështirësitë ekonomike të vendeve përreth, misioni parandalues ndaj korrupsionit dhe abuzimeve ndaj ekonomisë shtetërore merr një rol të rëndësishëm, duke ditur masën e madhe të dëmit që shkakton mashtrimi financiar dhe korrupsioni, si dhe fokusin që ka marrë sot lufta kundër korrupsionit. Luftën pa kompromis ndaj korrupsionit e shtron edhe parimi Nr. 5 (*Çojë më tej luftën kundër korrupsionit*) i Deklaratës së INTOSAI në Johaneshburg në vitin 2010, si dhe Rekomandimi Nr. 8 i Komisionit Evropian për integrimin e Shqipërisë. Kjo përpjekje ka përparësi edhe në vendet më të zhvilluara dhe demokratike të Europës. Kështu, sipas Zyrës Kombëtare të Auditit (NAO) në Britaninë e Madhe :”*Puna jonë me luftën ndaj mashtrimit financiar na lejon të përgatishim një perspektivë unike në uljen e kostos së korrupsionit për ekonominë e Britanisë së Madhe. Ne e vlerësojmë koston e korrupsionit dhe mashtrimit financiar në më shumë se 30 miliardë paund në vit. Ne inkurajojmë përhapjen e praktikave më të mira dhe një kuptim më të gjerë të rreziqeve të këtyre dukurive mbi ekonominë, si një mënyrë të punuari për të ulur dëmin që sjellin këto dukuri*”(NAO, Botimi “Praktika të mira në trajtimin e korrupsionit dhe mashtrimit financiar”, f. 4, 2008).

Konferenca Ndërkombëtare e Anti-Korrupsionit, e zhvilluar në Afrikën e Jugut 12 vite më parë (tetor 1999), hodhi bazat e një përafrimi efikas në punën parandaluese të institucioneve të auditit të lartë ndaj korrupsionit dhe abuzimeve. Në dokumentin e saj kryesor, të titulluar “Roli i Institucioneve të Auditit të Lartë në Luftën kundër Korrupsionit”, thuhet se :”*Institucionet e Auditit të Lartë (SAI) kanë dakort se është e vështirë të zbulosh format e shumta të korrupsionit, duke qenë se humbja dhe dëmi i Shtetit nuk del domosdoshmërisht në rregjistrat e llogarive ose në deklaratat financiare të subjektit që kontrollohet. Megjithatë, treguesit statistikorë dëshmojnë për një*

lidhje mes treguesve të ndryshëm të financave publike dhe nivelit të perceptuar të korrupsionit.

Prandaj dhe SAI bien dakort që ligjet dhe rregullimet, së bashku me kontrollin e duhur, mund të parandalojnë dhe zvogëlojnë mashtrimin financiar dhe korrupsionin. Shembuj të sektorëve veçanërisht të ekspozuar ndaj korrupsionit janë:

- mbledhja e taksave dhe e burimeve të tjera të të ardhurave;*
- administrimi i tenderave, prokurimeve dhe kontratave;*
- koncesionet, lejet dhe liçensat;*
- marrja në punë e personelit të administratës;*
- doganat; dhe*
- procesi i privatizimit (“Roli i Institucioneve të Auditit të Lartë në Luftën kundër Korrupsionit”, f. 4, 1999).*

KLSH duhet të thellojë analizën e vet të riskut në auditin financiar pikërisht në këta sektorë, duke e fuqizuar dhe e kombinuar rolin e tij luftues ndaj korrupsionit me rolin parandalues, të cilin duhet ta ushtrojë fuqimisht.

Magnus Borge, drejtor i Inisiativës së Zhvillimit të INTOSAI dhe botues i dokumentit të mësipërm, shprehet në qershor 2008 se “roli qëndror i SAI në luftën ndaj korrupsionit është promovimi i menaxhimit financiar të shëndoshë dhe inkurajimi i mekanizmave të fortë të kontrollit të brendshëm në strukturat publike. Në veçanti, sisteme të fuqishëm të menaxhimit financiar, të bazuar në raportimin financiar efektiv dhe në publikimin e çdo deviacioni kanë një efekt ndalues tek ata që tentojnë të kryejnë korrupsion”.

Sipas Konferencës Ndërkombëtare të Anti-Korrupsionit në Afrikën e Jugut, “Institucionet e Larta të Kontrollit (SAI) ndjekin disa praktika në identifikimin e fushave me rrezik të lartë korrupsioni dhe abuzimi, që nga rishikimi i punës së auditit të vitit të kaluar tek vlerësime sistematike të dobësisë së programeve, projekteve apo institucioneve, të bazuara nga histori abuzimi të së kaluarës, nga dobësia menaxheriale ose nga denoncimet e mediave. Këto dy përafrime përfaqësojnë koncepte të ndryshme të vlerësimit të riskut. Në përafrimin e

parë, programet, projektet dhe institucionet renditen me risk të ulët, të mesëm dhe të lartë për të përcaktuar një plan auditë. Kjo i lejon institucionit të auditit superior të alokojë burime tek institucioni apo programi vulnerabël, duke ndërtuar edhe procedura auditë shtesë, nëse do të ishte e nevojshme. Pothuajse gjithnjë auditimet në subjekte me risk të lartë kanë identifikuar aktivitet korruptiv dhe abuziv domethënës.

Përafrimi i dytë përqëndrohet në sektorë e fusha veprimtarie, më shumë se sa në institucione e projekte të veçanta qeveritare dhe shtetërore. Ai bëhet baza e një strategjie për të targetuar sektorin që u jep një kërcënim të fortë burimeve publike dhe për të synuar pakësimin ose eliminimin e këtij kërcënim” (Magnus Borge, “Roli i Institucioneve të Auditit të Lartë në luftën ndaj korrupsionit”, dokumente përmbledhëse të Konferencës Ndërkombëtare të Anti-Korrupsionit në Afrikën e Jugut, f. 16, 1999).

Mendoj se këto përafrime kanë vlerë aktuale për veprimtarinë e KLSH dhe duhet të përqëndrojnë vëmendjen e stafit të saj. Lufta ndaj korrupsionit dhe roli parandalues i KLSH- ndaj veprimeve korruptive dhe abuzive me pronën shtetërore do të jenë politika dhe veprime qëndrore në Strategjinë e zhvillimit të institucionit 2012-2015, vijim i strategjisë së tanishme 2009-2012, duke përsosur metodologjinë e kontrollit.

Këtëj e tutje, çdo pozicionim jo i mirë i Shqipërisë në renditjen e vendeve që luftojnë korrupsionin nga organizata Transparency International do të konsiderohet edhe si punë e rezultate të dobëta të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

3. Kthim i vëmendjes tek auditë i performancës, krahas konsolidimit të auditit financiar

Deri tani në punën e KLSH ka preluar auditë financiar, duke u përqëndruar me shumë në kontrollin e mbajtjeve të llogarive dhe në disiplinën financiare, pa konsideruar me përparësi treguesit e efektivitetit, efikasitetit dhe rezultatin ekonomik të institucionit shtetëror objekt i kontrollit.

Sipas INTOSAI, auditë i performancës përkufizohet si

“(a) auditi i përdorimit ekonomik të burimeve në aktivitetet administrative, në përputhje me parime dhe praktika administrative të shëndosha, si dhe me politikat menaxheriale të duhura

(b) auditi i efikasitetit të përdorimit të burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe të burimeve të tjera, duke përfshirë ekzaminimin e sistemeve të informacionit, treguesve të performancës dhe të sistemit të monitorimit, dhe

(c) auditi i efektivitetit të performancës në lidhje me përmbushjen e objektivave të subjektit të kontrolluar, si dhe auditi i impaktit aktual të aktiviteteve, i krahasuar me impaktin e synuar”(INTOSAI, “Manual Zbatimi për Auditin e Performancës”, f. 3, 2004)

Sipas eksperiencës britanike, *“matja e performancës është kuptimi i asaj çfarë marrim për paranë që shpenzojmë. Punonjësi, auditori i performancës duhet të jetë i gatshëm të ndihmojë kolegët e institucionit qeveritar që kontrollojnë për t’i orientuar në:*

- zhvillimin e planeve dhe treguesve të performancës
- përmirësimin e cilësisë së të dhënave
- rregjistrimin e performancës dhe raportimin ndaj drejtuesve dhe publikut
- përdorimin e masave të performancës për të përmirësuar apo motivuar performancën
- lidhjen e performancës me vendimet e alokimit të burimeve
- kryerjen e vlerësimeve organizative (Manual i NAO “Matja e performancës qeverisëse, 2010”, f. 28, qershor 2010).

Sipas z. Amyas Morse, kryetar i Zyrës Kombëtare të Auditit(NAO), Britani e Madhe, *“Matja e performancës së qeverisë është jetësore. Tregon nëse taksapaguesi po merr vlerë për paranë dhe i lejon njësitë qeveritare të mësojnë nga eksperiencia dhe të përmirësojnë performancën. Çdo tregues matjeje performance duhet të jetë i qartë, i matshëm dhe drejt për së drejti i lidhur me burimet e përdorura për të siguruar shërbimet apo produktet e performancës”* (nga fjala e z. Morse mbajtur më 14 korrik 2010 përpara Dhomës së Lordëve).

Ky aspekt i matjes së performancës së institucioneve që kontrollojnë mund të shndërrohet në dobinë kryesore të punës së KLSH, krahas parandalimit të korrupsionit dhe abuzimeve. Ndarja e detyrave në të mund të çojë në të ardhmen e afërt dhe në një specializim të një pjese të inspektorëve të KLSH në auditues performance, ku roli korrigjues, orientues dhe këshillues mbizotëron.

Auditimi nëse aktivitetet administrative janë bërë **në mënyrë ekonomike** ka për qëllim të vlerësojë nëse ato janë në pajtim me parimet bazë dhe praktikat me të mira të administrimit dhe në pajtim me politikat e pranuar të drejtimit në ekonomi.

Auditimi **i efijcences**, ka për qëllim të vlerësojë përdorimin eficient të burimeve financiare dhe burimeve të tjera; ai përfshin edhe ekzaminimin e sistemeve të informacionit, vlerësimin e matësve të performancës dhe sistemet e monitorimit dhe procedurat që duhet të ndjekin entitetet e audituara për të korrigjuar mangësitë e vërejtura.

Auditimi **i efektivitetit** ka për qëllim të vlerësojë efektivitetin e performancës në lidhje me arritjen e objektivave të entitetit të audituar dhe gjithashtu, edhe ndikimin (impaktin) aktual të aktiviteteve krahasuar me ndikimin e parashikuar. Auditimi i performancës nuk është një auditim i rregullt (pra që kryhet me procedura e standarde të përcaktuara) dhe që përfundon me një opinion të formalizuar. Rrënjët e tij nuk lidhen me auditimin e entiteteve private. Ai konsiderohet një ekzaminim i pavarur që nuk bëhet mbi një bazë që ripërseritet. Për nga natyra, ky auditim është më i gjerë dhe i hapur për gjykime dhe interpretime. Në dispozicion të tij ka një varg metodash të zgjedhjes për investigimin dhe vlerësimin dhe nga ana tjetër ai kërkon një varietet të madh të njohurive, krahasuar me ato që kërkohen për auditimin tradicional.

Thënë ndryshe, auditimi i performancës i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike, e cila nënkupton faktin që individët që janë

përgjegjës për zbatimin e programeve qeveritare ose drejtimin e ministrive kanë përgjegjësinë për drejtimin e tyre me efektivitet dhe efikasitet.

Auditimi i performancës është një mënyrë për ushtrimin e kontrollit dhe marrjen e informimit mbi mënyrën e drejtimit dhe rezultatet e aktiviteteve të ndryshme qeveritare nga veprimtarët kyçë, ku përfshihen: taksapaguesit, Parlamenti, drejtuesit ekzekutivë, qytetarët e zakonshëm, shoqëria civile dhe media.

Auditimi i performancës shërben për t'ju dhënë përgjigje pyetjeve si : A merret shërbimi më i mirë nga paratë e shpenzuara? A është e mundur që paratë të shpenzohen më mirë ose në një mënyrë më të zgjuar?

Auditimi i performancës është i lidhur ngushtë me mirëqeverisjen. Kriteri kryesor i qeverisjes së mirë është pikërisht fakti që të gjitha shërbimet publike (ose programet qeveritare) t'i nënshtrohen auditimit.

KLSH është përpara një sfide të fortë për ta përqëndruar punën tek auditimi i performancës, pse ai i shërben vleresimit të përgjegjshmërisë publike. Përqëndrimi i vëmendjes tek auditimi i performancës do të jetë ndër shtyllat kryesore të planit të ri strategjik 2012-2015 të KLSH. Në të, manuali i auditimit të performancës do të zbatohet jo thjesht si një procedurë , por do të konceptohet si një filozofi e të menduarit dhe vepruarit nga i gjithë stafi i KLSH. Një filozofi pune që konsideron se kontrolli nuk është një qëllim në vetevetë, por në rradhë të parë një instrument parandalimi ndaj korrupsionit dhe abuzimit me pronën shtetërore, një instrument korigjimi dhe këshillimi të institucionit që kontrollohet. Së bashku me audituesit e brendshëm të institucioneve shtetërore, në bazë të Ligjit Nr. 9720 dt. 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” , si dhe me inspektorët financiarë publikë të Ministrisë së Financave, në bazë të Ligjit Nr. 10294 dt. 01.07.2010 “Për Inspektimin Financiar Publik”, KLSH do të koordinojë punën e auditit financiar, për të mos patur dublime të panevojshme, duke u përqëndruar vetë si institucion tek auditimi financiar, dhe shumë herë më tepër se sa tani, tek auditimi i performancës.

4. Realizim i sinergjizimit të politikave dhe veprimeve me strukturat e tjera shtetërore të së njëjtes fushe, si me Departamentin e AntiKorrupsionit pranë Kryeministrit, me Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit dhe me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe, në veçanti me Prokurorinë e Shtetit, duke ruajtur pavarësinë e KLSH si organi më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar

Praktika e deritanishme ka dëshmuar se KLSH ka humbur efikasitetin e ndërhyrjeve të tij në rastet kur ka vepruar i vetëm, ose kur e ka konceptuar veprimtarinë e tij veçmas nga institucionet e tjera të ngjashme me të. Prej kohësh tashmë ka lindur nevoja e një bashkëveprimi konkret dhe intensiv me struktura shtetërore që kryejnë detyra të afërta me një pjesë të detyrave të KLSH, si Departamenti për Luftën ndaj Korrupsionit në Këshillin e Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit dhe Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave, apo edhe që vijojnë punën pas propozimeve të KLSH, sikurse është Prokuroria e Shtetit, si organ qëndror i akuzës së Shtetit.

Strategjia Anti-Korrupsion 2008-2013 e qeverisë Berisha kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuara dhe pikërisht: *“Shkëmbimin e informacionit, jo vetëm ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, por të çdo organi shtetëror që luan rol dhe ka përgjegjësi në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, i cili synon shkëmbimin e informacionit jo si pjesë e detyrimit e përgjegjësisë ligjore e institucionale të zakonshme, por mbi baza funksionale, proaktive dhe me periodicitet më të shpejtë* “(f. 16, Strategjia Ndërsektoriale e Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013) .

Duhet theksuar se KLSH nuk i cënohet pavarësia kur sinergjizon politikat dhe veprimet e tij me institucionet e lartpërmendura. por përkundrazi i rritet efektiviteti dhe eficientia e tij, në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese.

Unë, në rast se votëbesohem nga Ju, do të propozoj dhe të kërkoj menjëherë realizimin e një bashkëveprimi institucional, nëpërmjet Memorandumeve të Bashkëpunimit me të katër strukturat e lartpërmendura. Për këtë ekziston baza ligjore e duhur. Për shembull, Neni 26 i Ligjit Nr. 9720 dt. 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” e kërkon shprehimisht bashkëpunimin me KLSH, si dhe po ashtu edhe Neni 8, pika “d” e Ligjit Nr. 10294 dt. 01.07.2010 “Për Inspektimin Financiar Publik”.

Në këto marrëveshje, krahas shkëmbimit reciprok të informacionit, nëse do të gjykohet në dobi të punës, mund të planifikohen dhe ndërhyje e kontrole të përbashkëta (sidomos për tre strukturat e para), për të rritur efektivitetin dhe eficiencën e auditit.

Një përjasje e tillë është një praktikë pune e hasur dëndur në vendet më të zhvilluara të BE-së anëtare të INTOSAI (p.sh., Zyra Kombëtare e Auditit në Britaninë e Madhe për parandalimin e korrupsionit dhe mashtrimit financiar bashkëpunon me Autoritetin Kombëtar të Parandalimit të Mashtrimit Financiar dhe me Komisionin Britanik të Auditit. Të njëjtin bashkëpunim realizon Bundesrechnungshof-i gjerman, organi suprem i auditit në Republikën Federale të Gjermanisë, me gjykatat rajonale gjermane).

Një bashkëpunim i veçantë lypset të jetë ai i KLSH me organin e Prokurosisë së Shtetit, duke parë rastet shumë të rralla të deritanishme, kur denoncimet dhe rekomandimet e KLSH kanë gjetur jehonë në punën e Prokurorisë. Një akt-marrëveshje, një memorandum bashkëveprimi me këtë institucion do t'i hapte rrugë jo vetëm thellimit të njohjes reciproke mes të dyja institucioneve, por edhe kuptimit më të mirë të natyrës së punës së njëra-tjetres dhe rritjes së informacionit dhe kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit. Shpesh mungesa e informacionit dhe e komunikimit në nivelet e duhura, ka bërë të dështojnë përpjekjet për bashkëpunim. Ju garantoj se nëse ka ndonjë draft apo marrëveshje me Prokurorinë, ai do të çpluroset dhe do të marrë formën e duhur të një bashkëpunimi konkret dhe intensiv në të ardhmen e afërt. Nëse nuk ka, kjo marrëveshje do të jetë ndër veprimet e para që do të ndërmerren.

Nga ana tjetër, rezultatet e kontroleve të kryera nga grupe të përbashkëta me institucionet e lartpërmendura, ose të mbikqyrura apo konfirmuara nga ekspertë të institucioneve paralele janë të mirëpritura dhe pse mbartin një peshë më të madhe në publik dhe japin mesazhin e fuqishëm të angazhimit të përbashkët të të gjitha strukturave shtetërore për luftën ndaj korrupsionit dhe abuzimeve me administrimin e pronës shtetërore.

5. Intensifikim i konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH 2011-2018, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj Kuvendit, si një detyrim kushtetues

Në zbatim të neneve 162 dhe 164 të Kushtetutës dhe të detyrave të lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë dt. 02.06.2011 për konsolidimin e bashkëpunimit me Kuvendin, në përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, në përmirësimin e administrimit të vlerave materiale e monetare dhe rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të institucionit, KLSH do të organizojë dhe mbajë gjithnjë operativ një kalendar takimesh e konsultimesh me përfaqësues të Kuvendit, sidomos me Ju, anëtarë të Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Bazuar në përvojën tuaj si legjislatorë dhe profesionistë të fushës, KLSH do t'ju adresohet në vijimësi për ide dhe sugjerime lidhur me përpilimin dhe zbatimin e planit të tij strategjik të zhvillimit 2012-2015. Ky plan do të vlerësojë përpjekjet e Planit Strategjik 2009-2012 në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor, të përsosjes së metodologjisë së kontrollit, të rritjes së burimeve njerëzore dhe të mbështetjes administrative, përfshirë teknologjinë e informacionit, por do të thellohet në rekomandimet e kongreseve të fundit të INTOSAI, të cilat mendoj se nuk njihen sa duhet(duke u nisur dhe nga pasqyrimi në website-in e KLSH).

Në zbatim të detyrimit kushtetues, KLSH do të shërbejë tërësisht si struktura numër një dhe më e besueshme e informimit të Kuvendit për mirëadministrimin e pronës shtetërore, si për shumicën ashtu dhe për pakicën

parlamentare, nëpërmjet raporteve periodike të saj dhe takimeve e konsultimeve të herëpashershme me anëtarët e Kuvendit, por sidomos të Komisionit tuaj. Informimi kushtetues dhe ligjor ndaj Kuvendit do të shtrihet me efikasitet dhe profesionalizëm edhe drejt publikut.

6. Intensifikim i bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademikë të auditit të financave publike, si dhe me organizata të kontabilitetit dhe të fushave të tjera të ekonomisë

Mbështetur në nenin 15 të Ligjit organik të KLSH-së, i cili shprehet se ky institucion mund të kontraktojë ekspertë të përkohshëm. KLSH, për vetë sfidat që e presin ka nevojë të grumbullojë pranë vetes ekspertizën më të mirë të fushës, duke forcuar lidhjet dhe madje duke i vendosur ato në baza institucionale me organizatat e kontabilistëve, me ekspertët dhe profesoratin e financave publike në universitetet kryesore të vendit dhe me akademikët e kësaj fushe. KLSH duhet të ketë lidhje dhe të zhvillojë konsultime të herëpashershme për veprimtarinë e saj me IEKA dhe me organizatat e tjera profesionale të fushës. Kjo nuk përbën aspak nënvleftësim ndaj ekspertizës së vetë institucionit, por do të jetë në dobi të rritjes së profesionalizmit të stafit të KLSH, për të përballuar me efikasitet auditet e rëndësishme, në veçanti atë të performancës.

Bashkëpunimi mund të jetë shumëformësh, duke i ftuar këta ekspertë si lektorë në trajnimet e stafit të KLSH, duke i angazhuar në grupet e kontrollit, apo në kontrollet e performancës së sektorëve të caktuar të ekonomisë, me risk të lartë, si dhe për testimin e vetë stafit të KLSH. Ekspertiza e ftuar prej tyre ka vlerë si mendim i pavarur dhe i një niveli të lartë profesional.

Një përjasje të tillë e rekomandon edhe FMN në Kodin e tij të Praktikave të Mira mbi Transparencën Fiskale (Pika 4.3.4 faqe 4 e Kodit), kur thotë se “ekspertë të pavarur duhet të ftohen për të vlerësuar parashikimet fiskale...”.

Sfidat e reja e bëjnë të domosdoshëm rritjen e kapaciteteve të audituesve të KLSH. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se niveli i tyre profesional nuk është ai i duhuri, pavarësisht nga përpjekjet e bëra, duke u nisur që nga viti 1992.

7.Intensifikimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e larta të kontrollit të vendeve të BE-së, të vendeve të rajonit dhe në veçanti me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës

Deklarata e Johannesburgut(2010) e INTOSAI i ka kushtuar një pikë të veçantë të saj(pika 6) bashkëpunimit mes Institucioneve Supreme të Auditit të vendeve anëtare. Është për t'u vlerësuar bashkëpunimi i deritanishëm i KLSH me Zyrën Kombëtare të Auditit në Britaninë e Madhe dhe me Gjykatën Hollandeze të Auditit në përgatitjen e planeve strategjike. Ky bashkëpunim duhet vijuar dhe thelluar edhe më tej, në formën e vizitave të shkëmbimit të eksperiencës dhe/ose të trajnimeve që ekspertë të SAI të këtyre vendeve dhe të shteteve të tjera të zhvilluara në BE, ose të Komitetit të Trajnimeve në EUROSAI, mund të zhvillojnë për stafin e KLSH.

Do të intensifikohen kontaktet dhe mundësitë e bashkëpunimit me Institutin e Zhvillimit të INTOSAI dhe me strukturat e EUROSAI, sidomos për luftën kundër korrupsionit. Do shihen mundësitë e bashkëpunimit me Gjykatën Europiane të Audituesve, e cila mbikqyr auditin e jashtëm të vendeve të BE-së, sidomos për rritjen e nivelit të audituesve të performancës.

Gjykata ka fuqinë të kontrollojë çdo person ose organizatë që përdor fonde të Bashkimit Evropian, duke përfshirë autoritetet kombëtare në vendet anëtare të BE, institucione të tjera të BE dhe madje edhe vende të tjera jashtë BE që përfitojnë nga fondet e BE. Sipas Vitor Caldeira, President i Gjykatës Europiane të Auditoreve, *“Gjykata kryen audite, nepermjet te cilave ajo vlereson mbledhjen dhe shpenzimin e fondeve te BE-se. Ajo ekzaminon nese veprimet financiare jane rregjistruar si duhet dhe deklaruar, nese ato jane kryer ne menyre ligjore dhe ne baze te rregullave dhe nese jane menaxhuar per te siguruar perdorimin me ekonomi te fondeve, eficiencen dhe efektivitetin e tyre. Gjykata promovon pergjegjesine dhe transparencen duke ndihmuar Parlamentin European dhe Keshillin e Europes qe ata te mbikqyrin zbatimin e buxhetit te BE-se...Ajo i sjell vlere te shtuar menaxhimit financiar te BE-se*

nepermjet raporteve dhe opinioneve te saj. ...Kjo Gjykate njihet per integritetin dhe paanesine, per profesionalizmin, eficiencyn dhe cilesine e auditimeve dhe opinioneve te saj...Hyrja ne fuqi e Traktatit te Lizbones riafirmoi mandatin e Gjykates dhe statusin si nje institucion qendror i BE-se”(nga fjala e miresearchjes ne website te Gjykates, 2010).

Gjykata Europiane e Auditoreve, krahas raporteve të saj të kontrollit financiar, jep mendime dhe rreth legjislacionit financiar të BE dhe veprimit të BE për të luftuar korrupsionin dhe mashtrimin financiar, duke bashkëpunuar me Zyrën Evropiane të Antikrimit Financiar.

Në rajon, KLSH do të zhvillojë më tej kontaktet rajonale me strukturat homologe të rajonit, si dhe do të thellohet marrëdhënia me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës(deri tani në website-in e KLSH gjendet vetëm një vizitë e kësaj Zyre në mars 2008), duke dhënë dhe shkëmbyer eksperiencë, si dhe duke kryer trajnime të përbashkëta. Mendoj se krahas marrjes së eksperiencës nga SAI të vendeve më të zhvilluara të BE-së dhe nga ato të vendeve të rajonit, kemi shumë për të bashkëpunuar reciprokisht me strukturën e re të auditit suprem të Kosovës.

8, *Zhvillim i burimeve njerëzore të KLSH në nivelin e parametrave të kërkuar nga standardet e INTOSAI(Rezoluta e Meksikos 2007 dhe e Afrikes se Juqut 2010) dhe në përputhje me sfidat për të luftuar me efikasitet korrupsionin*

Rezoluta e Kryetarëve të Institucioneve të Auditit Suprem të vendeve të Evropës Qëndrore dhe Lindore, si dhe të Gjykatës Europiane të Auditorëve në takimin e tyre në Pragë në tetor 1999, në Rekomandimin e saj të Shtatë shprehet: *“Institucionet e Larta të Kontrollit(SAI) duhet të sigurojnë se burimet e tyre njerëzore dhe financiare përdoren në mënyrë eficiente për të mundësuar ushtrimin më efikas të mandatit të tyre. Për këtë qëllim, SAI kanë nevojë të zhvillojnë dhe institucionalizojnë politika dhe masa të duhura për të garantuar që Institucioni i Auditit të Lartë të jetë tërësisht i organizuar për të prodhuar punë auditit dhe raporte efektive profesionale dhe të një cilësie të lartë”*

Cilësia dhe profesionalizmi do të jenë fjalët kyçe të punës së çdo anëtari të stafit të KLSH, mbas integritetit dhe pavarësisë. Audituesi i KLSH do t'i largohet klishesë së gjobvënësit apo deklarimeve për bujë, një formatim ky i hasur shpesh, për fat të keq, në të shkuarën. Ç'ka është më e rëndësishme, KLSH do t'i largohet "zbulimeve" të shpërdorimeve hipotetike. Çdo nëpunës i KLSH do të vlerësohet për punën e tij/saj mbi kritere të sakta dhe të qarta profesionale dhe integrale, duke respektuar kërkesat e Ligjit Nr. 8549 dt. 11.11.1999 "Për Statusin e Nëpunësit Civil", Ligjin 9131 dt. 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike" dhe Ligjit Nr. 9367, dt 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike".

Do të realizohet përshkrimi i ri i punës së secilit, i bazuar mbi standardet INTOSAI për punonjësit e institucioneve supreme të auditit, të përmbajtura në dy Deklaratat e fundit Meksiko 2007 dhe Johannesburg 2010, me synimin e sigurimit të audituesve dhe nëpunësve me integritet të lartë moral dhe profesional, të varur vetëm nga Kushtetuta, ligji dhe Kodi i Etikës i KLSH.

Në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë së Universitetit të Tiranës dhe me universitetet e tjera të vendit, KLSH do të organizojë një konferencë vjetore për të sjellë mendimin më të avancuar në fushën e auditit financiar dhe atij të performancës, mbi bazën dhe të eksperiencave konkrete, duke promovuar specialistët më të zotë dhe rezultativë të tij.

Mbi bazën e Nenit 20 të Ligjit organik të KLSH për trajnimin e audituesve, të gjithë audituesit e institucionit do të trajnohen në vijimësi për të përmbushur detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe duhet ta gjejnë veten në respektimin rigoroz të standarteve të etikës së audituesit dhe të standardeve ndërkombëtare INTOSAI.

9.Përmirësim i transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse që luftojnë korrupsionin

Sipas Magnus Borge, Drejtori i Institutit të Zhvillimit të INTOSAI, roli luftues dhe parandalues ndaj korrupsionit për SAI rritet shumë dhe me bashkëpunimin e tyre efikas me mediat. *“SAI mund të luajnë një rol të madh në luftën ndaj korrupsionit, duke komunikuar dhe bërë publike rreziqet e korrupsionit dhe rastet e praktikave korruptive, kur këto janë identifikuar. Ky rol përfshin rritjen e ndërgjegjësimit publik për rëndësinë e transparencës dhe të përgjegjësisë së mbajtjes së llogarive, duke prodhuar raporte auditi me vlerë dhe në kohën e duhur, të cilat aksesohen nga publiku* (‘‘Roli i SAI në luftën kundër korrupsionit’’, broshurë e përbashkët e INTOSAI me Transparency International, 2008). Borge po ashtu vëren se disa SAI kanë vendosur lidhje me mediat për të deklaruar në publik rastet e mashtrimit financiar dhe korrupsionit.

Ky përafrim duhet të jetë në fokus të punës së përditshme të KLSH me mediat dhe organizatat jo-fitimprurëse që luftojnë korrupsionin. KLSH ka nevojë të fitojë akses në publik dhe për këtë i duhet:

- a) të transformojë rrënjësisht faqen e saj në internet, duke vendosur lidhje(links) me strukturat e tjera shtetërore që luftojnë korrupsionin dhe pse jo, dhe me OJF-të aktive në këtë fushë;
- b) të furnizojë periodikisht me informacion rrjetet e mediave elektronike dhe të shtypit të përditshëm, të interesuara për mirëmenaxhimin e pronës publike
- c) të bashkëpunojë si partner në botimin e revistave profesionale të fushës, duke kontribuar me kumtesa dhe ese nga anëtarët më aktivë të stafit të tij
- d) të rrisë aksesin e buletinit periodik të KLSH në aktorët kryesorë të opinionit publik, si mediat, opinionistët dhe OJF-të e angazhuara kundër korrupsionit dhe/ose të interesuara për bashkëpunim.

KLSH ka nevojë parësore për një investim të plotë në kuptimin e tërësishëm nga publiku të misionit të tij dhe të aktiviteteve që kryen, si dhe në përmirësimin e imazhit aktual. Për këtë do të përgatisim një strategji

komunikimi 2012-2015, që të synojë rritjen e aksesit dhe kuptimin e plotë në publik të misionit dhe rolit të KLSH si luftues dhe parandalues i korrupsionit dhe i abuzimeve me pronën shtetërore, si dhe të rolit të tij orientues dhe ndreqës në performancën e institucioneve publike që kontrollon. Një strategji e tillë do të pajiset me një plan konkret veprimi 2012-2015, duke mundësuar tryeza të rrumbullakta informacioni dhe konsultimi me OJF-të që luftojnë korrupsionin dhe/ose të interesuara për bashkëpunim, si dhe me mediat, etj.

DEKRET

PËR

PROPOZIMIN E KRYETARIT TË KONTROLLIT TË LARTË TË

SHTETIT

Në mbështetje të neneve 162, pika 2 dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 11 të ligjit 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar,

DEKRETOJ

Neni 1

Z. Bujar Leskaj i propozohet Kuvendit për t'u zgjedhur Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 2


Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Nr. i dekretit 7163

Tiranë, më 17 nëntor 2011

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

BAMIR TOPI



Shënim 1: Kandidati Bujar Leskaj u votua në Kuvendin e Shqipërisë më 15 Dhjetor 2011. Rezultati : me **70** vota Pro, **61** kundër, **3** abstenime



Në përputhje me nenin 6 të ligjit Nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” (i ndryshuar) me datë 22 dhjetor 2012, Kryetari i KLSH-së betohet para Kuvendit të Shqipërisë.



Shënim 2: Ky material u punua më 23 dhjetor 2011 me audituesit e KLSH nga Bujar Leskaj, në ditën e parë në detyrë si Kryetar i KLSH.

EKSPERIENCA E PËRBASHKËT U SHËRBEN TË GJITHËVE*

Të nderuar bashkëpunëtorë të KLSH,

Të nderuar përfaqësues të medias,

Pas zhvillimit gjatë javës të analizave të departamenteve, sot jemi mbledhur për të zhvilluar analizën vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2011.

Vitin që porsa përfundoi, duke respektuar punën e të gjithë



kontrollorëve të KLSH, e vlerësoj një vit pune në zbatim të rekomandimeve të Rezolutës së 2 qershorit 2011 të Kuvendit të Shqipërisë dhe të objektivave të Planit të tij Strategjik të Zhvillimit 2009-2012. Gjatë këtij viti, KLSH ka kryer 152 kontrolle, ku janë konstatuar shkelje financiare me dëm të

konsiderueshëm ekonomik dhe ka rekomanduar shpërblimin e këtij dëmi ekonomik në nivel të lartë financiar në arkën e Shtetit. Janë propozuar 1,605 masa korigjuese administrative, nga të cilat 1,108 janë zbatuar. Nga 720 masa disiplinore dhe administrative të rekomanduara, janë zbatuar 536 prej tyre. Përgjithësisht më duhet të pohoj se janë masa relativisht të lehta. Gjithashtu, KLSH ka kryer kallzim penal gjatë vitit 2011 pranë organeve të Prokurorisë në 6 raste dhe për 13 persona.

Pak! Shumë pak! Dobët për të gjithë ne.

Vlerësoj se stafi i institucionit është përpjekur të zbatojë Rregulloren e tij të Brendshme, Standardet e Kontrollit të KLSH, Metodikat, Manualet e Auditimit

Financiar e të Performancës dhe Kodin Etik, si dhe është përpjekur, por pa ia arritur, për implementimin e standardeve të përditësuara të INTOSAI.

Më pas, z. Robert Gjini, Drejtor i Përgjithshëm i KLSH do t'ju paraqesë një raport më të plotë rreth veprimtarisë së kryer nga institucioni i KLSH gjatë vitit 2011. Gjithashtu, Drejtorët e Departamenteve do të realizojnë një përmbledhje jo vetëm të punës njëvjeçare, por edhe të analizës së zhvilluar në departamente. Kryekontrollorët dhe kontrollorët besoj do të flasin në këtë analizë.

Është e natyrshme dhe frytdhënëse që puna e të shkuarës të analizohet me realizëm dhe objektivitet, duke vlerësuar dhe marrë me vete në të ardhmen kontributet dhe produktet më cilësore, të cilat nuk kanë munguar në KLSH. Kjo strukturë e kontrollit më të lartë ekonomiko-financiar të Shtetit ka qenë drejtuar përgjatë dy dekadave të fundit nga personalitete të jetës politike dhe ekonomike të vendit, si zotërinjtë Alfred Karamuço, Ylli Memisha, Blerim Çela, Mustafa Kërçuku dhe Robert Çeku, të cilët gjej rastin t'i falenderoj për kontributin e dhënë. Dua të falenderoj po ashtu në mënyrë të veçantë anëtarët e Panelit Drejtues të kësaj Analize Vjetore, inspektorët e nderuar të KLSH: Zyra Kepi, Rustem Tare, Fatos Gjyrezi, Rasim Hoxha, Bashkim Spahia dhe Irena Kokona, të cilët në gjithë këto vite kanë kontribuar për institucionin dhe në këtë vit janë në përmbyllje të kontributit të tyre, për arsye moshe.

Mirëpo, mbi të gjitha duhen evidentuar edhe mangësitë apo mosrealizimet, me qëllim që projektimi i të ardhmes të përfshijë plotësimin e mangësi dhe përmirësimin cilësor të punës.

Megjithë përpjekjet e stafit për të realizuar planin e auditimeve dhe detyrat e vëna në sasi, jemi të ndërgjegjshëm se cilësia e punës ka lënë për të dëshiruar. Audituesit në jo pak raste janë mjaftuar me dokumentacionet e ofruara nga subjektet e kontrolluara dhe ka munguar vullneti ose aftësia profesionale në zbulim të mashtrimit financiar dhe korrupsionit. Kontrollat më tepër janë kryer formale dhe sa për të plotësuar numrin. Kjo është dhe arsyeja

kryesore e një numri shumë të ulët të kallëzimeve penale për vitin e kaluar, numër i cili duhet theksuar se në vijimësi ka qenë i ulët gjatë viteve të fundit.

Bashkëpunimi me organet e Prokurorisë në ndjekjen e kallëzimeve penale nuk ka qenë në nivelin e kërkuar, megjithëse kemi një marrëveshje ndërmjet të dy institucioneve, të nënshkruar në vitin 2005, e cila ende nuk është bërë efektive, për pasojë të punës sonë të dobët dhe nënvleftësimin apo injorimit të Prokurorisë.

Po ashtu, me shqetësim duhet të konsiderohet fakti se niveli i realizimit të rekomandimeve të KLSH për shpërblimin e dëmit të konstatuar në organet tatimore dhe doganore ka një përqindje mjaft të ulët (vetëm 9 përqind), ose nga 183 milionë lekë rekomanduar për shpërblim të dëmit, janë nxjerrë urdhrat përkatës për vetëm 16 milionë lekë.

Ne do t'i analizojmë më mire këto raporte, duke qenë institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar, por asnjëherë duke tejkaluar kompetencat tona, për të kontrolluar subjektet private.

Duke vlerësuar punën gjatë vitit 2011, analizat vjetore të departamenteve në këtë muaj të parë të vitit 2012 dhe përpjekjet e shumta prej jush në auditimet e kryera dhe në raportimet e dhëna, më duhet të pohoj se kemi ende shumë për të bërë, për të qenë konform standardeve ndërkombëtare të auditimit, sidomos me Strategjinë e INTOSAI për vitet në vazhdim (2011-2016), të titulluar "Për promovimin e përgjegjshmërisë, transparencës dhe qeverisjes së mirë". Kjo strategji, e miratuar në Kongresin e INTOSAI në Johannesburg në vitin 2010 përmban objektivin e "Vazhdimin të luftës ndaj korrupsionit".

Ky vit është viti pararendës i 60 vjetorit të themelimit të INTOSAI dhe në këtë vigjilje, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara shpalli më 22 dhjetor 2011 Rezolutën e saj "Për promovimin e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike duke fuqizuar institucionet e auditimit suprem", ku në pikën 5 të saj thuhet "Asambleja inkurajon Shtetet Anëtare dhe institucionet përkatëse të Kombeve të

Bashkuara që të vazhdojnë dhe të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre, duke përfshirë në ngritjen e kapaciteteve INTOSAI-n, në mënyrë që të promovohet qeverisja e mirë, duke siguruar efikasitet, përgjegjshmëri, efektivitet dhe transparencë nëpërmjet forcimit të institucioneve përgjegjëse të kontrollit” (Rezoluta A/66/209, faqe 1),

Krahas rekomandimit të sipërcituar të INTOSAI dhe Rezolutës së Kombeve të Bashkuara , orientim për sinergjizimin e përpjekjeve tona për parandalimin e korrupsionit, ndëshkimin e tij apo për propozimet për përmirësime aktesh ligjore e nënligjore do të përbëjë dhe Strategjia Ndërsektoriale e Qeverisë Berisha e “Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe e Qeverisjes Transparente 2008-2013”. Referuar kësaj Strategjie, dua të citoj: “Shkëmbimi i informacionit jo vetëm ndërmjet agjensive të zbatimit të ligjit, por të çdo organi shtetëror që luan rol dhe ka përgjegjësi në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, i cili synon shkëmbimin e informacionit jo si pjesë e detyrimit dhe përgjegjësisë ligjore e institucionale të zakonshme, por mbi baza funksionale, proaktive dhe me periodicitet më të shpejtë” (faqe 22, paragrafi 3-te, Strategjia Ndërsektoriale).

Pra, nuk mund të pretendojmë se po luftojmë me efikasitet korrupsionin, kur propozojmë rekomandime për raste që kontrollorë të veçantë zbulojnë shitje asetesh pa tituj pronësie në një njësi vendore, ose shkelje të ligjeve të Urbanistikës, ose përçmim në pjesëmarrjen në tendera, etj dhe nuk propozojmë largimin nga puna të personit shkaktar përgjegjës dhe kallzimin në Prokurori. Përmenda këto raste, por të tilla ka shumë.

Kemi kërkuar sinergjizim veprimesh me institucionet e tjera që luftojnë korrupsionin. Ne duhet ta denoncojmë korrupsionin edhe kur ai është në një njësi vendore që drejtohet nga socialistët apo demokratët, edhe kur është ushtruar në institucione qëndrore, pra në çdo vend dhe kohë.

Ne do të kërkojmë riaktivizimin potencial të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave, Prokurorisë,

Shërbimit Informativ Shtetëror, Inspektoratit të Deklarimit të Pasurive dhe KLSH, me synim maksimizimin e dobisë së vlerave të saj për çdo department. Do të punojmë për një bashkëpunim intensiv me Departamentin e Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave dhe për një rivendosje të marrëdhënieve me Prokurorinë, të shkëputura prej disa vitesh.

Dua të tërheq vëmendjen se shumë shpejt do të rregullohen kundërtitë në orientimet e Rregullores së Brendshme të Institucionit me përcaktimet dhe rregullat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe të Auditimit të Performancës. Auditimet e performancës së subjekteve nën kontroll kanë filluar të praktikohen 2-3 vitet e fundit dhe kanë qenë formale. Këto auditime nuk janë ushtruar dhe përgatitur sipas kërkesave të Manualit përkatës. Filozofia e re ku duhet të orientohemi është përqëndrimi i punës mbi të gjitha tek auditimet e performancës, krahas fuqizimit të auditimeve financiare. Për këto të fundit duhen shfrytëzuar dhe audituesit e brendshëm të subjekteve nën kontroll.

Të gjithë duhet të kuptojmë se, nuk ka kontroll pa ndëshkim. **Është e rëndësishme që ne të largojmë hijen e kontrolluesit gjobvënës dhe të atij që abuzon me detyrën.** Deri tani janë shumë pak masat për largimin nga puna të personave shkaktare përgjegjës të dëmeve të konstatuara. Konstatimet dhe masat e propozuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të jenë të efektshme dhe të ndihen në publik. Ne duhet të heqim dorë nga zbulimi i vjedhjeve hipotetike, që s'ekzistojnë, për faktin se këto “zbulime” tonat i shërbejnë mbulimit të korrupsionit të vërtetë. Duhet të rifreskohet praktika e dërgimit të evidencave të sakta pranë DAP për masat administrative dhe disiplinore të propozuara, në mënyrë që persona të implikuar në shkaktimin e dëmit të mos lëvizin lirisht në administratën shtetërore. Dëshirës pozitive dhe vullnetit të mirë të Kryeministrit, të shprehur në Urdhërin Nr. 70 të vitit 2006 “Për zbatimin e masave të propozuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”, ne duhet t'i përgjigjemi me denoncimin e çdo shkeljeje. Një libër gri për nëpunësit abuzues ne do ta dorëzojmë çdo vit pranë Departamentit të

Administratës Publike, institucioneve qëndrore dhe më gjerë. Fund i këtij muaji do të jetë afati për shkeljet e vitit 2011.

Pavarësia dhe integriteti i institucionit duhet të na bëjë të ndërgjegjshëm se korrupsioni nuk ka ngjyrë, nuk është as i kuq, as blu, por është i zi.

Konstatohet se brënda strukturave të brendshme të KLSH mungon koordinimi në nivelin e duhur. Ka ndodhur që në një subjekt nën kontroll të shkojë një grup auditimi i njëjës drejtori dhe pas disa muajsh një grup tjetër nga një departament tjetër, duke ia ulur seriozitetin dhe imazhin institucionit. Informacioni për kontrollet e kryera dhe rezultatet e marra nuk qarkullon elektronikisht mes departamenteve dhe shumë pak punonjës kanë njohuri të mjaftueshme për atë çfarë ndodh në departamentin fqinj.

Programet e sotme të teknologjisë së informacionit në kontrollin e financave publike dhe doganave e tatimeve duhet të përpunohen dhe implementohen nga ne. Dihet që shërbimi online për tatimpaguesit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të cilat për ne janë objekt kontrolli, ka disa vite që funksionon. Këtij zhvillimi KLSH nuk i është përgjigjur. Çdo departament kontrolli tek ne duhet të përgatitet për të filluar kontrollet që përdorin programet e teknologjisë së informacionit, ku më i njohuri dhe që përdoret nga SAI-t homologe është programi "IDEA", të cilin KLSH e disponon, por nuk e përdor. Duhet të marrim dhe të përvetësojmë programe të tjera të kohës, si "Oracle" dhe ato që përdorin institucionet e Thesarit, doganat, tatimet dhe institucionet e tjera.

Do të fuqizojmë cilësinë e veprimtarisë kontrolluese dhe të përgatitjes së raportimeve, përfshirë rekomandimet për zbatim, duke organizuar kontrollin e cilësisë brënda departamenteve të kontrollit, si hallkë e parë në ngritjen e cilësisë së punës së stafit. Dijet e stafit për auditimin e performancës janë ende shumë të kufizuara dhe trajnimet janë zhvilluar përpara dy viteve dhe tani kanë pushuar. Do të realizojmë një planifikim shkencor të kontrollit, si atij financiar, por sidomos të atij të performancës dhe për këtë do te

bashkëpunojme me partnerë nga brënda vendit, si Instituti i Kontabilistëve të Autorizuar IEKA, etj. por edhe me strukturat e BE-së, si SIGMA dhe ECA. Deri tani kemi marrë shumë pak ekspertizë nga jashtë institucionit dhe edhe kur e kemi marrë, kjo ka ndodhur në mënyrë sporadike.

Sfida jonë për vitet në vijim do të jetë partneriteti me Gjykatën Evropiane të Audituesve. Do të synojmë të marrim pjesë në programet e tyre të kontrollit për vendet që aspirojnë për në Bashkimin Evropian dhe që përfitojnë nga programet e asistencës së BE-së, përfshirë vendin tonë. Për thellimin e dijeve në auditimin e performancës, do të vazhdojmë partneritetin me institucione homologe që na kanë ndihmuar në të kaluarën, si Zyra Kombetare e Auditimit e Britanisë së Madhe apo Gjykata Hollandeze e Auditimit, por njëkohësisht duke kërkuar partneritet edhe nga institucioni homolog gjerman, suedez apo i vendeve të tjera të fuqishme të EUROSAI.

Ne do të nisim të kryejmë auditime të performancës për kreditë që strukturat publike qëndrore dhe vendore marrin nga institucione dhe organizata të huaja, duke parë tendencën në rritje të këtyre financimeve për ekonominë dhe shërbimet publike të vendit. Vlerësimi i performancës së kredive kërkon dije të zgjeruara dhe specifike dhe për këtë do të kryejmë trajnimet e duhura.

Hapja e institucionit ndaj praktikave më të mira ndërkombëtare të auditimit të jashtëm, të përditësuara në çdo kongres të fundit të INTOSAI dhe respektimi i orientimeve të MSA-së të Shqipërisë me Bashkimin Evropian (Neni 90-të i MSA) kërkon vlerësim dhe studim maksimal nga ne. Kjo detyrë dhe sfidë bëhet akoma dhe më e rëndësishme për fatet e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të vendit, sidomos në ditët tona të përjetimit të krizës në Eurozonë, kur disiplina buxhetore dhe financiare e administrimit publik është bërë përparësi absolute për përballimin e pasojave të kësaj krize. Një nga rolet qëndrore në mbajtjen e kësaj disipline dhe në mirëadministrimin financiar publik e ka pikërisht Kontrolli i Lartë i Shtetit, si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar të vendit.

Për të qenë të aftë për ta kryer këtë detyrë, dua t'ju kujtoj shtatë parimet e jetës publike të përcaktuara nga Lordi Nolan, një nga reformatoret e administratës publike në Britaninë e Madhe për mbajtësit e pozicioneve zyrtare, dhe pikërisht:

1. Vetëmohimin. 2. Integritetin. 3. Objektivitetin. 4. Llogaridhënien. 5. Të qenit i hapur. 6. Ndershmërinë dhe 7. Mbështetja për Lidërsip.

Këto parime të vitit 1994 janë derivuar më tej nga shumë institucione kombëtare e ndërkombëtare kontrolli, përfshirë INTOSAI dhe EUROSAI.

Në fillimin e vitit 2012 e organizuam duke analizuar gjerësisht punën e departamenteve, arritjet, mosarritjet, dobësitë tonat dhe të partnerëve tanë e të institucioneve të tjera në Shqipëri. Gjatë kësaj jave takimesh me secilin prej jush në analizën vjetore të drejtorive përkatëse, kemi mundur të ridimensionojmë objektivat tona si auditues të lartë dhe të dimë se ç'kërkohej nga ne. Këtë vit i kemi kryer ndoshta për herë të parë këto takime krejtësisht të hapura. Njerëzit e medias dhe të shoqërisë civile janë ftuar të qëndrojnë në ballafaqimet tona dhe të na njohin e kuptojnë deri në fund, me mundësitë, dobësitë dhe përparësitë tona, si në një libër të hapur. E kemi kërkuar dhe gjithnjë do ta kërkojmë këtë partneritet me median dhe shoqërinë civile, pse janë aleatët tanë më të vlefshëm për të ndërgjegjësuar publikun dhe nëpërmjet tij vendim-marrësit publikë për rolin dhe detyrat tona në të ardhmen. Programi i veprimtarisë i KLSH për vitin që sapo kemi hyrë, synon tejkalimin e mangësive të cituara më sipër dhe fuqizimin e mëtejshëm të rezultateve dhe arritjeve të derisotme të institucionit. Në vijim po përqëndrohemi në disa nga drejtimet më kryesore, ku mendoj se duhet të intensifikojmë punën për shndërrimin e KLSH në një strukturë profesionale që përdor në mënyrë ekonomike burimet e saj dhe që funksionon me efikasitet dhe efektivitet, drejtime të cilat ia kam paraqitur në fund të vitit të kaluar Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë dhe që janë thelluar më tej pas konsultimeve të deritanishme me ju.

Më konkretisht:

- 1.** Vizion koherent për KLSH, mbi bazën e eksperiencave më të mira të vendeve të BE-së dhe respektimit rigoroz të standarteve ndërkombëtare të kontrollit INTOSAI.
- 2.** Thellim i realizimit të misionit të KLSH në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike. Ky obligim do të jetë përparësia jonë madhore gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimeve për këtë vit dhe në vijimësi.
- 3.** Përmirësim i metodologjisë së kontrollit, duke kthyer vëmendjen tek auditimi i performancës dhe auditimi i çertifikimit të pasqyrave financiare, krahas rritjes së efijencës së auditimit financiar.
- 4.** Realizim i sinergjizimit të politikave dhe veprimeve me strukturat e tjera shtetërore të së njëjtës fushë, si me Departamentin e AntiKorrupsionit pranë Kryeministrisë, me Njësinë Qëndrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe, në veçanti me organet e Prokurorise, duke ruajtur pavarësinë e KLSH si organi më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar.
- 5.** Komunikim dhe ndërveprim me Kuvendin, Qeverinë dhe partnerë të tjerë institucionalë, sidomos intensifikim i konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH 2013-2018, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj Kuvendit, si një detyrim kushtetues.
Brënda gjysmës së dytë të këtij viti, do të përgatisim Planin Afatmesëm Strategjik të Zhvillimit të institucionit për vitet 2013-2015.
- 6.** Programim dhe konsolidim i bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademikë të auditimit të financave publike, si dhe me organizata profesionale të kontabilitetit dhe të fushave të tjera të ekonomisë. Unë sapo vij në këtë analizë pas një takimi të vyer me profesorin gjerman, ekspertin e financave publike Hans Ditrich Wenzel.

7. Intensifikimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare të auditimit si INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e larta të kontrollit të BE-së, si SIGMA dhe Gjykata Europiane e Audituesve, me institucionet homologe të vendeve të BE-se dhe të rajonit, dhe në veçanti me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës.

8. Zhvillim i burimeve njerëzore të KLSH në nivelin e parametrave të kërkuar nga institucionet ndërkombëtare të auditimit dhe në përputhje me sfidat integruese të vendit. Në këtë kontekst, do të përshtaten më mirë cilësitë profesionale dhe aftësitë e secilit punonjës, me strukturën organike të institucionit, duke bashkuar apo krijuar struktura të reja (si për shëmbull Vendimi i ditëve të para në ushtrimin e detyrës sime për krijimin e Drejtorisë për Kërkimin, Zhvillimin dhe Kontrollin e Brendshëm), të afta të përballojnë sfidat e kohës dhe kërkesat e standardeve të miratuara nga INTOSAI.

Do të ketë rritje cilësore dhe të numrit të kontrollorëve të trajnuar brënda dhe jashtë institucionit, mbi bazën e listës së nevojave reale të stafit për ngritjen profesionale dhe të kërkesave të shtruara për institucionet supreme të kontrollit në Rezolutën e Kombeve të Bashkuara të datës 22 dhjetor 2011 dhe kërkesave në Marreveshjen e Stabilizim-Asocimit të Shqipërisë me BE.

9. Ngritje e kapaciteteve të nevojshme për parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik në teknologjinë e informacionit. Qeverisja elektronike po fiton gjithnjë e më shumë terren në administrimin e pasurisë publike dhe ofrimin e shërbimeve publike në Shqipëri dhe është e kuptueshme që përdorimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit të shoqërohet edhe me forma të reja të krimit ekonomik. Kjo është edhe një nga sfidat më të rëndësishme të KLSH-së në një periudhë afatshkurtër.

10. Përmirësim i transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse të interesuara për bashkëpunim. Vend të veçantë do të zerë partneriteti i KLSH me shoqërinë civile të angazhuar në luftën për parandalimin e mashtrimit financiar dhe korrupsionit.

Në përgjigje të ndjeshmerise dhe pritshmerise se publikut, kam realizuar me shkresën zyrtare Nr. 92 datë 19.01.2012 dorëheqjen nga imuniteti si Kryetar i KLSH.

Në mbyllje dua të jap mesazhin se do të punojmë për një institucion të lartë auditimi që siguron një komunitet të angazhuar që ka interes ta mbajë qeverisjen qendrore dhe vendore përgjegjëse. Për këtë do të fuqizojmë rolin e pazëvendësueshëm kushtetues të KLSH si institucioni kryesor ekonomiko-financiar, për ekonominë dhe shoqërinë tonë, me detyrë kontrollin e mirëadministrimit të pronës publike dhe shëndoshjen e financave publike, duke i shërbyer me devotshmëri Kuvendit dhe duke rritur pjesmarrjen e opinionit publik në realizimin e Buxhetit të Shtetit dhe të auditimit në tërësi.

Ju faleminderit për vëmëndjen dhe angazhimin tuaj!

*Fjala e Kryetarit në Analizën vjetore të KLSH për vitin 2011 mbajtur më datë 20.01.2012 në sallën e Pallatit të Kongreseve, Tiranë. Si titull është zgjedhur motoja e INTOSAI-t *“Experientia mutua omnibus prodest”*.

PËRSHËNDETJA E Z. ADRIATIK LLALLA, INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM I ILDKP, NË ANALIZËN VJETORE TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT

I nderuar zoti Leskaj,
Të nderuar pjesëmarrës,



Është kënaqësi e dyfishtë për mua të jem këtu; së pari, për të uruar drejtuesin e ri të institucionit Tuaj për detyrën e rëndësishme. Së dyti, për të dëshmuar vullnetin e mirë që ekziston ndërmjet institucioneve për bashkëpunimin në drejtim të forcimit të shtetit ligjor në Shqipëri.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive e Kontrolli i Lartë i Shtetit janë dy agjenci që japin kontribut shumë të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit. Falë angazhimit tonë të përbashkët janë mbyllur shumë shtigje për korrupsion. Shumë zyrtarë janë vendosur para përgjegjësisë disiplinore e penale, si edhe është rritur ndërgjegjësimi i funksionarëve të administratës publike për respektimin e ligjit.

Inspektorati i Lartë dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit kanë pasur gjithmonë një bashkëpunim të suksesshëm dhe ne do të synojmë që të avancojmë më tej në këtë drejtim.

Para pak ditësh kemi diskutuar në nivel titullarësh për nënshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve. Shumë shpejt ky projekt do të realizohet dhe besojmë se do të jetë një mekanizëm shumë i rëndësishëm për suksese të mëtejshme në sfidën antikorrupsion.

Të nderuar kolegë,

Analiza e punës Suaj është një moment domethënës, pasi përball çdo institucion me performancën financiare që ka realizuar, me arritjet dhe të metat. Është një pasqyrë që reflekton gjendjen aktuale të institucioneve shqiptare dhe objektivat për përmirësime të mëtejshme. E parë në këtë këndvështrim, shpresoj dhe besoj se stafi i Kontrollit të Lartë të Shtetit do të vazhdojë të jetë në lartësinë e duhur për evidentimin e shkeljeve ligjore dhe për ndërgjegjësimin e të gjithë zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike të punojnë me ndershmëri, korrektesë dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie. Duke Ju falenderuar që më krijuat mundësinë të flas në këtë takim, Ju uroj punë të mbarë dhe suksese të mëtejshme!

Ju falemiderit!

Tiranë, më 20 janar 2012

PËRSHËNDETJA NË EMËR TË NJË GRUPI OJF. E AV. ALTIN GOXHAJ

DREJTOR I ZMK.



Av. Altin Goxhaj
Drejtore i Zyrës për
Mbrotjtjen e Konsumatorit

I nderuar z. Kryetar, të nderuar punonjës të KLSH,

Ju falenderoj për ftesën që të marr pjesë në këtë analizë tuajën. Së bashku me një kolegun time erdhëm dhe u befasuam këndshëm nga predispozicioni juaj për të qenë tërësisht i hapur me mediat dhe shoqërinë civile. Rrallë herë kemi parë dyer kaq të hapura në administratën shtetërore.

Mendoj se një bashkëpunim i ardhshëm mes institucionit tuaj dhe ne organizatave të shoqërisë civile që mbrojmë qytetarin dhe konsumatorin do të ishte shumë i vlefshëm. Ne si shoqata mund t'ju japim eksperiencën dhe këndvështrimin tonë.

Ju, z. Kryetar thatë se kërkoni bashkëpunim dhe transparencë të plotë me mediat. Ju po synoni edhe një kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarin dhe që t'i shërbeni atij, duke marrë edhe ankimet e tij ndaj abuzimeve me pronën shtetërore dhe nga administrata shtetërore.

Ne e mbështesim këtë. Personalisht jam gati të ndaj eksperiencën dhe të angazhohem në aktivitete të përbashkëta. Mendoj se ju mund të vendosni një

numër blu komunikimi me publikun, ku kostot janë shumë të vogla dhe ai qytetar që është i interesuar është gati të paguajë për telefonatën.

Ka dhe shumë forma të tjera të përshtatshme komunikimi me njerëzit, për të cilat mund të bisedojmë më gjerësisht në të ardhmen.

Ju faleminderit!

Tiranë, më 20 janar 2012

RAPORT- ANALIZË*

MBI VEPRIMTARINË E KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR VITIN 2011



z. Robert Gjini
Drejtor i Përgjithshëm

I nderuar z. Kryetar,

Të nderuar të ftuar dhe gazetarë,

Të nderuar kolegë,

Pas kryerjes së analizave në nivel departamenti dhe drejtorie, jemi mbledhur sot për të analizur veprimtarinë njëvjeçare të punës në nivel institucioni.

Që në fillim, më duhet të

theksoj se, problematika që

do të parashtroj në këtë analizë, është rezultante e të gjitha të dhënave dokumentare dhe fakteve të konstatuara e të evidentuara në dokumentacionin përkatës të hartuar, miratuar e të plotësuar gjatë vitit 2011, madje të publikuar në buletinet periodike 3-mujore.

Theksojmë se, për vitin 2011, përvetësimi dhe zbatimi me rigorozitet i kërkesave të dispozitave ligjore, njëkohësisht dhe standardeve të kontrollit, kanë qenë ndër prioritetet e institucionit, gjë që ka bërë të mundur prodhimin e materialeve cilësorë, gjykuar në këndvështrimin e përmbajtjes së masave rekomanduese dhe të nivelit të shpërblimit të dëmeve ekonomike të konstatuara dhe evidentuara. Për çdo kontroll të ushtruar dhe përfunduar, krahas përpunimit, vlerësimit të të dhënave dhe nxjerrjes së përfundimeve, janë përcaktuar dhe detyrat për të ardhmen, si dhe përgjegjësitë individuale e institucionale.

Në nivel institucional, treguesit kryesorë nëpërmjet të cilëve matet realizimi i objektivave dhe detyrave të vitit 2011, i kemi grupuar në dy kategori, procesi kontrollues si procesi parësor i institucionit dhe procesi i shërbimeve mbështetëse të kontrollit.

I. Veprimtaria kontrolluese përfshirë kontrollin për zbatimin e masave të rekomanduara.

I.1 Programimi i kontrolleve dhe realizimi i tij

Për vitin 2011, veprimtaria kontrolluese e KLSH^{së} është bazuar në programin e kontrolleve të parashikuara për këtë vit. Në programimin e subjekteve dhe tematikave të kontrollit, që në fazën e studimit dhe planifikimit, KLSH i ka dhënë prioritet ushtrimit të kontrollit në ato subjekte për të cilët ka detyrim kushtetues dhe ligjor dhe që përdorjnë fonde të buxhetit të shtetit në vlera të mëdha apo subjekte që kanë shkallë të lartë materialiteti dhe që rrit riskun.

Strategjia e planifikimit të kontrolleve, përfshin një set dokumentesh, ku përfshihen dhe një sërë kriteresh, ndër të cilët përmendim:

- Rëndësinë që kanë subjektet dhe çështjet që duhen kontrolluar.
- Rezultatet përfundimtarë të kontrolleve të mëparshëm.
- Vlerësimin e materialitetit dhe të riskut.
- Rekomandimet e dërguara subjekteve të kontrolluar dhe nivelin e zbatimit të tyre.
- Mjetet financiare, bazën materiale dhe burimet njerëzore.
- Faktorë të tjerë, përfshirë informacione dhe të dhëna që sigurohen nga jashtë institucionit etj.

Procesi për strategjinë e planifikimit të kontrolleve, karakterizohet nga një punë profesionale dhe voluminoze, duke filluar nga grumbullimi dhe përzgjedhja e materialeve dhe të dhënave, konsultimet brenda për brenda departamentit dhe më pas në shkallë institucioni, madje duke konsideruar dhe auditimet që parashikojnë të ushtrojnë strukturat e auditimit të brendshëm, për të shmangur mbivendosjet e kontrolleve.

Lidhur me tematikën e kontrolleve, ato janë hartuar pas grumbullimit dhe shqyrtimit të të gjitha të dhënave dhe informacioneve për subjektet objekt kontrolli, duke patur parasysh dhe kërkesat e përcaktuara në aktet e miratuara nga titullari i institucionit, dhe më konkretisht: - standardet e kontrollit të KLSH, rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, dokumentet standard të kontrollit dhe ndonjë tjetër.

Kurse, përsa i përket programimit të detyrave të kontrollit si hapi i parë dhe i rëndësishëm në procesin e kontrollit, pasqyrojmë se, ato janë hartuar dhe zhvilluar subjekt për subjekt, duke u pasuruar me çështje dhe nënçështje objekt kontrolli. Si rregull, programet e kontrollit hartohen nga kontrollorët e grupit të kontrollit me përgjegjësin e grupit, dhe më pas vlerësohen nga Kryekontrollori dhe Drejtori i Departamentit. Tërë ky proces është karakterizuar nga kërkesa të tilla si:

- Njohja paraprake e natyrës së subjektit që i nënshtrohet kontrollit (mbledhja dhe analiza e fakteve dhe e të dhënave të mjaftueshme për të arritur konkluzione të besueshme dhe të vlefshme);
- Njohja me legjislacionin mbi të cilin operon dhe realizon veprimtarinë subjekti;
- Përcaktimi i saktë në program i drejtimeve dhe çështjeve kryesore që mbulon procesi i kontrollit;
- Vlerësimi i riskut dhe materialitetit, etj.

Më pas, vijohet me *procesin e zhvillimit të kontrollit*, i cili ka rëndësi parësore. Në këtë proces, vëmendja përqëndrohet në kryerjen e kontrollit me cilësi të lartë, në rrugë ekonomike dhe efektive, si dhe në kohën e duhur. Dokumentet e punës së kontrollit janë pjesë thelbësore e procesit të kontrollit. Në këtë kontekst, gjatë kontrollit kujdes i veçantë i është kushtuar përputhjes së veprimtarisë së subjektit të kontrolluar me dispozitat ligjore, udhëzimet dhe rregulloret, shqyrtimit të dokumenteve të punës, evidentimit të problematikës së kontrolluar e të rezultuar, si dhe evidencës së zbulimeve gjatë kontrollit. Këto kanë qenë dhe janë instrumentët kryesorë që shprehin vlerësime për

efektivitetin e kontrollit dhe matës pune për secilin grup pune apo kontrollor që operon në kontroll. Gjithashtu, procesi i zhvillimit të kontrollit, është parë dhe trajtuar i lidhur ngushtë me fazën e përgatitjes së dokumentacionit të evidentuar gjatë zhvillimit të kontrollit, sidomos të raporteve përfundimtarë të kontrolleve e të masave rekomanduese për përmirësimin e gjëndjes. Shtoj se, transparenca dhe metoda e ballafaqimit mes kontrollorit dhe personave përgjegjës; objektiviteti dhe paanësia në vlerësim; si dhe matura e përgjegjësia kolegjiale e grupeve të kontrollit për propozimin e masave, kanë qenë momente shumë rëndësishme të procesit të zhvillimit të kontrollit.

I.2 Llojet e kontrolleve dhe struktura e subjekteve të kontrolluar

Detyrat e programuara të kontrollit për vitin 2011 në numër, janë realizuar dhe tejkaluara. Nga 150 kontrolle të planifikuara për evadim, janë përfunduar dhe evaduar gjithsej 152 kontrolle, nga të cilat:

- Kontrolle të ligjshmërisë, rregullshmërisë e vlerësues.....	74
- Kontrolle të ligjshmërinë dhe rregullshmërinë.....	57
- Auditime financiare.....	9
- Auditim pilot, çertifikim të llogarive.....	1
- Auditime performance	2
- Kontrolle vlerësues	4
- Kontrolle tematikë.....	5

Ndonëse në numër, kontrollet janë realizuar dhe tejkaluara, në strukturë ato nuk janë realizuar sipas programit të veprimtarisë të miratuar në fillim të vitit 2011. Më konkretisht, auditimet financiare nga 15 të programuara, nga të cilat 2 kontrolle për çertifikimin e llogarive, janë realizuar 10; po kështu auditimet e performancës nga 5 të programuara është realizuar vetëm 1.

Vlen të theksohet se, mosrealizimi i detyrave të programuara për auditimet financiare dhe të performancës është njëra anë, ana tjetër dhe më e rëndësishmja është cilësia e përgatitjes së tyre, konformë kërkesave të përcaktuara në manualët e këtyre dy auditimeve. Për këtë mbetet shumë për

të bërë, por rezultatet e dëshiruara mund të arrihen vetëm me kapacitetet e mjaftueshme njerëzore dhe të mirëtrajnuar.

Sipas natyrës së subjekteve të kontrolluar rezultojnë:

- Ministri dhe institucione qendrore.....	39
- Institucione të administratës së qeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor.....	62
- Drejtori dhe degë të tatimtaksave e të doganave.....	17
- Institucione financiare dhe shoqëri anonime.....	16
- Njësi dhe projekte me financime të huaja.....	9
- Subjekte të mbrojtjes së mjedisit.....	4
- Subjekte të administrimit dhe regjistrimit të pronës	5

I.3 Gjetjet kryesore sipas fushave apo sektorëve dhe departamenteve të kontrollit.

Në përfundim të kontrolleve të ushtruar gjatë vitit 2011, kontrollorët kanë **zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm efektiv të përgjithshëm në shumën totale prej 7,027,566 mijë lekë.** Nga kjo vlerë dëmi të evidentuar, **kemi rekomanduar shpërblimin e tij në masën 100%.**

Ky dëm efektiv i përket veprimtarisë ekonomiko-financiare të ushtruar në periudhën kohore 2008-2011, periudhë e cila është cilësuar në programet respektive të kontrollit të çdo subjekti të kontrolluar.

A. Sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar dhe evidentuar dëmet ekonomike, rezultojnë:

A.1 Në fushën e shitjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore, në vlerën.....	352,232 mijë lekë;
A.2 Në fushën e prokurimeve publike, në vlerën.....	210,324 mijë lekë;
A.3 Në sektorin doganor, në vlerën.....	184,104 mijë lekë;
A.4 Në fushën e shpërblimeve, në vlerën.....	149,359 mijë lekë;

A.5 Në fushën e urbanistikës, në vlerën.....	87,663 mijë lekë;
A.6 Në sektorin e tatimtaxsave, në vlerën.....	49,052 mijë lekë;
A.7 Në fushën e sistemit të pagave, në vlerën.....	36,614 mijë lekë;
A.8 Në fushën e shpenzimeve operative, në vlerën.....	25,087 mijë lekë;
A.9 Mungesë materiale në shumën.....	55 mijë lekë;
A.10 Në fusha dhe sektorë të tjerë, në vlerën e përgjithshme prej.....	5,933,076 mijë lekë.

Në këtë zë, peshën kryesore e zenë dëmet e evidentuara në *Operatorin e Sistemit të Trasmimit të Energjisë Sh.a. Tiranë* në vlerën 1,924,209 mijë lekë (moslikujdim i shërbimit të kryer për transmetimin e energjisë elektrike për periudhën nga privatizimi i OSSH deri më 15.12.2010) dhe në *Albpetrol sh.a. Fier* në vlerën 3,936,800 mijë lekë (shkaktuar nga moslikujdimi i detyrimeve prej 3,578,689 mijë lekë të rrjedhura nga furnizimi me naftë bruto, gaz natyror dhe hollues deri më datë 31.12.2010 nga kompania ARMO sh.a (ARMO Oil) dhe 358,108 mijë lekë nga moslikujdimi në afat i faturave të shitjes së naftës po nga kjo kompani), pra gjithsej 5,860,898 mijë lekë.

B. Sipas departamenteve të kontrollit, vlera e shkeljeve financiare me dëm ekonomik paraqitet, si më poshtë:

1. Departamenti i Kontrollit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike e Mbrojtjes së Mjedisit.....	6,094,587 mijë lekë;
2. Departamenti i Kontrollit të Buxhetit Qëndror, të Institucioneve të Administratës së Lartë Publike dhe Mbikëqyrjes së Auditimit të Brendshëm.....	420,478 mijë lekë;
3. Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Publike.....	327,227 mijë lekë;
4. Departamenti i Kontrollit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.....	185,274 mijë lekë.

Në mënyrë të detajuar, sipas emërtimeve të subjektit ku janë evidentuar dëmet ekonomike, zërave të tyre (në të ardhurat dhe shpenzimet), si dhe vlerave respektive për çdo zë dhe subjekt paraqiten në pasqyrën bashkëlidhur këtij raporti.

B.1 Departamenti i Kontrollit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Gjatë vitit 2011, ky Departament ka kryer, përfunduar dhe evaduar 30 kontrolle nga 31 të programuara, dhe konkretisht:

- 10 në Projektet me financime të huaja të zbatuara në fushën e ndërtimit, si ndërtim segmentesh rrugorë dhe mirëmbajtje rrugësh, në fushën e furnizimit me ujë e të kanalizimeve, në fushën e shërbimeve sociale e bujqësore etj.
- 14 kontrolle në shoqëritë publike;
- 5 kontrolle në entet që operojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit; dhe
- 1 kontroll për zbatimin e rekomandimeve të lëna në kontrollet e mëparshme.

Klasifikuar sipas *llojit të kontrolleve* rezulton se; 27 kanë qenë kontrolle të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare; 1 auditim performance sipas praktikës së auditimit të Gjykatës së Auditimit të Holandës, 1 auditim për certifikimin e llogarive (pasqyrave financiare) sipas praktikës së auditimit të NAO të Britanisë së Madhe dhe 1 kontroll tematik.

Auditimi i performancës është kryer në Ministrinë e Shëndetësisë “Për performancën në menaxhimin dhe trajtimin e mbetjeve spitalore në sistemin e shëndetësisë”, ku në përfundim të auditimit ka rezultuar: një kuadër ligjor jo i plotë për menaxhimin e mbetjeve spitalore, mungesë e strukturave përkatëse për menaxhimin e mbetjeve spitalore; mungesë e Planit të Administrimit të tyre; mungesë e pjesshme e bashkëveprimit ndër-institucional ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave me Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit; mos hartimi nga MSH e strategjisë, planeve operative vjetore dhe rregullores tip për administrimin e mbetjeve spitalore sipas

tipologjisë së gjenerimit të mbetjeve; mungesë e të dhënave për subjekte të sektorit privat shëndetësor si klinikat mjekësore, farmacitë e klinikat dentare, si dhe subjekte jashtë sistemit shëndetësor, të cilat prodhojnë mbetje spitalore; moszbatimi dhe mosrespektimi i kërkesave të rregullores nr. 6, datë 30.11.2007 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”; kontratat e shërbimit në institucionet shëndetësore të audituar nga kontrollorët e KLSH në përgjithësi ishin lidhur me subjekte të palicencuar për trajtimin e mbetjeve spitalore; për impiantet e djegies së mbetjeve spitalore në shfrytëzim nuk kishte studime mbi ndikimin e tyre në mjedis, si dhe nuk ishin të miratuara për shfrytëzim nga MMPAU etj. Përgjithësisht, mbetjet spitalore trajtohen njësoj si mbetjet urbane, gjithashtu, në fondet e akorduara nga Buxheti i Shtetit, nuk ka zë të veçantë për trajtimin e mbetjeve spitalore. Madje, në institucionet e audituar u konstatua se mungonte analiza e kostos për trajtimin e mbetjeve spitalore deri në asgjësimin e tyre dhe nga Ministria e Shëndetësisë nuk është marrë asnjëherë në analizë menaxhimi i tyre.

Kurse, auditimi për çertifikimin e llogarive (Mbi vlerësimin e parimeve të përdorura për kontabilitetin dhe çmuarjet e bëra nga menaxhimi, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare) realizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve, Tiranë në projektin me financim të huaj: “*Menaxhimi i Integruar i Ujërave dhe Ekosistemit*”, sipas opinionit të kontrollorëve të KLSH, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Projektit, të fondeve të marra dhe shpenzimeve të paguara nga Projekti në përputhje me faturat në Kesh dhe mbi bazën e disbursimeve në periudhat përkatëse, shoqëruar me problematika të veçanta.

Në përfundim të kontrolleve të evaduar në vitin 2011, si pasojë e parregullsive dhe veprimeve të kundërligjshme të ndërmarrë nga punonjësit e subjekteve të kontrolluar, sidomos nga drejtuesit e lartë, në 15 prej tyre nga 29 gjithsej, **arkës së shtetit i është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 6,094,587 mijë lekë.**

Sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar këto dëme ekonomike, rezulton:

1. Në fushën e shpërblimeve.....	145,090 mijë lekë;
2. Në fushën e shitjes dhe dhënies me qira të pronës publike.....	6,413 mijë lekë;
3. Në fushën e shpenzimeve operative.....	5,226 mijë lekë;
4. Në sistemin e pagave.....	2,498 mijë lekë;
5. Në sektorin e tatimtaksave.....	1,909 mijë lekë;
6. Në fushën e prokurimit publik.....	713 mijë lekë;
7. Në sektorin e doganave.....	688 mijë lekë;
7. Në fusha të tjera (OSTEE sh.a. Tiranë dhe Albpetrol sh.a. Fier).....	5,932,050 mijë lekë.

Ndër problemet më kryesore që kanë konstatuar dhe evidentuar kontrollorët e këtij Departamenti në kontrollet e evaduar gjatë vitit 2011, paraqesim:

a) Në investimet dhe projektet me financime të huaja:

a.1 Në ndërtimin e infrastrukturës rrugore (*rruga Lushnjë-Fier dhe Levan-Tepelenë*) ka rezultuar se Autoriteti Rrugor Shqiptar nuk ka realizuar në kohë shpronësimet për realizimin me sukses të programeve investuese; nuk kish hartuar një program masash të shoqëruara me koston financiare për sigurimin e niveleve të larta të sigurisë; studimet dhe projektimet e investimeve me financime të huaja nuk ishin të thelluara, për pasojë ato shoqërohen me ndryshime gjatë zbatimit duke rritur koston e tyre; nuk ka bërë inventarizimin e plotë fizik dhe financiar të segmenteve rrugore për secilin projekt; si dhe Njësitë e Menaxhimit të Projekteve nuk kanë ndjekur dhe nuk kanë ndëshkuar përgjegjësit për realizimin jashtë afateve të punimeve. Për vonesat e shkaktuara, nuk janë bërë njoftimet përkatëse për fillimin e aplikimit të penalteteve për vonesa dhe nuk janë realizuar testimet për të garantuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të parashikuara në kontratë.

a.2 Në fushën e arsimit (*projekti “Cilësi dhe barazi në arsim”*), Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, nuk ka të analizuar ecurinë e projektit, pasi vonesat kanë sjellë rritje të shpenzimeve dhe rëndim të kostos së kredive; nuk u ka dërguar donatorëve raportet financiare dhe raportet mbi ecurinë e projektit; si dhe nuk ka ngritur kapacitet e nevojshme për sektorin e prokurimeve dhe menaxhimin financiar të projektit.

a.3 Në fushën e ujësjellës-kanalizimeve (*PIU Hidrik, Tiranë, furnizimi me ujë dhe sanitetet në qytetin e Korçës*), nuk janë riparuar defektet në rrjetin e tubacioneve, nuk ka studim për gjendjen e veprave të artit të ndërtuara për sigurinë e Impiantit të Trajtit të Ujërave Bovillë nga rrëshqitjet, rishikimin e zbatimit të punimeve për plotësimin në afat të kontratave, etj; Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Korçë, nuk ka analizuar ecurinë e projektit, është lidhur amendamenti i kontratës pa u siguruar financimi i saj, ka ndryshime të strukturës së huasë, nuk ka inventarizim të dokumentacionit të projektit, nuk janë aplikuar penalitete për vonesa në zbatimin e kontratës.

a.4 Në fushën e shërbimit shëndetësor (*Spitali Kavajë*), Ministria e Shëndetësisë nuk ka plotësuar me stafin e specializuar mjekësor repartet e shërbimit të kirurgjisë së përgjithshme, sallës së operacionit të maternitetit dhe shërbimit të reanimacionit; Njësia e Zbatimit të Projektit nuk ka bërë inventarizimin e plotë të pajisjeve mjekësore dhe elektronike, si dhe regjistrimin kontabël e evidentimin në llogaritë e bilancit; gjithashtu kjo Njësi nuk ka marrë masa për ndjekjen e realizimit të punimeve të pakryera, por të situacionuara dhe të likuiduara për zërin “Matja e tymrave” etj.

a.5 Në fushën e energjisë elektrike (*“Transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike Vau Dejës”*, për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e ballkanit, fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit); KESH sh.a. nuk ka bërë të mundur vënien në punë të komponentit të projektit “Ndërtimi i rrjetit shpërndarës 20 kw të qytetit të Koplikut”; nuk ka regjistruar ne kontabilitet investimet e kryera; nuk ka zbatuar penalitet për vonesat; si dhe nuk ka marrë masa për mbajtjen

e materialeve të pa dorëzuar nga kontraktori. Gjithashtu, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe PIU/OST, në bashkëpunim dhe me METE dhe PMU/METE, nuk kanë përfunduar në kohë projektin; PIU/OST nuk ka raportuar mbi ecurinë e projektit në Ministrinë e Financave dhe nuk ka hartuar raporte të plota dhe reale, për realizimin e secilit komponent të projektit; planifikimi i disbursimeve nuk ka qenë i saktë; nuk janë kryer misione të përbashkëta monitorimi mbi ecurinë e projektit; nuk është inventarizuar dhe arkivuar dosja e prokurimit etj.

a.6 Në fushën e bujqësisë (*Projekti i menaxhimit të burimeve ujore*), Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Bordet e Kullimit në rrethe, nuk kanë marrë masa për një paraqitje reale të veprimeve kontabël për kontratat e përfunduara.

Zbatimi i kontratave në projektet me financime të huaja është shoqëruar me mangësi, duke shkaktuar dëme nga shpërblimet e përfituara padrejtësisht prej shoqërive mbikëqyrëse. Kontraktori për rimbursimet e taksës doganore dhe për punime të pakryera, ka kryer pagesa të pajustificuara në zërin “sigurime” dhe për punime jashtë parametrave teknikë të parashikuar në kontratat përkatëse; ndërsa për kontratat e punimeve në proces, për t’ju mbajtur nga shuma e garancisë ose në të kundërt, duhet të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik të përfutur padrejtësisht, nga pagesa e taksës doganore dhe t.v.sh. për mallin e furnizuar jo sipas kushteve të kontratës etj.

b) Në shoqëritë publike:

b.1 Moshartimi në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, të dokumentacionit ligjor të shoqërive publike si statut, rregullore e brëndshme, kontrata kolektive dhe individuale të punës, dokumente të regjistrimit etj.

b.2 Mospërbërja e Këshillave Mbikëqyrëse dhe/ose Bordet Drejtuese në përputhje me udhëzimet përkatëse; miratimi prej tyre shpesh herë i vendimeve të nxituara e të pabazuara ligjërisht, madje të shoqëruara me efekte financiare në dëm të personit juridikë publik; mosanalizimi periodikisht i veprimtarisë të

shoqërive apo mos zbatimi me rigorozitet i detyrimit statutor për raportimin në institucionet përkatëse.

b.3 Moshartimi nga drejtuesit e shoqërive dhe/ose drejtoritë, në përmbajtjen e kërkuar (siç duhet) të programeve ekonomiko-financiare të shoqërisë, marrja e vendimeve duke anashkaluar Këshillat Mbikëqyrëse. Gjithashtu, mosevidentimi dhe mosndjekja sistematike e detyrimeve debitore, si dhe mosnxjerrja e përgjegjësisë për mosrealizimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë apo menaxhim jo të mirë të shoqërisë.

b.4 Në fushën e menaxhimit financiar, abuzime në shpenzimet për personelin; mungesë të dokumentacionit justifikues në kryerjen e pagesave me arkë dhe bankë; dhënie të sponsorizimeve të pambështetura ligjërisht; shpenzime për telefonat celular në kundërshtim me legjislacionin; abuzime në përdorimin e kursit të këmbimit të valutës dhe shitjen e produkteve të tyre; dhënie pa kriter të paradhënies; mosshlyerje në afat të detyrimeve të ndryshme; dhënie shpërblimesh në fund të vitit për punonjësit e shoqërisë edhe në rastet kur shoqëria ka rezultuar me humbje; planifikimi dhe përdorimi i të ardhurave nga subvencioni jo sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimet përkatëse; mangësi në dokumentet justifikues për pagesat për shpenzimet e karburantit dhe për udhëtim e dieta etj.

Mangësi janë konstatuar dhe në dhënien me qira të objekteve pronë e shoqërive, duke favorizuar subjekte private dhe duke cënuar interesat e shoqërisë publike.

b.5 Në fushën e prokurimit publik, shkelje të dispozitave ligjore e nënligjore dhe të detyrimeve kontraktore si: - mangësi në përcaktimin e fondit (vlerës) limit; po kështu në dokumentacionin e tenderit; mosrespektim të afateve ligjorë për shqyrtimin e ankesave; pagesa të kundërligjshme në formën e shtesës së kontratës; si dhe moszbatim të afatit e të përcaktimeve kontraktuale; çka kanë ulur përdorimin efektiv të fondeve publike.

b.6 Lidhur me auditimin e brendshëm, në mjaft shoqëri, njësitë nuk janë ngritur dhe nuk kanë funksionuar në përputhje me standardet e auditimit,

procedurat dhe kërkesat e përcaktuara në manualin e auditimit të brendshëm publik.

c) Në institucionet dhe entet që veprojnë në fushën e mjedisit, është konstatuar:

- Moshartimi nga MMPAU të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe të metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis; moshapja e regjistrave të lejeve mjedisore dhe mospasqyrimi në mënyrë të detajuar të këtyre lejeve, për pasojë moskryerja e monitorimit të treguesve mjedisorë; moskoordinimi i punëve ndërmjet departamenteve brënda Ministrisë dhe kësaj të fundit me institucionet e tjera, sidomos në drejtim të ndjekjes së kundërvajtësve dhe arkëtimit të gjobave; etj.

- Mosfunksionimi i Drejtorive të Shërbimit Pyjor në bazë Qarku; moshartimi i planeve të mbarështimit, të trajtimit dhe të shfrytëzimit të fondit pyjor e të kullotave; mungesë e dokumentacionit në kontrata për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe mosndjekja sa dhe si duhet e vjeljes së qirasë dhe gjobave etj.

- Mosdisponimi nga ARM-të të lejeve mjedisore të subjekteve, të cilët ushtronin aktivitet në zonën e tyre; mospërcaktimi i masave dhe afateve për rehabilitimin e gjendjes së mjedisit të dëmtuar nga subjektet qiramarrës dhe mosvendosja nga inspektorët e mbrojtjes së mjedisit në rastet e konstatuara të sanksioneve ligjore; diferencime në caktimin e masës së gjobës; mangësi në përgatitjen e dosjes për autorizim dhe pëlqim mjedisor etj.

B.2 Departamenti i Kontrollit të Zbatimit të Buxhetit Qëndror, të Institucioneve të Administratës së Lartë Publike dhe Mbikëqyrjes së Auditimit të Brendshëm.

Ky Departament ka ushtruar dhe evaduar gjithsej 39 kontrolle, nga 38 të planifikuara.

Nga kontrollet e evaduar, 19 kanë qenë të kombinuar (ligjshmërie, rregullshmërie dhe për vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare); 7 ligjshmërie dhe rregullshmërie, 8 auditime financiare sipas praktikës së auditimit të NAO të Britanisë së Madhe, 4 vlerësues dhe 1 kontroll tematik.

Nga totali i kontrolleve të ushtruar, në 22 prej tyre janë konstatuar dhe evidentuar **shkelje me dëm ekonomik në vlerën 420,478 mijë lekë.**

Sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar këto shkelje, rezulton:

a. Në fushën e të ardhurave në vlerën..... 343,722 mijë lekë;

Nga të cilat:

1. Nga dhënia e objekteve me qira..... 978 mijë lekë;

2. Nga tatimtaksat..... 743 mijë lekë;

3. Nga shfrytëzimi i pasurive kombëtare..... 342,001 mijë lekë;

b. Në fushën e shpenzimeve..... 76,756 mijë lekë;

Nga të cilat:

1. Në fushën e prokurimeve publike..... 65,159 mijë lekë;

2. Në shpenzimet operative..... 11,154 mijë lekë;

3. Në fushën e pagave në vlerën..... 440 mijë lekë;

5. Mungesë mjete materiale e monetare..... 6 mijë lekë.

Të analizuara sipas subjekteve, shkeljet e konstatuara me dëm ekonomik në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës financiare, paraqiten;

a) Në fushën e të ardhurave

a.1 Në *Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektoratit Shtetëror të Punës*, janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në të ardhurat e buxhetit të shtetit në vlerën totale *187 mijë lekë*, për të cilat është rekomanduar zhdëmtimi në masën 100% i vlerës së demit të shkaktuar, *rekomandim i zbatuar plotësisht*.

a.2 Në *Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit*; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për të ardhurat e buxhetit të shtetit në vlerën totale *158 mijë lekë*, për të cilat është rekomanduar zhdëmtimi në masën 100% i vlerës së demit të shkaktuar, *rekomandim i zbatuar plotësisht*.

a.3 Në *Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë*; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në të ardhurat e buxhetit të

shtetit në vlerën totale 978 mijë lekë, për të cilat është rekomanduar zhdëmtimi në masën 100% i vlerës së dëmit të shkaktuar dhe është zbatuar plotësisht.

a.4 Në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Pyjeve dhe Kullotave në MMPAU; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në të ardhurat e buxhetit të shtetit në vlerën totale 342,001,000 lekë, për të cilat është rekomanduar zhdëmtimi në masën 100% i vlerës së dëmit të shkaktuar dhe është realizuar plotësisht.

a.5 Në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në të ardhurat e buxhetit të shtetit në vlerën totale 398 mijë lekë, për të cilat është rekomanduar zhdëmtimi në masën 100% i vlerës së dëmit të shkaktuar, kanë filluar procedurat për zbatim.

b) Në fushën e shpenzimeve

b.1 Në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën totale prej 23,239,000 lekë, për të cilat është kërkuar zhdëmtimi në masën 100% i vlerës së dëmit të shkaktuar. Janë pranuar dhe zbatuar 13 rekomandime për vlerën 21,037,000 lekë dhe nuk janë zbatuar 3 rekomandime në vlerën 2.202.000 lekë.

b.2 Në Ministrinë e Shëndetësisë; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 183 mijë lekë, për të cilat është kërkuar zhdëmtimi në masën 100% i vlerës së dëmit të shkaktuar, e cila është zbatuar plotësisht në shumën 183 mijë lekë.

b.3 Në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 6,119,000 lekë, për të cilat është kërkuar zhdëmtimi në masën 100% i vlerës së dëmit. Realizuar pjesërisht dhe pjesa tjetër në proces.

b.4 Në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 67 mijë lekë, për të cilat është kërkuar zhdëmtimi në masën 100% i vlerës së dëmit të shkaktuar, e cila është zbatuar pjesërisht.

b.5 Në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Qarku Tiranë; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 293 mijë lekë, është zbatuar plotësisht.

b.6 Në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 13,154,000 lekë, e cila është zbatuar plotësisht.

b.7 Në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 884 mijë lekë, e cila është zbatuar plotësisht.

b.8 Në Ministrinë e Mbrojtjes; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 1,204,000 lekë, e cila është zbatuar plotësisht.

b.9 Në Ministrinë e Punëve të Jashtme; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 202 mijë lekë, e cila është zbatuar plotësisht.

b.10 Në Drejtorinë e Menaxhimit të Tokave dhe Ujërave në MBUMK; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 6,168,000 lekë, e cila është zbatuar plotësisht.

b.11 Në Administratën e Kuvendit të Shqipërisë, janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 3,874,000 lekë, e cila është zbatuar plotësisht.

b.12 Në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 3,585,000 lekë, e cila është zbatuar plotësisht.

b.13 Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 259 mijë lekë, e cila është zbatuar plotësisht.

b.14 Në Aparatin e Kryeministrit; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 618 mijë lekë, e cila është zbatuar plotësisht.

b.15 Në Fondin e Zhvillimit Shqiptar; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 7,550,000 lekë, në proces zbatimi.

b.16 Në Ministrinë e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 1,644,000 lekë, e cila është zbatuar pjesërisht.

b.17 Në Institutin e Monumenteve të Kulturës; janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 7,713,000 lekë, zbatuar pjesërisht.

Përsa i përket, zbatimit të procedurave të prokurimit me fonde publike, është kryer kontroll për zbatimin e dispozitave ligjore, duke filluar nga forma e komunikimit me ofertuesit, në llogaritjen e vlerës limit të kontratës, në respektimin e kufijve monetarë, në përgatitjen e dokumenteve të tenderit, në paraqitjen e pranimit të ofertave, në shqyrtimin, vlerësimin dhe kualifikimin e ofertuesve, në shqyrtimin e ankesave, si dhe në lidhjen e zbatimit të kontratave për punë, mallra e shërbime.

Gjatë vitit 2011 është kontrolluar zbatimi i procedurave të prokurimit, ku nga rezultatet e kontrolleve të subjekteve të evaduar rezulton se, nga 850 procedura prokurimi të zhvilluara, me një vlerë prej 28,360,372 mijë lekë, janë kontrolluar 689 prej tyre, me një vlerë prej 24,497,203 mijë lekë ose 82% e numrit dhe 86% të vlerës së fondeve të prokuruar. Nga kontrolli ka rezultuar se, për prokurimet e zhvilluara nga institucionet e kontrolluara, procedurat e hapura zënë rreth 33% të numrit dhe 81% në vlerë, procedurat me negociim pa shpallje paraprake të kontratës zënë 51% të numrit dhe 9% të vlerës etj.

Për 689 tenderat e kontrolluar rezulton se, kanë shprehur interesin dhe kanë tërhequr dokumentet e tenderit 2165 ofertues, kanë paraqitur ofertat 2079 prej tyre; kanë konkurruar 2051 ofertues ose mesatarisht 3 konkurent për një tender, janë skualifikuar 305 ofertues ose 1.5% e tyre; janë kualifikuar 1746 ofertues, janë shpallur fitues dhe kanë lidhur kontratat 745 operatorë ekonomik me një vlerë totale kontrate prej 21,166,109 mijë lekë. Si rrjedhojë e konkurrencës, është ulur vlera monetare e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike në shumën 3,331,094 mijë lekë ose në masën rreth 13.5%. Nga 689 procedura prokurimi të kontrolluara, në 497 prej tyre u konstatuan 1042 shkelje të dispozitave ligjore të cilat paraqiten:

1. Në llogaritjen e vlerës së kontratës në 97 raste.
2. Në respektimin e kufijve monetar në 23 raste.
3. Në komunikimin dhe informimin me ofertuesit në 16 raste.
4. Në përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe veçanërisht të specifikimeve teknike e të kriterëve të vlerësimit në 387 raste.
5. Në paraqitjen dhe pranimin e ofertave nga ofertuesit në 23 raste.
6. Në hapjen dhe shqyrtimin e ofertave të paraqitura, janë konstatuar 32 raste të shkeljeve të dispozitave ligjore.
7. Në vlerësimin dhe kualifikimin e ofertuesve, janë konstatuar 367 raste të shkeljes së dispozitave ligjore.
8. Në skualifikimin e ofertuesve janë konstatuar 5 raste.
9. Në sigurimin e vlefshmërisë së ofertës 8 raste.
10. Në njoftimin e fituesit 3 raste të shkeljes së dispozitave ligjore.
11. Në shqyrtimin administrativ dhe zgjidhjen e ankesave 9 raste të shkeljes së dispozitave ligjore.
12. Në lidhjen e kontratave dhe marrëdhëniet me nënkontraktorët 42 raste të shkeljeve të dispozitave ligjore, duke vepruar në kundërshtim me kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratave,

13. Në zbatimin e kontratave nga kontraktorët dhe nënkontraktorët, në përputhje me kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratave të lidhura 24 raste të shkeljes së dispozitave ligjore.

14. Në arkivimin e dosjeve për tenderat e zhvilluar 9 raste të shkeljes së dispozitave ligjore në fuqi.

B.3 Departamenti i Kontrollit të Zbatimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Publike.

Gjatë vitit 2011, ky Departament ka evaduar 67 kontrole të ushtruara në ministri, bashki, prefektura, këshilla qarqesh, komuna, agjenci qendrore dhe zyra rajonale të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, njësi të ndryshme buxhetore etj.

Nga totali i kontrolleve, në 54 prej tyre janë konstatuar dhe evidentuar **shkelje me pasojë dëm ekonomik në vlerën prej 327,227 mijë lekë**, vlerë e cila është rekomanduar të dëmshpërblehet në masën 100%.

Sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar shkeljet me dëm ekonomik, ka rezultuar:

1) Në sektorin e tatim taksave, për mospagesën e detyrimeve tatimore nga subjektet në vlerën 44,542 mijë lekë ku përmendim:

- Bashkia Elbasan 111 mijë lekë, detyrime të pa arkëtuara nga subjektet.
- Njësia Bashkiake Nr. 3 Tiranë 2 mijë lekë, mosarkëtim tatimi në burim.
- Njësia Bashkiake Nr. 10 Tiranë 6 mijë lekë, mosarkëtim të tatimit mbi të ardhurat.
- Bashkia Tiranë 7,592 mijë lekë, për përfitim dy herë të t.v.sh. dhe përqindje për tarifa studim projektimi.
- Komuna Vllahinë Vlorë 755 mijë lekë, për tarifën e ujit të pishëm.
- Këshilli i Qarkut Lezhë 35 mijë lekë, paguar më pak tatim mbi të ardhurat.
- Bashkia Fush Krujë 194 mijë lekë, paguar më tepër detyrim OSSH.
- Bashkia Sarandë 214 mijë lekë, taksa vendore të pa paguara.
- Bashkia Pogradec 265 mijë lekë, taksa vendore të pa paguara.

- Bashkia Ballsh 145 mijë lekë, për mosmbajtje të tatimit në burim.
- Bashkia Sukth 262 mijë lekë, për mosmbajtje të tatimit në burim.
- Bashkia Durrës 83 mijë lekë, për mos llogaritje dhe pagesë të t.v.sh.
- Bashkia Patos 16 mijë lekë, për mosmbajtje të tatimit në burim mbi të ardhurat.
- Bashkia Fier 860 mijë lekë, për mospagesë taksë reklame dhe ndërtesë.
- Bashkia Fushë Arrëz 720 mijë lekë, për mospagim të taksës së fjetjes.
- Bashkia Lushnjë 1,890 mijë lekë, për mospagesë të taksës mbi pasurinë.
- Universiteti "Ismai Qemali" Vlorë 31,392 mijë lekë, për mosarkëtim të taksës së rregjistrimit në Universitet.

2) Në sistemin e pagave dhe në fushën e shpërblimeve, nga subjekte në vlerën 38,259 mijë lekë ku përmendim:

- Komuna Bërdicë 974 mijë lekë, ku 191,459 lekë paguar pushime vjetore të pakryera, 553,883 lekë paguar jashtë kriterëve për statusin e shërbimit civil, 229,189 lekë për punë jashtë kohës normale të punës.
- Njësia Bashkiake Nr. 2 Tiranë 2,475 mijë lekë, për orë shtesë jashtë kohës normale të punës.
- Njësia Bashkiake Nr. 3 Tiranë 1,303 mijë lekë, për orë shtesë jashtë kohës normale të punës dhe mosllogaritje e tatimit mbi pagë.
- Njësia Bashkiake Nr. 6 Tiranë 1,565 mijë lekë, për orë shtesë jashtë kohës normale të punës.
- Njësia Bashkiake Nr. 10 Tiranë 90 mijë lekë, për përfitim më tepër page dhe pozicion pune.
- Këshilli i Qarkut Shkodër 310 mijë lekë, për përfitim në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1619 datë 02.07.2008
- Komuna Vllahinë Vlorë 238 mijë lekë, për përfitim dieta dhe pjesëmarrje në mbledhje e borde.
- Këshilli i Qarkut Lezhë 638 mijë lekë, për shpërblim të padrejtë si anëtar këshilli dhe biseda telefonike.

- Bashkia Fush Krujë 117 mijë lekë, për orë shtesë jashtë kohës normale të punës dhe dieta.
- Bashkia Sarandë 130 mijë lekë, për përfitim page në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe 47 mijë lekë për përfitim të padrejtë shpërblim për dieta.
- Bashkia Ballsh 852 mijë lekë, për përfitim të padrejtë orë shtesë jashtë kohës normale të punës.
- Bashkia Sukth 29 mijë për përfitim të padrejtë page dhe 257 mijë lekë për përfitim të padrejtë shpërblim udhëtime e dieta.
- Bashkia Koplik 1,276 mijë lekë, për përfitim të padrejtë page.
- Bashkia Divjakë 12 mijë lekë, për përfitim të padrejtë orë shtesë jashtë kohës normale të punës.
- Komuna Otlak Berat 10 mijë lekë, për përfitim të padrejtë për shpërblime dhe dieta.
- Njësia Bashkiake nr. 1 Tiranë 182 mijë lekë, për orë pune shtesë mbi kohën normale të punës.
- Bashkia Durrës 3,241 mijë lekë, për shpërblim të paligjshëm me rastin e festave dhe nga fondi i veçantë për punë të mirë.
- Bashkia Vau Dejës 1,816 mijë lekë, për dhënie page për funksion në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe shpërblime të kundraligjshme.
- Bashkia Patos 225 mijë lekë, shtesë në pagë për mastera dhe tituj shkencor në kundërshtim me ligjin.
- Bashkia Fier 5,378 mijë lekë, për llogaritje gabim të pagës për funksion dhe shpërblime në kundërshtim me ligjin.
- Bashkia Fushë Arrëz 54 mijë lekë, për marrje page në vend të lejes së zakonshme.
- Komuna Qendër Ballsh 5 mijë lekë, për orë pune jashtë orarit zyrtar.
- Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë 17,035 mijë lekë, për përfitim më tepër paga të punonjësve.

3) Pagesa të kundërligjshme në shpenzimet operative, në vlerën 8,393 mijë lekë ku përmendim:

- Bashkia Elbasan 418 mijë lekë, për pagesa të papërfshira në preventiv punimesh e shërbimesh dhe të pa argumentuara.
- Komuna Bërdicë 420 mijë lekë, shpenzime karburanti për autoveturën, ndërkohë që është përfituar bonusi për transportin.
- Njësia Bashkiake Nr. 2 Tiranë 519 mijë lekë, për shpenzime si karta telefoni dhe aktivitete sociale për anëtarët e këshillit të minibashkisë.
- Komuna Kolsh 220 mijë lekë, për shpenzime telefonie të kundraligjshme.
- Njësia Bashkiake Nr. 3 Tiranë 93 mijë lekë, për likujdim shpenzimi pa dokumenta justifikues të shpenzimit.
- Komuna Bërzhitë 192 mijë lekë, për shpenzime të pajustificuara për mjetet e transportit.
- Drejtoria Nr. 1 e Punëtorëve Bashkia Tiranë, në vlerën 248 mijë lekë, për vonesa në furnizim në kundërshtim me kontratën e nënshkruar.
- Njësia Bashkiake Nr. 11 Tiranë 211 mijë lekë, për likujdim shpenzimi pa dokumenta justifikues të shpenzimit.
- Komuna Dushk 186 mijë lekë, për përfitim më tepër në kundërshtim me kontratat e nënshkruara.
- Komuna Ndroq Tiranë 213 mijë lekë, për shpenzime tepër për pjesë këmbimi dhe telefonike.
- Bashkia Sarandë 1,087 mijë lekë, për shpërblime të padrejta burse dhe udhëtime e dieta.
- Bashkia Durrës 469 mijë lekë, për shpenzime të pa argumentuara operative si telefoni etj.
- Bashkia Vlorë 89 mijë lekë, blerje kontatorësh elektrik për llogari të OSSH të palikujduara bashkisë.
- Bashkia Gjirokastër 93 mijë lekë, për shpenzime të kundraligjshme telefonie dhe transmetime dokumentarësh jashtë kriterëve.

- Bashkia Roskovec 28 mijë lekë, për përfitim udhëtime e dieta në kundërshtim me VKM nr. 228 datë 13.04.2001.
- Bashkia Fier 200 mijë lekë, për dhënie ndihme të kundraligjshme.
- Bashkia Fushë Arrëz 671 mijë lekë, për furnizim me karburant në mënyrë të kundraligjshme.
- Bashkia Lushnje 1,528 mijë lekë, për shpenzime të kundraligjshme për karburant.
- Komuna Gjinar Elbasan 1,508 mijë lekë, për shpenzime të kundraligjshme për karburant dhe automjete.

4) Për dhënien me qira të pasurisë, nga subjekte në vlerën 2,840 mijë lekë, ku përmendim:

- Drejtoria e Punëtorëve Nr. 1 Tiranë 615 mijë lekë, për vonesa në arkëtimin e qirasë për objekte të dhëna me qira.
- Bashkia Elbasan 171 mijë lekë, për vonesa në arkëtimin e qirasë për objekte të dhëna me qira.
- Komuna Bërdicë 106 mijë lekë, për mosarkëtim të diferencave të qirasë së tokës dhënë operatorëve celularë me qira.
- Bashkia Sarandë 1,014 mijë lekë, për mosarkëtim qiraje dhe kamatëvonesa.
- Bashkia Gjirokastër 791 mijë lekë, për mosarkëtim qiraje për asetet e bashkisë dhënë me qira të tretëve.
- Bashkia Fier 33 mijë lekë, diferencë në arkëtimin e qirasë e kamatëvonesa.
- Komuna Qendër Ballsh 165 mijë lekë, për mospagesë të qirasë së tokës.
- Spitali Rajonal Durrës 51 mijë lekë, për mospagesë të qirasë për ambiente të marra me qira.

5) Në fushën e prokurimeve publike dhe zbatim kontratash publike, nga subjekte në vlerën 144,455 mijë lekë, ku përmendim:

- Njësia Bashkiake Nr. 6 Tiranë 13,847 mijë lekë, për diferenca të zërave të punimeve të pakryera dhe dëmshpërblim për vonesat e dorëzimit punimeve.
- Komuna Bërdicë 5,446 mijë lekë, për llogaritje gabim të fondit limit dhe moszbatim kontrate të nënshkruar.

- Bashkia Elbasan 1,334 mijë lekë për moskryerje punimesh sipas kontratave publike të nënshkruara.
- Komuna Kolsh 640 mijë lekë, për shpallje të kufirit monetar me vlerë më të lartë se fondi i miratuar.
- Njësia Bashkiake Nr. 3 Tiranë 4 mijë lekë, për shkelje procedure në blerjet me vlera të vogla.
- Komuna Bërzhitë 668 mijë lekë, për moskryerje punimesh sipas kontratave publike të nënshkruara.
- Komuna Dushk 448 mijë lekë, për moskryerje punimesh sipas kontratave publike të nënshkruara.
- Komuna Armen 851 mijë lekë, për moskryerje punimesh sipas kontratave publike të nënshkruara.
- Komuna Prezë 460 mijë lekë, për moskryerje punimesh sipas kontratave publike të nënshkruara
- Njësia Bashkiake Nr. 1 Tiranë 146 mijë lekë, për diferenca të zërave të punimeve të pakryera.
- Bashkia Tiranë 30,491 mijë lekë, për pagesa të pa argumentuara në dorëzimin e objekteve si dhe diferenca fizike në zëra punimesh të pakryera.
- Komuna Ndroq 220 mijë lekë, për përfitim të padrejtë të t.v.sh.
- Komuna Vllahinë 336 mijë lekë, për zëra punimesh të pakryera.
- Bashkia Fush Krujë 187 mijë lekë, për volume punimesh të pakryera.
- Komuna Shëngjin 4,478 mijë lekë, për zëra punimesh të pakryera dhe llogaritje gabim të fondit limit.
- Bashkia Sarandë 1,610 mijë lekë, për zëra punimesh të pakryera.
- Bashkia Kavajë 3,328 mijë lekë, për zëra punimesh të pakryera.
- Bashkia Ballsh 702 mijë lekë, për zëra punimesh të pakryera.
- Bashkia Sukth 2,765 mijë lekë, për zëra punimesh të pakryera.
- Bashkia Manëz 198 mijë lekë, për zëra punimesh të pakryera.
- Bashkia Koplík 1,917 mijë lekë, për punime të pakryera sipas kontratës së nënshkruar.

- Bashkia Divjakë 208 mijë lekë, për zëra punimesh të pakryera.
- Komuna Ksamil 1,959 mijë lekë, për punime të pakryera sipas kontratës së nënshkruar.
- Komuna Maminas 653 mijë lekë, për zëra punimesh të pakryera.
- Komuna Rashbull 39 mijë lekë, për zëra punimesh të pakryera.
- Komuna Otllak 582 mijë lekë, për zëra punimesh të pakryera.
- Komuna Pojan 405 mijë lekë, për zëra punimesh të pakryera.
- Bashkia Durrës 22,396 mijë lekë, për llogaritje tepër të vlerës së kontratës, moskryerje punimesh në afat, përfitim të padrejtë të fondit rezervë në investime etj.
- Bashkia Korçë 831 mijë lekë, për punime të pakryera sipas kontratës për ndërtime për llogari të bashkisë.
- Bashkia Shkodër 11,632 mijë lekë, për punime të pakryera sipas kontratës për ndërtime për llogari të bashkisë.
- Bashkia Gjirokastër 1,004 mijë lekë, për pagesa më tepër në situacionet e ndërtimeve për llogari të bashkisë.
- Bashkia Roskovec 42 mijë lekë, për punime të pakryera sipas kontratës për ndërtime për llogari të bashkisë.
- Bashkia Vau Dejës 592 mijë lekë, për moszbatim të kontratës së sipërmarrjes.
- Bashkia Patos 828 mijë lekë, për punime të pakryera sipas kontratës.
- Komuna Paskuqan 1,536 mijë lekë, për punime të pakryera sipas kontratës për ndërtime për llogari të komunës.
- Bashkia Fier 10,553 mijë lekë, për diferenca në përlllogaritjen e fondit limit, ofertës fituese dhe zëra punimesh të pakryera.
- Komuna Synej Kavajë 830 mijë lekë, për vlerë të shtuar në ofertë dhe zëra punimesh të pakryera.
- Këshilli i Qarkut Elbasan 1,339 mijë lekë, për punime të pakryera në bazë të kontratës.

- Bashkia Fushë Arrëz 2,659 lekë, për moslogaritje dhe mosarkëtim të sanksioneve të kontratës për vonesa në zbatimin e saj.
- Bashkia Lushnjë 13,430 mijë lekë, për volume pune të pakryera dhe mosarkëtim penalitetesh.
- Bashkia Kamëz 1,730 mijë lekë, për volume pune të pakryera sipas kontratës.
- Komuna Kashar 552 mijë lekë, për volume pune të pakryera sipas kontratës.
- Komuna Qendër Ballsh 309 mijë lekë, për volume pune të pakryera sipas kontratës.
- Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë 269 mijë lekë, për volume pune të pakryera sipas kontratës.

6) Në fushën e urbanistikës, në vlerën 87,663 mijë lekë, ku përmendim:

- Komuna Prezë Tiranë 1,736 mijë lekë, për përlogaritje të gabuar të kostos mesatare të ndërtimit.
- Komuna Bërdicë 3,723 mijë lekë, për mosarkëtim të taksës 1% të vlerës së investimit.
- Bashkia Elbasan 2,094 mijë lekë, për mosarkëtim të taksës së studimeve urbanistike dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë.
- Bashkia Tiranë 3,848 mijë lekë, për pagesë më pak të detyrimit për leje ndërtimi.
- Komuna Ndroq 472 mijë lekë, për mospagim të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
- Bashkia Fush Krujë 21,204 mijë lekë , për mospagim të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
- Bashkia Sarandë 3,570 mijë lekë, për pagesë më pak të detyrimeve për leje ndërtimi.
- Bashkia Kavajë 6,382 mijë lekë, për mospagim të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
- Bashkia Pogradec 1,058 mijë lekë, për mospagesë të detyrimeve për leje shfrytëzimi.

- Bashkia Ballsh 54 mijë lekë, për aplikim të gabuar të kostos mesatare të ndërtimit.
- Bashkia Sukth 1,137 mijë lekë, për pagesë më pak të detyrimeve për leje ndërtimi.
- Komuna Pojan 747 mijë lekë, për mosllogaritje dhe mosarkëtim të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
- Bashkia Vlorë 2,257 mijë lekë, për mosllogaritje dhe mosarkëtim të taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe gjobave për ndërtime pa leje.
- Bashkia Gjirokastrë 1,378 lekë, për mosllogaritje të saktë dhe mosarkëtim të detyrimeve për leje ndërtimi për 20 subjekte.
- Bashkia Fier 8,626 lekë, për mosarkëtim të detyrimeve për leje ndërtimi.
- Bashkia Fushë Arrëz 770 mijë lekë, për mosarkëtim të detyrimit për leje ndërtimi.
- Bashkia Lushnjë 32,330 mijë lekë, për mosarkëtim të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

7) Të tjera, në vlerën 1,075 mijë lekë ku përmendim :

- Komuna Prezë Tiranë 668 mijë lekë, për llogaritje t.v.sh. mbi vlerën e makinerive dhe pajisjeve të ujësjellësit, jo në përputhje me strukturën e kostos të punimeve të ndërtimit.
- Komuna Vllahinë 358 mijë lekë, për përfitim të padrejtë të ndihmës ekonomike.
- Bashkia Ballsh në vlerën 49 mijë lekë, për mungesë inventari ekonomik.

B.4 Departamenti i Kontrollit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit

Për vitin 2011, ky Departament ka përfunduar dhe evaduar 17 kontrolle, nga 22 të programuara, nga të cilat 11 kontrolle në degët doganore dhe DPD dhe 6 kontrolle në subjektet e tatimtaksave, nga të cilat 2 kontrolle në drejtoritë e tatim taksave vendore, Tiranë dhe Durrës.

Në këto kontrolle, objektivi kryesor ka qenë shqyrtimi i gjëndjes, konstatimi dhe evidentimi i parregullsive dhe shkeljeve të legjislacionit tatimor dhe

doganor, nga punonjësit e administratës tatimore dhe doganore, si dhe përcaktimi i masave për parandalimin e tyre në të ardhmen.

Në përfundim të kontrolleve të ushtruar, informacionet dhe aktet e kontrollit të mbajtura, përfshirë zbatimin e rekomandimeve, janë azhurnuar periodikisht në regjistrin elektronik të departamentit dhe në mbyllje të periudhës është bërë përpunimi dhe nxjerrja e të dhënave statistikore, të cilat dhe janë raportuar. Në këtë kontekst, janë konstatuar dhe evidentuar parregullsi dhe shkelje të legjislacionit fiskal në fuqi, me *efekte negative në arkëtimin e të ardhurave tatimore nga sistemi tatimor dhe doganor për llogari të buxhetit të shtetit të vitit 2011, në shumën 185,274 mijë lekë, nga të cilat 183,416 mijë lekë në sistemin doganor.*

Sipas subjekteve dhe llojit të shkeljeve ligjore ku janë evidentuar efektet negative në grumbullimin e të ardhurave tatimore, rezulton:

A. Në *organet tatimore dhe drejtoritë e tatimtaksave vendore*, janë konstatuar shkelje në vlerë totale prej 1,858,000 lekë; përkatësisht mosvendosje të penalteteve për dorëzim jashtë afateve ligjore të pasqyrave financiare (bilanceve) me vlerë 400,000 lekë dhe detyrime tatimore e taksë pasurie me vlerë 1,458,000 lekë.

B. Në *organet doganore*, janë konstatuar shkelje në vlerë totale prej 183,416,000 lekë, të cilat sipas llojeve dhe vlerave janë si poshtë:

- Detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e artikujve të ndryshëm të importuar, me vlerë 157,000,000 lekë
- Detyrime e penaltete të pa vendosura për subjekte që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv, me vlerë 13,071,000 lekë.
- Detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e autovegurave dhe motoçikletave me vlerë 5,657,000 lekë.
- Detyrime doganore të papaguara për diferencë në peshë me atë të deklaratës doganore me vlerë 6,767,000 lekë
- Penaltete të pavendosura për mospagim të t.v.sh. me vlerë 300,000 lekë dhe detyrime e penaltete të tjera me vlerë 612,000 lekë.

Sipas llojit, vlerave dhe subjekteve ku ato janë konstatuar, ato paraqitet si me poshtë:

1. Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan në vlerën 400,000 lekë, për gjoba të pavendosura për mosdorëzim në afat të pasqyrave të llogarive financiare (bilancit) dhe deklaratës vjetore të tatim fitimit.

2. Drejtoria Tatim Taksave Vendore, Bashkia Durrës në vlerën 1,458,000 lekë, detyrime tatimore dhe taksë pasurie e papaguar.

3. Dega e Doganes Kapshticë, në vlerën prej 1,263,000 lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për mos zbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm, në vlerë 479,000 lekë

- Detyrime dhe penalitete te pa vendosura për subjekte që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv, në vlerë 784,000 lekë.

4. Dega e Doganës Elbasan, me vlerë 1,978,000 lekë, përkatësisht detyrime doganore të pallogaritura e të papaguara për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm.

5. Dega e Doganës Qafë Thanë, me vlerë 11,131,000 lekë, përkatësisht:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për mos zbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm, me vlerë 2,698,000 lekë.

- Detyrime dhe penalitete te pavendosura për subjekte që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv, me vlerë 1,561,000 lekë.

- Detyrime doganore të papaguara për diferencë në peshë me atë të deklaratës doganore në vlerën 6,767,000 lekë.

- Penalitete të pavendosura për mospagim të t.v.sh., me vlerë 105,000 lekë.

6. Dega e Doganës Kakavijë, me vlerë 8,918,000 lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm, me vlerë 4,192,000 lekë.

- Detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e autoveturave dhe motoçikletave në vlerën prej 4,726,000 lekë.

7. Dega e Doganës Durrës, me vlerë 142,811,000 lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importin e mallrave, me vlerë 141,817,000 lekë

- Detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e autoveturave dhe motoçikletave me vlerë 799,000 lekë.

- Kamatëvonesa të pallogaritura në skemën e shlyerjes së t.v.sh. në vlerën 195,000 lekë.

8. Dega e Doganës Vlorë, me vlerë 5,872,000 lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për mos zbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm, me vlerë 1,067,000 lekë;

- Detyrime dhe penalitete të pa vendosura për subjekte që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv, me vlerë 4,552,000 lekë dhe detyrime te tjera me vlerë 253 000 lekë.

9. Dega e Doganës Shkodër me vlerë 7,967,000 lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importin e mallrave, me vlerë 3,542,000 lekë.

- Detyrime dhe penalitete të pa vendosura për subjekte që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv, me vlerë 4,066,000 lekë

- Kamatëvonesa te pallogaritura në likuidimin e detyrimeve jashtë afatit ligjor në vlerën 359,000 lekë.

10. Dega e Doganes Lezhë, me vlerë 481,000 lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve në importin e disa artikujve të ndryshëm, me vlerë 349,000 lekë.

- Detyrime doganore te papaguara ne zhdoganimin e automjeteve me vlerë 132,000 lekë.

11. Dega e Doganes Korçë, me vlerë 2,995,000 lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve në importin e disa artikujve të ndryshëm, me vlerë 887,000 lekë.

- Detyrime dhe penalitete të pavendosura për subjekte që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv, me vlerë 2,108,000 lekë.

I.4 Rekomandimet e bëra dhe zbatimi i tyre.

Bazuar në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, KLSH, për të gjitha të metat, parregullsitë dhe shkeljet e ndryshme të ligjshmërisë dhe ato financiare me pasojë dëm ekonomik, të konstatuara gjatë vitit 2011 dhe të pasqyruara në raportet respektive të kontrolleve të këtij viti; u ka dërguar zyrtarisht subjekteve të kontrolluar raportet përfundimtarë të kontrolleve së bashku me rekomandimet për përmirësimin e gjendjes. Njëkohësisht me to, janë njoftuar edhe ishtitucionet qëndrore eprore, në disa raste edhe organet më të larta shtetërore.

Krahas sigurimit të cilësisë në procesin kontrollues dhe përmirësimit cilësor të përmbajtjes të materialeve të kontrollit, objektiv prioritar i yni ka qenë *ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara*. Cilësoj se, rekomandimet e bëra për përmirësimin e gjëndjes dhe ndjekja e realizimit të tyre përbëjnë një ndër objektivat kryesor të veprimtarisë së KLSH.

Detyrat (masat) e rekomanduara kanë qenë të karakterit organizativ, të propozimeve për ndryshime apo përmirësim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, të zhdëmtimit, administrative dhe disiplinore.

Për të përmbushur objektivin e parashikuar për vitin 2011 në drejtim të realizimit të masave të rekomanduara, kemi parashikuar dhe zbatuar një sërë masash, duke filluar nga puna për kthimin e përgjigjeve nga subjektet objekt kontrolli, rritja e kërkesës së llogarisë ndaj punonjësve të institucionit të ngarkuar me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të tyre dhe deri në rikontrollin e zbatimit të detyrave të lëna në kontrollin e mëparshëm në vetë subjektet e

kontrolluar. Krahas detyrimit ligjor të kontrolluar për kthimin e përgjigjeve për masat e marra brenda 20 ditëve nga marrja e tyre nga subjektet e kontrolluar, KLSH, në të gjitha programet e kontrollit ka parashikuar pikë të veçantë **“rikontrollin e detyrave të lëna”**. Përveç kësaj, brenda numrit të kontrolleve të përvitshme, kemi përcaktuar që në fillim dhe në fund të çdo viti, të gjithë departamentet e kontrollit me programe pune të veçanta të ushtrojnë kontrolle për zbatimin e detyrave të lëna.

Vlen të theksohet se, në drejtim të rritjes së nivelit të zbatimit të masave përmirësuese të rekomanduara nga KLSH, ka ndikuar ndjeshëm Urdhëri i Kryeministrit nr.70, datë 18.4.2006 “Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ e Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit e të Ministrive”. Pasqyrojmë se, gjatë vitit 2011 është konstatuar se, për lloje të ndryshme rekomandimesh, niveli i zbatimit të këtij Urdhëri ka qenë i ndryshëm.

Nga 147 kontrolle (152 gjithsej minus 5 kontrolle tematikë për zbatimin e rekomandimeve), të evaduar gjatë vitit 2011, është ushtruar kontroll me objekt verifikimin e zbatimit të masave të rekomanduara në 136 prej tyre, ose në masën mbi 92.5%.

Më konkretisht, niveli i realizimit të masave të rekomanduara për vitin 2011, sipas llojit të masave të rekomanduara, paraqitet:

1. Masat me karakter organizativ:

Nga 1605 masa të rekomanduara gjithsej janë zbatuar plotësisht 1093 prej tyre, pjesërisht 15, në proces 184 dhe nuk janë zbatuar 278 masa, ndërkohë që 35 nuk janë verifikuar nga ana e jonë, pra përqindja e realizimit rezulton në masën 69% (1108:1605).

Në krahasim me një vit më parë (2010), ndonëse numri i masave të rekomanduara është rritur me 80 rekomandime (1605-1525), niveli i realizimit të tyre ka pësuar rënie. Kështu, nga 82.3% niveli i realizimit të rezultuar në

vitin 2010 (1256:1525), në vitin analizues 2011 ky nivel ka rezultuar në masën 69%, pra me një diferencë në ulje prej 13.3 pikë përqindje.

Institucionet për të cilat aplikohet Urdhëri i Kryeministrit nr. 70, datë 18.4.2006 dhe që kanë nivelin më të ulët të zbatimit të këtyre rekomandimeve janë: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me 4 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 8, Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit me 8 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 14, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me 3 masa organizative të pazbatuara nga 11, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me 2 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 11, Ministria e Financave me 2 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 4 etj.

2. Masat për shpërblimin e dëmit ekonomik:

Nga vlera e përgjithshme e dëmit ekonomik prej 7 miliardë e 27 milionë lekë rekomanduar për shpërblimin e dëmit të evidentuar, *deri në fund të vitit 2011 janë nxjerrë urdhërat përkatës për shpërblimin e dëmit dhe janë në proces arkëtimi rreth 667 milionë lekë, ose në masën 9.5% të vlerës gjithsej të rekomanduar për shpërblimin e dëmit.*

Peshën kryesore në mosarkëtimin vlerave të dëmit ekonomik të shkaktuar e kanë Albpetrol sh.a me një dëm të konstatuar në vlerën 3 miliardë e 937 milionë lekë dhe OST Energji Tiranë me 1 miliardë e 924 milionë lekë, në total 5 miliardë e 861 milionë lekë.

Ndonëse në krahasim me vitin 2010, vlera për shpërblimin e dëmit është disa herë më e madhe, përkatësisht në vlerë 5 miliardë e 413 milionë lekë (7,027 milionë lekë – 1,614 milionë lekë), niveli i realizimit të shpërblimit të dëmit rezulton disa herë më i vogël, më konkretisht; nga rreth 49% (787:1,614) të rezultuar në vitin 2010, në 9.5% në vitin 2011. Edhe nga krahasimi i vlerave absolute të raportuara për shpërblimin e dëmit në vitin 2010 përkatësisht 787 milionë lekë, kundrejt 667 milionë lekë në vitin 2011, rezulton se në vitin 2010 janë dëmshpërblyer 120 milionë lekë më tepër.

3. Masat administrative dhe disiplinore:

Bazuar në përcaktimet në Ligjin Organik të KLSH i ndryshuar, ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, në “Kodin e punës”, ligjin për prokurimin publik, për urbanistikën, për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, për kontabilitetin etj., për parregullsitë dhe shkeljet e ndryshme të konstatuara me apo pa dëm ekonomik, KLSH, u ka rekomanduar subjekteve të kontrolluar dhe organeve respektive të emërtesës, shqyrtimin dhe marrjen e masave administrative dhe disiplinore ndaj punonjësve shkaktarë përgjegjës. *Nga 720 masa të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar 536 prej tyre, ose në masën 74.4%.*

Në krahasim me një vit më parë, numri i masave të rekomanduara është ulur me 127 masa rekomanduese (720-847), gjithashtu niveli i realizimit ka pësuar rënie. Kështu, nga 80.8% niveli i realizimit të rezultuar në vitin 2010 (685:847), në vitin analizues 2011 ky nivel ka rezultuar në masën 74.4%, pra me një diferencë në ulje prej 6.4 pikë përqindje.

Institucionet për të cilat aplikohet Urdhëri i Kryeministrit nr.70, datë 18.4.2006 dhe që kanë nivelin më të ulët të zbatimit të këtyre rekomandimeve janë: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me 4 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 13 të rekomanduara, Fondi Shqiptar i Zhvillimit 0 të pazbatuara nga 17, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan 0 nga 10, Dega e Doganës Qafë Thanë 0 nga 10, Dega e Doganës Durrës 0 nga 9 etj.

4. Propozimet për ndryshime apo përmirësime ligjore

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese në vitin 2011, *KLSH ka përgatitur dhe dërguar në strukturat respektive 45 propozime (1 propozim i korrespondon 1 akti) për ndryshim apo përmirësim të dispozitave ligjore në fuqi. Nga totali i propozimeve të rekomanduara, janë zbatuar plotësisht 22 prej tyre, 13 janë në proces zbatimi, 9 rezultojnë të pazbatuara, kurse 1 propozim nuk është verifikuar. Duke i klasifikuar propozimet për ndryshime dhe përmirësime ligjore sipas institucioneve të ngarkuar me përgatitjen dhe*

paraqitjen e tyre, si dhe ecurinë e zbatimit të tyre deri në fund të vitit 2011, rezulton:

Nr.	SUBJEKTI	Propozuar	Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar	Papërgjigje
1.	MTKRS Tiranë	3	-	-	3	-
2.	Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit	3	1	-	2	-
3.	Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit	1	-	-	1	-
4.	Ministria e Brëndshme	1	1	-	-	-
5.	Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	2	2	-	-	-
6.	Banka e Shqipërisë	3	3	-	-	-
7.	QSUT “Nënë Tereza”	1	1	-	-	-
8.	Instituti të Përndjekurve Politikë	3	-	3	-	-
9.	MF (për borxhin publik)	3	2	-	1	-
10.	Ministria e Financave	3	1	2	-	-
11.	Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave	3	3	-	-	-
12.	DP e ISKSH	2	-	2	-	-
13.	MPÇSSH	1	1	-	-	-
14.	Instituti i Monumenteve të Kulturës	3	3	-	-	-
15.	Bashkia Shkodër	1	1	-	-	-
16.	Agjencia Rajonale e Mjedisit, Qarku Durrës	2	2	-	-	-
17.	Autoriteti Portual Durrës	2	-	2	-	-
18.	KESH sh.a. Tiranë	1	-	-	1	-
19.	Ministria Shëndetësisë	1	-	1	-	-
20.	Enti Kombëtar i Banesave	1	-	1	-	-
21.	Agjencia Rajonale e Mjedisit, Qarku Tiranë	2	1	1	-	-
22.	Drejtoria e Shërbimit Trupit Diplomatik	1	-	1	-	-
23.	DP e Doganave	1	-	-	-	1
24.	DP e Tatimeve	1	-	-	1	-
	GJITHSEJ:	45	22	13	9	1

Institucionet që kanë nivelin më të ulët të zbatimit të këtyre rekomandimeve janë: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit me nga 3 rekomandime të pazbatuara, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit dhe Ministria e Brendshme me nga 1 rekomandim të pazbatuar.

Krahas përgjegjësisë së institucioneve të kontrolluara për moszbatimin e rekomandimeve të KLSH të cituar më sipër, përgjegjësi kanë edhe punonjësit e departamenteve të kontrollit, kryekontrollorët, drejtorët e departamenteve të kontrollit deri te Drejtori i Përgjithshëm, të cilët nuk i kanë ndjekur me përgjegjshmëri dhe këmba këmbës zbatimin e rekomandimeve dërguar subjekteve të kontrolluar. Jo për justifikim, por është fakt se mangësitë e punës në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dërguar nga KLSH, lidhen dhe me gjendjen e pasivitetit dhe të pritshmërisë të një pjese të konsiderueshme të punonjësve të KLSH me mbarimin e mandatit të ish Kryetarit të KLSH në fund të muajit tetor 2011.

II. Mbikëqyrja e auditimit të brendshëm.

Drejtim tjetër i rëndësishëm i veprimtarisë së KLSH për vitin 2011 ka qenë vlerësimi i funksionimit të auditimit të brendshëm, parë edhe në kontekstin e zbatimit të detyrimit ligjor dhe të standarteve të auditimit.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 7 i Ligjit Organik të KLSH, gjatë vitit analizues, në nive qëndror, kemi ushtruar:

- *Mbikëqyrjen e funksionimit të auditimit të brendshëm në 17 subjekte si: Ministri, Universitete Shtetërore, Drejtori të Përgjithshme, Institute etj.; dhe*
- *Vlerësimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm në 7 institucione.*

Ky proces vlerësimesh dhe mbikëqyrje, arritjet dhe dobësitë apo shkeljet ligjore të vërejtura në organizimin dhe funksionin e shërbimit të auditimit të brendshëm publik, janë pasqyruar në Raportet Përfundimtare të Kontrollit që u janë përcjellë së bashku me rekomandimet përmirësuese përkatëse subjekteve të audituara.

Ndër arritjet dhe progresin e bërë në auditimin e brendshëm: nënvizojmë harmonizimin e kuadrit ligjor me praktikat më të mira dhe standardet profesionale të Institutit të Audituesve të Brendshëm (IIA Florida), e reflektuar kjo në:

- bashkërendimin e përgjithshëm të veprimtarisë së auditimit të brendshëm;
- ngritjen dhe zbatimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik;
- miratimin e politikave, manualeve, metodave, procedurave, udhëzimeve, të tilla si:

- Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, ndryshuar me ligjin nr. 10138, datë 16.09.2010;

- Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 640, datë 11.06.2009 “Për miratimin e Letër Politikave të KBFP dhe planit të veprimit” dhe nr. 806 datë 6.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së auditimit financiar”;

- Manualin e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, miratuar me Urdhrin nr. 69, datë 29.09.2010 të Ministrit të Financave; dhe

- Trajnimin e vijueshëm dhe edukimin e përditësuar të njohurive, etj.

Megjithatë, nga kontrollet e kryera janë konstatuar dhe *mangësi, të meta dhe shkelje në rregullimin dhe eficiencën e shërbimit të auditimit të brendshëm publik*, të cilat janë pasqyruar në Raportet Përfundimtare të Kontrollit. Ndër shkeljet kryesore apo më tipike paraqesim:

a) *Në disa subjekte publike nuk janë ngritur njësitë e auditimit, kjo për shkak të indiferentizmit, paqartësive dhe mungesës së kriterëve rigoroze detyruese, mbi ngritjen e këtij shërbimi të dhënies së sigurisë publike. Për këtë KLSH i ka rekomanduar Ministrisë së Financave që “të përcaktohen me një akt të veçantë ligjor kriteret e detyrueshme për themelimin e strukturave audituese në entitetet e sektorit publik”. Në zbatim të këtij rekomandimi, MF ka përgatitur Projekt-Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për ngritjen e strukturave të auditimit të brendshëm në subjektet e sektorit publik” dhe kjo çështje është në proces.*

b) Në disa institucione qëndrore janë evidentuar *probleme dhe mangësi konceptuale në organizimin e këtyre strukturave, e shprehur kjo si në emërtimin e strukturës, ashtu dhe në varësinë e tyre* (emërtesa administrative dhe e raportimit) në kuadër të entitetit publik.

c) Në disa raste të tjera, është vërejtur një moskuptim i saktë i rolit dhe misionit të auditimit të brendshëm nga niveli i lartë i menaxhimit. Kështu, edhe pse janë shndërruar në struktura të auditimit të brendshëm, *nuk janë të pakta rastet kur këto njësi veprojnë ende si struktura të KONTROLL-REVIZIONIT apo ushtrojnë funksionin e inspektimit financiar*. Gjithashtu, në disa raste, organizimi i strukturave nuk ka qenë në pajtueshmëri të plotë me kuadrin ligjor e procedural që rregullon auditimin e brendshëm, përderisa audituesit janë atashuar pranë departamentit ekonomik, duke humbur sensin e pavarësisë funksionale.

▪ Lidhur me çertifikimin e audituesve, nuk ka gjetur zbatim detyrimi i përcaktuar në nenin 19 të ligjit nr. 9270, datë 23.4.2007, ku shprehimisht cilësohet se: *“Audituesit, jo më vonë se 2 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, (d.m.th pas shtatorit 2009) duhet të jenë të pajisur me çertifikatën “Auditues i brendshëm në sektorin publik”*.

Nga analiza e të dhënave të evidencës vjetore të vitit 2010, vërehet, se nga 406 persona që punojnë në auditim në shkallë sistemi gjithsej, janë çertifikuar 277 punonjës, ose 68,2% e tyre.

Niveli i certifikimeve për disa institucione publike me rëndësi, paraqitet si më poshtë:

-Sistemi i Ministrisë Punëve Publike dhe Transportit 72%, (7ët paçertifikuar nga 28 të punësuar gjithsej); Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve 57%; Sistemi i METE-s 57%; tre subjekte të vartësisë së MBUMK; Instituti i Sigurimeve Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) me 50%; ISSH ka 15 të çertifikuar nga 18 të punësuar në auditim; QSUT “Nënë Tereza” me 3 auditues të çertifikuar nga 5 të punësuar etj.

Kjo gjendje ka vazhduar edhe per 9-mujorin e vitit 2011, ku rezulton se nga 406 auditues të punësuar në sektorin publik, 332 prej tyre ose 81% janë të çertifikuar; 74 prej tyre, ose 19% janë të pa çertifikuar, madje nga keta 15 prej tyre janë në procesin e ndjekjes së trajnimeve dhe kualifikimeve për efekt çertifikimi dhe 59 tjerë nuk janë çertifikuar dhe nuk ndjekin trajnimin dhe kualifikimin respektiv.

▪ Frekuencat e auditimit.

Nga verifikimi i pasqyrave të evidencës statistikore dhe raportimeve vjetore, rezulton se 86 subjekte që përbëjnë 4.4% e numrit të përgjithshëm, janë objekte që nuk janë audituar dhe rezultojnë me tejkalim të afatit 2 vjeçar, duke mos përmbushur kriteret e pikës 9, seksioni I të Manualit të Auditimit të Brendshëm të Sektorit Publik, miratuar me VKM nr. 345, datë 01.06.2004. Kontrolli vëren se një numër më të konsiderueshëm në këtë kuadër zënë 5 entitete publike me 72 subjekte ose 83% të kësaj prapambetje, te tilla si 27 subjekte të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, 15 subjekte të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë, 18 të Ministrisë së Punëve të Jashtme, 5 të INSTAT-it etj.

▪ *Në mjaft raste njësitë e auditimit të brendshëm funksionojnë më shumë si njësi inspektimi, sesa si shërbime të dhënies së sigurisë dhe këshillimit, sikundër përcaktojnë dhe Standardet për praktikat profesionale të Institutit të Audituesve të Brendshëm të SHBA.*

Nga analiza dhe studimi i të dhënave vërtetojmë se:

Së pari: për të gjithë sektorin publik ka një rënie të ndjeshme të numrit të objekteve të programuara, krahasuar me periudhat e mëparshme. Kështu, nga 2813 objekte të planifikuara në vitin 2007, në 2034 në vitin 2008, 2294 në vitin 2009 dhe vetëm 1961 objekte të programuara për vitin 2010, pra në vitin 2010 janë programuar 333 objekte më pak se sa në vitin 2009.

Së dyti: Në aktivitetin e auditimit publik gjatë vitit 2010, njësitë e auditimit të brendshëm të sektorit publik janë fokusuar nga auditimet tematike dhe mbikëqyrjet. Këto tregues shpjegojnë se, pavarësisht faktit që në përbërje të

Ministrisë së Financave është krijuar Drejtoria e Inspektimit Financiar, përsëri nga strukturat e auditimit vijohet të shpenzohet shumë energji dhe kohë, duke u fokusuar si njësi dhe autoritete të inspektimit sesa në misione vlerësuese të brendshme, përmes auditimeve tërësore të bazuara në materialitetin dhe shkallën e rrisqeve të vlerësuara paraprakisht për sistemet.

Nga analiza e të dhënave vjetore 2010, vërejmë se në shkallë sektori publik: Auditimet tematike dhe mbikëqyrjet në planin e përgjithshëm përfaqësojnë 38,4% të tij dhe në realizim përfaqësojnë 58,5% të misioneve të kryera gjithsej.

Pasqyra e realizimit të planit të auditimeve tregon një tendencë të përgjithshme drejtë auditimeve tematike dhe mosrealizim të planit të auditimeve të plota. Kështu: Ministria e Mbrojtjes, për vitin 2010 ka realizuar auditimet gjithsej në masën 63%, kurse ato të plota në masën 21,3%; Ministria e Turizmit, Kulures, Rinise dhe Sporteve, ku auditimet gjithsej janë realizuar në masën 200%, kurse ato të plota 64,1%; Ministria e Arsimit dhe Shkencës, auditimet gjithsej janë realizuar në masën 240%, kurse ato të plota 100% etj. Në Institutin e Monumenteve të Kulturës Tiranë për vitin 2009 janë programuar vetëm 70% e objekteve (nga 10 objekte që i nënshtrohen detyrimit), kurse për vitin 2010 dhe 2011 ky nivel programimi ishte vetëm për 40% të këtij numri.

Gjithashtu, nga kontrollet e kryera është konstatuar se njësitë e auditimit nuk kanë kryer verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim që vjen në kundërshtim me kreun V, pika 1 të Urdhrit të Kryeministrit nr. 70, datë 18.4.2006 *“Për masat në zbatim të rekomandimeve të KLSH, auditimit të brendshëm dhe Departamentit të kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në institucionet në varësi të Kryeministrit dhe Ministrive”*

Kjo vërehet p.sh nga kontrollet e kryera në Drejtorinë e Përgjithëshme të Burgjeve, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, etj.

- *Indikatorët krahasues të zbulimeve nga auditimi dhe përfaqësimi numerik.*

Nga analiza e këtyre treguesve të llogaritur, vërejmë se:

- Numri i audituesve në Institucionet Qendrore zë 26% të numrit të përgjithshëm të audituesve publikë,
 - Kontributi i tyre në zbulimin e shkeljeve të ligjshmërisë është 84%;
 - Zbulimet mesatare vjetore për një auditues gjatë vitit 2010 janë më të lartat, 26,886 mijë lekë/për një auditues. Këto fakte ilustrojnë efijencën e këtyre strukturave.
 - Numri i audituesve në Subjektet e Varësisë së Ministrive të linjës zë 46% të numrit të përgjithshëm të audituesve publikë;
 - Kontributi i tyre në zbulimin e shkeljeve të ligjshmërisë është 13.8%;
 - Zbulimet mesatare për një auditues gjatë vitit janë më të ulëtat, 2501 mijë lekë/për një auditues. Këto fakte ilustrojnë apatinë e këtyre strukturave.
- Cilësojmë se, ndonëse numri i audituesve në Institucionet Vendore zë 21% të numrit të përgjithshëm të audituesve publikë;
- Kontributi i tyre në zbulimin e shkeljeve të ligjshmërisë janë të papërfillshme, vetëm 2.2% e tyre;
 - Zbulimet mesatare për një auditues gjatë vitit janë të pajustificueshme, 705 mijë lekë/për një auditues. Këto fakte ilustrojnë mungesën e efijencës së këtyre strukturave.

▪ *Mbi dhënien e opinionit të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm nga KLSH në Kuvend “Për buxhetin konsuntiv”.*

Në kuadrin e opinionëve që KLSH jep për saktësinë e Raportëve që Ministri i Financave paraqet në Kuvend “Për zbatimin e buxhetit konsuntiv” pjesë e raportimeve është dhe raporti “Mbi gjendjen e sistemeve të menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, në zbatim të Ligjit Organik të Buxhetit dhe të Ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Ky i fundit ka hyrë në fuqi në Janar të vitit 2010 dhe nga Ministria e Financave janë hartuar një sërë aktesh rregullative për implementimin e konceptëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik.

E parë në këtë këndvështrim kjo reformë është në hapat e para dhe në proces konsolidimi të mëtejshëm.

KLSH si stukturë e auditimit të jashtëm në sektorin publik luan një rol të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit dhe forcimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet e kontrollit.

Sa më sipër, gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese në vitin 2012, që në fazën e programimit të kontrollit do të përfshihet në programin e kontrollit si drejtim i veçantë kontrolli “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, e detajuar në nënpika në drejtim të vlerësimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm që janë:

- A. Mjedisi i kontrollit
- B. Menaxhimi i riskut
- C. Aktivitetet e kontrollit
- D. Informim Komunikimi, dhe
- E. Monitorimi.

(Kjo do të formalizohet me urdher të brendshëm të titullarit të institucionit në kuadrin e miratimit të strukturës së Raportit që KLSH do të paraqesë në Kuvend në vitin 2012).

Me synim rritjen e cilësisë së punës audituese të kontrollorëve tanë do të kryhen trajnime teorike dhe praktike për ushtrimin e kontrollit.

Në vitin 2011, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave kemi kryer një trajnim, ndërsa për vitin 2012 në kuadrin e bashkëpunimit me Njësinë Qendrore të Harmonizimit do të ndërmarim një cikël trajnimesh të kontrollorëve në përgjithësi dhe në veçanti kontrollorët të cilët do të kryejnë dhe specializohen për këtë fushë auditimi.

Po kështu në Ministrinë e Financave objekt i përvitshëm kontrolli i KLSH ka qenë dhe do të jetë vlerësimi i veprimtarisë së kësaj Ministrie për zbatimin e planit të veprimit 2010-2014 për zbatimin e letër politikave për kontrollin e brendshëm financiar publik. Ndaj, me synim trajnimin e kontrollorëve në këtë fushë, prioritet do të jetë dhe kërkesa e KLSH për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të suportuar dhe financuara nga organizmat ndërkombëtare me projekte binjakëzimi etj.

▪ Lidhur me organizimin e funksionimin e njësive të auditimit në qeverisjen vendore, gjatë vitit 2011, janë mbikëqyrur Zyrat e Auditimit në bashkitë: Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Shkodër, Sarandë, Fier, Korçë, Pogradec, Kavajë, Gjirokastrë, Kamëz, Lushnjë, Patos, Ballsh dhe komuna Rrashbull, Durrës, ku ka rezultuar:

1. Në organizimin e auditimit të brendshëm, u konstatua:

a) Mungesë standardizimi të pozicionit të auditimit, pasi nuk ka asnjë kriter orientues mbi të cilin ato do të ngrihen. Kjo mungesë standardizimi në konturimin e njësive të auditimit, nuk është shoqëruar me një politikë aktive nga MF, siç përcaktohet në Nenin 17 të Ligjit nr. 9720, ku nënvizohet se *“Njësitë e auditimit të brendshëm krijohen për të realizuar veprimtarinë e auditimit të brendshëm brenda subjekteve publike të audituara. Kriteret për ngritjen e këtyre njësive miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave”*. Më konkretisht, në 7 organe vendore të qeverisjes, njësia e auditimit është organizuar me 1 punonjës dhe është kompozuar në nivel Specialisti; në 19 organe vendore të qeverisjes, njësia e auditimit është organizuar me 1 punonjës dhe është kompozuar në nivel Zyre; në 5 bashki njësia e auditimit është organizuar me 1 punonjës dhe është kompozuar në nivel Sektor; në 4 organe qeverisje lokale, njësia e auditimit është organizuar me 2 punonjës dhe është kompozuar në nivel Sektor; në 3 bashki, njësia e auditimit është organizuar me 2 punonjës dhe është kompozuar në nivel Drejtorie; në 3 bashki njësia e auditimit është organizuar me 1 punonjës dhe është kompozuar në nivel Drejtorie tj.

b) Në një numër të kufizuar rastesh evidentohet dukuria e përfshirjes së punonjësve *me arsim të mesëm në strukturat e auditimit*, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e nenit 19 pika 2 të ligjit 9720, që përcakton shprehimisht se punësimi i audituesve bëhet sipas parimeve dhe rregullave të shërbimit civil, dhe se kandidatët për tu angazhuar në këtë funksion duhet të rekrutohen detyrimisht ata që kanë mbaruar studimet e larta universitare në njërën nga degët: ekonomi, financë, kontabilitet, drejtësi ose disiplina të tjera,

të cilat gjykohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit të nevojshme për sektorin që auditohet”. Për t’u përmendur një rast në Ndërmarrjet e varësisë së Bashkisë së Tiranës dhe një rast në Komunën Shëngjin ku janë punësuar persona që nuk kanë kryer arsimin e lartë, për të cilën kërkohet ndërhyrje e menjëhershme.

Ndërsa, në Bashkinë Patos janë emëruar dhe larguar në Drejtorinë e Auditimit gjatë një viti 8 punonjës, jo në fushën e përcaktuar në ligj. Në Komunën Rrashbull, Durrës, e cila nuk ka objekte në vartësi, zyra e auditimit funksiononte me 3 punonjës, ku me vështirësi mbulohej me punë një auditues. Po kështu edhe në Bashkinë Durrës, janë 5 auditues dhe në krahasim me objektet që kanë në vartësi dhe punën e kryer deri tani ata nuk mbulohej me punë.

Lidhur me pajisjen me çertifikatën “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, ka rezultuar se në bashkitë Elbasan, Berat, Lushnjë, Patos, Fier, Vlaç dhe Sarandë, mjaft auditues nuk ishin të pajisur me këtë çertifikatë.

2. Lidhur me *cilësinë e hartimit të programeve të auditimit*, megjithëse ka një përmirësim, përsëri janë konstatuar mangësi. Kështu, në disa raste nuk është përcaktuar plotësisht kuadri ligjor i nevojshëm, ditët efektive të punës, kostoja e auditimit për secilin auditues, siç përcaktohet në Seksionin III/II/3, të Manualit të auditimit, *si në bashkitë Patos dhe Elbasan*.

Në disa bashki nuk janë parashikuar kontrole për fondet e shpenzuara nga vet aparati, po kështu nuk është parashikuar funksionimi dhe koordinimi i strukturave të ndryshme brenda bashkisë, si ai i taksave dhe tatimeve, me urbanistikën, financën etj.

Në ndonjë rast në raportimet e auditimit për zbulime ka pasaktësi, kështu auditimi i Bashkisë Patos, raporton si zbulim në MF edhe mosrealizimin e taksave në vlerën 17,350 mijë lekë, me pretendimin se ky mosrealizim përbën evazion fiskal.

3. Zbatimi i Manualit të Procedurave, për kryerjen e auditimeve, raportimin, shqyrtimin e evadimin e materialeve të auditimit, megjithëse ka përmirësime, ende ka mangësi në moshartimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

a) Në hartimin e proces verbaleve, në disa raste nuk është vendosur dispozita e ligjit të shkelur, në kundërshtim me Kap II “Dokumentet e auditimit dhe procedurat për administrimin”, pika 5 “Proces verbali”, si në *bashkitë Durrës, Fier, Elbasan, Patos dhe komunën Rrashbull, Durrës*.

Në Bashkinë Sarandë, audituesit për shkeljet nuk kanë mbajtur asnjë proces verbal apo akt-konstatim.

b) Në përfundim të kontrollit është hartuar Memorandumi (informacion mbi përfundimet e kontrollit), por ai është identik me raportin final të auditimit, si nga numri i fletëve dhe problematika, gjithashtu, është shumë i detajuar, nuk është i qartë dhe konçiz, nga i cili, si drejtuesi i Institucionit dhe mbikëqyrësi i auditimit (KLSH), nuk mund të nxjerrin përfundime, çka bie në kundërshtim me seksionin V, pika 5, Memorandumi, si në bashkitë *Fier, Sarandë, Elbasan, Korçë, Lezhë dhe komuna Rrashbull, Durrës*.

c) Në disa raste problemet e nxjerra trajtohen vetëm në proces verbalet, apo akt-verifikimet dhe nuk trajtohen në mënyrë të përmbledhur (konçize) në raportin final, duke e bërë të vështirë për titullarin marrjen e informacionit dhe në vendimarrje, ku përmendim: *bashkitë Fier, Patos dhe komunën Rrashbull, Durrës*,

d) Masat disiplinore që propozohen ndaj personave përgjegjës, nuk janë shoqëruar me motivacionin përkatës dhe shkeljet nuk janë trajtuar në mënyrë të përmbledhur, por vetëm duke përmendur standard disa dispozita ligjore (ku pothuajse ato nuk kanë lidhje me shkeljet e konstatuara). Për pasojë nuk është zbatuar VKM nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, pika 8, si në *bashkitë Vlorë, Durrës, Lushnjë dhe Patos*.

Madje, auditimi i Bashkisë Fier për vitin 2010 ka propozuar vetëm 1 masë disiplinore dhe Bashkia Gjirokastër vetëm 2 masa. Nuk kanë propozuar dhënien e asnjë mase bashkitë Shkodër, Lushnjë dhe Durrës. Si bazë ligjore

për dhënien e masave disiplinore, ka shërbyer ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit Civil”, Kreu VII, neni 25, pika 3, shkronja “a”, ndërkohë që *punonjësit e bashkisë nuk e kanë fituar Statusin e Nëpunësit Civil.*

4. *Pas shqyrtimit të praktikës së auditimit, hartohet shkresa e evadimit, e cila i dërgohet subjektit të kontrolluar e shoqëruar dhe me raportin final të auditimit, por nuk kishte konfirmim zyrtar të këtij raporti nga subjekti i kontrolluar. Në disa raste masat disiplinore janë përfshirë në raportin final të auditimit, kur ato duhet ti shkojnë subjektit të audituar me shkresë zyrtare dhe firmë të Kryetarit të Bashkisë apo komunës, si në Bashkinë Patos dhe komunën Rrashbull, Durrës.*

5. *Në trajtimin e problemeve të mosfunksionimit të drejtorive të bashkive, për shkeljet e konstatuara, audituesit nuk i janë referuar detyrave që përcaktojnë rregulloret e brendshme të bashkive apo komunave, si në Bashkinë Patos dhe Komunën Rrashbull, Durrës.*

Në disa raste për marrjen e masave disiplinore janë vendosur dispozita ligjore të cilat nuk kanë fare lidhje, madje as llogjikë, si ligjin nr. 7697, datë 07.04.1993 “Për kundravajtjen administrative”, ligj i cili nuk parashikon masa disiplinore, si në *Bashkinë Patos.*

Nga mjaft auditues, megjithëse janë konstatuar shkelje, nuk janë rekomanduar masa disiplinore ndaj personave përgjegjës, si në *bashkitë Durrës dhe Vlorë.*

6. *Nuk janë kryer auditime tematike të veçanta për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Verifikimi i tyre ishte pjesë e auditimeve të radhës, si në bashkitë Patos, Durrës, Sarandë, Korçë, etj.*

7. *Dosjet e auditimit, në përgjithësi nuk janë plotësuar me materialin që duhet të vendoset në dosje, pasi nuk kishin kopjet e shkresave për masat disiplinore drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, nuk kishin përgjigjen zyrtare të subjekteve të audituara dhe më kryesorja nuk kishin akt verifikimet mbi zbatimin e rekomandimeve (masave të zhdëmtimit, masave organizative dhe disiplinore).*

Së fundi vlen të pasqyrohet se, kontrollet që ushtrohet mbi audituesit e bashkive dhe komunave nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë Financave, le për të dëshiruar, pasi në auditimin e Bashkisë Patos, sapo kishte ikur Auditimi i sipërcituar (Janar 2011), të njëjtën periudhë mbikëqyrën dhe kontrollorët e KLSH, dhe po të krahasosh përfundimet nga audituesit e MF nuk ka asnjë kritikë, ndërsa nga ana e kontrollorëve të KLSH, një “lumë problemesh”. Pse kjo situatë, kur standardet janë njësoj.

III. Sigurimi i cilësisë gjatë procesit të kontrollit.

Në zbatim të standarteve ndërkombëtare të kontrollit të miratuara nga INTOSAI, detyrë prioritare për strukturat e kontrollit të KLSH, ka qenë sigurimi i cilësisë gjatë procesit të kontrollit. Bazuar në problematikën, përmbajtjen dhe rezultatet e veprimtarinë kontrolluese të vitit 2011, theksojme se gjatë këtij viti është bërë një punë më e organizuar dhe më profesionale për sigurimin e cilësisë.

Në këtë drejtim ka ndikuar dukshëm njohja dhe përvetësimi më i mirë i standarteve të kontrollit dhe dispozitave ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë kontrolluese të KLSH. Po kështu, kanë ndihmuar dhe trajnimet e herëpashershme e të programuara që ka organizuar institucioni me personelin kontrollues, brenda dhe jashtë vendit, si dhe materialet e ndryshme dhe orientimet e dhëna nga SIGMA apo organizma të tjerë të auditimit për këtë çështje.

Fakti që gjatë vitit 2011, ka patur më pak materiale kontrolli të kontestuara nga subjektet e kontrolluara dhe niveli i pranueshëm i përqindjes së realizimit të detyrave të rekomanduara nga KLSH-ja në subjektet e kontrolluara, janë tregues kuptimplotë të përmirësimeve të bëra në drejtim të cilësisë së kryerjes së kontrolleve dhe përgatitjes së materialeve.

Tashmë është bërë praktikë pune, që të gjitha projektraportet dhe raportet e kontrollit të përgatitura nga grupet e kontrollit, para se të dërgohen në

subjektin e kontrolluar t'i nënshtrohen një verifikimi dhe rishikimi të hollësishëm nga Kryekontrollori, Drejtori i Departamentit përkatës të Kontrollit, specialistët dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike e Kontrollit të Cilësisë, Drejtori i Përgjithshëm dhe së fundi për vendimmarrjen Kryetari i KLSH. Gjatë këtij shqyrtimi është bërë e mundur që të përmirësohen të metat e mangësitë e konstatuara, duke filluar nga mënyra e të shprehurit dhe të renditurit të çështjeve dhe nënçështjeve, në argumentimin ligjor të shkeljeve të paraqitura si zbulime gjatë kontrollit, në argumentimin më të mirë dhe të bazuar ligjërisht të shkeljeve të dispozitave ligjore, në përcaktimin e saktë të detyrave të lëna për zbatim dhe në argumentimin e mbështetjen ligjore të projektvendimit që do të kalojë për miratim.

Bazuar në standartet e kontrollit, përgjithësisht, janë mirëpritur vërejtjet që kanë bërë subjektet e kontrolluara për materialet e kontrollit, duke i vlerësuar dhe konsideruar realisht si ndihmë për grupet e kontrollit. Ndikim pozitiv kanë pasur në këtë drejtim dhe takimet e mirëkuptimit të organizuar nga kontrollorët me subjektet e kontrolluar. Vërejtjet dhe sugjerimet e subjekteve, në të gjitha rastet, i janë nënshtruar shqyrtimit një për një, duke u reflektuar dhe në dokumentacionin e kontrollit.

Në 3/mujorin e parë të vitit 2011, është organizuar puna dhe është përgatitur raporti mbi sigurimin e cilësisë së kontrollit, i cili hartohet një herë në vit. Konkluzionet e këtij raporti u bënë pjesë e raportit të veprimtarisë së KLSH për vitin 2010, të shqyrtuar në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave në muajin prill 2011. Në mënyrë konstante është punuar për hartimin e kriterëve dhe strategjisë që do të përdoren në procesin e kontrollit të cilësisë. Për këtë qëllim i jemi referuar praktikave të organeve homologe, standarteve ndërkombëtare të kontrollit të përpunuar dhe miratuar nga INTOSAI dhe kriterëve të përcaktuara në deklaratën e Limës. Gjithashtu, këtij qëllimi i kanë shërbyer rekomandimet dhe seminarët e organizuara nga SIGMA pranë KLSH^{së}, udhëzuesit mbi kontrollin dhe sigurimin e cilësisë, të miratuar në mbledhjen e Presidentëve të SAI^{ve} të vendeve të Europës Qendrore e

Lindore, Gjykatës Europiane të Kontrollorëve dhe SIGMA^s, të zhvilluar në Letoni në mars të vitit 2004, si dhe eksperiencia e fituar nga projekti i binjakëzimit me NAO të Britanisë së Madhe dhe Gjykatën e Auditimit të Mbretërisë së Hollandës. Bazuar në këto praktika nga ana e KLSH^{së} janë hartuar e miratuar formularët përkatës që përdoren për shqyrtimin e sigurimit të cilësisë të auditimeve të kryera.

Në bazë të kësaj strategjie dhe kritereve që lidhen në mënyrë analitike me zbatimin e kërkesave ligjore dhe standarteve në procesin kontrollues, synohet të krijohen baza sa më të qëndrueshme, objektive dhe racionale për një sistem të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë sa më efektiv dhe sa më afër standarteve bashkëkohore.

Megjithë sa sipër, në këtë drejtim mbetet akoma për të bërë.

III.1 Përsa i përket punës së Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, për vitin 2011, cilësojmë:

- Dhënien e asistencës dhe konsulencës juridike për cilësinë dhe bazueshmërinë ligjore të projektvendimeve e të raporteve përfundimtare të kontrollit të KLSH. Kjo mbështetje me asistencë juridike i ka shërbyer Kryetarit të KLSH për të vlerësuar gjatë procesit të vendimmarrjes bazueshmërinë ligjore të zbulimeve dhe konkluzioneve të pasqyruara në raportin përfundimtar, bazueshmërinë ligjore dhe proporcionalitetin e rekomandimeve, si dhe zbatimin korrekt të procedurave dhe standarteve të kontrollit.
- Komunikimin dhe mbajtjen periodike të marrëdhënieve institucionale me Prokurorinë dhe institucionet e interesuara dhe Gjykatat, respektivisht për kallëzimet penale të depozituara nga KLSH dhe çështjet e përcjella në Gjykata.
- Hartimin dhe ndjekien e strategjisë dhe kritereve që lidhen në mënyrë analitike me zbatimin e kërkesave ligjore dhe standardeve në procesin kontrollues, duke synuar të krijohen baza sa më të qëndrueshme, objektive

dhe racionale për një sistem të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë sa më efektiv dhe sa më afër standarteve bashkëkohore.

- Kontribuimin për realizimin e detyrimeve të marra përsipër nga KLSH në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe raportimi për masat e marra.

- Përfaqësimin e institucionit në nismat dhe përpjekjet kombëtare antikorupsion.

Në mënyrë më analitike, gjatë kësaj periudhe analizuese Drejtoria Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, ka realizuar këto detyra:

- Ka dhënë mendim juridik për 152 dosje kontrolli, prej tyre janë shqyrtuar 140 dosje të kontrollit të ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe vlerësues, 10 auditime financiare, 1 auditim performance dhe 1 certifikim të llogarive të kryer në Gjykatën Kushtetuese.

- Për çdo dosje të kontrollit, para dhënies së mendimit juridik, është kontaktuar me grupet e kontrollit përkatëse duke kërkuar sqarimet konkrete për paqartësitë apo saktësimet në rastet e veçanta. Në mjaft raste grupeve të kontrollit i është dhënë mendimi verbalisht për përmirësimet apo ndryshimet që duheshin bërë dhe për rastet e tjera ku nuk kemi rënë dakort është dhënë mendimi me shkrim.

Duhet theksuar se mbi 98% e mendimeve të dhëna, janë marrë në konsiderate dhe janë reflektuar në materialet e kontrollit, ndërsa 2% e tyre kanë vazhduar më tej me procesin e evadimit, duke kaluar tek Drejtori i Përgjithshëm dhe më pas tek Kryetari.

- Mendimet e dhëna i janë përcjellë Departamenteve përkatëse, për ndryshime apo përmirësime të raporteve përfundimtare të kontrollit dhe projekt/vendimeve, dhe kryesisht kanë konsistuar në referenca të gabuara të akteve ligjore e nënligjore ku *për rrjedhojë grupet e kontrollit kanë nxjerrë dëme ekonomike jo të drejta dhe të sakta, apo kanë ngarkuar me përgjegjësi persona pa të drejtë.*

Ka pasur raste dhe është dhënë mendim për ndryshime në materialet e kontrollit, kur grupi i kontrollit nuk ka marrë në konsideratë dhe për pasojë nuk kanë reflektuar observacionet e ardhura nga subjektet e kontrollit, të cilat kanë rezultuar të nevojshme për ndryshim.

Në kryerjen e kësaj detyre, është synuar dhënia e mendimeve sa më efektive mbi cilësinë dhe bazueshmërinë ligjore të materialeve të kontrollit si dhe respektimi i afatit të përcaktuar në rregulloren e brendshme të KLSH. Në këtë mënyrë, Drejtoria Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, ka shërbyer si një filtër i rëndësishëm në procesin e evadimit të materialeve të kontrollit, duke rritur në një shkallë të konsiderueshme sigurinë për saktësinë, cilësinë dhe bazueshmërinë ligjore të konkluzioneve dhe rekomandimeve të kontrollit.

- Gjatë evadimit të materialeve të kontrollit në vitin 2011, në verifikimin e bazueshmërisë ligjore të materialeve të kontrollit i është kushtuar kujdes i veçantë evidentimit të akteve të reja ligjore e nënligjore të hyra në fuqi, të cilat për hir të së vërtetës në këtë periudhë kanë qënë të shumta. Në këtë mënyrë, kujdes i është kushtuar ndarjes së drejtë të periudhave në të cilat këto akte aplikohen, duke qënë se ky është pikërisht momenti kur mund të krijohet konfuzion me periudhat e kontrolluara (kemi parasysh legjislacioni i ri për prokurimet publike, kontabilitetin, regjistrimin e pasurive të paluajtëshme, koncesionet, administrimi i pronës publike etj).

- Në vazhdimësi është mbajtur kontakt me Prokurorinë e Përgjithshme si dhe është marrë pjesë në takimet e kryera në kuadrin e taskë forcës të ngritur në organin e Prokurorisë, gjithashtu janë mbajtur kontakt me Prokuroritë pranë gjykatave të rretheve në lidhje me ecurinë e proçedimeve të filluara në vijim të kallëzimeve penale.

Për vitin 2011 janë përgatitur dhe dërguar në organin e Prokurorisë 6 kallëzime penale për 13 persona, për vlerën 354 milionë lekë.

Si rregull, proceduralisht, si institucion i depozitojmë kallëzimet, bazuar në nenin 281 "Kallëzimi i bërë nga nëpunësi publik" i Kodit të Procedurës Penale. Praktika ka treguar, se koha mesatare që kalon nga momenti i depozitimit të kallëzimit nga

KLSH, deri në momentin e njoftimit të KLSH nga prokuroria për vendimin e marrë prej saj është 20 muaj.

Duhet theksuar se organet e Prokurorisë para vitit 2005, për kallëzimet e bëra nga KLSH nuk dërgonin informacione mbi ecurinë e procedimeve penale apo të pushimit të çështjeve. Këto marrëdhënie ndryshuan me nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit të datës 6 Maj 2005 midis Kryetarit të KLSH dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Nga zbatimi në praktikë i kësaj marrëveshje për KLSH ka qenë shqetësues zgjatja deri në maksimum nga ana e organeve të Prokurorisë i afateve të hetimit, pasi në vijimësi ka rezultuar se janë pushuar procedime penale pas hetimeve që gati gjithmonë zgjasnin për një periudhë rreth 2 vite që nga momenti i regjistrimit të kallëzimeve të bëra nga ana jonë. Duhet theksuar se zgjatja e vazhdueshme e afateve të hetimit deri në maksimum, bën që një pjesë e çështjeve të humbasin aktualitetin dhe në këtë mënyrë efekti parandalues i auditimit zvogëlohet.

Gjithashtu, nisur nga mënyra e parashtrimit të fakteve dhe argumenteve në *vendimet e pushimeve* të paraqitura nga prokurorët përkatës të Prokurorisë të Rretheve Gjyqësore për kallëzimet nga KLSH, jo gjithmonë kemi qenë të sigurt nëse hetimi është kryer i plotë dhe me ekspertizën e saktë për të arritur në ato vendime pushimi. Për këto shqetësime është vënë në dijeni Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr.66, datë 19.01.2010 ku i bëhen me dije problematikat e konstatuara për çështje konkrete.

Në varësi të burimeve njerëzore në dispozicion të KLSH, rast pas rasti janë bërë edhe ankimime të këtyre vendimeve të pushimit në gjykatë, apo pranë Prokurorit të Përgjithshëm. Në disa prej këtyre rasteve gjykata apo Prokurori i Përgjithshëm, ka vendosur rikthimin e çështjes për hetime të mëtejshme.

- Me autorizim të Kryetarit të KLSH, janë ndjekur proceset gjyqësore ku KLSH ka qenë palë dhe konkretisht në gjykatën e shkallës së parë në Durrës është kërkuar prishja e vendimit të mosfillimit nr. 6413 Prot. datë, 22.04.2011 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjithashtu pjesëmarrja në Gjykatën e

Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një çështje civile me paditës ish punonjës të KLSH, për të cilën gjykata dha vendimin në favor të KLSH-së.

- Vëmendje e veçantë i është kushtuar njohjes dhe azhurnimit të vazhdueshëm me dispozitat ligjore e nënligjore të kontrollorëve si kusht i domosdoshëm për njohjen dhe vlerësimin e veprimtarisë së subjekteve të kontrollit, argumentimin e zbulimeve, nxjerrjen e konkluzioneve, përgjegjësi dhe rekomandimeve përkatëse. Për këtë qëllim është përgatitur paketa “baza ligjore e përditësuar” mbi dispozitat kryesore ligjore e nënligjore në shërbim të punës kontrolluese. Në kuadër të kësaj pune janë vënë në dispozicion të kontrollorëve 80 akte të reja ligjore e nënligjore, të shoqëruara edhe me konsulta për probleme të ndryshme të dalta gjatë auditimeve.

▪ Lidhur me angazhimin e KLSH për integrimin evropian, Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit të Cilësisë, ka përgatitur përgjigjet e KLSH, për pyetjet e Pyetësorit të BE duke mbajtur marrëdhënie intensive me Ministrinë e Integritit, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë. Përgjigjet e pyetësorit për kapitujt 1, 22, 23 dhe 32 janë plotësuar dhe dërguar, sipas metodologjisë së kërkuar në ministritë përkatëse, brenda afateve që ishin kërkuar. Gjithësej nga KLSH janë dhënë përgjigje për 7 pyetje. Në vijim është bashkëpunuar për hedhjen e të dhënave në portalin përkatës dhe për verifikimin e korrektesës së versionit anglisht të këtyre përgjigjeve.

- Gjithashtu, nga kjo Drejtori është bërë në mënyrë sistematike koordinimi, mbledhja dhe sistemimi i informacionit përkatës dhe raportimi mujor në Ministrinë e Integritit, si dhe janë mbajtur kontaktet dhe është kryer raportimi për çështje të veçanta në lidhje me proceset e integritit evropian me Ministrinë e Integritit dhe partneret në Komisionin Evropian, si p.sh kontributi për përditësimin e PKZMSA për periudhën 2010–2014, pjesëmarrja dhe raportimi në takimet e Nënkomitetit ECOFIN Shqipëri – BE etj.

IV. Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet brënda dhe jashtë vendit.

Gjatë vitit 2011, KLSH ka konsoliduar marrëdhëniet me Kuvendin dhe strukturat e administratës shtetërore. Këto marrëdhënie kanë qenë korrekte, të qëndrueshme dhe transparente. Ato janë ngritur në nivel institucional dhe brenda normave kushtetuese, dhe kanë shërbyer si një mjet shumë i rëndësishëm në përpjekjet e përbashkëta të strukturave shtetërore dhe opinionit publik, për t'i prerë rrugën dukurive negative, si shkeljeve të ligjshmërisë, evazionit fiskal, shpërdorimeve dhe abuzimeve me pronën publike dhe më gjerë.

Për vitin raportues, marrëdhëniet me Kuvendin, Presidentin e Republikës, Këshillin e Ministrave, Organet e Sistemit të Drejtësisë dhe Masedian janë konsoliduar me tej.

Me Kuvendin janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me Komisionin e Ekonomisë dhe Financës, duke dërguar raportet rregullisht, buletinin tremujor të raporteve të kontrollit, në të cilin përmblihen të dhëna, zbulimet dhe rekomandimet respektive për secilin subjekt kontrolli, si dhe materiale të tjera sipas kërkesës. Në këtë Komision janë shqyrtuar, diskutuar dhe miratuar Raportet e KLSH-së për zbatimin e buxhetit dhe veprimtarinë vjetore të KLSH^{së} të vitit 2010, të cilat janë bërë edhe publike.

Me institucionin e Presidentit, përveç buletineve tremujore dhe raporteve të lartpërmendura, sipas rastit janë dërguar informacione të ndryshme për rezultatet e kontrolleve. Gjithashtu, i jemi përgjigjur në kohë çdo kërkesë për informim të ardhur nga ky institucion.

Me Kryeministrinë dhe institucionet qendrore të administratës shtetërore, marrëdhëniet kanë qenë institucionale dhe brenda normave kushtetuese. Njëkohësisht, është bashkëpunuar nga afër në disa fusha me interes të përbashkët, kryesisht në parandalimin dhe mënjanimin e dukurive negative të shpërdorimit e të korrupsionit. Gjithashtu, KLSH ka bashkëpunuar

ngushtësisht me Ministrinë e Integritimit në kuadër të hartimit e të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (trajtuar më sipër).

Me qëllim realizimin me përpikmëri të detyrave të përcaktuara në planin e punës, një drejtim i rëndësishëm i veprimtarisë institucionale të KLSH, kanë qenë marrëdhëniet me jashtë, si dhe procesi i euro-integritimit të institucionit, i cili ka shërbyer si një element shumë i dobishëm në mbështetje të punës dhe veprimtarisë së kontrollorëve.

Gjatë vitit 2011, janë realizuar me mjaft sukses disa aktivitete me rëndësi në fushat e auditimit, si dhe janë zbatuar objektivat kryesore për ndjekjen e procedurave në lidhjen e marrëveshjeve, protokoll marrëveshjeve, vizitave zyrtare, si dhe planeve të punës së KLSH, ku përmendim si ngjarje të rëndësishme:

- Zhvillimin e vizitës së përfaqësuesve të SIGMA^s në KLSH, në kuadrin e përpilimit nga Komisioni European të raportit të plotë mbi kontrollin e jashtëm në Shqipëri. Pasqyrojmë se, raporti i vlerësimit të vitit 2010, i cili u realizua në muajin prill 2011, u cilësua se do të ishte një “light assessment” si rezultat i ecurisë pozitive dhe progresit të arritur nga KLSH në fushat e kontrollit, draft/ndryshimeve të bëra në kuadrin ligjor dhe arritjes së standardeve bashkëkohore.

Gjatë vitit 2011, në zbatim të planeve të punës dhe programeve të KLSH, theksojmë pjesëmarrjen në vizita zyrtare dhe takime të rëndësishme ndërkombëtare si: vizita zyrtare e delegacionit të KLSH në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, Prishtinë. Kjo vizitë u konsiderua si mjaft informative dhe e vlefshme në përfundimin e atyre eksperiencave, të cilat ndihmojnë dhe çojnë më përpara bashkëpunimin institucional, zhvillimin e mëtejshëm të dialogut, strategjive dhe politikave për ta ngritur këtë bashkëpunim edhe në nivel rajonal.

- Takimi i Kryetarëve të Rrjetit të SAI^{ve} të Vendeve Kandidate dhe Kandidate të Mundshme për në BE, organizuar nga SIGMA dhe Gjykata e Llogarive të Turqisë në Stamboll, Turqi. Delegacioni i KLSH^{së} pati një rol mjaft aktiv në

diskutimet e zhvilluara lidhur me temat e përcaktuara, të cilat u konsideruan të një rëndësie të veçantë për ecurinë e punës së një SAI. Këto tema trajtuan çështjet lidhur me “Marrëdhëniet me Parlamentin”, “Pavarësinë e SAI^t” si edhe “Kontrollin e Cilësisë”.

- Në zbatim të projektit transrajonal të IDI^t, u ndoqën të gjitha procedurat për pjesëmarrjen në takimin mbi “Rishikimin e Auditimit”, zhvilluar në Lusaka, Zambia. Në përfundim të takimit, duhet theksuar se puna mjaft e mirë, përkushtimi dhe cilësia e punës së dy përfaqësuesëve të KLSH^{së} në përmbushjen e afateve sipas programit dhe gjatë pjesëmarrjes në aktivitet, u vlerësua edhe nëpërmjet një shkrese zyrtare falënderimi.

- Pjesëmarrja në seminarin e mbajtur në Varshavë, Poloni “Komunikimi i SAI^t me publikun dhe median”. Në këtë aktivitet u diskutuan çështje lidhur me përmirësimin e komunikimit midis SAI^t, publikut dhe medias me synim informimin e publikut me rezultatet e auditimeve. Ky seminar kishte për qëllim shkëmbimin e eksperiencave midis SAI^{ve} pjesëmarrës dhe Gjykatës Europiane të Llogarive.

- Pjesëmarrja në seminarin e mbajtur në Oslo, Norvegji “Mbi Auditimin e Menaxhimit të Mbetjeve”, ku u diskutua dhe u shkëmbyen eksperiencat e ndryshme të SAI^{ve}, njohuritë dhe praktikat më të mira lidhur me temën por edhe mënyrat e përmirësimit të tyre.

- Takimi vjetor i Bordit Ndërkombëtar të Auditorëve të NATO^s, zhvilluar në Bruksel, Belgjikë.

Vend të veçantë i është kushtuar bashkëpunimit të Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Teknologjinë e Informacionit me departamentet e kontrollit për përgatitjen dhe dërgimin në kohë të pyetësorëve dhe anketave të ndryshme si:

- “Mbi nevojat për trajnim”, dërguar sekretariatit të EUROSAL.

- “Mbi lidhjet mes SAI^{ve} dhe qytetarëve”, dërguar SAI^t të Austrisë.

- “Mbi financimin e partive politike”, dërguar SAI^t të Hollandës.

- “Mbi auditimet e performancës publike”, dërguar Gjykatës Europiane të Llogarive.
- Gjithashtu pyetësorët e INTOSAI/WGEA për auditimet e mjedisit, mbi “Llogaritë Buxhetore” etj.

IV.1 Media dhe marrëdhëniet me publikun

Gjatë vitit 2011, marrëdhëniet e KLSH me median janë karakterizuar nga zhvillime të rëndësishme, me një impakt pozitiv për veprimtarinë institucionale të KLSH, kundrejt mjeteve të komunikimit masiv. Theksojmë se, brënda harkut kohor të kësaj periudhe janë pasqyruar me mjaft objektivitet raportet dhe deklaratat e KLSH për shtyp, të cilat kanë patur jehonë në median e shkruar dhe atë audiovizive.

Kështu, vetëm media e shkruar nga fillimi i muajit janar 2011 deri në fund të muajit dhjetor 2011 ka pasqyruar në faqet e saj një numër prej 280 artikujsh, editorialesh, si dhe komentesh analitike. Fokus të veçantë mediatik duke u pasqyruar gjerësisht në faqet e para të medias së shkruar dhe edicionet e lajmeve televizive, zuri raportimi i Kryetarit të KLSH në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave, mbi aktivitetin vjetor të KLSH gjatë vitit 2010 dhe raportin për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2010.

Po kështu, janë pasqyruar me vërtetësi buletinet e kontrolleve të institucionit, në lidhje me rezultatet e kontrolleve të ndryshme, të cilat janë servitur me qëllim rritjen e transparencës me opinionin mediatik dhe atë publik në veçanti. Pasqyrojmë se është arritur një konsolidim i raporteve të komunikimit dhe bashkëpunimit me të gjithë aktorët mediatikë, duke mundur kështu një kontakt të drejtëpërdrejtë, me qëllim parandalimin e risqeve prej publikimeve të materialeve të pa autorizuara.

Nga ana e medias audiovizive janë transmetuar 100 sekuenca filmike, edicione informative, apo kronika të ndryshme televizive, si nga TV kombëtare dhe ato lokale, ku ndër më kryesoret përmendim: “Top Channel, Klan, TVSH, ALSAT, News24, TVSH, Vizion+, ShijakTv”, etj, duke sensibilizuar akoma më

tej opinionin publik, mbi rezultat e kontrolleve të ushtruara nga ana e KLSH-së.

▪ *Për kontaktet me publikun*, gjatë vitit 2011 janë zhvilluar dhe pritur në takime të ndryshme 382 qytetarë nga rrethe të ndryshme të vendit, ku një pjesë e tyre ka paraqitur dhe me shkrim ankesat për problematika të ndryshme. Në këto raste, kryesisht edhe për mosnjohje të ligjit, është ofruar asistencë juridike e përshtatshme e KLSH ndaj tyre, duke u dhënë mundësi të qartësohen për problematikën e paraqitur dhe të shmangin procedurat administrative.

Në bashkëpunim me Departamentet e tjera të Kontrollit, janë administruar me seriozitet 20 letra dhe disa e-mail nga publiku, duke respektuar rigorozisht dhe harkun kohor ligjor, të parashikuar nga Ligji nr. 8503 “Mbi të Drejtën e Informimit”.

Rezultatet e kontakteve me publikun kanë qenë tepër produktive dhe janë mirëpritur nga qytetarët për trajtimin dhe respektin tonë të treguar kundrejt tyre.

▪ *Lidhur me publikimet dhe statistikën*, gjatë vitit 2011 janë realizuar:

- Përgatitja e buletineve periodikë 3/mujorë të kontrolleve;
- Përpunimi dhe ilustrimi grafik i publikimeve të KLSH;
- Përgatitja e evidencave statistikore;
- Ndjekja dhe kryerja e procedurave të dërgimit të publikimeve të KLSH.

Për publikimet, aktiviteti është ushtruar në përputhje me objektivin parësor, atë të zhvillimit të komunikimit me faktorët kryesorë të përcaktuar në planin e 2011, si dhe veprimet e masat e planifikuara për arritjen e këtij objektiv. Në mënyrë të përmbledhur, është kryer:

- Hartimi i buletinit nr. 4 të kontrollit të vitit 2010, nr. 1, 2 dhe 3 të vitit 2011 dhe po punohet për publikimin në afat të buletinit nr. 4 të vitit 2011, për nxjerrjen, hartimin dhe botimin e të cilëve, specialistët e buletinit kanë punuar në mënyrë sistematike dhe kanë përballuar një punë voluminoze, duke arritur t'i përfundojnë ato veç e veç, në kohën e kërkuar dhe me cilësi.

Ndërsa, detyra e përpunimit dhe ilustrimi grafik u krye për raportin "Mbi veprimtarinë e KLSH për vitin 2010" dhe "Mbi zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2010".

Në punën për hartimin e këtyre publikimeve, një vëmendje dhe kujdes i veçantë i është kushtuar cilësisë, saktësisë dhe paraqitjes së materialeve, si pasojë e të cilës janë arritur nivele më të larta se sa vitet paraardhëse.

Për statistikën, për realizimin e evidencave statistikore të kontrolleve, janë mbledhur informacione nga të 4 departamentet e kontrolleve, për vitin 2010 dhe po punohet për përfundimin në afat të këtyre evidencave për vitin 2011.

Janë përpiluar evidencat e caktuara sikurse janë: evidenca e "Strukturës së subjekteve të kontrolleve të përfunduara", "Evidenca përmbledhëse e zbulimeve nga kontrollet për të ardhurat e shpenzimet", "Evidenca e masave disiplinore e administrative të rekomanduara dhe zbatimi i tyre" dhe "Evidenca e kallëzimeve penale të ngritura nga KLSH^{ia}", të cilat iu bashkëlidhën buletinit nr. 4, Raportit të Veprimtarisë dhe Zbatimit të Buxhetit 2010, si dhe buletinëve nr. 1, 2 e 3 të vitit 2011.

Me prioritet është trajtuar monitorimi i procesit të kontrollit dhe aktivitetit të KLSH, nëpërmjet teknikave statistikore, duke hartuar statistikat e vitit 2004-2010, të cilat janë vënë në shërbim të analizave të ndryshme si dhe raporteve të aktivitetit të KLSH-së.

▪ Teknologjia e informacionit, gjatë vitit 2011, në këtë fushë janë kryer këto detyra:

- Konfigurimi i sistemit të internetit, e-mail^{ave} dhe faqes së internetit, pas ndërrimit të operatorit të shërbimit të internetit dhe mbajtësit të faqes së KLSH.
- Ringritja e sistemit Network të intranetit në KLSH, me qëllim shfrytëzimin sa më të mirë të burimeve njerëzore dhe të pajisjeve elektronike (sistemi i mëparshëm u dëmtua si rezultat i një avarie në një nga serverat e sistemit).
- Mirëmbajtja e pajisjeve dhe programeve kompjuterike në institucion, si dhe asistencë teknike për stafin.

- Mirëmbajtja dhe rifreskimi i informacionit të faqes së Intranetit dhe Internetit të KLSH.
- Trajnimi i stafit auditues gjatë muajit mars mbi përdorimin e programit IDEA në kontroll.
- Përpunimi dhe hedhja e materialeve e aktiviteteve të ndryshme në Intranet dhe Internet.

V. Burimet Njerëzore, Trajnimet dhe Metodologjia

Gjatë vitit 2011, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë janë zbatuar me përpikmëri të gjitha detyrat e përcaktuara në “Programin e veprimtarisë së KLSH^{së} për vitin 2011”. Më konkretisht:

- Është kryer përditësimi i të dhënave për çdo punonjës, përpilimi i kontratave dhe hapja e dosjeve të reja për personelin e rekrutuar rishtas.
- Është përpunuar dhe sistemuar regjistri themeltar i punonjësve, si dhe është bërë hedhja e të dhënave për lëvizjen e personelit dhe plotësimin e dosjeve përkatëse të tyre.
- Është hartuar një database, i cili shërben për nxjerrjen e të dhënave kryesore për secilin punonjës të KLSH.
- Është kryer plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për deklarin e pasurisë të nëpunësve civil të nivelit të lartë, të mesëm e të ulët drejtues dhe ky dokumentacion është dorëzuar në ILDKP brenda afateve të përcaktuara.
- Në muajin Qershor 2011, është mbyllur procedura për punonjësit që kanë qenë në periudhë prove dhe në bashkëpunim me drejtorët e departamenteve dhe drejtorive përkatëse është përgatitur dokumentacioni i nevojshëm për vlerësimin e tyre.
- Në muajin Nëntor 2011, në bashkëpunim me drejtorët e departamenteve dhe drejtorive është kryer vlerësimi vjetor i stafit të KLSH. Formularët e vlerësimeve vjetore më pas janë vendosur në dosjet përkatëse të personelit.
- Ndërkohë, në bashkëpunim me Sektorin e Teknologjisë së Informacionit po koordinohet puna për hapjen e një e-maili elektronik i cili do të shërbejë si një

pikë kontakti për rekrutimin e stafit të KLSH; gjithashtu po shikohet mundësia e aplikimit për marrjen e një programi të liçensuar për burimet njerëzore.

▪ Për metodologjinë

Ka përfunduar rishikimi i udhëzimeve dhe standardeve të INTOSAI dhe më konkretisht janë përkthyer:

- Deklarata e Limës.
- Parimet themelore në Auditimin e Njësive Publike;
- Standardet e Përgjithshme të Auditimit Shtetëror;
- Standardet e Fushës së Auditimit Shtetëror;
- Standardet e Raportimit në Auditimin Shtetëror.

Është realizuar përkthimi dhe përshtatja e standardeve të sipërcituara me një terminologji sa më të saktë në gjuhën shqipe. Aktualisht ky proces është në fazën e redaktimit të materialeve.

Një risi për vitin 2011 ka qënë hartimi i disa formularëve standard për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare për institucionet buxhetore. Këto formularë do të studiohen për të parë nëse janë të zbatueshëm nga audituesit. Për këtë qëllim do të duhet të kryhen disa auditime pilote. Nëse rezultojnë se këto formularë janë të thjeshtë për audituesit dhe mbulojnë të gjitha proceset e punës, ato do të vendosen në manualin e auditimit financiar.

Një proces tjetër i rëndësishëm i metodologjisë dhe trajnimit është dhe njohja e personelit të KLSH me standardet dhe metodikat e auditimit. Ky proces kryhet me anë të trajnimeve mbi tema të ndryshme.

Një pjesë e temave të trajnimeve është mbuluar dhe referuar nga specialisti i metodologjisë. Mbi bazën e programit të trajnimeve të punonjësve për vitin 2011, specialisti i metodologjisë ka referuar temat:

- Auditimi Financiar;
- Auditimi i Performancës;
- Vlerësimi i riskut dhe materialitetit;
- Azhurnimi me rregulloren e brendshme, standardet dhe kodin etik.

▪ Trajnimi i stafit të KLSH

Trajnimi i punonjësve, veçanërisht i stafit kontrollor, ka qenë dhe mbetet një ndër objektivat prioritare. Gjatë vitit 2011, specialisti i metodologjisë në bashkëpunim me apecialistin e trajnimeve kanë implementuar metodika dhe mënyra të ndryshme trajnimi, duke synuar zhvillimin e burimeve njerëzore nëpërmjet plotësimit të objektivave të matshëm, lidhur me kualifikimin profesional të punonjësve.

Kështu, në fillim të vitit 2011 u monitoruan të gjithë pyetësorët të cilët ishin plotësuar nga stafi i KLSH^{së} në fund të vitit 2010. Në bazë të përgjigjeve të dhëna u hartua “Programi i trajnimit të punonjësve për vitin 2011”.

Në zbatim të programit të trajnimit është kryer përgatitja, zhvillimi dhe monitorimi i trajnimeve të ndryshme. Në këtë program ishin planifikuar 16 tema trajnimesh nga të cilat janë realizuar 11 tema si: auditimi financiar; auditimi i performancës; programi IDEA; njohja me IT; prokurimi publik; materialiteti dhe risku; kontabiliteti publik; urbanistika; njohja me rregullat e brendshme, standardet dhe kodin etik të KLSH etj. Ndërsa, temat sistemi doganor; ofrimi i përditësimeve teorike mbi studimin e kontratës FIDIC; mësimi i programeve financiare (Financa 5 dhe programeve të doganave); Programi Alpha; Mësimi i Programit Oracle, nuk u realizuan për arsye objektive, kryesisht mungesa e mjeteve monetare.

Në vitin 2011 për herë të parë u hartua “Programi i trajnimit të punonjësve të rinj në KLSH për vitin 2011”. Ky program kishte si qëllim trajnimin intensiv të punonjësve të rinj me tema të ndryshme si: njohja e institucionit të KLSH, proceset e punës që kryen KLSH, dokumentet standarde të KLSH, llojet e auditimit, riskun dhe materialitetin.

Duhet pasqyruar se, në vitin 2011 u aplikua një mënyre e re e përcaktimit të personelit që do të trajnohej në zbatim të “Programit të trajnimit të punonjësve për vitin 2011”. Procesi i përzgjedhjes së personelit është kryer në bashkëpunim me drejtorët e departamenteve.

Gjithashtu është hartuar dhe një database që përcaktonte personat të cilët duhen të trajnoheshin gjatë vitit 2011.

Në total janë trajnuar:

- 160 ditë/njerëz nga programi i trajnimit të punonjësve për vitin 2011;
- 27 ditë/njerëz nga programi i trajnimit të punonjësve të rinj në KLSH për vitin 2011.

Pra, në total 187 ditë/njerëz të trajnuar, ndërkohë që numri i të trajnuarve të planifikuar sipas të gjitha trajnimeve ishte 157 ditë/njerëz.

Gjithashtu, në dhjetor të vitit 2011 është hartuar, miratuar dhe shpërndarë pyetësori për nevojat e stafit KLSH për trajnim, rezultatet e të cilit do të shërbejnë për hartimin e Programit të trajnimit të punonjësve për vitin 2012.

Krahas sa më sipër, gjatë vitit 2012 do të kryhet redaktimi i standardeve të përkthyer gjatë vitit 2011 dhe konkretisht për:

- a)** dhënien e opinionëve të pasqyrave financiare për institucionet buxhetore dhe nëse ato janë të zbatueshme, do të paraqiten për miratim të Kryetari dhe më pas do të vendosen në manualin e auditimit financiar;
- b)** hartimin dhe sigurimin e strukturës së raportimit me anë të dokumenteve dhe formularëve standard që nxirren nga INTOSAI dhe EUROSAL, për të lehtësuar punën dhe gjykimin e tyre;
- c)** rishikimin e efikasitetit dhe efektivitetit të standardeve të brendshme dhe procedurave të KLSH;
- d)** zhvillimin e mëtejshëm të kontakteve për bashkëpunim me institucione të tjera (Fakulteti i Ekonomisë në Universitetin e Tiranës, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik, ITAP etj.) për realizimin e disa temave të trajnimit;
- e)** hartimin e një plani strategjik afatgjatë për trajnimet, ku të përcaktohen objektivat e trajnimeve, nevojat për trajnim, vendosja e përparësive të trajnimeve sipas institucionit dhe më pas sipas personelit, mënyra e dhënies së trajnimeve, bashkëpunimi me departamentet e kontrolleve për

pjesëmarrjen e stafit që do trajnohet dhe vlerësimi i efektivitetit të trajnuarve pas trajnimit.

f) mbajtjen e regjistrit të aftësive profesionale, ku të përshkruhet për çdo kontrollor arsimimi, kategoritë, detyrat e kryera, kualifikimet dhe trajnimet, sektorët në të cilët kanë eksperiencë pune, etj.

g) vlerësimin/monitorimin e stafit të KLSH pas trajnimit mbi aftësitë e fituara gjatë temave të ndryshme që janë kryer në KLSH.

h) hartimin e pyetësorëve për vlerësimin e trajnuesve që do të plotësohet në fund të çdo trajnimi nga personat e trajnuar dhe specialisti i kualifikimeve dhe trajnimeve etj.

▪ *Korrespondenca me ekspertë të jashtëm për trajnimin e stafit.*

Me qëllim që kontrollorët të jenë të azhurnuar me proceset edhe ndryshimet që APP po bënte, më datë 07.07.2011 është kryer trajnimi me ekspertë të huaj dhe të Agjencisë së Prokurimit Publik, për trajnimin e stafit të KLSH me temat si në vijim:

- koncesionet për shërbimet dhe punët – legjislacioni Evropian,
- marrëveshja kuadër,
- kriteret e dhënies së kontratës me theks të veçantë mbi tenderin ekonomikisht më të favorshëm,
- prokurimi elektronik në Shqipëri.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur korrespondencat me Ministrinë e Financave për trajnimin e stafit të KLSH mbi “Sistemin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm”. Trajnimi i stafit u krye në zyrat e KLSH dhe kishte si qëllim dhënien e informacionit mbi:

- Letër Politikat për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik
- Ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK)” dhe risitë.
- Ligjin nr. 9720 i ndryshuar me Ligjin nr 10318 datë 16.09.2010 “Për Auditimin e Brendshëm”.
- Ligjin nr. 10294, datë 1.07.2010 “Për Inspektimin Financiar Publik”.

- Manuali për MFK, miratuar me Urdhërin nr. 54, datë 15.7.2010, të Ministrit të Financave etj.

Gjithashtu, janë zhvilluar korrespondenca me Bankën Botërore për trajnimin e stafit të KLSH në fusha të ndryshme të auditimit.

VI. Buxheti i vitit 2011 dhe realizimi i tij.

Në zbatim të ligjit nr. 8270, dt. 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, dt. 01.06.2000, dhe në zbatim të rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Drejtoria Ekonomike ka mision të saj mbeshtetjen e aktivitetit kryesor të KLSH, për krijimin e kushteve optimale për zhvillimin normal të punës, duke siguruar bazën e nevojshme materiale dhe rezervat për vazhdimësinë e punës, miradministrimin e pasurisë së KLSH, bashkërendimin e punëve të departamenteve dhe drejtorive të KLSH, për realizimin e detyrave të ngarkuara.

Për realizimin e buxhetit, të detyrave dhe objektivave të përcaktuara për vitin 2011, Drejtoria Ekonomike ka funksionuar në bazë të strukturës së miratuar me vendimin nr. 159, datë 29.12.2010 të Kryetarit të KLSH "Për strukturën e renditjes së punëve, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave në Kontrollin e Lartë të Shtetit për vitin 2011".

Për vitin 2011, puna ka filluar me miratimin e detajimit të buxhetit të KLSH, dërguar nga Ministria e Financës me shkresën nr. 13379/157, datë 05.01.2011, dhe me qëllim disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve operative është miratuar urdhëri i brendshëm nr. 36, datë 29.12.2010 "Për ndjekjen dhe kontrollin e përdorimit të fondeve të miratuara për shpenzime operative për vitin 2011", ku ndër të tjera në pikën 4 të këtij urdhëri përcaktohen kuotat për shpenzimet për udhëtim e dieta për çdo departament dhe drejtori, pasi ky zë pjesën më të madhe rreth 63% të shpenzimeve operative. Cilësojmë se, gjatë vitit 2011 është kryer në mënyrë periodike kontrolli i shpenzimeve ditore për

rastet e prokurimeve të drejtpërdrejta si dhe të gjitha llojet e shpenzimeve të kryera me bankë dhe arke.

- Çdo muaj është bërë rakordimi i situacioneve të shpenzimeve të buxhetit me Degën e Thesarit dhe Ministrinë e Financave.

- Janë hartuar në kohë evidencat statistikore sipas formularëve përkatës.

- Raporti i shpenzimeve faktike të Institucionit sipas artikujve të buxhetit si dhe raporti i monitorimit të shpenzimeve buxhetore është hartuar çdo 3-mujor.

- Është ndjekur me përparësi zbatimi në kohë i detyrave për përdorimin me efektivitet të këtij buxheti duke respektuar kërkesat ligjore financiare. Për këtë qëllim është bashkëpunuar rregullisht me sektorin e financës, specialistët e shërbimeve dhe komisionin e blerjeve me vlera të vogla, i ngritur në fillim të vitit 2011 me urdhër të brendshëm, duke siguruar me parë ofertat më të përshtatshme, si dhe janë bërë çdo muaj rakordimet e këtyre shpenzimeve duke plotësuar evidencat përkatëse.

- Sektori i financës ka kryer me rigorozitet veprimet që kanë të bëjnë me përpilimin e dokumentacionit të bankës, arkës dhe magazinës.

- Është realizuar në afat mbyllja e bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2010. Gjithashtu, janë kryer rakordimet me Degën e Thesarit për realizimin e shpenzimeve të buxhetit, si dhe janë bërë akt rakordimet për çeljen dhe lëvizjen e fondeve buxhetore me Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Financës.

- Janë dorëzuar brenda afatit pranë Drejtorisë së Menaxhimit dhe Monitorimit të Buxhetit, raportet e monitorimit të shpenzimeve faktike, sipas programeve dhe artikujve për vitin 2010 dhe 9-mujorin e vitit 2011. Gjithashtu është dërguar brenda afatit në Ministrinë e Financave informacioni i zgjeruar mbi numrin faktik të punonjësve si dhe shpenzimet faktike për çdo element të pagës për vitin buxhetor 2010. Gjatë kësaj periudhe, sektori i financës në bashkëpunim me departamentet e tjerë ka përgatitur dhe dorëzuar brenda afatit PBA e viteve 2012-2014 për raundin e parë e të dytë, përkatësisht në muajt prill dhe gusht 2011.

Në muajn gusht, referuar tavanit të shpenzimeve përcaktuar për KLSH (në shkresën e Ministrisë së Financës nr.15409, datë 01.08.2011 dhe VKM nr.521, datë 20.07.2011), është përgatitur dhe bërë detajimi i zërave të shpenzimeve të KLSH për vitin 2012.

- Të gjitha pagesat e punonjësve si paga, dieta, paradhënie e shërbime të tjera me arkën janë kryer brenda rregullave. Janë ushtruar kontrole sistematike në arkë dhe në asnjë rast nuk janë konstatuar diferenca.

- Shërbimet jashtë vendit janë mbyllur brenda afatit dhe në fund të çdo muaji situacioni i shpenzimeve të valutës jo tregtare është dërguar në Drejtorinë e Thesarit pranë Ministrisë së Financës.

- Veprimet ekonomike që janë kryer në Institucion janë pasqyruar gjithmonë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

Dokumentet vërtetuese si faturat, fletëhyrjet, fletëdaljet, mandat-arkëtimet, mandat-pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi janë kryer në mënyrë kronologjike.

- Në fillim të vitit 2011, është dërguar brenda afatit rregjistri i realizimit të prokurimeve publike për vitin 2010 dhe rregjistri i parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2011. Gjatë vitit 2011 është mbajtur në vijimësi rregjistri i realizimit të prokurimeve publike për vitin 2011.

- Në çdo rast të prokurimeve të drejtpërdrejta dokumentacioni përkatës është përpiluar konform listës së proceseve të punës për prokurimet me vlerë të vogël.

Për vitin 2011 në KLSH është kryer vetëm një prokurim me vlerë të madhe (tender 3,531,700 leke me t.v.s.h) për blerje karburanti. Edhe në këtë rast është përgatitur dokumentacioni i nevojshem sipas listës së proceseve të punës për prokurimet me vlerë të lartë.

- Janë ndjekur në vazhdimësi kontratat me të tretët për furnizimin me energji elektrike, uji dhe telefon.

- Gjatë vitit janë kryer në kohë dhe me cilësi riparimet dhe shërbimet e pajisjeve dhe orendive në institucion për krijimin e kushteve optimale për

zhvillimin normal të punës. Po kështu menaxhimi i aktiveve në institucion është kryer në çdo rast konform akteve ligjore të miratuara.

- Dokumentet autorizuese si urdhërat e blerjeve, kontratat, urdhërat për krijimin e komisioneve, urdhër për jashtë përdorimit janë përpiluar rast past rasti, dhe është bërë kontrolli me qëllim që dokumentacioni të tregojë me vërtetësi veprimin e kryer.

Për vitin 2011 buxheti është realizuar në masën 95%. Situacioni i zbatimit të buxhetit 12-mujor për KLSH, i krahasuar me planin 12-mujor (sipas strukturës së shpenzimeve të miratuar) paraqitet si më poshtë:

Në mijë/lekë

Artikulli	Emërtimi	Plani vjetor	Realizimi 12-mujor	Në %
600	Paga	191,068	186,911	98
601	Sigurime shoqërore	25,500	25,500	100
602	Shpenzime operative	46,156	38,272	83
605	Kuote anëtarësie	131	126	96
606	Ndihmë sëmundje	276	276	100
231	Investime	3,000	2,032	68
	Totali:	266,131	253,117	95

Referuar shpenzimeve operative, vlen të përmendim se janë likuiduar në kohë të gjitha detyrimet ndaj të tretëve si për blerjet dhe për shërbimet e parashikuara në planin e 12-mujorit të vitit 2011.

Zëri “Shpenzime udhëtimi”, që zë peshën më të madhe në shpenzimet operative, për vitin 2011 është realizuar si më poshtë:

Emërtimi	12-mujori i 2011 (në 000/lek)	Realizuar në % në raport me shpenzimet operative
Dieta gjithsej	27,142	71%
Nga këto:		
Brenda vendit	24,104	63%
Jashtë vendit	3,038	8%

Në shpenzimet e kryera gjatë këtij 12-mujori për energjinë elektrike, telefoninë dhe ujë është treguar kujdes dhe korrektësi.

Krahasuar me totalin e shpenzimeve operative 12-mujore, shpenzimet për ujë, energji elektrike, telefoni fikse dhe telefoni celulare, gjendja paraqitet si në tabelë:

Nr.	Shërbime nga të tretë	12- mujori 2011 në 000/lek	Realizuar në % në raport me shpenzimet operative
1.	Ujë	29	0.07%
2.	Energji elektrike	807	2,1%
3.	Telefoni	353	0.9%
4.	Celular	862	2,3%
5.	Posta	87	0.2%
	Totali:	2,138	5,6%

Gjatë 12-mujorit të vitit 2011 është treguar kujdes për plotësimin e nevojave me artikuj të tjerë kancelarie, për mirëmbajtjen e mjedisit, për riparimin e pajisjeve etj.

Realizimi në përqindje i zërave të mëposhtëm kundrejt totalit të shpenzimeve operative paraqitet:

Nr.	Emërtimi	12-mujori - 2011 në 000/lek	Realizimi në % në raport me shpenzimet operative
1.	Materiale zyre e të përgjithshme	877	2,3%
2.	Shërbime nga të tretet	359	0,9%
3.	Mirëmbajtje të zakonshme	1,772	4,6%
4.	Shpenzime të tjera operative	439	1,2%
	Totali:	3,447	9%

Duke krahasuar shifrat e vitit 2010 me ato të vitit 2011, rezulton se në zërin “Materiale të përgjithshme zyre”, në vitin 2011 janë shpenzuar më pak 1,155 mijë lekë, dhe konkretisht këto shifra paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Nr	Shpenzime	Viti 2010 në 000/lekë	Viti 2011 në 000/lekë	Shpenzuar më pak në 000/lekë
1.	Materiale zyre e të përgjithshme	2,032	877	1,155

Po kështu duke krahasuar shifrat e vitit 2010 me ato të vitit 2011, rezulton se në zërin “Shërbime nga të tretë”, për vitin 2011 ka një kursim prej 2,805 mijë lekë.

Nr.	Shërbime nga të tretë	Viti 2010 në 000/lekë	Viti 2011 në 000/lekë	Shpenzuar më pak në 000/lekë
1.	Ujë	637	29	608
2.	Energji elektrike	1,743	807	936
3.	Telefoni	619	353	266
4.	Celular	1,695	862	833
5.	Posta	249	87	162
Totali:		4,943	2,138	2,805

Për vitin 2011, në fushën e transportit, është punuar duke zbatuar me rigorozitet urdhërat e brendshëm “Për përdorimin, administrimin dhe furnizimin me karburante të automjeteve të KLSH”.

- Është punuar për mbajtjen në gatishmëri të mirë teknike të automjeteve duke respektuar afatet e kryerjes së shërbimeve.

- Është bërë përgatitja e të dhënave dhe pajisja në kohë me taksa fikse plus siguracionin e të gjithë autoveturave.

Të gjitha shpenzimet e kryera ne fushën e transportit, si konsumi i karburantit, kryerja e shërbimit të mirëmbajtjes të automjeteve, taksat dhe siguracionet janë evidentuar për çdo muaj dhe për çdo mjet në veçanti.

Më konkretisht shpenzimet për blerje dhe shërbime në fushën e transportit paraqiten si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	12- mujori 2011 (në /000 lekë)	Realizuar në % në raport me shpenzimet operative
1.	Karburant	3531	9,2%
2.	Lubrifikante	165	0,4%
3.	Pjese këmbimi	837	2,3%
4.	Goma	125	0,3%
5.	Siguracione dhe taksa fikse	519	1,3%
6.	Shpenzime te tjera e servis	368	0,9%
	Totali:	5,545	14,4 %

Përsa i përket shpenzimeve faktike, referuar daljeve nga magazina ne fushën e transportit paraqitet situacioni si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	12- mujori 2011 (në /000 lekë)
1.	Karburant (25.980 litra)	4050
2.	Lubrifikante	183
3.	Pjese këmbimi	847
4.	Goma	140
	Totali:	5,220

Duke krahasuar sasinë e karburantit të tërhequr me atë që justifikohet me fletë-udhëtimet për 12-mujorin e vitit 2011, rezulton se nuk ka diferenca. Për vitin 2012, Drejtorja Ekonomike do të angazhohet për realizimin e objektivave prioritarë të planifikuara për vitin në vazhdim, dhe sidomos në:

- Menaxhimin efikas të burimeve monetare dhe materiale të KLSH.
- Ofrimin e kushteve cilësore të punës për zhvillimin e aktivitetit auditues dhe administrativ, me qëllim konsolidimin dhe rritjen e institucionit të KLSH si Institucion bashkëkohor.
- Hartimin e projektbuxhetit të vitit 2013; kontrollin periodik të shpenzimeve; hartimin e evidencave statistikore; hartimin e bilancit kontabël për vitin 2011; hartimin e PBA për vitin 2013-2015 etj.

VII. Veprimtaria kontrolluese për vitin 2012.

Për hartimin e programit të veprimtarisë të KLSH-së për vitin 2012, departamentet e kontrollit, si dhe departamentet e drejtoritë e aktivitetit mbështetës, gjatë muajit dhjetor 2011-janar 2012 përcaktuan masat dhe organizuan punën për përgatitjen, paraqitjen dhe shqyrtimin e projektprogrameve të vitit 2012.

Për hartimin e projektprogrameve të veprimtarisë kontrolluese, janë grumbulluar, seleksionuar dhe studjuar një sërë të dhënash të grumbulluara për çdo subjekt kontrolli për disa vite radhazi, përfshirë vitin 2011, më konkretisht; lloji dhe volumi i veprimtarisë së secilit subjekt objekt kontrolli, periudha e mëparshme e kontrolluar, rezultatet e kontrollit, cilësia dhe shkalla e zbatimit të detyrave të rekomanduara, arësyet e kontrollit duke konsideruar materialitetin dhe riskun. Gjithashtu, lidhur me zhvillimin e strategjisë së planifikimit të kontrollit, janë shfrytëzuar dhe aplikuar gjerësisht njohuritë e përfuara dhe përvoja e NAO të Britanisë së Madhe. Më konkretisht, janë hartuar dhe përpunuar tre mjete të planifikimit strategjik dhe janë përdorur e shfrytëzuar formularët standard, në të cilët sipas një sistemi vlerësimi me pikë për çdo kriter përzgjedhjeje nga 0-5, nga tërësia e kontrolleve të parashtruar, janë përzgjedhur kontrollet për vitin 2012.

Referuar llojeve të kontrollit, krahas atyre të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, vëmendja është fokusuar në konsolidimin e auditimeve financiare dhe në shtrirjen e përmirësimin cilësor të auditimeve të performancës, si auditime të përdorimit ekonomik të burimeve në aktivitetet administrative, të eficiencës së përdorimit të burimeve njerëzore, financiare e të tjera dhe të aktivitetit të performancës lidhur me përmbushjen e objektivave të subjektit të audituar. Madje, aspekti i matjes së performancës së institucioneve që kontrollohen, mund dhe duhet të shndërrohet në dobinë kryesore të punës të KLSH, krahas parandalimit të abuzimeve dhe korrupsionit.

Pas shqyrtimit në nivel Departamenti Kontrolli, të të dhënave përfshirë vlerësimet për çdo subjekt apo tematikë kontrolli, të pasqyruara në formularët e sipërpërmendur, u realizua shqyrtimi i hollësishëm dhe seleksionues i tyre në takime të veçanta me Kryetarin e KLSH-së dhe në takimin përmbyllës në rang drejtorësh. Në këtë takim u konkludua dhe u vendos përgatitja e “Programit të veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2012”, duke reflektuar në të ndryshimet e propozuara.

Në këtë program, trajtohen objektivat prioritare të institucionit, detyrimet kushtetuese dhe ligjore për raportimin në Kuvend, planifikimi strategjik i veprimtarisë kryesore (kontrolluese), duke vijuar me menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe veprimtarinë mbështetëse.

Për vitin 2012 janë *parashikuar të ushtrohen gjithsej 153 kontrole*, ku në mënyrë të përmbledhur, fushat më kryesore të ushtrimit të kontrollit konsistojnë në:

1. Zbatimin e buxhetit të shtetit në 36 institucione shtetërore në nivel qendror, nga të cilat 10 auditime financiare dhe 2 auditime pilot-çertififikim të llogarive vjetore. Në këto institucione, përparësi do t'i jepet kontrollit të përdorimit të fondeve publike të vëna në dispozicion nga buxheti dhe zbatimit të ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike.

2. Zbatimin e buxhetit vendor (përfshirë grumbullimin e taksave vendore dhe përdorimin e fondeve të vëna në dispozicion) në 37 bashki, nga të cilët 6 auditime financiare; 2 këshilla qarqesh; 3 prefektura dhe 11 komuna.

3. Vlerësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në 16 subjekte në nivel qendror dhe pothuajse në të gjithë subjektet në nivel vendor që kanë detyrimin për të kryer këtë auditim.

4. Kontrollin e zbatimit të investimeve dhe projekteve me financime të huaja në 12 projekte që i përkasin fushës së infrastrukturës, si; ndërtimin e rrugëve; në fushën e energjetikës, ujësjellës kanalizime dhe të shëndetësisë nga të cilët 1 auditim performance.

5. Kontrollin e zbatimit të legjislacionit tatimor dhe doganor, në 16 subjekte tatimore dhe doganore, kryesisht lidhur me detajimin dhe grumbullimin e të ardhurave fiskale, nga të cilët 2 auditime performance. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet kontrollit të caktimit të detyrimeve fiskale dhe rivlerësimit të tyre gjatë vitit, si dhe masave të marra për arkëtimin e borxhit tatimor dhe doganor, si dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja.

6. Kontrollin e veprimtarisë ekonomiko-financiare në 13 shoqëri anonime, në drejtim të menaxhimit dhe përdorimit të fondeve publike, nga të cilët 2 auditime performance.

7. Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, sidomos realizimin e fondeve për investime të programuara, në 7 subjekte, nga këto 1 auditim performance.

8. Kontrollin për administrimin dhe rregjistrimin e pronës publike në 6 subjekte të kësaj fushe (ZVRPP).

Gjatë kontrollit të zbatimit të legjislacionit, objekt kontrolli do të jenë edhe; zbatimi i legjislacionit në fushën e urbanistikës, dhënia e objekteve me qira dhe vjelja e qirasë, zbatimi i detyrimeve të ndërsjellta në fushën e konçensioneve, dhënia e licencave të ndryshme, zbatimi i detyrimeve të ndërsjellta në fushën e konçensioneve, etj.

Në raportin që sapo lexova, trajtova në mënyrë të përmbledhur drejtimet kryesore të veprimtarisë të vitit 2011 të KLSH. Ju me diskutimet tuaja do ti

plotësoni më mirë ato, ndaj secili nga Ju është i lirë të marrë fjalën për të prezantuar punën e tij, të drejtorisë apo departamentit, si dhe të paraqesë mendime dhe ide për përmirësimin dhe fuqizimin e veprimtarisë të punës sonë për vitin 2012.

Ju faleminderit.

*Raporti i mbajtur nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini në Analizën Vjetore të KLSH për vitin 2011

Tiranë më 20.012012

DISKUTIM NË ANALIZEN VJETORE 2011



Zyra Kepi

Kontrollore e Lartë,

Departamenti i Kontrollit të Buxhetit Qendror

Kontrollit Financiar, Auditimit të Brendshëm

Zoti Kryetar

Vizioni për ecurinë në të ardhmen është reformimi i sistemit aktual të sigurimeve shoqërore, nëpërmjet reformimit të shtyllës publike, futjes graduale dhe zgjerimit të veprimtarisë së fondeve që veprojnë në baze të kontributeve të përcaktuara, të menaxhuara nga subjekte të specializuara juridike mbi bazën e rregullave konkrete të përcaktuara me ligj të veçante.

Reforma e përgjithshme e sistemit të sigurimeve shoqërore ka për objektiva përfundimtar që të sigurojë pensione të mira për ata që paguajnë kontribute, të ofrojë nxitje për t'u futur në skemën kontributeve edhe për ata që aktualisht nuk paguajnë kontribute.

Realizimi i këtij vizioni do të kërkojë: ristrukturimin dhe reformimin e sistemit ekzistues një shtyllësh "pay-as-you-go" (kontributet e sotme paguajnë pensionet e sotme), për të bërë një lidhje më të drejtpërdrejtë midis kontributeve dhe pensioneve; kalimin gradual, me hapa të matur dhe në klimën e një pjesëmarrje dhe konsensusi të gjere drejt një sistemi shumë shtyllësh të pensioneve.

Qeveria do të krijojë kushtet për qëndrueshmërinë afatgjatë të masave për uljen e varfërisë të të moshuarit dhe do t'u japë mundësi individëve të krijojnë kursime të mjaftueshme gjatë kohës së punës për të mbajtur veten pas daljes në pension, ndër të cilat përfshihen:

- Nxitje për të rritur masën e popullsisë që i drejtohet skemave të pensioneve të kapitalizuara

- Pakësimin gradual te subvencionit të qeverisë për programet e sigurimeve shoqërore

- Kontrolli dhe rregullimi i aktivitetit të kompanive të licencuara të investimeve për t'u kujdesur që investimet të jenë të sigurta dhe të mbrojtura nga rreziqet

Përgatitja e sistemit për të kaluar drejt një sistemi shumë shtyllësh do të bëhet nëpërmjet:

- Forcimit të masave për zbatimin ligjor të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore:

- Përmirësimit të metodave për të evidentuar, kontrolluar dhe dënuar rastet e moszbatimit ligjor;

- Zbatimit të penaliteteve përkatëse në rastet e evazionit;

- Lidhjes më të mirë midis kontributeve dhe pensioneve që do të ketë për pasojë një përmirësim të masës së pensioneve në varësi të kontributeve;

- Indeksimit të pensionit maksimal me pagat dhe të pensionit minimal me inflacionin.

Duke u mbështetur në të gjithë infrastrukturën që aktualisht kanë sigurimet shoqërore, në eksperiencën e punës dhe në specializimin e stafit, në forcimin e kontrollit dhe të monitorimit të detyrave si dhe në reformat e vazhdueshme që kemi marrë dhe po zbatojmë në drejtim të përmirësimit të metodës së punës dhe rritjen e efektivitetit të punës të të gjithë punonjësve, marrim përgjegjësinë për zbatimin e këtij buxheti konform legjisllacionit dhe rregullave në fuqi. Nga ana tjetër, Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore do të informojë Këshillin Administrativ në mënyrë periodike për realizimin e buxhetit si dhe për nevojat për ndryshime.

Nga verifikimet e bëra në shkallë vendi, rezulton se një numër i konsiderueshëm, subjektsh të biznesit të madh, deklarojnë dhe paguajnë kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore vetëm për 1 person. Në

disa Drejtori Tatimore, kjo përqindje është shume e larte, si në Drejtoritë Rajonale të Tatimeve Vlore, Shkodër, Tiranë, Durrës dhe Elbasan.

Për biznesin e vogël, në shkalle vendi, raporti i subjekteve me numrin e kontribuuesve është 1 subjekt me 1,29 kontribuues. Duke iu referuar VKM nr. 1251, date 10.9.2008, ky raport do te ishte shume me i larte, mbasi edhe për bizneset me xhiro deri ne 3 milion, numri mesatar i kontribuuesve duhej te ishte me i madh.

Informalitet të theksuar ka dhe për pagat e deklaruar mbi të cilat janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Megjithëse VKM nr. 285, datë 4.5.2007, përcakton pagat referuese sipas nomenklaturave, te rretheve, degëve te ekonomisë dhe të posteve të punës, një numër relativisht i konsiderueshëm subjektesh, paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore me paga minimale. Nga analiza e bërë listë pagesave të dërguara, rezulton se rreth 18.6 përqind e kontribuuesve deklarohen dhe paguhen kontribute mepage minimale. Shpesh herë janë ndeshur dhe me raste kur nuk është respektuar edhepaga minimale e miratuar me VKM, ose për disapunonjës janë paguar kontributetpër sigurimet shoqërore, me pagën minimale te miratuar për te vetë punësuarit. Në shume raste nga ana e DRSSH-ve janë kthyer liste pagesat mepagesajo të rregulltapranë DRT.

Përqindje të larte në deklarimin dhe pagesa me paga minimale kanë Drejtoritë Rajonale të Tatimeve Berat, Dibër, Lezhë, Shkodrër, Korçë, Durrës, Kukësi dhe Vlora. Përqindjen më të ulët e kanë Drejtoritë Rajonale të Tatimeve Tiranë, Gjirokastra dhe Elbasan.

Ashtu sikurse mund të gjykohet nga këto tregues, në pagesat e kontributeve ka informalitet, për tu marrë në konsiderate. Minimizimi i tij do të rrisë të ardhurat nga kontributet.

Janë bërë informacione të herëpashershme, për të gjitha problemet që trajtuam me lart. Megjithëse ka përmirësime, përsëri mbetet shume për të bërë. Nga ISSH, nuk ka munguar vullneti dhe angazhimi për të bashkëpunuar. Kanë

dërguar disa herë projekt Akt- Marrëveshje bashkëpunimi (kjo ka qenë detyre e lënë dhe nga KLSH), dhe nuk është marrëpërgjigje.

Duhet të bëhen te gjitha përpjekjet, për te forcuar bashkëpunimin me organet tatimore, në funksion të përmirësimit të punës dhe minimizimit e informalitetit, sipas e problemeve të trajtuara më sipër.

Kur të kontrollohet DPT, mendoj se duhet të programohet e veçantë pika që ka të bëjë, me të ardhurat e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, detyrimet e prapambetura të trashëguara nga ISSH-ja sipas aktrakordimeve përkatës, detyrimet e krijuara gjatë viteve 2005-2011, të raportuara me deklaratimet e bëra me subjekt dhe arkëtimet përkatëse. Grumbullimi dhe dorëzimi i listëpagesave, brenda afateve të caktuara dhe veçanërisht rakordimi i tyre për çdo DR të Tatimeve me Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, sepse nga kontrollet në ISSH rezulton se ka shume prej tyre të pa dorëzuara, duke krijuar probleme për përfituesit.

Problemet në drejtim të bashkëpunimit me Inspektoratin Shtetëror të Punës, në zbatim të marrëveshjes së përbashkët bashkëpunimin, nga kontrollet rezulton se nuk ka kontrolle të përbashkëta.

Tiranë 20.01.2011

DISKUTIM NË ANALIZEN VJETORE 2011



Luljeta Nano

Kryekontrollore

Departamenti i Kontrollit të Buxhetit Qendror

Kontrollit Financiar Auditimit të Brendshëm

(Sektori i Buxhetit)

Kjo analizë është përqëndruar në disa çështje kryesore:

- Në **punën e bërë** nga Departamenti ynë për “Përgatitjen e Raportit për zbatimin e buxhetit” që KLSH paraqet në Kuvend PER VITIN 2011 .
- **Fushat prioritare** te kontrollit per vitin 2012
- **Disa mendime** për rritjen e performances se punes audituese .

Kontrolli i zbatimit të buxhetit të shtetit nuk është thjesht dhe vetëm detyrim ligjor por edhe objektiv primar i funksionimit të KLSH-së.

Në funksion të këtij detyrimi që në fillim të vitit 2011 u përgatitën dy dokumente të rëndësishëm të cilat u miratuan me Urdhër të brendshëm nga Titullari i institucionit. Në këto dokumente u përcaktua:

- 1- **Struktura e përmbajtjes** së këtij raporti si dhe **objektivat** e kontrollit për çdo Departament.
- 2- **Skema dhe kalendari i veprimeve** qe do të ndërmerren nga Departamentet përkatëse për hartimin e këtij Raporti.

- Me poshtë do te trajtohen çështjet që lidhen me punën e bërë nga ana jonë për kontrollet e ushtruara në subjektet të cilat kanë të bëjnë me dhënien e opinionit për saktësinë e Raportit që Ministri i Financave paraqet në Parlament për buxhetin konsuntiv.

Ne funksion të sa më sipër ushtrohet Kontroll në Ministrinë e Financave në Bankën e Shqipërisë si dhe në Ministrinë e Linjës.

Kontrrolli në Ministrinë e Financave

Drejtimit e kontrollit për zbatimin e buxhetit :

1. Kontroll mbi zbatimin e procedurave teknike te saktësisë së Treguesve Fiskalë të Buxhetit të Shtetit për fondet e planifikuara dhe ato faktike.
2. Deficiti i Përgjithshëm i Buxhetit dhe burimet e tij të financimit, saktësia e treguesve, komente dhe analiza.
3. Saktësia e evidentimit dhe raportimit të borxhit Publik treguesit e planifikuar dhe ata faktikë raporti ndaj PBB-se, saktësia e evidentimit te borxhit te jashtëm etj.
4. Kontrolli ne Ministrinë e Financave është gërshetuar me Kontrollin në Bankën e Shqipërisë në rolin e Agjentes Fiskale të Qeverisë. Në këtë të fundit grupi i kontrollit është fokusuar në kontrollin e rregullshmërisë së zhvillimit të ankandëve të letrave me vlerë të qeverisë, akordimin e kredisë së drejtpërdrejtë për nevoja të huamarrjes së brendshme si dhe transferimit te fitimit te BSH-se ne favor te buxhetit te shtetit.
5. Zbatimi i ligjshmërisë së përdorimit të fondit rezervë të Këshillit të Ministrave dhe kontigjencave.
6. Dhënia e opinionit për Raportin “Mbi buxhetin faktik” që Ministri i Financave paraqet ne Qeveri dhe më pas në Kuvend.

Me poshte rendisim disa nga rekomandimet :

I. Kontrolli mbi saktësinë e treguesve: Të ardhurat Shpenzimet Deficiti burimet e financimit të tij. Ose me fjale të tjera saktësisinë e Projektligjit të Buxhetit faktik.

Shkeljet e konstatuara: Evidentimi nga ana e Ministrisë së Financave i burimeve të financimit të deficitit në kundërshtim me .

Për sa më sipër u dha rekomandim: Ndryshimi i treguesve fiskalë të financimit të deficitit referuar klasifikimit të burimeve gje e cila u pranua nga Ministria e Financave.

II. Kontrolli i saktësisë së analizave të indikatorëve kryesorë që Ministria e financave paraqet në Raportin e buxhetit Konsuntiv kundrejt GDP-së.

Shkeljet e konstatuara. Analizat e treguesve të Buxhetit she atyre të Borxhit kryheshin kundrejt niveleve të ndryshme të GDP-së. U dha rekomandim që në Udhëzimin që Ministri i Financave nxjerr për zbatimin e buxhetit të përcaktohet që treguesit duhet ti referohen të njëjtit tregues të PBB-së më të fundit të miratuar në momentin e hartimit të projekt ligjit.

III. -Kontrolli mbi borxhin e jashtëm dhe të brendshëm si dhe shërbimin e tij është një nga drejtimit kryesore të kontrollit në Ministrinë e Financave. Kontrolli në është fokusuar në saktësinë e shifrave të Borxhit të deklaruar nga Qeveria si dhe në Kuadrin rregullator të raportimit të Borxhit publik (Ky i fundit u krye nën asistencën e drejtpërdrejtë të IDI-INTOSAI).

Në drejtim të raportimit të borxhit publik u dhane një sërë rekomandimesh për përmirësim legjislativ apo organizativ .

Përmendim: Nxjerrjen nga ana e Ministrit të financave të udhëzimeve në të cilat të Përcaktohet struktura e Raportit të Borxhit publik që Ministri i Financave paraqet në Kuvend si dhe struktura dhe afatet e publikimit të treguesve të Borxhit publik.

-Në funksion të nxjerrjes së konkluzioneve dhe analizave të tregues të borxhit të brendshëm si dhe menaxhimit të tij u ushtrua kontroll në Bankën e Shqipërisë. Kontrolli në Ministrinë e Financave është gërshetuar me Kontrollin në Bankën e Shqipërisë në rolin e Agjentes Fiskale të Qeverisë. Në këtë të fundit grupi i kontrollit është fokusuar në kontrollin e rregullshmërisë së zhvillimit të ankandëve të letrave me vlerë të qeverisë, akordimin e kredisë së drejtpërdrejtë për nevoja të huamarrjes së brendshme si dhe transferimit të fitimit të BSH-se në favor të buxhetit të shtetit.

Kontrolli u fokusua në analizën e ecurisë së tregut të bonove të thesarit dhe obligacioneve si dhe e normave të interesit të bonove të thesarit obligacioneve dhe repove, analiza e ecurisë së pjesëmarrësve në blerjet e letrave me vlerë të qeverisë (investitorëve) etj .

IV. Kontrolli ne Ministrinë e Financave u përqëndrua edhe menaxhimit të likuiditeteve të qeverisë. Në kushtet e nje buxheti dinamik (ndryshimi i buxhetit disa here gjate vitit) u rekomandua përmirësimi i udhëzimit të zbatimit të buxhetit në lidhje me regjistrimin e fondeve të angazhuara gje e cila sjell rritjen e efektivitetit te menaxhimit te likuiditeteve.

Nga kontrolli mbi evidentimin e financimit të huaj janë konstatuar mangësi ne drejtim të raportimit të financimit të huaj si dhe u rekomanduan marrja e masave për përmirësimin e gjendjes.

V. Për Fondin Rezervë të Këshillit të Ministrave, dhe Kontigjencave i cili është një trajtese e vecantë e raportit dhe objektiv i kontrollit ne Ministri. Nga kontrolli janë konstatuar shkelje të kriterëve të përcaktuar në Ligjin Organik të buxhetit si: përdorimi dhe prekja e fondit rezervë në raste për të cilat Ministri i Financave është shprehur ndryshe, apo përdorimi për raste që kanë të bëjnë me veprimtarinë normale të institucioneve dhe jo për raste të paparashikuara dhe emergjente etj.

Me synim dhenjen e opinionit për planifikimin dhe monitorimin e fondeve buxhetore kontrolli në Ministrinë e Financave është gërshetuar me kontrollin në Ministrinë e linjës në të cilën kemi kontrolluar si zbatohen kriteret e planifikimit të fondeve dhe zbatimit te buxhetit.

Objektivat e prioritetet e kontrollit ne vitin 2012

1. Për vitin 2102 fushe prioritare auditimi di të jetë **auditimi iborxhit publik**. Borxhi publik eshte nje ceshtje sa:

- Materiale nga përmbajtja(Treguesi i borxhit ndaj GDP - 58.51 / GDP
- Sensitive nga natyra (Mjaft i rëndesishem opinionit i KLSH).

Per 2012 do jetë një drejtim kontrolli në të cilën do ti kushtojmë vëmendje kohe dhe profesionalizem.

2. Prioritet do te jete edhe vlerësimi i sistemeve te planifikimit të buxheteve nga Ministrinë e linje dhe institucioneve sidomos te investimeve publike në

novel projekti. Performanca e ekzekutimit te buxhetit varet nga performanca e planifikimit te tij.

3. Për vitin 2012 do te jete risi “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit” , dmth gjatë veprimtarisë kontrolluese që në fazën e programimit të kontrollit do të përfshihet në programin e kontrollit si drejtim i veçantë kontrolli “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit”. Sikurse është kontrolli mbi mbikëqyrjen e auditimit te brendshëm ashtu do te ushtrohet kontrolli mbi funksionimin e sistemeve dhe rezultatet e kontrolleve do të konsolidohen dhe do te përfshihen ne Raportin qe do paraqesim ne Parlament.

Ky proces padyshim duhet te shoqërohet me një cikël trajnimesh teorike dhe praktike ne KLSH fillimisht këtë vit ne bashkëpunim edhe me njësinë qendrore te harmonizimit te Ministrisë se Financave .

Disa mendime për rritjen e performancës se punës audituese.

1- Hartimi i udhërrëfyesve, manualeve te auditimit guidave për fushat e veçanta te auditimit.

Në stafin e KLSH-se kemi kontrolore me një experience mbi 10 vjet të cilët kontrollojnë fusha te caktuara te auditimit dhe qe kane fituar një experience ne këtë fushe.

E parë ne këtë aspekt ata janë aset i këtij institucioni dhe përbejnë një vlerë të shtuar.

KLSH ka “Luksin” që të aktivizojë këto burime këto kapacitete dhe të mund të realizojmë manual për Auditimin e buxheteve të pagave të shërbimeve etj.

Si mund te arrihet? .

Duhet një bashkëpunim me Departamentin e Metodologjisë te cilët mund te asistojnë grupin e specialisteve eksperteve ne lidhje me formatimin dhe njëkohësisht duhet te planifikohet qe këta eksperte auditues te mos angazhohen me kontrole deri ne përfundimin e manualit.

2- **Në lidhje me botimet:** sugjeroj te caktohet një fond për KLSH-në për blerjen e botimeve kombëtare dhe ndërkombëtare me të fundit në fushën e

auditimit . te këtë një kopje institucioni dhe ne rrjetin e brendshëm te këtë njoftim mbi titullin dhe shkurtimisht çfarë përmban.

Tiranë, më 20 janar 2012

DISKUTIM NË ANALIZEN VJETORE 2011



Pjetër Beleshi

Kontrollor i Lartë

Departamenti i Kontrollit të Buxhetit Qendror
Kontrollit Financiar, Auditimit të Brendshëm

Mbi Auditimet Financiare të ushtruara për vitin 2011

Pas përfundimit të projektit të binjakëzimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Britanisë së Madhe (NAO), ka vazhduar puna për kryerjen e Auditimeve Financiare sipas praktikave më të mira edhe gjatë vitit 2011.

Sipas këtyre praktikave për vitin 2011 ishte parashikuar auditimi i **9 subjekteve**. Në fakt ka filluar kontrolli në **11 subjekte** nga të cilat, në **8 subjekte** ka përfunduar auditimi dhe në **3 subjekte** auditimi është në proces. Sipas praktikave të NAO-s për vitin 2011, Departamenti ka audituar kryesisht Institucionet më të larta shtetërore dhe ato institucione që kanë përdorur fonde të pakta, si:

Administrata e Kuvendit, Aparati i Këshillit të Ministrave, Gjykatën Kushtetuese, Ministrinë e Integritit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Zyrën e Buxhetit Gjyqësor, Ministrinë e Financave (për borxhin publik), Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, si dhe ka në proces auditimi tre institucione si; Ministrinë e Drejtësisë, Agjencinë Telegrafike Shqiptare dhe Qendrën e Publikimeve Zyrtare.

Në auditimet e kryera kemi aplikuar praktika të reja dhe bashkëkohore të cilat kanë pasur një ndikim pozitiv, duke i afruar subjektit

një rezultat më të mirë, i cili ka ardhur kryesisht nga ndryshimi i metodës së auditimit, e cila konsiston në:

- **Planifikimin** më të mirë të auditimit,
- Mënyrën e *dokumentimit*,
- Mënyrën e *raportimit*.

Ndryshimi i metodës së auditimit ka bërë që Raportet tona të Auditimit të jenë më të shkurtër, më konciz, më transparent dhe për rrjedhojë më të besueshëm.

I. Planifikimi i Auditimit.

Gjatë **planifikimit të auditimit** për të arritur në konkluzione të besueshme dhe të vlefshme rreth veprimtarisë së subjektit, një vëmendje të madhe i kemi kushtuar grumbullimit të informacionit, i cili i ka ndihmuar grupet e punës, në zgjedhjen e metodave për përmbushjen e objektivave të auditimit.

Për këtë qëllim grupet e punës kanë analizuar **faktorët** që ndikojnë tek subjekti i audituar dhe që ndahen në; Faktor të **jashtëm** dhe, Faktor të **brendshëm**.

Në identifikimin e **faktorëve të jashtëm**, grupet e punës kanë verifikuar:

- *Kuadrin ligjor* që rregullon veprimtarinë e institucionit, nëse është i plotë apo ka nevojë për plotësime.
- *Ndjeshmërinë e publikut dhe të medieeve*, dmth nëse në media është ngritur ndonjë problem shqetësues për subjektin që auditohet.
- *Marrëdhëniet me institucionet sponsorizuese*, siç janë Kuvendi dhe Ministria e Financave, nëse subjekti në bazë të politikave buxhetore të hartuara i ka marrë fondet e duhura apo jo.

Në identifikimin e **faktorëve të brendshëm**, grupet e punës kanë marrë informacione që lidhen:

- Me mënyrën e organizimit dhe drejtimit të subjektit duke siguruar të dhëna për strukturën organike, rregulloren e brendshme, veprimtarinë ekonomike e

financiare, sistemin e kontabilitetit, besueshmërinë e kontrollit të brendshëm etj.

- Auditimin e brendshëm të kryer në subjekt nga strukturat përgjegjëse nëpërmjet shikimit të raporteve të tyre, me qëllim nëse audituesit tanë mund të mbështeten në këto raporte.

- Gjatë kohës së grumbullimit të informacionit grupet e auditimit kanë intervistuar punonjësit e subjektit, me gojë, apo me shkrim duke ju dorëzuar drejtuesve të institucionit **pyetësorët** e hartuar.

Pas grumbullimit të informacionit dhe përpunimit të tij, grupet e auditimit kanë hartuar **listën e verifikimeve** e cila dokumenton kuptimin e veprimtarisë së subjektit.

Një rëndësi e veçantë grupet e auditimit i kanë kushtuar **përcaktimit të materialiteti** dhe **vlerësimit të riskut**, për të kuptuar nëse llogaritë janë të sakta, apo jo.

Është përcaktuar **niveli i materialitetit** në *masën 2%*. (i cili varion nga 0.5-2% për shpenzimet dhe nga 1-2% për të ardhurat).

Është bërë **vlerësimi i riskut** për të përdorur më mirë burimet tona të auditimit, për tu përqendruar më shumë në zonat më problematike dhe duke minimizuar punën në zona të tjera.

Grupet e auditimit kanë identifikuar faktorët si:

Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm

- Shpejtësia e auditimit të kryer
- Dhe faktor të tjerë që u trajtuan më lart.

Pas përcaktimit të këtyre faktorëve është **përcaktuar faktori i riskut** i cili ka të bëjë me pemën e vendimmarrje, e përkatësisht;

- Tek *investimet 2*, (që varion nga 0.7-3) pasi sipas eksperiencës tonë gjatë këtyre viteve investimet kanë qenë vazhdimisht me risk.
- Tek *zonat e tjera* të llogarisë është marrë në *masën 0.7*.
- Në raste të veçanta sipas problematikës tek zona *"Mallra e Shërbime"* në *masën 2*.

Pas grumbullimit dhe përpunimit të informacionit që cilësuar më lart grupet e auditimit kanë hartuar memorandum mbi planifikimin e auditimit dhe **Programin e Auditimit**.

E gjithë procedura e planifikimit të auditimit që trajtuam më sipër ka zgjatur **nga 10 deri në 15 ditë pune**, nga 1-5 ditë që ka zgjatur në kontrollet tradicionale të kryera më parë.

II. Mënyrën e dokumentimit

Në subjekt grupet e auditimit kanë përdorur si **metodë auditimi**, metodën e bazuar në sistem, duke bërë vlerësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Gjatë auditimit në subjekt për dokumentimin e punës, grupet e auditimit kanë hartuar pasqyrat **epohimit të auditimit**, duke regjistruar të gjitha transaksionet apo çështjet e audituara, duke u shprehur për secilën prej tyre nëse janë të rregullta, ose jo, duke i evidentuar në rubrikat përkatëse (plotësia, ndodhja, matja, rregullshmëria dhe zbatimi), ndërsa për bilancet (plotësia, ekzistenca, vlerësimi, përkatësia dhe zbulimi).

Në përfundim të punës në subjekt, para se të plotësohen aktverifikimet, apo procesverbalet, me personat përgjegjës janë bërë ballafaqimet përkatëse.

Grupet e punës gjatë hartimit të Projektraportit të Auditimit kanë përcaktuar të gjitha rekomandimet që do të lihen subjektit, të cilat janë shqyrtuar me drejtuesit *si për sa i përket përmbajtjes ashtu edhe për afatet* e zbatimit.

Kjo praktikë e re ka ndihmuar në pranimin e tyre nga subjekti që në fazën e Projektraportit duke lehtësuar në maksimum punën gjatë procesit të hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

III, Mënyra e raportimit

Grupet e auditimit para hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasi kanë shqyrtuar të gjitha observacionet e bëra nga subjekti, kanë bërë **takimin e mirëkuptimit** me drejtuesit kryesor të subjektit, për të shqyrtuar edhe një herë dhe rënë dakord për rekomandimet, nëse ato janë të sakta, të realizueshme dhe për të caktuar afatet kohore për zbatimin e tyre.

Observacionet, komentet rreth tyre ose përgjigjet për to, si dhe rekomandimet janë pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Pas gjithë këtyre procedurave grupet e auditimit kanë hartuar *Raportin Përfundimtar të Auditimit* dhe kanë ndjekur procedurat e evadimit në përputhje me afatet e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të KLSH.

Për çdo auditim të kryer sipas kësaj metode, grupet e auditimit kanë hartuar evidencën javore të punës, ku çdo auditues evidenton punën e tij të bërë gjatë javës.

Gjatë vitit 2011, për 8 subjektet e audituara sipas këtyre praktikave janë bërë 53 rekomandime; nga të cilat 5 rekomandime për përmirësimi e dispozitave ligjore e nënligjore, 35 rekomandime për përmirësimin e gjendjes dhe 6 masa zhdëmtimi për shumën 4.492 mijë lekë. Nga përgjigjet e institucioneve dhe nga verifikimet tona rekomandimet në numër janë zbatuar 47, ose 87 % e tyre dhe në vlerë 100% e shumës

Për vitin 2012 në Programin e Auditimeve, është parashikuar auditimi i **12 subjekteve** sipas praktikave të NAO-s, ose 33% më shumë se në vitin 2011 dhe 33% më shumë se plani vjetor.

Pavarësisht nga rritja në krahasim me një vit më parë numri i subjekteve që do të auditohen me sipas këtyre praktikave është i vogël, pasi në dy takimet që janë zhvilluar me ekspertët e SIGMAS në vitin 2010 dhe **2011**, pyetja e parë dhe e fundit që kanë bërë ka qenë, "**kurë do të kalojë i gjithë institucioni në auditimin financiar dhe të performancës për të gjitha subjektet që auditon**, duke hequr dorë njëherë e përgjithmonë nga praktikat tona të vjetruara dhe që nuk përputhen me standardet ndërkombëtare të auditimit.

Për vitin 2012 mendojmë se, duhet të përqendrohemi në këto drejtim

1. Në trajnimin e vazhdueshëm të stafit auditues, nëpërmjet zhvillimit të temave të trajnimit nga trajnerët e përgatitur nga ekspertët e NAO-s.

2. Në angazhimin e sa më shumë audituesve në auditimin praktik të subjekteve të parashikuara për auditim sipas këtyre praktikave, me qëllim që në një të ardhme të afërt të kalohet tërësisht me këto praktika.
3. Duhet punuar për miratimin e **Kodit të Detyrës së Caktuar** dhe vënien e tij në zbatim për ti shërbyer më mirë planifikimit të burimeve njerëzore dhe përzgjedhjes së çështjeve për tu audituar

Tiranë më 20.01.2012

DISKUTIM NË ANALIZEN VJETORE 2011



Bashkim Arizaj

Kontrollor i Lartë

Departamenti i Kontrollit të Buxhetit Qendror
Kontrollit Financiar, Auditimit të Brendshëm

1. Vlerësimi i legjislacionit dhe menaxhimit të sistemit elektronik

Prokurimet publike rregullohen nga ligji i vitit 2006, i cili ndër vite ka pësuar ndryshime të shumta. Për zbatimin e tij ekzistojnë rregulla të detajuara. Agjencia e Prokurimit Publik (APP) është autoriteti qeveritar përgjegjës për politikëbërje dhe zbatim në fushën e prokurimeve publike. Në vitin 2008 u krijua Avokati i Prokurimit Publik. Në vitin 2008 u vu në punë Sistemi i Prokurimit Elektronik (SPE), një sistem i bazuar në internet, i cili mundëson menaxhimin elektronik të procedurave të prokurimit publik në vend. Këshilli i Ministrave, në vitin 2009, vendosi që të gjitha institucionet publike mbi pragun e shumës 400 mijë lekë duhet t'i realizojnë prokurimet vetëm përmes Sistemit të Prokurimit Elektronik.

Megjithë këto përmirësime, më poshtë po jap disa sugjerime, të cilat rrjedhin nga rezultatet e kontrolleve të kryera nga departamenti ynë gjatë këtij viti, por edhe me parë:

• Rekomandime për përmirësime në sistemin elektronik

Sistemi i Prokurimit Elektronik duhet të përmirësohet për t'i lejuar autoriteteve kontraktore (AK) të kryejnë të gjitha procedurat e prokurimit përmes këtij sistemi, duke përfshirë këtu edhe ato për shërbimet e konsulencës, si dhe procedurën me negociim me shpallje paraprake të njoftimit.

- Agjencia e Prokurimit Publik duhet të rrisë shpejtësinë e komunikimit elektronik, pavarësisht nga lidhja e internetit që përdorin autoritetet kontraktore.
- Agjencia e Prokurimit Publik duhet të marrë masat e nevojshme teknike që faqja e internetit të punojë gjatë gjithë kohës, sepse ndërprerjet pengojnë punën e përdoruesve (audituesve) gjatë dhe pas orarit normal të punës.
- Sistemi i Prokurimit Elektronik duhet të rishikohet për t'u lejuar autoriteteve kontraktore t'i ruajnë vendimet e ndërmjetme të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Kjo do të ndihmojë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave që të mbajnë shënime në çdo hap gjatë procesit të vlerësimit, por pa dyshim ndihmon edhe punën e auditimit.
- Kur një ofertues bën ankesë para datës së hapjes së ofertave, procedura e prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të ndalet dhe nuk duhet të lejojë që të paraqiten oferta të tjera për këtë procedurë prokurimi, për sa kohë që Autoriteti Kontraktor ose Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është duke shqyrtuar ankesën.
- Sistemi i Prokurimit Elektronik duhet të rishikohet, me qëllim që ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë të shfaqen në sistem vetëm në autoritetin kontraktor përkatës dhe jo në të gjitha autoritetet kontraktore të vendit. Kjo do të ndihmonte punën e Komisionit të Prokurimit Publik, Agjencinë e Prokurimit Publik dhe pa dyshim punën audituese.
- Procedurat për vlerësimin e dokumenteve të operatorëve ekonomikë (OE-ve) në Sistemin e Prokurimit Elektronik, duhet të rishikohen në përputhje me hapat që anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave janë të detyruar ligjërisht të ndjekin.
- Sistemi i Prokurimit Elektronik duhet të rishikohet, me qëllim që operatorët ekonomikë të cilët fillimisht kanë tentuar të marrin pjesë në tender duke hedhur në sistem dokumente jo të plota dhe më vonë janë tërhequr, të mos shfaqen në faqen e audituesit, ashtu sikurse nuk shfaqen në faqen e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- Sistemi i Prokurimit Elektronik duhet të rishikohet për të lejuar që audituesi të ketë akses në hapjen e faqes "arkivimi". Sistemi lejon vetëm auditimin e dosjeve të dy viteve të fundit dhe pengon punën e dosjeve të viteve të tjera. Sistemi i Prokurimit Elektronik duhet të lejojë që kjo faqe të hapet pa lejen e administratorit të sistemit në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Rekomandime për përmirësim të kuadrit ligjor

- Legjislacioni në fuqi përcakton vetëm Agjencinë e Prokurimit Publik si autoriteti kompetent për dhënien e masave administrative ndaj personave përgjegjës që kanë kryer shkelje. Të gjitha institucionet kontrolluese dhe audituese, përfshirë këtu edhe KLSH-në i dërgojnë raportet përfundimtare dhe rekomandimet në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe jo direkt në autoritetin kontraktor. KLSH si institucion kushtetues, duhet t'i rekomandojë masat administrative ndaj personave përgjegjës direkt në subjekte dhe jo nëpërmjet Agjencisë së Prokurimit Publik.

- Të shfuqizohet nga ligji "shërbimet e konsulencës", dhe për këtë shërbim të përdoren procedurat e prokurimit si të gjitha shërbimet në tërësi.

Mendime:

Duke marrë shkas nga indiciet që dha Kryetari në analizën e punës së departamentit, për sinergjizimin ndërinstitucional, për rritjen e frymës së bashkëpunimit me disa institucione të cilat janë përgjegjëse të politikëbërjes dhe të zbatimit të prokurimeve publike, të politikëbërjes dhe zbatimit të ligjshmërisë për rregullimin e tregut të lirë dhe të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të subjekteve fizike e juridike apo të qytetareve, kundër veprimeve ose mosveprimeve të institucioneve shtetërore, me qëllim sigurimin ndihmës së ndërsjelltë dhe shkëmbimin e informacioneve, mendoj se:

1. Duhet të mundësohen dhe të hartohen memorandume mirëkuptimi me: Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Popullit, Avokaturën e Shtetit, Avokatin e Prokurimeve, Agjencinë e Prokurimit Publik,

Komisionin e Prokurimit Publik, etj, si dhe së bashku të organizohen seminare, konferenca, mësimet treguese, etj, me tematika të ndryshme.

2. Në strukturën e KXSH-së të krijohet një njësi (sektor, drejtori apo departament) për kontrollin e prokurimeve dhe investimeve buxhetore dhe financimeve të huaja, me përbërje specialistë të fushave si ekonomist, jurist dhe veçanërisht inxhinier ndërtimi.
3. Të gjitha gjetjet që gjykohen të rëndësishme të përshkruhen në një komentari (broshurë). Ky komentari do të japë shembuj apo modele konkrete të shkeljeve dhe mund të ndihmojë mjaft punën e kontrollorëve.
4. Të organizohen trajnime të ndryshme për ligjin e prokurimit publik dhe menaxhimin e sistemit elektronik të prokurimit.

Tiranë 20.01.2011

Departamenti i Kontrollit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Kontrollit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm Analiza vjetore 2011 e Departamentit u realizua më dt. 16.01.2012 në ambientet e KLSH, në praninë e gazetarëve të medias së shkruar. Paraqiti raportin e punës vjetore drejtori Dede Trieshi. Diskutuan kontrollorët Zyra Kepi, Luljeta Nano, Pjeter Beleshi dhe Bashkim Arizaj. Problemi kryesor i paraqitur ishin shkeljet e dispozitave ligjore në një pjesë të tenderave publikë. Në analizë mori pjesë edhe Kryetari i KLSH, i cili dha orientimet për punën e departamentit në të ardhmen.

R A P O R T

ANALIZA MBI AKTIVITETIN E DEPARTAMENTIT PËR VITIN 2011



Ded TRIESHI

Drejtor i Departamentit të Kontrollit të Buxhetit
Qendror, Administratës së Lartë Publike,
Kontrollit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm

Departamenti i Kontrollit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Kontrollit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm ka ushtruar aktivitetin e tij në funksion të planit strategjik dhe të programit vjetor të veprimtarisë së KLSH-së, në përputhje me Rregulloren e Brendshme dhe me Standartet e KLSH-së, në funksion të interesave kombëtare dhe kërkesave të Kuvendit duke siguruar pavarësinë dhe objektivitetin në të gjitha fazat e zhvillimit të

kontrollit,gjykimin profesional në të gjithë punën kontrolluese si në planifikimin,ushtrimin dhe raportimin e rezultateve,në caktimin e grupeve të kontrollit profesionalë,kompetentë dhe që zotërojnë njohuritë e duhura për të ushtruar kontroll profesional,të drejtë e të pa anshëm.Gjithashtu puna jonë ka konsistuar në realizimin e detyrave në përshtatje me standartet dhe kërkesat e faktorëve ndërkombëtarë si Intosai, BE,Banka Botërore, Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve etj.

Në planin e kontroleve të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2011 ishin parashikuar për t'u kontrolluar **38** subjekte nga të cilat ka filluar kontrolli në **37** subjekte të përcaktuara në planin vjetor.



Për **37** subjekte të kontrolluara gjëndja paraqitet:

- në **23** subjekte ka përfunduar kontrolli dhe janë evaduar materialet e kontrollit.
- në **12** subjekte ka përfunduar kontrolli por nuk janë evaduar materialet e kontrollit.
- në **2** subjekte kontrolli është në proces.

Sipas llojeve të kontrollit kemi:

- në **17subjekte**, kontrollet janë kryer të kombinuara për vlerësimin e veprimtarisë dhe të rregullshmërisë e ligjshmërisë ekonomiko-financiare;
- në **7 subjekte**, kontrolli është kryer për zbatimin e rregullshmërisë dhe të ligjshmërisë ekonomike dhe financiare;
- në **4 subjekte**, kontrollet kanë qenë për vlerësimin e veprimtarisë.
- **1** kontroll tematik për zbatimin rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja në kontrollet e kryera.

- në **8 subjekte**, kontrollet kanë qënë auditime financiare të zbatimit të rregullshmërisë dhe të ligjshmërisë, (sipas praktikave të auditimit të NAO të UK), nga të cilat në Gjykatën Kushtetuese është kryer një kontroll Pilot ku është realizuar edhe dhënia e opinionit (çertifikimi) për llogaritë vjetore të vitit 2009 . Pas përfundimit me sukses të projektit të binjakëzimit me Zyren Kombëtare të Auditimit të Britanisë së Madhe,KLSH ndryshoi metodën e auditimit duke aplikuar metoda të reja dhe bashkëkohore që konsistojnë :

1 -Në planifikimin e auditimit;

-Zgjatja e afatit kohorë për të hartuar programin e auditimit,kohë e cila shërben për të grumbulluar informacionin e nevojshëm rreth veprimtarisë së subjektit, kuadrin ligjor, mënyrën e organizimit, sistemin e kontabilitetit, sistemin e IT, bilancin kontabël, regjistrin e prokurimeve,marrëdhëniet me institucionet e tjera,me Kuvendin etj.

-Testimin e punonjësve nëpërmjet intervistave apo hartimit të pyetësorëve me shkrim si një formë e grumbullimit të informacionit.

-E rëndësishme ishte se arritëm të bëjmë përcaktimin e materialitetit dhe vlerësimin e rrishtit.

-Pas grumbullimit të informacionit u hartuan listat e verifikimeve dhe në fund hartuam memon mbi të cilën u hartua programi i auditimit.

2- Dokumentimi;

-Dokumentimi ka të bëjë me pasqyrimin e punës audituese për të cilën plotësohen pasqyrat e pohimet e auditimit.

Grupi i auditimit çdo javë plotëson evidencat javore të punës.

3- Raportimi

-Ndryshoi forma e raportimit pasi që në projektraport u vendosen rekomandimet përkatëse.Gjithashtu para se të dergohej raporti përfundimtar zhvillohet takimi i mirëkuptimit me përfaqësuesit e subjektit për të rënë dakort nëse rekomandimet janë plotësisht të zbatueshme dhe cilat janë afatet kohore për zbatimin e tyre etj.

Analiza e rekomandimeve të bëra.

Për vitin 2011 në kontrollet e kryera janë dhënë gjithsej **591** rekomandime për përmirësimin e gjendjes të cilat paraqiten në vijim;

- Për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore janë dhënë **32 rekomandime**;

- Për përmirësimin e gjendjes dhe të veprimtarisë së institucioneve të kontrolluara janë rekomanduar **312 masa organizative**;

- Për zhdëmtimin e dëmeve ekonomike të shkaktuara nga persona dhe subjekte private kontraktore, është kërkuar nxjerrja e titujve ekzekutivë dhe ndjekja në rrugë ligjore për **116 raste** në vlerën **420,478,000 lekë**,

- Janë rekomanduar **4 masa administrative**.

- Janë rekomanduar **127 masa disiplinore**

Nga **37** subjekte që duhej të kthenin përgjigje për zbatimin e rekomandimeve, kanë kthyer përgjigje **30** subjekte, nuk kanë kthyer përgjigje **7** subjekte duke shkelur detyrimin ligjor që kanë për të njoftuar KLSH brenda 20 ditëve.

1. Realizimi i rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi.

Në kontrollet e evaduar në vitin 2011, në **14** prej tyre janë bërë **32** propozime për ndryshime dhe përmirësime të legjislacionit në fuqi, nga të cilat sipas përgjigjeve të subjekteve dhe verifikimeve tona, janë zbatuar **18** propozime ose 56 % e tyre, janë në proces zbatimi 7 rekomandime ose 22 % e tyre dhe nuk janë zbatuar **7** propozime ose 22 % e tyre.

2. Masat organizative të rekomanduara.

Nga materialet e kontrolleve të evaduara janë rekomanduar gjithsej **312 masa me karakter organizativ** nga të cilat sipas përgjigjeve të kthyer nga subjektet për zbatimin e rekomandimeve, dhe verifikimeve tona të kryera me programin e kontrollit nr. 285, datë 04.07.2011, rezulton se janë pranuar nga titullarët dhe janë zbatuar plotësisht **208 masa** organizative ose 67% e tyre, janë zbatuar pjesërisht **6 masa** organizative ose 2% e tyre, janë në proces

zbatimi **64 masa** organizative ose 21% e tyre dhe nuk janë zbatuar **34 masa** organizative ose 10 % e tyre.

3. Analiza e zbulimeve me dhe pa dëm ekonomik.

Zbulimet e konstatuara për shkelje të disiplinës financiare janë në vlerën prej **420.478,000 lekë**, është rekomanduar për zhdëmtim vlera prej **420.478,000 lekë** ose 100 % e dëmit ekonomik sipas tabelës së mëposhtme:

E m ë r t i m i		Shuma
A. Në fushën e të ardhurave;		343,722,000
1	Nga tatim taksat	743,000
2	Nga dhënia e objekteve me qira	978,000
3	Nga shfrytëzimin e pasurive kombëtare	342,001,000
B. Në fushën e shpenzimeve		76,756,000
1	Në fushën e pagave	440,000
2	Në shpenzimet operative	11,154,000
3	Në prokurimet publike	65,159,000
4	Mungesa në mjete materiale e monetare	6,000
SHUMA (A+B)		420,478,000
Rekomanduar për zhdëmtim		420,478,000

III. Mbi zbatimin e procedurave të Prokurimit Publik me fonde buxhetore.

Për zbatimin e procedurave të prokurimit me fonde publike, është kryer kontroll për zbatimin e dispozitave ligjore, duke filluar nga forma e komunikimit me ofertuesit, në llogaritjen e vlerës limit të kontratës, në respektimin e kufijve monetarë, në përgatitjen e dokumenteve të tenderit, në paraqitjen dhe pranimin e ofertave, në shqyrtimin vlerësimin dhe kualifikimin e ofertuesve, në shqyrtimin e ankesave dhe në lidhjen e zbatimit e kontratave për punë, mallra e shërbime.

Gjatë vitit 2011 është kontrolluar zbatimi i procedurave të prokurimit dhe nga rezultatet e kontrolleve të subjekteve të evaduar rezulton se, nga **850**

procedura prokurimi të zhvilluara, me një vlerë prej **28,360,372,000 lekë**, janë kontrolluar **689** prej tyre, me një vlerë prej **24,497,203,000 lekë** ose **82 %** e numrit dhe **86 %** të vlerës së fondeve të prokuruar. Nga kontrolli ka rezultuar se, për prokurimet e zhvilluara nga institucionet e kontrolluara, procedurat e hapura zënë rreth 33 % të numrit dhe 81 % në vlerë, procedurat me negociim pa shpallje paraprake të kontratës zënë 51 % të numrit dhe 9 % të vlerës, etj. Për **689** tenderat e kontrolluar rezulton se kanë shprehur interesin dhe kanë tërhequr dokumentet e tenderit **2 165** ofertues, kanë paraqitur ofertat **2 079** prej tyre, kanë konkurruar **2 051** ofertues ose mesatarisht **3** konkurrent për një tender, janë skualifikuar **305** ofertues ose **1.5 %** e tyre, janë kualifikuar **1 746** ofertues, janë shpallur fitues dhe kanë lidhur kontratat **745** operatorë ekonomik me një vlerë totale kontrate prej **21,166,109,000 lekë**. Si rrjedhojë e konkurrencës është ulur vlera monetare e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike në shumën **3,331,094,000** lekë ose rreth **13.5 %**. Nga **689** procedura prokurimi të kontrolluara, në **497** prej tyre u konstatuan **1 042** shkelje të dispozitave ligjore.

Mbikqyrja e Auditit të Brëndshëm

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 7 i Ligjit Organik të KLSH gjatë vitit 2011 Departamenti jonë ka kryer;

- Mbikqyerjen e funksionimit të auditit të brëndshëm në 17 subjekte
- Vlerësimin e kontrollit të brëndshëm në 7 subjekte.

Me synim nxjerrjen e opinionit të përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit të auditimit të brëndshëm në sektorin publik rezultatet dhe konkluzionet e nxjerra për njësi të veçanta të kontrolluara janë gërshetuar me kontrollin e kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Auditit në Ministrinë e Financave si struktura përgjegjëse për mirëfunksionimin

E shërbimit të auditit.

Nga mbikëqyrja e auditimit të brëndshëm kemi evidentuar një sërë mangësishë në organizimin dhe funksionimin e auditimit të sektorit publik dhe ndër më kryesoret janë;

- Mos ngritja dhe funksionimi i njesive të auditimit në subjektet publike në kundërshtim me kriteret ligjore
- Rekrutim të audituesve të pa certifikuar
- Strukturat e auditimit në vite kanë tendencë të funksionojnë si struktura inspektimi apo kontroll revizioni si dhe reflekton përdorimin jo me efektivitet të stafeve audituese etj.

Ky proces vlerësimesh dhe mbikqyrje, arrijtjet dhe dobësitë apo shkeljet ligjore të vërejtura në organizimin dhe funksionimin e shërbimit të auditimit të brëndshëm publik, janë pasqyruar në raportet përfundimtare të kontrollit që së bashku me rekomandimet përkatëse u janë përcjellë subjekteve të audituara.

Objektivat per vitin 2012

-Duke ditur se sfidat e kohës së sotme janë akoma dhe më kërkuese dhe se disiplina buxhetore dhe financiare e administrimit publik është bërë përparësi absolute në botë, KLSH si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiarë në vend vihet përballë një sprove të madhe sidomos në drejtim të kontrollit të performancës së administrimit dhe financave publike, të miradministrimit të pronës shtetërore dhe zbatimit të buxhetit të shtetit, nëpërmjet një kontrolli të burimeve në mënyrë ekonomike, me efektivitet dhe efijencë.

-Thellimi i misionit të KLSH në luftën kunder korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike nëpërmjet analizës së rrisikut dhe kontrolleve të bazuara mbi këtë analizë si dhe nëpërmjet auditit të performancës kërkon nga kontrollorët e KLSH nivel të lartë profesional, disiplinë të lartë dhe shfrytëzimin maksimal të kohës së punës jo vetëm duke qëndruar në punë por duke rritur efektivitetin në punë dhe duke zbatuar kodin e etikës së KLSH.

-Sipas planit strategjik të KLSH po shkojmë drejt kontrollit të përvitshëm të Institucioneve që thithin fonde në vlera të mëdha nga Buxheti i Shtetit pasi në keto subjekte bëhet edhe vlerësimi i rrishtit dhe materialitetit më i saktë dhe se interesi i nderkombetareve dhe i Kuvendit është me i madh.

-Në kontrollin e këtyre subjekteve për vitin 2012 do të mbahet parasysh që kontrollet të ushtrohen dhe në njesitë e vartësisë sepse dhe kontrolli është me i plotë dhe se niveli i fondeve të audituara do të jetë më i lartë, objektivi ynë është që të kontrollohen mbi 65% e fondeve që administrojnë çdo subjekt, kërkesë kjo edhe e partnerëve nderkombetarë. Për këtë në çdo material auditimi do të bëhet pasqyrimi i saktë i fondeve të kontrolluara sipas zërave dhe qëllimit të shpenzimit të tyre.

-Me qëllim që matja dhe vlerësimi i punës për çdo kontrollorë në kontrollet e ardhshme përveç ndarjes së detyrave që bëhen në kohën e hartimit të programit të kontrollit, në përfundim të kontrollit krahas evidencave që janë plotësuar deri më tani do të bëhet edhe përcaktimi i sakte për zbulimet dhe rekomandimet që ka bërë çdo kontrollorë.

-Në përshtatje dhe me kërkesat e kohës gjatë këtij viti në krahasim me vitin e kaluar do të kryehen me tepër kontrolle të plota ku përfshihen edhe njesitë e vartësisë, me tepër Auditime financiare sipas metodave të NAO dhe do të kryehen me shumë kontrolle për certifikimin e llogarive vjetore.

-Për të arritur objektivat e vitit 2012 kërkohet një disiplinë më e lartë në punë, nivel më i lartë profesional të cilin do ta përmirësojmë nëpërmjet trajnimeve që do të kryehen nga ekipet e trajnimit në KLSH dhe jashtë KLSH si dhe me aktivizimin e ekspertëve të ndryshëm.

* Diskutim i mbajtur në analizën e Departamentit dhe në Analizën Vjetore 2011 të KLSH.

Tiranë më 16.01.2012

Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Publike

Analiza vjetore 2011 e Departamentit u realizua më dt. 17.01.2012 në ambientet e KLSH, në praninë e gazetarëve të medias së shkruar. Paraqiti raportin e punës vjetore drejtori Osman Alushi. Diskutuan kontrollorët Bexhet Zeqiri, Xhemal Luka, Niko Nako dhe Halil Isufi. Problemet kryesore të paraqitura ishin abuzimet me rregjistrimet e tokave në zyrat hipotekore të audituara dhe mosarkëtimi i taksave vendore në shumë njësi bashkiake dhe komuna. Në analizë mori pjesë edhe Kryetari i KLSH, i cili dha orientimet për punën e departamentit në të ardhmen.

R A P O R T

ANALIZA MBI AKTIVITETIN E DEPARTAMENTIT PËR VITIN 2011



Osman Alushi

Drejtor i Departamentit

të Kontrollit të Buxhetit të Pushtetit Vendor,
Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Publike

Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Publike, vepron në dy drejtime kryesore:

a. Kontrolli i ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe vlerësimit të përdorimit të fondeve nga njësitë e qeverisjes vendore (Bashkitë, Qarqet, Prefekturat dhe Komunat) dhe institucionet buxhetore, apo subjektet që krijojnë dhe

menaxhojnë fonde publike në nivel vendor, me qëllim hartimin dhe përgatitjen e raportit vjetor për veprimtarinë e kontrollit të zbatimit të buxhetit të shtetit në nivel vendor.

b. Kontrolli i zbatimit të legjislacionit, rregullshmërisë dhe vlerësues në administrimin e pronës shtetërore në procesin e tjetërsimit nga shteti në subjektet private si kthimin e kompensimin e pronave, privatizimin, dhënien me qira etj., detyrim i cili realizohet duke kontrolluar: (Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme; Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave; Agjencinë e Legalizimit të Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Informale, Komisionet e Verifikimit të Titujve të Pronësisë, etj.

Për përmbushjen e detyrave të tij ky departament përbëhet nga 35 punonjës sipas kësaj strukture: Drejtor Departamenti 1 punonjës, Kryekontrollorë 2 punonjës, dhe 32 kontrollorë, të cilët të ndarë sipas profesioneve janë 18 me profil financiar, 9 me profil ekonomist, 7 jurista dhe 1 inxhinier.

Gjatë vitit 2011 për realizimin e detyrave të ngarkuara janë angazhuar edhe ekspertë/specialistë të jashtë të profesioneve të ndryshme si: inxhinier ndërtimi/ arkitekt, jurist, ekonomistë dhe financier.

Për vitin 2011, Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Publike, ka realizuar 92 kontrolle, nga 60 kontrolle të parashikuara, nga të cilët 67 kontrolle janë evaduar, 24 kontrolle kanë përfunduar dhe do të evadohen në 3/mujorin e I^{rë} 2012 dhe 1 kontroll është në proces (kontrolli i zbatimit të detyrave 2011).

Në përcaktimin e numrit të subjekteve të planifikuar dhe realizuar për vitin 2011, jemi mbështetur në:

- Numrin e kontrollorëve dhe nivelin e tyre profesional.
- Azhurnimin e çdo kontrolli me dispozitat ligjore para se të shkojë në subjekt për kontroll.
- Mbështetjen e grupit të kontrollit me dispozitat ligjore.

- Marrjen në subjekt nga ana e kontrollorëve të të dhënave paraprake në lidhje me veprimtarinë ekonomiko-financiare, strukturat etj.
- Plotësimin e grupit të kontrollit me specialistë të të gjitha fushave, kryesisht inxhinier ndërtimit/arkitekt etj.
- Është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme që të rritet cilësia e hartimit të programit të kontrollit në funksion të misionit të caktuar, bazuar edhe në të dhënat e grumbulluara nga kontrollorët në subjekt, problemet e trajtuara në media, problematika e konstatuar në kontrollet e mëparshme etj.

Për realizimin e detyrave për vitin 2011, kemi pasur në vëmendjen tonë edhe detyrat e ngarkuara nga rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2010”, datë 02.6.2011, akt i cili ndër objektivat e vendosura, ka cilësuar:

- Rritjen e cilësisë së kontrolleve në përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit.
- Përdorim më gjerësisht të metodologjisë bashkëkohore të kontrollit, mbështetur në praktikat më të mira.

Mbështetur në rekomandimet e mësipërme, për vitin 2011, vëmendjen kryesore e kemi përqendruar në kontrollet që kemi ushtruar në bashki dhe disa komuna kryesore, në funksion kjo të hartimit të buxhetit të shtetit që paraqitet në parlament nga KLSH, për pjesën e pushtetit vendor.

Duke ju referuar planit të kontrolleve ky departament për vitin 2011, nga 60 kontrolle të programuara ka realizuar 92, si më poshtë:

a. Sipas strukturë:

- 29 kontrolle të vitit 2010
- 59 kontrolle të programuara të vitit 2011
- 4 kontrolle jashtë planit

b. Sipas fazave të kontrollit:

- 67 të evaduara

- 24 të përfunduara
- 1 në proces

Në 67 subjekte të evaduara janë kontrolluar 33 Bashki, 19 Komuna, 5 Zyra Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, 3 Këshilla Qarku dhe 7 institucione të tjera.

Të nderuar kolegë më lejoni tju parashtroj se nga 67 subjekte të evaduara të veçoja e vlerësoja problematikat e trajtuara kryesisht në:

A. Në fushën e administrimit të pronës.

B. Kontrolli në fushën e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në njësitë e qeverisjes vendore (bashki, komuna e institucione të tjera të varësisë).

Në fushën e administrimit të pronës

Gjatë vitit 2011 janë evaduar kontrollet e kryera në **Zyrat Qendrore e Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, Pogradec, Vlorë dhe Lezhë**, nga ku është konstatuar se punonjësit e këtyre institucioneve nuk kanë respektuar kërkesat e ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, UKM nr.1, datë 31.01.2007 “Për Procedurat e Regjistrimit në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, Rregullores së Brendshme nr.184, datë 08.4.1999, Urdhrit nr.155 datë 07.7.2006 të ZQRPP, etj.

Në mënyrë të përmbledhur disa nga shkeljet e konstatuara po i paraqesim për çdo ZVRPP, si më poshtë:

Për ZVRPP Tiranë

- Janë bërë regjistrime për truallin dhe objektin në bazë të VKM^{së} “Për regjistrimin sipas listës emërore të pronarëve të trojeve dhe të shtëpive”, kur akti është e shfuqizuar me VKM nr.159, datë 21.03.2006.

- Janë regjistruar për tokë bujqësore mbi argjinaturën e bregut të lumit Lanë, duke krijuar pasuri të reja mbi argjinaturë dhe duke bërë ndryshim të zërit kadastral nga shtrat lumi në tokë bujqësore.

-Janë hapur kartela e pasurisë së paluajtshme me pasurinë “Garazh” dhe më pas është zëvendësuar me pasurinë “Apartament”, ndryshe nga sa përcaktuar në aktkolaudimin e objektit.

-Ka rezultuar se është regjistruar kontratë shitje, pa asnjë dokument për mënyrën e fitimit të titullit të pronësisë nga shitësi, si dhe pa pasur më parë të regjistruar pronën.

-Ka rezultuar se në bazë të Lejes së legalizimit, është regjistruar një godinë duke regjistruar 1 kat më shumë se sa ka pasur në lejen e ndërtimit.

Për ZVRPP Pogradec

-Në 105 raste, janë regjistruar në favor të subjekteve private truall sipas listës emërore të trojeve, më shumë se sa përcaktohet në aktet ligjore.

-Në 56 raste, janë regjistruar sipërfaqe tokë arë më shumë se sa është përcaktuar në Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi.

-Në 9 raste, janë regjistruar pasuri të përfituara me vendime të kthimit e kompensimit të pronave, kur dokumentacioni i paraqitur për regjistrim ka rezultuar në kundërshtim me kërkesat ligjore e nënligjore në fuqi.

-Në 8 raste, janë regjistruar objekte me leje ndërtimi, kur dokumentacioni i paraqitur për regjistrim ka rezultuar në kundërshtim me kërkesat ligjore e nënligjore në fuqi.

Për ZVRPP Vlorë

- Në 16 raste, janë regjistruar objekte dhe sipërfaqe trualli bazuar vetëm në vendime gjyqësore për “Vërtetim e faktit juridik të pronësisë dhënë pas datës 1 Nëntor 1994”; “njohje pronar” dhe “njohje pronar me parashkrim fitues”, në kundërshtim me ligjin “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, udhëzimin “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Rregullores së Brendshme, etj.

-Në 5 raste, janë regjistruar sipërfaqe tokë bujqësore më tepër nga sa rezulton në dokumentin ligjor “Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi”.

-Janë regjistruar bazuar në Lejet e Legalizimit objekte dhe sipërfaqe trualli në pasuri lulishte, kur janë regjistruar më parë në listën e pronave publike të Bashkisë.

-Janë regjistruar tokë “Truall” bazuar vetëm në listën emërore (shitesë) të pronarëve të trojeve dhe të shtëpive, në kundërshtim me VKM “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të Fshatit”.

-Janë regjistruar sipërfaqe tokë bujqësore brenda vijës së verdhë në regjistrat e hipotekës në bazë të “Akteve të marrjes së tokës në pronësi” pa vendim nga Komisioni Vendor i Titujve të Pronësisë, për shqyrtimin e kërkesës për vlefshmërinë ligjore të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore.

Për ZVRPP Lezhë

- Në 73 raste, janë regjistruar dhe hapur kartelat e pasurive të paluajtshme nga ish-Njësia e Menaxhimit të Projektit, duke regjistruar tokë arë, bazuar në Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi, kur lëshimi i tyre është në kundërshtim me VKM nr.88, datë 01.3.1993, “Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit”.

- Në 16 raste, në Ishullin e Shëngjinit, bazuar në Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi, janë regjistruar dhe lëshuar certifikata pronësie, për zërin kadastral “tokë arë”, kur nga dokumentacioni rezulton në zërin kadastral “Kënetë”, veprim i kryer pa asnjë dokumentacion referues.

- Në 23 raste, janë regjistruar objekte të ndryshme, si pallate, qendra biznesi, lokale shërbimi, banesa etj, në pronë publike, pa pasur marrëdhënie me truallin, si kontratë qiraje etj.

Për përmirësimin e gjendjes në këto subjekt, janë rekomanduar **140** masa organizative, për kufizime mbi pasuri në zonat urbane dhe zonat rurale, për rreth **400** pasuri, si dhe për shkeljet e konstatuar janë rekomanduar **26** masa disiplinore nga të cilat, **6** masa “Zgjidhje e menjëhershme e kontratës” dhe **20** masa “Vërejte me paralajmërim”.

Vlerësojmë se puna e grupeve të kontrollit e kryer në këto subjekte ka rezultuar cilësisht e mirë, si dhe masat e propozuara kanë qenë të mbështetura në dispozitat ligjore përkatëse, gjë e cila u vërtetua gjatë verifikimit të detyrave, ku nga këto subjekte janë zbatuar rekomandimet tona, si më poshtë:

Nr	Llojet e Masave të Rekomanduar	Rekomanduar	Zbatuar
1	Masa Organizative	140	135
2	Masa Disiplinore	26	26
Totali		166	161

B. Kontrolli në fushën e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në njësitë e qeverisjes vendore

Nga 67 subjekte të evaduara, në 54 prej tyre janë konstatuar shkelje financiare me dëm ekonomik në shumën prej 327.377 mijë lekë, vlerë e cila është rekomanduar për zhdëmtim, në masën 100%, si më poshtë:

-Në 29 Bashki me vlerë.....	246.015 mijë lekë
-Në 19 Komuna me vlerë.....	29.430 mijë lekë
-Në 3 Këshilla Qarku me vlerë.....	2.322 mijë lekë
-Në 3 Institucione të tjera me vlerë.....	49.610 mijë lekë

Në 29 bashki që janë konstatuar shkelje financiare me dëm ekonomik, 7 prej tyre zënë 78% të dëmit, të zbuluar e konkretisht:

1. Bashkia Lushnje zë 22% të dëmit e barabartë me.....	49.178 mijë lekë.
2. Bashkia Tiranë zë 18% të dëmit e barabartë me.....	41.931 mijë lekë.
3. Bashkia Durrës zë 12% të dëmit e barabartë me.....	26.189 mijë lekë.
4. Bashkia Fier zë 11% të dëmit e barabartë me.....	25.650 mijë lekë.
5. Bashkia Fushë-Krujë zë 10% të dëmit e barabartë me.	21.702 mijë lekë.
6. Bashkia Shkodër zë 5% të dëmit e barabartë me.....	11.632 mijë lekë.

Në 19 komuna që janë konstatuar shkelje financiare me dëm ekonomik, 3 prej tyre zënë 61% të dëmit, të zbuluar e konkretisht:

1. Komuna Bërdicë zë 36% të dëmit e barabartë me 10.669 mijë lekë.
2. Komuna Shëngjin zë 15% të dëmit e barabartë me 4.478 mijë lekë.
3. Komuna Prezë zë 10% të dëmit e barabartë me 2.864 mijë lekë.

Në institucionet e tjera në të cilat është evidentuar një dëm prej 70.053 mijë lekë, 70% e dëmit i përket Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Në mënyrë të përmbledhur po ju paraqes fushat në të cilat janë konstatuar shkelje për 54 subjektet të rezultuara më dëm ekonomik, si vijon:

I. Në sektorin e tatim taksave në vlerën 44.542 mijë lekë, ku përmendim:

1. Universiteti "I.Qemali" Vlorë në vlerën 31,392 mijë lekë, për mos arkëtim të taksës së regjistrimit në universitet.
2. Bashkia Lushnje në vlerën 1,890 mijë lekë, për mos pagesë të taksës mbi pasurinë.
3. Bashkia Tiranë, në vlerën 7,592 mijë lekë, për përfitim dy herë të tvsh dhe përqindje për tarifa studim projektimi.
4. Bashkia Pogradec, në vlerën 265 mijë lekë, për detyrim të pa paguar të taksave vendore.
5. Bashkia Sarandë, në vlerën 214 mijë lekë, për detyrim të pa paguar të taksave vendore.
6. Bashkia Fier në vlerën 860 mijë lekë, për mospagesë taks reklame e ndërtesë.
7. Shkelje me shuma jo të konsiderueshme në vlerën 2.329 mijë lekë, janë konstatuar edhe në Bashkitë Durrës, Ballsh, Sukth, Fushë-Krujë, Elbasan, si dhe Komunën Vllahinë, Vlorë.

II. Në sistemin e pagave dhe shpërblimeve, në vlerën 38.259 mijë lekë, ku përmendim:

1. Universiteti "I.Qemali" Vlorë, në shumën 17,035 mijë lekë, për përfitim më tepër paga të punonjësve.
2. Bashkia Fier, në vlerën 5,378 mijë lekë, llogaritje gabim të pagës për funksion dhe shpërblime në kundërshtim me ligjin.
3. Bashkia Durrës, në vlerën 3,241 mijë lekë, për shpërblim të paligjshëm me rastin e festave dhe nga fondi i veçantë për punë të mirë.
4. Bashkia Vau Dejës, në vlerën 1,816 mijë lekë, dhënie page për funksion në kundërshtim me VKM si dhe shpërblime të kundërligjshme.
5. Bashkia Koplik, në vlerën 1,276 mijë lekë, për përfitim të padrejtë page.
6. Bashkia Ballsh, në vlerën 852 mijë lekë, për përfitim të padrejtë orë shtesë jashtë kohës normale të punë.
7. Shkelje me shuma jo të konsiderueshme në vlerën 8.661 mijë lekë, të konstatuar në disa Bashki, Komuna, Këshilla Qarku dhe Njësi Bashkiake.

III. Pagesa të kundërligjshme në shpenzimet operative, në vlerën 8.393 mijë lekë, ku përmendim:

1. Bashkia Lushnjë, në vlerën 1,528 mijë lekë, për shpenzime të kundërligjshme për karburant.
2. Komuna Gjinar, Elbasan në vlerën 1,508 mijë lekë, për shpenzime karburanti dhe automjetesh.
3. Bashkia Sarandë, në vlerën 1,087 mijë lekë, për shpërblime të padrejta burse dhe udhëtime e dieta.
4. Bashkia Durrës, në vlerën 469 mijë lekë, për shpenzime të paargumentuara operative si telefonie etj.
5. Bashkia Fushë Arrëz, në vlerën 671 mijë lekë, për furnizim me karburant të autoveturës në mënyrë të kundërligjshme.
6. Bashkia Elbasan, në vlerën 418 mijë lekë, për pagesa të papërfshira në preventiv punimesh e shërbimesh si dhe të paargumentuara.

7. Komuna Bërdicë, në vlerën 420 mijë lekë, për shpenzime karburanti për autoveturën dhe përfituar bonus për transportin.

8. Shkelje me shuma jo të konsiderueshme janë konstatuar edhe në disa Bashki e Komuna, sipas listës.

IV. Për dhënien me qira të pasurisë, në vlerën 2.840 mijë lekë, ku përmendim:

1. Bashkia Sarandë, në vlerën 1,014 mijë lekë, për mosarkëtim qiraje dhe kamatëvonesa.

2. Bashkia Gjirokastër, në vlerën 791 mijë lekë, për mos arkëtim qiraje për asetet e bashkisë dhënë me qira të tretëve.

3. Drejtoria e Punëtorëve nr.1 Tiranë në vlerën 615 mijë lekë, për vonesa në arkëtimin e qirasë për objekte të dhëna me qira.

4. Bashkia Elbasan, në vlerën 171 mijë lekë, për vonesa në arkëtimin e qirasë për objekte të dhëna me qira.

5. Komuna Qendër Ballsh, në vlerën 165 mijë lekë, për mos arkëtim të diferencave të qirasë së tokës dhënë operatorëve celularë me qira.

V. Në fushën e prokurimeve publike dhe zbatim e kontratave në vlerën 144.455 mijë lekë, ku përmendim:

1. Bashkia Tiranë, në vlerën 30,491 mijë lekë, për pagesa të paargumentuara në dorëzimin e objekteve si dhe diferenca fizike në zëra punimesh të pakryera.

2. Bashkia Durrës, në vlerën 22,396 mijë lekë, për llogaritje tepër të vlerës së kontratës, mos kryerje punimesh në afat, përfitim të padrejtë të fondit rezerve në investime etj.

3. Bashkia Lushnjë, në vlerën 13,430 mijë lekë, për volume pune të pakryera dhe mosarkëtim penalitetesh.

4. Bashkia Shkodër, në vlerën 11,632 mijë lekë, për punime të pakryera sipas kontratës për ndërtime për llogari të bashkisë.

5. Njësia Bashkiake nr.6 Tiranë në vlerën 13,847 mijë lekë, për diferenca të zërave të punimeve të pakryera dhe dëmshpërblim për vonesat e dorëzimit të punimeve.
6. Bashkia Fier, në vlerën 10,553 mijë lekë, për diferenca në përlogaritjen e fondit limit, ofertës fituese dhe zëra punimesh të pakryera.
7. Komuna Shëngjin, në vlerën 4,478 mijë lekë, për zëra punimesh të pakryera dhe llogaritje gabim të fondit limit.
8. Komuna Bërdicë në vlerën 5,446 mijë lekë, për llogaritje gabim të fondit limit dhe mos zbatim kontrate të nënshkruar.
9. Në 15 Komuna të tjera në vlerën 10.500 mijë lekë, kanë rezultuar zëra punimesh të pakryera, sipas listës.

VI. Në fushën e Urbanistikës, në vlerën 87.813 mijë lekë, ku përmendim:

1. Bashkia Lushnjë në vlerën 32,330 mijë lekë, për mos arkëtim të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
2. Bashkia Fushë Krujë, në vlerën 21,204 mijë lekë, për mos pagim të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
3. Bashkia Fier, në vlerën 8,626 lekë, për mosarkëtim të detyrimeve për leje ndërtimi.
4. Bashkia Kavajë, në vlerën 6,382 mijë lekë, për mos pagim të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
5. Bashkia Tiranë, në vlerën 3,848 mijë lekë, për pagesë më pak të detyrimit për leje ndërtimi.
6. Komuna Bërdicë në vlerën 3,723 mijë lekë, për mos arkëtim i taksës 1% të vlerës së investimit.
7. Bashkia Vlorë, në vlerën 2,257 mijë lekë, për mosllogaritje dhe arkëtim të taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe gjoba për ndërtime pa leje.
8. Bashkia Elbasan në vlerën 2,094 mijë lekë, për mosarkëtim të taksës së studimeve urbanistike dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Masat për shpërblim dëmi sipas natyrës të rekomanduara, për të gjitha subjektet e evaduara gjatë vitit 2011, paraqiten:

Nr.	Shpërblimi i dëmit sipas natyrës	Rekomand.	Zbatuar	Në %
1.	Në fushën e pagave, shpërblime e sigurimeve	38.259	32.122	84
2.	Në fushën e shpenzime operative	8.393	6.022	72
3.	Në fushën e prokurimeve publike	144.455	120.595	83
4.	Në dhënien me qira të pasurisë	2.840	2.675	94
5.	Në fushën e taksave dhe tatimeve	44.542	41.664	94
6.	Në fushën e urbanistikës	87.813	85.706	97
7.	Në fusha të tjera	1.075	1.075	100
Totali		327,377	291,749	89

C. Mbi masat organizative, administrative dhe disiplinore të rekomanduara.

Për mangësitë e të metat, si dhe shkeljet financiare të konstatuara për vitin 2011, nga departamenti u janë rekomanduar 67 subjekteve të evaduara marrja e 1150 masa me karakter organizativ, disiplinor dhe administrativ, të cilat pas verifikimit të rekomandimeve, për 65 subjekte, rezultojnë se janë zbatuar si më poshtë:

Në numër

Nr	Llojet e Masave	Rekomand.	Zbatuar	Në %	Diferenca
1	Masa Organizative	782	720	92	62
2	Masa Disiplinore	236	193	82	43
3	Masa Administrative	132	70	53	62
	Totali i masve (1+2+3)	1150	983	85	167
4	Shpërblim dëmi 000/lekë	286.896	211.113	74	74.183

D. Kallëzime penale

Për vitin 2011, nga departamenti janë bërë 2 kallëzime penale, për 10 persona, dhe konkretisht për punonjësit e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe Komunën Gjinar, Elbasan, për konsumimin e figurës së veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", pasi në ushtrimin e funksioneve publike kanë shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, në shumën 17.854.668 lekë.

Objektivat për vitin 2012

Siç jeni në dijeni për vitin 2012, janë programuar 60 kontrolle të ndara si më poshtë:

- 1) **37** Bashki (nga të cila 6 Auditime Financiare)
- 2) **11** Komuna
- 3) **6** ZVRPP
- 4) **3** Prefektura
- 5) **2** Këshilla Qarku dhe
- 6) **1** Kontrolli i Zbatimit të Detyrave

Realizimi i këtyre kontrolleve jo vetëm si vlerë numerike por mbi të gjitha si cilësi kontrolli na angazhon që të kemi të kemi të përcaktuara disa drejtime kryesore ku duhet të përqendroni e fokusoni punën tuaj si kontrollorë, për vitin 2012.

Ashtu si patët mundësinë ta dëgjoni gjatë prezantimit të Raportit Vjetor 2011, por që edhe vet secili prej jush është në dijeni, punën tonë duhet ta përqendrojmë kryesisht tek fushat me Risk të Lartë, siç janë:

- a) Fusha e Prokurimeve Publike
- b) Fusha e Tatim Taksave
- c) Fusha e Pagave e Shpërblimeve

Për këtë është e nevojshme:

- Njohja sa më e mirë e objektit të kontrollit duke shfrytëzuar evidencat statistikore të subjektit.

- Azhurnimi i bazës ligjore mbi të cilat funksionojnë dhe veprojnë subjektet si: (Ligjet, aktet nën ligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave, apo Ministrinë e linjës ku përmendim: vendime, udhëzime, urdhëresa, por dhe akte të nxjerra për zbatim nga vet subjektet).

- Kontrollat e mëparshme të kryera në subjekt. Nisur nga fakti se pjesa më e madhe e subjekteve që mbulon departamenti, kontrollohen në mënyrë sistematike si dhe duke qenë se për të gjitha subjektet e kontrolluar departamenti disponon kopje në format elektronik të Raporteve të Kontrollit, secili kontrollor, në varësi të ndarjes së pikave të kontrollit dhe përpara shkuarjes për kontroll duhet të analizojë paraprakisht problematikat e hasura në këto subjekte.

- Detyrat e lëna nga kontrollat e mëparshme.

Të gjitha këto do të na ndihmojnë që në përgatitjen e Programeve të Kontrollit të përcaktojmë qartë se ku do ta përqendrojmë punën tonë dhe cilat do të jenë fushat prioritare.

- Të organizohet më mirë puna në grupe duke i kushtuar rëndësinë e duhur çdo faze të procesit të kontrollit.

- Rritja e bashkëpunimit me ekspertë të jashtëm, në fushat e kontrollit të inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës dhe topografisë.

- Rritja e mëtejshme e nivelit profesional të kontrolluesve përmes trajnimeve të ndryshme të organizuara nga KLSH apo institucione të tjera të specializuara.

- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet Departamentit tonë dhe Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Brendshme, me qëllim shmangien e mbivendosjeve të kontrolleve.

Nr	Subjektet e Kontrolluara	000/ Lekë
I. BASHKI		225,572
1	Bashkia Elbasan	4,128
2	Bashkia Tiranë	41,931
3	Bashkia Fushë Krujë	21,702
4	Bashkia Sarandë	7,672
5	Bashkia Kavajë	9,710
6	Bashkia Pogradec	1,323
7	Bashkia Ballsh	1,802
8	Bashkia Sukth	4,450
9	Bashkia Manëz	198
10	Bashkia Koplík	3,193
11	Bashkia Divjak	220
12	Bashkia Durrës	26,189
13	Bashkia Fier	25,650
14	Bashkia Korçë	831
15	Bashkia Vlorë	2,346
16	Bashkia Shkodër	11,632
17	Bashkia Gjirokastër	3,266
18	Bashkia Roskovec	70
19	Bashkia Vau Dejës	2,408
20	Bashkia Patos	1,069
21	Bashkia Fushë Arrëz	4,874
22	Bashkia Lushnjë	49,178
23	Bashkia Kamëz	1,730

Nr	Subjektet e Kontrolluara	000/ Lekë
II.KOMUNA		29,430
1	Komuna Bërdicë, Shkodër	10.669
2	Komuna Kolsh, Lezhë	1.010
3	Komuna Armen, Vlorë	851
4	Komuna Dushk, Lushnjë	634
5	Komuna Prezë, Tiranë	2.864
6	Komuna Bërzhitë, Tiranë	860
7	Komuna Ndroq, Tiranë	905
8	Komuna Vllahinë, Vlorë	1,687
9	Komuna Shëngjin, Lezhë	4,478
10	Komuna Ksamil, Sarandë	1,959
11	Komuna Maminas, Durrës	653
12	Komuna Rrashbull, Durrës	39
13	Komuna Otlak, Berat	592
14	Komuna Pojan, Korçë	1,152
15	Komuna Synej, Kavajë	830
16	Komuna Paskuqan, Tiranë	1,536
17	Komuna Kashar, Tiranë	552
18	Komuna Gjinar, Elbasan	1,508
19	Komuna Qendër, Ballsh	479

Nr	Subjektet e Kontrolluara	000/ Lekë
III.KËSHILLA QARKU		2,322
1	Këshilli i Qarkut Shkodër	310
2	Këshilli i Qarkut Lezhë	673
3	Këshilli i Qarkut Elbasan	1.339

Nr	Subjektet e Kontrolluara	000/ Lekë
IV.TË TJERA		70,053
1	Drejtoria e Punëtorëve Nr. 1, Tiranë	863
2	Njësia Bashkiake Nr. 1 , Tiranë	328
3	Njësia Bashkiake Nr. 2 , Tiranë	2,994
4	Njësia Bashkiake Nr. 3 , Tiranë	1,402
5	Njësia Bashkiake Nr. 6 , Tiranë	15,412
6	Njësia Bashkiake Nr. 10 , Tiranë	96
7	Njësia Bashkiake Nr. 11 , Tiranë	211
8	Universiteti "I.Qemali", Vlorë	48,696
9	Spitali Rajonal Durrës	51
SHUMA		327,377

Tiranë më 17 janar 2012

Departamenti i Kontrollit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit Analiza vjetore 2011 e Departamentit u realizua më dt. 18.01.2012 në ambientet e KLSH, në praninë e gazetarëve të medias së shkruar. Paraqiti raportin e punës vjetore drejtori Athanas Karaja. Diskutuan kontrollorët Mariola Lleshi, Gjovalin Preçi, Pellumb Beqiraj, Artan Topiana dhe Agron Maksutaj. Problemi kryesor i paraqitur ishte dëmi i shkaktuar Buxhetit të Shtetit nga mosarkëtimet e shumave për mallra dhe shërbime të shitura nga kompanitë shtetërore AlbPetrol dhe OST, në nivele respektivisht rreth 4 dhe rreth 2 miliardë lekë. Në analizë mori pjesë edhe Kryetari i KLSH, i cili dha orientimet për punën e departamentit në të ardhmen.

R A P O R T

ANALIZA MBI AKTIVITETIN E DEPARTAMENTIT PËR VITIN 2011



Athanas Karaja

Drejtor i Departamentit të Kontrollit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Departamenti i Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit, sipas programit vjetor të punës së KLSH-së, për vitin 2011 kishte për të kryer 31 kontrolle nga të cilat 27 kontrolle të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, 2 auditime të performancës, 1

certifikim i llogarive si dhe 1 kontroll për zbatimin e rekomandimeve, ndërsa të ndarë sipas subjekteve 15 kontrolle në investimet dhe projektet me financime të huaja, 8 kontrolle në Shoqëritë dhe personat juridik Publik, si dhe 7 kontrolle në entet mjedisore.

Gjatë zbatimit të programit vjetor të kontrolleve, si rezultat i një informacioni të përditësuar për subjekte të ndryshme, programi ka ndryshuar gjatë zbatimit në numrin dhe llojin e subjekteve. Me përjashtim të tremujorit të parë, zbatimi i programit të kontrolleve dhe përparësia në kohë i është nënshtruar përditësimit të rrethanave të reja të krijuara, në çdo rast duke synuar realizimin e programit vjetor të kontrollit.

Në mbyllje të vitit 2011 janë realizuar 30 kontrolle: 10 në projekte me investime të huaja, 14 në shoqëritë publike si dhe 5 në ente mjedisore, pavarësisht realizimeve të ndryshme brenda strukturës së fushave të kontrollit. Janë realizuar sipas programit llojet e kontrollit, me përjashtim të një auditimi të performancës në subjektet mjedisore.

Në mënyrë të përmbledhur programi vjetor i kontrolleve dhe realizimi i tij sipas subjekteve dhe llojeve të kontrollit për vitin 2011 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Fusha e kontrollit	Gjithsej			Nga këto sipas llojeve:					
				Ligjshmërie, rregullshmëri financiare.		Auditime performance		Certifikim i llogarive	
	Prog.	Fakti	+	Prog.	Fakt	Prog.	Fakt	Prog.	Fakt
Projekte	15	10	- 5	14	9	-	-	1	1
Shoqëri publike	8	14	+ 6	8	14	-	-	-	-
Mjedisi	7	5	-2	5	4	2	1	-	-
Zbatim i rekom	1	1	-	1	1				
Gjithsej	31	30	-1	28	28	2	1	1	1

Në rezultatet e mësipërme, janë përfshirë kontrolli i certifikimit të llogarive si dhe kontrolli i zbatimit të rekomandimeve, kontrole të përfunduara, por të pa evaduara. Duhet sqaruar se pasqyra e mësipërme evidenton kontrollet e përfunduara dhe të evaduar gjatë vitit 2011, duke ditur që një numër tjetër kontrollesh janë në proces (7 kontrole) në fazë projektraporti apo raporti përfundimtar, të cilat trashëgohen për vitin e ardhshëm. Gjithashtu, gjatë vitit 2011 janë evaduar 8 kontrole të trashëguara nga viti i kaluar.

Gjatë aktivitetit kontrollues janë rekomanduar ndryshime dhe përmirësime ligjore, masa organizative, masa administrative dhe të zhdëmtimit, masa disiplinore, si dhe kallëzime penale. Në mënyrë të përmbledhur sipas subjekteve, në varësi të zbulimeve të rezultuara janë rekomanduar:

1. Në investimet dhe projektet me financim të huaj

Në 9 subjekte janë rekomanduar 67 masa organizative, ku më shumë janë rekomanduar në projektin “Cilësi dhe barazi në arsim” (16), projekti “Fuqizimi i operatorit të transmetimit” (12), Projekti “Ndërtimi i rrugës Lushnjë- Fier etj.

Nga 67 masa nuk janë zbatuar 6 ose 8.9%, kryesisht në projektin “Fuqizimi i operatorit të transmetimit” (3), projekti “Rehabilitimi i rrjetit hidrik Tiranë” etj.

Janë dhënë masa zhdëmtimi në 5 subjekte për 64,689 mijë lekë, kryesisht në projektin Ndërtimi i rrugës Lushnjë Fier (28,832 mijë lekë), projekti i Menaxhimit të burimeve ujore (24,724 mijë lekë), projekti Ndërtimi spitalit Kavajë (6,294 mijë lekë etj. Masat e zhdëmtimit në pjesën më të madhe i përkasin prokurimeve (gjatë zbatimit të kontratave), në fushën e pagave (Rehabilitimi i rrjetit hidrik tiranë), shpërblimeve (projekti i menaxhimit të burimeve ujore) etj.

Vetëm në projektin “Transmetimi dhe shpërndarja energjisë elektrike” është dhënë dhe zbatuar një masë disiplinore vërejtje me paralajmërim, si dhe 1 masë administrative e pazbatuar në projektin “Ndërtimi i rrugës Lushnjë-Fier”. Duhet theksuar se masat disiplinore në projektet me investimet e huaja, përgjithësisht janë të ezauruara, për faktin se kontrolli ushtrohet në përfundim të projektit, stafi i të cilëve është larguar nga puna.

II. Në shoqëritë publike

Ndryshime dhe përmirësime ligjore janë dhënë gjithsej 4 në 3 subjekte: Autoriteti portal Durrës, Enti Kombëtar i Banesave dhe Drejtoria e shërbimit diplomatik. Këto rekomandime janë marrë në konsiderate nga subjektet përkatëse dhe janë në proces përfundimi.

Janë rekomanduar 231 masa organizative në 15 subjekte, kryesisht në OST(33), Autoritetin Portual Durrës (25), Albpetrol SHA (22), Ujësjellës-Kanalizime SHA Durrës etj. Të pazbatuara figurojnë vetëm 11 prej tyre (4.5%), kryesisht APD (4), Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror (3) etj., në proces në pjesën më të madhe janë në Ujësjellës-Kanalizime SHA Durrës (9), Autoriteti i Aviacionit Civil (7), KESH (6) etj.

Në 11 subjekte janë rekomanduar 60 masat disiplinore (APD, Drejtoria e Shërbimit Diplomatik, Autoriteti i Aviacionit Civil etj.), 25 prej të cilave me largim nga puna (Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë). Nuk janë zbatuar vetëm 2 masa disiplinore nga Albafilm SHA.

Masat administrative të rekomanduara në përgjithësi ju përkasin enteve publike. Janë rekomanduar 30 masa për 5 subjekte (Autoriteti i Aviacionit Civil, OST, Drejtoria e Përgjithshme e Meteorologjisë etj.), nga të cilat vetëm 3 prej tyre nuk janë zbatuar nga Drejtoria e Shërbimit Diplomatik.

Janë rekomanduar masa zhdëmtimi për 9 subjekte në shumën gjithsej 6,029,616 mijë lekë, ku në pjesën më të madhe i përkasin Albpetrol SHA në shumën 3,936,800 mijë lekë, OST 1,924,209 mijë lekë, KESH-i 155,295 mijë lekë etj. Megjithëse arkëtimet e deritanishme janë vetëm 9,279 mijë lekë, për pjesën tjetër kanë dalë njoftimet dhe urdhrat për shpërblimin e demit. Përgjithësisht demet i përkasin zërit "Të tjera shërbim e dieta", por dhe për paga e shpërblime, për shpenzime administrative etj.

Nga kontrolli ne KESH SHA ka rezultuar se ka elemente të veprës penale si rezultat i shpërdorimit të detyrës për 1 person, për te cilin është bere kallëzimi penal me shkresën nr. 423/7, datë 24.04.2011.

III Në entet mjedisore

Gjysma e përmirësimeve ligjore (5) janë rekomanduar në ente mjedisore gjatë kontrolleve të rregullshmërisë si dhe auditimit të performancës në 3 subjekte: ARM Tiranë(2), ARM Durrës(2) dhe Ministria e Shëndetësisë(1), nga te cilët janë marrë në konsiderate,pra janë në proces 3 prej tyre dhe është refuzuar pjesërisht nga ARM Tiranë dhe plotësisht nga Ministria e Shëndetësisë.

58 masat organizative janë rekomanduar në 5 subjekte, kryesisht tek ARM Tiranë (18), ARM Durrës (14), ARM Fier (12) etj., nga të cilat nuk ka masa të pazbatuara, janë në proces 18 të ARM qarkut Tiranë.

Në përgjithësi detyrat e rekomanduara nga KLSH, janë vlerësuar nga subjektet e kontrolluara, duke hartuar program pune për zbatimin e tyre, nxjerrjen e urdhrave përkatës, njoftime dhe duke bërë ndalesat e kontabilizimet, si dhe duke njoftuar për zbatimin e tyre brenda afatit ligjor KLSH-në. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve gjatë muajit korrik 2011 si dhe në fillim vitin 2010, rezulton që në 28 subjekte, rekomandimet për propozime për ndryshim legjislacioni, zhdëmtimet dhe masat disiplinore e administrative janë realizuar në masën 91%.(realizuar 350+92 në proces), kundrejt 83% që ishin vitin 2010.

Në mënyrë të përmbledhur, rekomandimet e dhëna në nivel Departamenti janë si më poshtë:

- Janë rekomanduar 10 raste për përmirësime ligjore, prej të cilave janë zbatuar 3 (tre), të cilat i përkasin subjektit Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, rekomandime të dhëna gjatë kontrollit të ushtruar në Agjencitë Rajonale të Mjedisit Qarku Durrës dhe Tiranë, gjashtë janë në proces realizimi si dhe nuk është marrë në konsideratë rekomandimi për përmirësim ligjor në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Janë rekomanduar 356 masa me karakter organizativ, nga të cilat janë verifikuar 339 (nuk janë verifikuar 17 masat të cilat i përkasin subjektit Instituti i Sigurimeve AD në Maqedoni), nga verifikimi i tyre rezultojnë të zbatuara dhe

në proces 313 ose 92% (227 të realizuar+86 në proces), nuk janë zbatuar 34 masa;

- Janë rekomanduar nisja e procedurave për dhënien e 133 masave disiplinore, nga të cilat 20 për kompetencë të Agjencisë së Prokurimit Publik, nga ku në verifikimin e të cilave rezultojnë të zbatuara 120 masa ose 90% e tyre, si dhe nuk janë zbatuar 13 masa 11 prej të cilave në kompetencë të Agjencisë së Prokurimit Publik, dhënë për subjektin “Albpetrol” SHA.

- Janë rekomanduar masa disiplinore për punonjësit e Njësive të Menaxhimit të Projekteve si “vërejtje me shkrim”, “vërejtje me paralajmërim” etj., në varësi të përgjegjësisë për mangësitë dhe dëmet e shkaktuara nga veprimtaria e tyre. Masat e largimit nga puna, përgjithësisht kanë qenë të ezaurura, për faktin se punonjësit përgjegjës janë larguar më parë nga puna;

- Janë rekomanduar masa administrative në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, në projektin “Ndërtimi i rrugës Lushnjë-Fier”, për të shpallur si të papranueshme për lidhje të mëtejshme të kontratave për shërbime mbikëqyrje kompaninë “SINTAGMA S.r.l.&SËS consulting Engineering S.R.L & S.T.P.E Studio Tecnico Italiano Progettazioni Estero S.p.A”, për moszbatimin me korrektesë të kontratës së mbikëqyrësit, pasi në kundërshtim me të i ka certifikuar firmës së zbatimit punime të parealizuara duke shkaktuar dëm ekonomik;

- Në totalin e kontrolleve të evaduara është zbuluar dëmi ekonomik me vlerë **6,094,587 mijë lekë** dhe është rekomanduar për t’u zhdëmtuar kjo vlerë në 15 subjekte. Është zhdëmtuar vlera 1,450 mijë lekë në gjashtë subjekte, nga e cila vlera 1,590 mijë lekë, është zhdëmtuar plotësisht nga subjekti “Autoriteti portal Durrës”, si dhe 2,171 mijë lekë të realizuar në projektin “Rehabilitimi i rrjetit hidrik, Tiranë”, është në proces realizimi shuma 6,083,088 mijë lekë;

- Për vitin 2011, është vlerësuar dhe dërguar për ndjekje penale një person në subjektin Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën 354,337 mijë lekë.

Realizimi i masave të rekomanduara jepet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Rekom.	Zbat.	Në proc	Pa Zbat.	Pjesërisht	Real. %
1	Ndryshim në legjislacion	10	3	6	1	-	90%
2	Masa organizative	356	227	86	34	9	92%
3	Masa zhdëmtimi (mijë lekë)	6,094,587	11,450	6,083,088	-	-	Në proces
4	Masa disiplinore dhe admin.	133	120	-	13	-	90%

Kontrollet më të spikatuara sipas llojit dhe subjekteve për vitin 2011 rezultojnë si më poshtë:

A. Në kontrollet financiare të investimeve dhe projekteve me financime të huaja në Projektin “Transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike Vau Dejës” ku janë rekomanduar 2 masa për shpërbllim dëmi në vlerë 89.6 mijë euro, si dhe masa organizative e disiplinore.

Në fushën e shoqërive publike kontrolli financiar në **Albpetrol SHA**, ku kanë rezultuar mangësi të shumta, për të cilat janë rekomanduar 22 masa organizative, shpërbllim dëmi në vlerë gjithsej mbi 3.9 miliard lekë, si dhe masa administrative dhe disiplinore për një numër të konsiderueshëm personash. Në kontrollin e ushtruar në “**Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare**” **SHA Tiranë** janë rekomanduar 1 përmirësim ligjor, 9 masa për shpërbllim dëmi në vlerën 134.9 milion lekë, kallëzim penal për ish drejtorin e përgjithshëm për shpërdorim detyre, si dhe masa disiplinore dhe administrative.

B. Në Auditimet e performancës, të cilët kanë qenë kryesisht në fushën mjedisore mbi mbrojtjen e mjedisit urban nga ndotja me mbeturina,

administrimin dhe largimin publik të tyre, në të cilat janë rekomanduar masa organizative për kontrollin dhe zbatimin e rregullave dhe kërkesave për grumbullimin, transportin dhe asgjësimin e mbetjeve urbane; hartimin e programeve të veprimit dhe të bashkëpunimit me institucionet e tjera që ligji i ngarkon për mbrojtjen e mjedisit; përcaktojnë subjektet publike dhe private për fillimin e veçimit dhe trajtimin e mbeturinave urbane sipas tipologjisë së tyre etj.

Auditimi i Performances në Ministrinë e Shëndetësisë **“Për performancën në menaxhimin dhe trajtimin e mbetjeve spitalore në sistemin e shëndetësisë”**, **ku rezultuan këto shkelje:** Kuadër ligjor jo i plotë për menaxhimin e mbetjeve spitalore, mungesë e strukturave përkatëse për menaxhimin e MS, mungesë e Planit të Administrimit të MS, mungesë e pjeshme e bashkëveprimit ndërinstitutional ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave si dhe me Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit, nuk është hartuar nga MSH strategji, plane operative vjetore dhe rregullore tip për administrimin e mbetjeve spitalore sipas tipologjisë së gjenerimit të mbetjeve, mungesë e të dhënave për subjekte të sektorit privat shëndetësor, klinikat mjekësore, farmacitë, klinikat dentare si dhe për subjekte jashtë sistemit shëndetësor, të cilat prodhojnë mbetje spitalore, moszbatim dhe mosrespektim i kërkesave të Rregullores nr. 6, datë 30.11.2007 “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”, kontratat e shërbimit në Institucionet Shëndetësore të audituar nga ne, në përgjithësi janë të lidhura me subjekte të palicencuara për trajtimin e mbetjeve spitalore, impiantet e djegies së mbetjeve spitalore, që janë në shfrytëzim nuk kanë studime mbi ndikimin e tyre në mjedis si dhe nuk janë të miratuara për shfrytëzim nga MMPAU, në përgjithësi mbetjeve spitalore trajtohen njësoj si mbetjet urbane, në fondet e akorduara nga Buxheti i Shtetit, nuk ka zë të veçantë për trajtimin e mbetjeve spitalore, në të gjitha Institucionet e audituara nga grupi i auditimit mungonte një analizë kostoje për trajtimin e mbetjeve spitalore deri në asgjësimin e tyre,

nga Ministria e Shëndetësisë nuk është marrë asnjëherë në analizë menaxhimi i mbetjeve spitalore, etj.

Gjatë zbatimit të programeve për auditimet e performancës, është trajtuar me përparësi krijimi i grupeve të kontrollit me pjesëmarrjen e kontrollorëve të trajnuar gjatë projektit me Gjykatën Holandeze të Llogarive dhe transmetimin e kësaj përvoje dhe tek kontrolloret e tjerë.

C. Certifikimi i llogarive (Mbi vlerësimin e parimeve të përdorura për kontabilitetin dhe çmuarjet e bëra nga menaxhimi, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare) është realizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjiellës Kanalizimeve, Tiranë në projektin me financim të huaj: **“Menaxhimi i Integruar i Ujërave dhe Ekosistemit”** ku, sipas opinionit të kontrollorëve, Pasqyrat Financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Projektit, të fondeve të marra dhe shpenzimeve të paguara nga Projekti në përputhje me faturat në kesh dhe mbi bazën e disbursimeve në periodat përkatëse, shoqëruar me problematika të veçanta.

I. Gjatë kontrollit të investimeve dhe projekteve me financime të huaja për vitin 2011 janë konstatuar probleme të ndryshme, ku sipas fushës së investimeve janë:

- Në ndërtimin infrastrukturës rrugore (**rruga Lushnjë-Fier dhe Levan-Tepelenë**) ka rezultuar se Autoriteti Rrugor Shqiptar nuk ka realizuar shpronësimet për realizimin në kohë dhe me sukses të programeve investuese, nuk ka hartuar një program masash të shoqëruara me koston financiare për sigurimin e niveleve të larta të sigurisë, studimet dhe projektimet e investimeve me financime të huaja të nuk janë të thelluara dhe për pasojë shoqërohen me ndryshime gjatë zbatimit duke rritur koston e tyre, nuk kanë inventarizimin e plotë fizik dhe financiar të segmenteve rrugore për secilin projekt; si dhe Njësitë e Menaxhimit të Projekteve nuk kanë ndjekur dhe nuk kanë ndëshkuar përgjegjësit për realizimin jashtë afateve të punimeve; Për vonesa të shkaktuara në përgjegjësinë e kontraktorëve, nuk janë bërë

njoftimet përkatëse për fillimin e aplikimit të penaliteteve për vonesa, nuk janë realizuar testimet, për të garantuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të parashikuara në kontratë.

- Në fushën e arsimit (**projektit “Cilësi dhe barazi në arsim”**), Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, nuk ka të analizuar ecurinë, pasi vonesat kanë sjellë rritje të shpenzimeve dhe rëndim të kostos së kredive; nuk ju ka dërguar donatorëve raportet financiare dhe raportet mbi ecurinë e projektit; nuk ngritur kapacitet e nevojshme për sektorin e prokurimeve dhe menaxhimin financiar të projektit.

- Në fushën e ujësjellës-kanalizimeve (**PIU Hidrik, Tiranë, Furnizimi me ujë dhe sanitetet në qytetin e Korçës”**), nuk janë riparuar defektet në rrjetin e tubacioneve, nuk ka studim për gjendjen e veprave të artit të ndërtuara për sigurinë e Impiantit të Trajtimit të Ujërave Bovillë nga rrëshqitjet, rishikimin e zbatimit të punimeve për plotësimin në afat të kontratave, etj; SHA Ujësjellës Kanalizimet Korçë, nuk ka analizuar ecurinë e projektit, është lidhur amendamenti i kontratës pa u siguruar financimi i saj, ka ndryshime të strukturës së huasë, nuk ka inventarizim të dokumentacionit të projektit, nuk janë aplikuar penalitete për vonesa në zbatimin e kontratës.

- Në fushën e shërbimit shëndetësor (**Spitali Kavajë**), Ministria e Shëndetësisë nuk ka plotësuar me stafin e specializuar mjekësor repartet e shërbimit të kirurgjisë së përgjithshme, sallës së operacionit të maternitetit dhe shërbimit të reanimacionit; Njësia e Zbatimit të Projektit nuk ka bërë inventarizimin e plotë të pajisjeve mjekësore dhe elektronike dhe regjistrimin kontabël dhe evidentimin në llogaritë e bilancit, Njësia e Zbatimit të Projektit nuk ka marrë masa për ndjekjen e realizimit të punimeve të pakryera, por të situacionuara dhe të likuiduara për zërin “Matja e tymrave etj.

- Në fushën e energjisë elektrike (**“Transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike Vau Dejës”, për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e ballkanit: fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit**), KESH SHA nuk ka bërë të

mundur vënien në punë të komponentit të projektit, “Ndërtimi i rrjetit shpërndarës 20 kv të qytetit të Koplikut”; nuk ka regjistruar ne kontabilitet investimet e kryera, nuk ka zbatuar penalitet për vonesat, nuk ka marrë masa për mbajtjen e materialeve të pa dorëzuar nga kontraktori, etj; Operatori i Sistemit të Transmetimit SHA dhe PIU/OST, në bashkëpunim dhe me METE dhe PMU/METE, nuk kanë përfunduar në kohë projektin, PIU/OST nuk ka raportuar mbi ecurinë e projektit në Ministrinë e Financave, nuk ka hartuar raporte të plota dhe reale, për realizimin e secilit komponent të projektit; planifikimi i disbursimeve nuk ka qenë i saktë, nuk janë kryer misione të përbashkëta monitorimi mbi ecurinë e projektit, janë sistemuar gabim dy pagesa të projektit, nuk është inventarizuar dhe arkivuar dosja e prokurimit etj.

- Në fushën e bujqësisë (**Projekti i menaxhimit të burimeve ujore**), Ministria e Bujqësisë dhe Bordet e Kullimit në rrethe nuk kanë marrë masa për një paraqitje reale të veprimeve kontabël për kontratat e përfunduara.

Zbatimi i kontratave në projektet me financime të huaja është shoqëruar me mangësi, duke shkaktuar dëme nga shpërblimet e përfituara padrejtësisht prej shoqërive mbikëqyrëse, nga kontraktori për rimbursimet e taksës doganore dhe për punime të pakryera, për pagesa të pa justifikuara në zërin “sigurime” si dhe për pagesa punimesh jashtë parametrave teknikë të parashikuar në kontratat përkatëse; për kontratat e punimeve në proces për t’ju mbajtur nga shuma e garancisë ose në të kundërt ti kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik të përfituar padrejtësisht, nga pagesa e taksës doganore dhe TVSH për mallin e furnizuar jo sipas kushteve të kontratës; përfitime të padrejta nga shpërblimet e dhëna për punonjësit e larguar nga puna etj.

II. Në shoqëritë publike.

a) Dokumentacioni ligjor i shoqërive publike (Statut, Rregullore e Brendshme, Kontrata kolektive dhe individuale e punës, dokumentet e regjistrimi etj.) nuk është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi;

b) Këshillat Mbikëqyrëse dhe/ose Bordet drejtuese përgjithësisht nuk kanë përbërjen e duhur në përputhje me udhëzimet përkatëse, shpesh herë marrin

vendime të nxituara dhe të pabazuara ligjërisht të shoqëruara me efekte financiare në dëm të personit juridik publik, nuk funksionojnë siç duhet duke mos analizuar periodikisht aktivitetin e shoqërisë ose duke mos raportuar në institucionet përkatëse;

c) Drejtori dhe/ose Drejtoritë nuk hartojnë në afate dhe në përmbajtje si duhet programet ekonomiko-financiare të shoqërisë, nuk raportojnë periodikisht dhe marrin vendime duke anashkaluar Këshillat Mbikëqyrëse, nuk kanë evidentuar dhe ndjekur në mënyrë të vazhdueshme e debitorët, nuk mbajnë përgjegjësi për mosrealizimin e treguesve ekonomiko-financiar dhe pasojat e menaxhimit jo të mirë të shoqërisë;

d) Në fushën e menaxhimit financiar vërehen abuzime në shpenzimet për personelin, mungesë e dokumentacionit justifikues në kryerjen e pagesave me arkë dhe bankë, dhënie sponzorizimesh të pabazuara ligjërisht, shpenzime për telefonat celular në kundërshtim me legjislacionin, menaxhimi jo i drejtë i depozitave mujore, abuzime në përdorimin e kursit të këmbimit të valutës, dhënie pa kriter e paradhënieve, mos shlyerjen në afat të detyrimeve të ndryshme, dhënie shpërbllim në fund të vitit për punonjësit e shoqërisë edhe në rastet kur shoqëria ka rezultuar me humbje, planifikimi dhe përdorimi i të ardhurave nga subvencionin jo sipas kriterëve në udhëzimet e përkatëse, probleme në procesin e rivlerësimit të aseteve të shoqërisë, mangësi në dokumentet justifikues për shpenzimet e karburantit dhe pagesat për udhëtim e dieta;

e) Gjatë procedurave të prokurimit publik dhe zbatimit i kontratave janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore e nënligjore dhe të detyrimeve kontraktore si mangësi në përcaktimin e vlerës limit të kontratës, dokumentacionin e tenderit, shqyrtim me mangësi i ofertave, mosrespektim i afateve ligjore për shqyrtimin e ankesave, pagesa të kundërligjshme në formën e shtesës së kontratës, moszbatim i afatit dhe detyrimeve kontraktuale etj. Të gjitha këto kanë ulur përdorimin efektiv të fondeve publike;

f) Janë konstatuar mangësi në dhënien me qira të objekteve pronë e shoqërive, duke favorizuar subjekte private dhe duke cenuar interesat e shoqërisë publike;

g) Njësia e Auditit të brendshëm në shumë raste nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar në përputhje me standardet e auditimit, procedurat dhe kërkesat e përcaktuara në manualin e auditit të brendshëm publik.

III. Në entet mjedisore.

a- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nuk ka hartuar Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, nuk ka hartuar metodologjinë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk ka hapur regjistrat e lejeve mjedisore dhe nuk ka pasqyruar në mënyrë të detajuar lejet mjedisore, nuk është bërë monitorimi i treguesve mjedisorë, mungon koordinimi i punës së departamenteve brenda Ministrisë dhe kësaj të fundit me institucionet e tjera në drejtim të ndjekjes së kundërvajtësve dhe arkëtimit të gjobave, etj.

b- Drejtoritë e Shërbimit Pyjor nuk funksionojnë në bazë Qarku; nuk kanë të hartuara planet e mbarështimit, trajtimit dhe shfrytëzimit të fondit pyjor dhe kullotave, nuk janë hartuar planet e mbarështimit pyjor, nuk kanë realizuar të ardhurat e programuara, mungon dokumentacioni në kontrata për dhënien në përdorim të fondit pyjor si dhe nuk ndiqet sa e si duhet vjelja e qirave dhe gjobave të vendosura, etj.

c- ARM-të nuk disponojnë lejet mjedisore të subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet në zonën e tyre, nuk kanë përcaktuar masat dhe afatet për rehabilitimin e gjendjes së mjedisit të dëmtuar gjatë ushtrimit të aktivitetit, janë evidentuar probleme me mbetjet dhe shkarkimet në ajër në subjekte të ndryshme private dhe publike dhe për të njëjtën shkelje, masa e gjobës bëhet e diferencuar si dhe mangësi në përgatitjen e dokumentacionit për pajisje me autorizim dhe pëlqim mjedisor etj.

Veç sa më sipër kontrollorët e Departamentit janë përfshirë në trajnimet brenda dhe jashtë institucionit, të cilët kanë shërbyer për rritjen e profesionalizmit dhe të cilësisë së punës kontrolluese. Pjesë veprimtarisë së Departamentit kanë qenë dhe takimet e organizuara me Bankën Botërore, SIGMA etj., ku jemi përpjekur për një paraqitje dinjitoze të institucionit.

Departamenti i Kontrollit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka rritur forcën dhe cilësinë zbuluese, e shprehur kjo në përqindjen e lartë të rekomandimeve të pranuar dhe të zbatuara dhe/ose në proces nga subjektet e kontrolluara në krahasim me numrin e rekomandimeve të dhëna, si dhe me periudhat e kaluara, duke shërbyer si bazë për rritjen e cilësisë së veprimtarisë kontrolluese gjatë këtij viti.

SFIDAT PËR TË ARDHMEN

Krahas punës së bërë dhe rezultateve të arritura, për Departamentin e Kontrollit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit, mbetet detyrë përmirësimi i punës në këto drejtime kryesore:

- 1. Rritja e eficiencës së auditimeve financiare në investimet e projektet me financime të huaja, duke u përqendruar në vlerësimin e zbatimit të projekteve, në eficiencën dhe efektivitetin e tyre. Veç kësaj do të synohet shtrirja e auditimeve të performances në investimet e huaja dhe shoqëritë publike, duke kombinuar përbërjen e grupeve të auditimit me kontrollor të trajnuar.*
- 2. Vlerësimi i riskut të subjektit të audituar, krahas të tjerave, do të shërbejë për të rritur eficiencën dhe për të kursyer burimet e auditimit, edhe si çështja kryesore në përzgjedhjen e subjektit dhe gjatë aktivitetit kontrollues.*
- 3. Lufta ndaj korrupsionit dhe abuzimeve, duke i paraprirë me parandalimin nëpërmjet ndryshimeve e përmirësimeve ligjore, do të realizohet edhe nëpërmjet bërjes publike të rezultateve nga kontrollet me nivel të lartë*

zbulueshmërie, si dhe duke pasqyruar nivelin e realizimit të objektivave të njësisë, entit, institucionit apo shoqërisë publike.

4. Do të thellohet dhe përmirësohet trajtimi i çështjes që ka të bëjë me auditin e brendshëm në institucionin dhe shoqëritë publike, duke u përqendruar në inkurajimin e tyre në këto struktura.

5. Pavarësisht numrit të lartë të kontrolleve për ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare, do të konsiderohen me përparësi çështjet që kanë të bëjnë me treguesit e efektivitetit, efikasitetit dhe rezultatin ekonomik të subjektit, me objektivin: çdo tregues matjeje performance të jetë i qartë, i matshëm dhe drejtpërdrejtë i lidhur me burimet e përdorura, për të siguruar shërbimet apo produktet e performancës.

6. Studimi dhe gjykimi më i thelluar i materialeve të kontrollit, vërejtjeve të paraqitura nga subjektet e kontrolluara, si dhe respektimin rigoroz të afateve dhe përgatitjen cilësore sipas përcaktimeve në Rregulloren e Brendshme në procesin e evadimit të raporteve të kontrollit.

7. Rritja e performancës së auditimeve kërkon thellim dhe zgjerim të njohurive të kontrollorëve, ku krahas trajnimeve, duhet të karakterizohen nga studim i gjithanshëm dhe i vazhdueshëm sipas subjekteve dhe llojeve të kontrollit.

8. Kontrollorët e departamentit do të jenë të gatshëm për të bashkëpunuar me institucionet e tjera të auditimit si Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit, Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik dhe Departamenti Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave, duke ruajtur pavarësinë e KLSH si organi më i lartë i kontrollit.

9. Gjatë veprimtarisë kontrolluese, auditorët do t'i largohen zbulimit të shpërdorimeve hipotetike, duke u shfaqur nëpunës me integritet të lartë moral dhe profesional.

Tiranë 20.01.2011

Tabela mbi detajimin e dëmit ekonomik sipas subjekteve

Është zbuluar dëmi ekonomik në vlerë 6 094 470 mijë lekë.

Është rekomanduar për t'u zhdëmtuar vlera 6 094 470 mijë lekë në 14 subjekte,

Nr.	Subjekti i kontrolluar	Vlera e shkeljes (000/lekë)	Natyra e shkeljes
1	Projekti "Cilësi dhe barazi në arsim"	282	- Për pagesë të përfituar padrejtësisht nga fondet e kredisë IDA, nga eksperti i menaxhimit financiar të projektit.
Shuma		282	
2	Projekti "Transmetimi dhe shpërndarja e Energjisë elektrike Vau Dejës"	71	- Në zërin të tjera - Për punime të pakryera (29 mijë lekë) - transport lokal (14 mijë lekë) - Furnizim me mallra (28 mijë lekë)
		688	- Taksë doganore e papaguar, për mallra të furnizuara jo sipas kushteve të kontratës
		1909	- Vlera e tvsh e papaguar, për mallra të furnizuara jo sipas kushteve të kontratës
Shuma		2 668	
3.	Autoriteti Portual, Durrës	2 600	- Shpenzime operative , Përfituar padrejtësisht nga anetarët e këshillit drejtues për pagesa telefonike.
		1 590	- Të tjera , Sponsorizime të kryera në kundërshtim me nenin 59, të ligjit 9920, datë 19.05.2008 " për procedurat tatimore" si dhe nenin 2 të ligjit 7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet"
Shuma		4 190	

4.	Autoriteti i aviacionit Civil	32	Në fushën e shpenzimeve operative, përfituar padrejtësisht nga punonjësit me udhëtimet jashtë shtetit
Shuma		32	
5.	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare	1352	Në fushën e shpenzimeve operative, përfituar padrejtësisht nga punonjësit me përdorimin e telefonisë celulare.
		121 930	Në fushën e shpërblimeve, - shpërblime të përfituara padrejtësisht nga punonjësit;
		32 013	Në zëri të tjera, -18 792 lekë, penalitete të pambajtura kompanive për moskryerjen në kohë të pagesave nga shitja e energjisë; -1 051 lekë, humbje nga depozitimi i kredisë në kundërshtim me vendimin e këshillit mbikqyrës; - 8 297 lekë, përfituar nga subjektet për sponsorizime me dokumentacion të paplotësuar; - 3 873 lekë, diferencë e punimeve të realizuara në krahasim me volumet e përshkruara në situacion
Shuma		155 295	
6.	Operatori i Sistemit të transmetimit të Energjisë	1 924 209	- Në zërin të tjera, -1 825 797 lekë, për moslikuidimin e shërbimit të kryer për transmetimin e energjisë elektrike për periudhën nga privatizimi i OSSH deri më 15.12.2010; -74 412 lekë, për mos aplikimin e normës të interesit për faturat e palikuiduara; - 24 000 lekë, përfituar padrejtësisht nga OST për furnizimin e tunelit të kalimashit
Shuma		1924 209	
7.	Projekti “Ndërtimi i spitalit, Kavajë”	6 294	- 476- Në zërin të tjera, përfituar padrejtësisht për punime të pakryera nga firmat e zbatimit të

			<p>projektit.</p> <p>- 5 818 përfituar padrejtësisht për punime të kryera , por të situacionuara dhe të likuiduara me çmim njësi më të lartë se ai i përcaktuar në kontratën e lidhur nga palët.</p>
Shuma		6 294	
8.	Projekti Ndërtimi i rrugës Lushnjë-Fier	28 832	<p>- Në zërin të tjera,</p> <p>- 28 832 lekë përfituar padrejtësisht për punime të pakryera nga firmat e zbatimit të projektit.</p>
Shuma		28 832	
9.	Projekti “Rehabilitimi i rrjetit hidrik”, Tiranë	2 171	<p>- Në sistemin e pagave</p> <p>- për pagesa të pa justifikuar në zërin “sigurime”</p>
Shuma		2 171	
10	Albpetrol, Sh.a. Fier	3936 800	<p>- Në zërin të tjera,</p> <p>- 358 107 lekë, për mos likuidim në kohë të faturave të shitjes së naftës.</p> <p>- 3 578 689 lekë, detyrime që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me naftë bruto, gaz natyror dhe hollues ndaj kompanisë “ARMA Oil”</p>
Shuma		3936 800	
11	Projekti “Menaxhimi i burimeve ujore” MBUMK	23 160	<p>Në fushën e shpërblimeve,</p> <p>- shpërblime të përfituara padrejtësisht nga punonjësit e larguar nga detyra;</p>
		1 564	<p>- Në zërin të tjera,</p> <p>- 1564 lekë përfituar padrejtësisht për punime të pakryera nga firmat e zbatimit të projektit.</p>
Shuma		24 724	
12	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	1040	<p>Në fushën e shpenzimeve operative,</p> <p>- 1040 lekë, përfituar padrejtësisht nga punonjësit, për shërbime e dieta jashtë shtetit.</p>
Shuma		1040	
13	Posta Shqiptare, Sh.a.	619	Në fushën e shpenzimeve operative,

			- 14 lekë, përfituar padrejtësisht nga punonjësit për shërbime e dieta jashtë shtetit.
			- Në zërin të tjera, - 605 lekë, vlerë e llogaritur si penalitet shkaktuar nga shoqëria "Elkri" firma e zbatimit të projektit për rikonstruksionin e objektit.
Shuma		619	
14	Albafilm Sh.a., Tiranë	188	Në fushën e shpenzimeve operative, - 188 lekë, përfituar padrejtësisht nga punonjësit, për shërbime e dieta jashtë shtetit.
		713	Në fushën e prokurimeve publike, - 713 lekë, përfituar padrejtësisht nga firma "Nezha" në ankandin e skrapit të organizuar nga "Albafilm" SHA
		6413	Në fushën e dhënies me qera të pasurisë, - 6413 lekë, përfituar padrejtësisht nga subjekte të ndryshme të cilat nuk kanë shlyer detyrimin e qirasë për ambiente të marra për shfrytëzim nga Albafilm SHA.
Shuma		7314	
15	Porti Detar, Vlorë	65	-Në fushën e shpërblimeve, - shpërblime të përfituara padrejtësisht nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës.
		52	- Në zërin të tjera, - 52 lekë përfituar padrejtësisht për punime të pakryera por të likuiduara nga firma e zbatimit të projektit.
Shuma		117	
SHUMA TOTAL		6 094 587	

I. Në Investimet dhe projektet me financime të huaja.

Gjatë veprimtarisë kontrolluese të shpenzimeve me burim të huaj financimi është synuar të analizohet përdorimi me efektivitet dhe sipas qëllimit për të

cilin janë akorduar huatë, sa dhe si janë përfituar të mirat dhe shërbimet me kosto efektive dhe me cilësinë e duhur, si janë zhvilluar procedurat e prokurimit dhe zbatimi i kontratave, shkalla e realizimit të objektivave të përcaktuara në marrëveshjet e huasë apo grantit, si dhe realizimi i projekteve sipas grafikëve duke identifikuar shkaqet për diferencat eventuale.

Nga kontrollet e ushtruara në zbatimin e projekteve me financime të huaja ka rezultuar se krahas përmirësimit të veprimtarisë manaxhuese nga njësitë zbatuese, ka dhe dëme ekonomike kryesisht në fushën e prokurimeve, tatimeve e taksave, si dhe shpërblimeve. Problematika ka konsistuar përgjithësisht në këto drejtime:

a) Vazhdon të mbetet problematike realizimi në afat i projekteve me financime të huaja, të shoqëruara me nivele të ulëta disbursimi në krahasim me programin e marrëveshjes, shpesh të shoqëruara me kosto shtesë në pagesën e përqindjes për kredinë e pa tërhequr, si dhe vonesa në realizimin e objektivave. Në rastin e rialokimeve, rriten me tepër shpenzimet manaxheriale dhe të konsulencës në dëm të shpenzimeve për investime. Ky problem rëndohet, pasi nuk bëhen analiza nga ministritë dhe institucionet e tjera përgjegjëse. Aq më keq kur nga paaftësia e njësive të zbatimit, donatorët nuk marrin raportet periodike financiare dhe të ecurisë së projektit.

b) Cilësia e dobët e shërbimeve të projektimit në fazën e negociimit, hartimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve është një shqetësim i përhershëm, që gjatë zbatimit të projektit sjell si pasojë ndryshime të shumta me rritje të koston në përgjithësi, si dhe ndryshim të strukturës së saj në dëm të madhësisë së investimeve.

c) Në projektet e infrastrukturës rrugore një nga shkaqet kryesore të vonesave dhe të rritjes së koston janë shpronësimet, ku përgjithësisht projektet nisin dhe kontratat nënshkruhen pa përfunduar plotësisht shpronësimet. Gjithashtu këtu duhet theksuar se pamundësia financiare për kompletimin plotë të segmenteve të veçanta rrugore, ka çënuar sigurinë rrugore si dhe standardet evropiane të kësaj sigurie.

d) Jo në të gjitha rastet mbahen garancitë bankare për kontratat e nënshkruara, duke lënë shkak për mospërbushje të detyrimeve kontraktore dhe mungesë penalizimi, kryesisht kjo për kontratat e shërbimeve të konsulencës

e) Mungesa e bashkërendimit të kohës së përfundimit të projektit, me përgatitjen dhe kualifikimin e personelit të nevojshëm për të vënë në zbatim investimet e kryera, kanë zvogëluar efektivitetin e projekteve kryesisht në fushën e shëndetësisë.

f) Gjatë zbatimit të kontratave, si rezultat edhe i paaftësisë së njësive të menaxhimit nuk penalizohen kontraktorët për tejkalim të afateve të përfundimit të kontratës, duke shkaktuar ulje të rezultateve dhe vonesa në realizmin e komponentëve dhe objektivave të projektit. Gjithashtu, njësitë e menaxhimit/koordinimit të projektit nuk arrijnë të zbatojnë ligjin e marrëveshjes në mënyrë të plotë lidhur me dokumentacionin që rrjedh prej saj (amendamentet, marrëveshje të veçantë mbi procedurat e disbursimit etj.).

g) Konstatohen mangësi dhe cilësi e dobët e shërbimit të supervizionit gjatë zbatimit të kontratave, pasi ka raste që nuk arrihen parametrat teknike të përcaktuar në marrëveshje për punimet e reja apo rehabilituese, duke rënë në ujdë me kontraktorin, për pasojë bie cilësia e punimeve dhe ligjërohen padrejtësisht vonesat në zbatimin e projektit. Gjithashtu, këto subjekte iu shmangen detyrimeve fiskale për tatimin në burim dhe pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore për pjesën e punëdhënësit.

h) Në fushën e prokurimeve hartohen kontrata pa objektiva të matshëm dhe pa sanksione në rastet e mos arritjes së treguesve; likuidime për shërbime/punime të porealizuara dhe të pa dokumentuara; mos aplikim të penaliteteve gjatë zbatimit të kontratës bazë; zgjatje të paargumentuara të afatit të punimeve.

i) Megjithëse objektet e projekteve me financime të huaja janë të kushtueshme, vërehet se subjektet shtetërore përfituese, nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur marrjes në dorëzim dhe administrimit të tyre. Po ashtu

edhe kontabilizimi, inventarizimi dhe arkivimi i dokumentacionit të projekteve lë shumë për të dëshiruar. Gjithashtu, konstatohen mangësi në mirëmbajtjen e projekteve të realizuar me financime të huaja nga subjektet përfituese.

II. Në shoqëritë publike.

a) Dokumentacioni ligjor i shoqërive publike (Statut, Rregullore e Brendshme, Kontrata kolektive dhe individuale e punës, dokumentet e regjistrimi etj.) nuk është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi;

b) Këshillat Mbikëqyrëse dhe/ose Bordet drejtuese përgjithësisht nuk kanë përbërjen e duhur në përputhje me udhëzimet përkatëse, shpesh herë marrin vendime të nxituara dhe të pabazuara ligjërisht të shoqëruara me efekte financiare në dëm të personit juridik publik, nuk funksionojnë siç duhet duke mos analizuar periodikisht aktivitetin e shoqërisë ose duke mos raportuar në institucionet përkatëse;

c) Drejtori dhe/ose Drejtoritë nuk hartojnë në afate dhe në përmbajtje si duhet programet ekonomiko-financiare të shoqërisë, nuk raportojnë periodikisht dhe marrin vendime duke anashkuar Këshillat Mbikëqyrëse, nuk kanë evidentuar dhe ndjekur në mënyrë të vazhdueshme e debitorët, nuk mbajnë përgjegjësi për mosrealizimin e treguesve ekonomiko-financiar dhe pasojat e menaxhimit jo të mirë të shoqërisë;

d) Në fushën e menaxhimit financiar vërehen abuzime në shpenzimet për personelin, mungesë e dokumentacionit justifikues në kryerjen e pagesave me arkë dhe bankë, dhënie sponzorizimesh të pabazuara ligjërisht, shpenzime për telefonat celular në kundërshtim me legjislacionin, menaxhimi jo i drejtë i depozitave mujore, abuzime në përdorimin e kursit të këmbimit të valutës, dhënie pa kriter e paradhënieve, mos shlyerjen në afat të detyrimeve të ndryshme, dhënie shpërblim në fund të vitit për punonjësit e shoqërisë edhe në rastet kur shoqëria ka rezultuar me humbje, planifikimi dhe përdorimi i të ardhurave nga subvencioni jo sipas kriterëve në udhëzimet e përkatëse, probleme në procesin e rivlerësimit të asetëve të shoqërisë, mangësi në

dokumentet justifikues për shpenzimet e karburantit dhe pagesat për udhëtim e dieta;

e) Gjatë procedurave të prokurimit publik dhe zbatimit i kontratave janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore e nënligjore dhe të detyrimeve kontraktore si mangësi ne përcaktimin e vlerës limit të kontratës, dokumentacionin e tenderit, shqyrtim me mangësi i ofertave, mosrespektim i afateve ligjore për shqyrtimin e ankesave, pagesa të kundërligjshme në formën e shtesës së kontratës, moszbatim i afatit dhe detyrimeve kontraktuale etj. Të gjitha këto kanë ulur përdorimin efektiv të fondeve publike;

f) Janë konstatuar mangësi në dhënien me qira të objekteve pronë e shoqërive, duke favorizuar subjekte private dhe duke cenuar interesat e shoqërisë publike;

g) Njësia e Auditit të brendshëm në shumë raste nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar në përputhje me standardet e auditimit, procedurat dhe kërkesat e përcaktuara në manualin e auditit të brendshëm publik.

*Ky raport u mbajt në Analizën Vjetore dhe në Analizën e Departamentit dt.18.01.2012

Departamenti i Kontrollit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit Analiza vjetore 2011 e Departamentit u realizua më dt. 19.01.2012 në ambientet e KLSH, në praninë e gazetarëve të medias së shkruar. Paraqiti raportin e punës vjetore drejtori i komanduar Kristaq Gjurgjaj. Diskutoi kontrollori Sali Agaj. Problemet kryesore të paraqitura ishin mosllogaritja dhe mosarkëtimi i taksës së pasurisë në tatimet dhe detyrimet doganore të papaguara. Në analizë mori pjesë edhe Kryetari i KLSH, i cili dha orientimet për punën e departamentit në të ardhmen.

R A P O R T

ANALIZA MBI AKTIVITETIN E DEPARTAMENTIT PËR VITIN 2011



Kristaq GJURGJAJ

Drejtor (i komanduar) i Departamentit të Kontrollit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit

Gjatë vitit 2011, nga Departamenti është punuar në realizimin e numrit të programuar të kontrolleve për rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të tyre. Në kontrollet e ushtruara, objektivi kryesor ka qenë shqyrtimi i gjendjes, konstatimi dhe evidentimi i parregullsive dhe shkeljeve të legjislacionit tatimor dhe doganor, si dhe përcaktimi i masave për parandalimin e tyre në të ardhmen. Sipas planit të kontrolleve të miratuar në fillim të vitit 2011, ishin

parashikuar për t'u kontrolluar gjithsej 31 subjekte. Janë kontrolluar 22 subjekte, nga të cilët evaduar 17 subjekte dhe 5 subjekte janë në fazën përfundimtare të përgatitjes dhe dërgimit të Raportit Përfundimtar.

Kontrollet sipas subjekteve dhe fazave në të cilat ato janë, paraqiten si më poshtë:

A. Të evaduar :

1. Kontroll në Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë dhe Shkodër *“Për zbatimin e rekomandimeve të kontrolleve të evaduara gjatë v. 2010”*
2. Kontroll në Degën e Doganës Shkodër, Fier dhe Durrës *“Për zbatimin e rekomandimeve të kontrolleve të evaduara gjatë viti 2010”*
3. Kontroll në Degën e Doganës Kapshticë *“Mbi zbatimin e legjislacionit doganor për periudhën e viti 2009 dhe 6 mujorin e I-rë 2010”*
4. Kontroll në Degën e Doganës Elbasan *“Mbi zbatimin e legjislacionit doganor për periudhën 01.07.2008 deri 30.06.2010”*
5. Kontroll në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës *“Mbi zbatimin e legjislacionit për realizimin e të ardhurave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën 01.07.2008 deri 30.6.2010”*
6. Kontroll në Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan *“Mbi zbatimin e legjislacionit për realizimin e të ardhurave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën 01.07.2008 deri 30.06.2010”*
7. Kontroll në Degën e Doganës Qafë Thanë *“Mbi zbatimin e legjislacionit doganor për periudhën 01.01.2008 deri më 30.09.2010”*
8. Kontroll në Degën e Doganës Kakavijë *“Mbi zbatimin e legjislacionit doganor për periudhën 01.01.2009 deri më datën 30.09.2010”*
9. Kontroll në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave - *“Mbi zbatimin e legjislacionit doganor gjatë viteve 2009 dhe 2010”.*
10. Kontroll në Drejtorinë e Tarifave e Taksave Vendore, Bashkia Durrës *“Mbi*

zbatimin e legjislacionit për programimin dhe zbatimin e tarifave për vjeljen e taksave vendore për periudhën e vitit 2010”

11. Kontroll në Degën e Doganës Vlorë “*Mbi zbatimin e legjislacionit doganor për periudhën 01.01.2010 deri më 31.12.2010”*

12. Kontroll në Degën e Doganës Durrës “*Mbi realizimin e të ardhurave doganore dhe zbatimin e legjislacioni doganor per periudhen 2009 – 2010”*

13. Kontroll në Drejtorinë e Tarifave e Taksa Vendore, Bashkia Tiranë “*Mbi realizimin e te ardhurave vendore dhe zbatimin e legjislacionit per programimin dhe vjeljen e tarifave dhe taksave vendore per periudhen e v. 2009 dhe v. 2010”*

14. Kontroll në Degën e Doganës Shkodër “*Mbi realizimin e të ardhurave doganore dhe zbatimin e legjislacioni doganor 01.10.2009 – 31.12.2010”*

15. Kontroll në Degën e Doganës Lezhë “*Mbi realizimin e të ardhurave doganore dhe zbatimin e legjislacioni doganor 01.10.2009 – 31.12.2010”*

16. Kontroll në Drejtorinë e Pergjithshme të Tatimeve- “*Mbi realizimin e te ardhurave tatimore dhe zbatimin e legjislacionit tatimor per periudhen e vitit 2010”*

17. Kontroll në Degën e Doganës Korçë “*Mbi realizimin e të ardhurave doganore dhe zbatimin e legjislacioni doganor 01.10.2009 – 31.12.2010”*

B. Kontrolle të pa evaduara, gjithsej 5 :

1. Dega e Doganës Bllate “*Mbi realizimin e te ardhurave doganore dhe zbatimin e legjislacionit doganor per periudhen 01.01.2009 deri 31.12.2010”*

2. Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe “*Mbi realizimin e te ardhurave tatimore dhe zbatimin e legjislacionit tatimor per periudhe 01.01.2010 deri 31.12.2010”*

3. Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë “*Mbi realizimin e te ardhurave tatimore dhe zbatimin e legjislacionit tatimor per periudhen 01.01.2010 deri 31.12.2010”*

4. Drejtoria Rajonale Tatimore Sarande "Mbi realizimin e te ardhurave tatimore dhe zbatimin e lgjislacionit tatimor per periudhen 01.01.2010 deri 31.12.2010"

5. Kontroll performance ne Drejtorine e Pergjithshme te Doganave për periudhën 01.01.2010 deri 31.12.2010

Referuar rezultateve përfundimtarë të kontrolleve konstatojmë se, krahas punës të kryer nga administrata tatimore e doganore, në veprimtarinë e punonjësve të këtyre subjekteve janë konstatuar dhe evidentuar parregullsi dhe shkelje të legjislacionit fiskal në fuqi, në disa raste të shoqëruar me evazion fiskal, e konkretisht:

Janë konstatuar dhe evidentuar shkelje të natyrave të ndryshme me vlerë totale prej **185 274** mijë lekë, të cilat sipas natyrës dhe llojit të shkeljes, të ndara në sistemin tatimor dhe atë doganor, paraqiten si më poshtë:

I. Në Organet Tatimore qëndrore dhe vendore, janë konstatuar shkelje në vlerë totale prej 1 858 mijë lekë; kjo e ndarë:

- Mos aplikim penaliteti për dorëzim jashtë afateve ligjore të pasqyrave financiare (bilanceve), me vlerë 400 mijë lekë.

- Mos llogaritje dhe mos vendosje takse pasurie me vlerë 1 458 mijë lekë.

II. Në Organet Doganore, janë konstatuar shkelje në vlerë totale prej 183 416 mijë lekë, të cilat sipas llojeve dhe vlerave janë si poshtë:

- Detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e artikujve të ndryshëm të importuar, me vlerë 157 000 mijë lekë

- Detyrime e penalitete të pa vendosura për subjekte që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv, me vlerë 13 071 mijë lekë

- Detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e autoveturave dhe motoçikletave me vlerë 5 657 mijë lekë.

- Detyrime doganore të papaguara për difference në peshë me atë të deklaratës doganore me vlerë 6 767 mijë lekë

- *Penalitetet të pavendosura për mospagim të TVSH-së me vlerë 300 mijë lekë dhe detyrime e penalitete të tjera me vlerë 612 mijë lekë.*

Për subjektet e kontrolluara të dhënat sipas vendimeve të nxjerra në përfundim të kontroleve dhe informacioneve apo akteve të mbajtura në subjekte për zbatimin e detyrave, janë azhurnuar në regjistërin elektronik në mënyrë të vazhdueshme, dhe në mbyllje të periudhës është bërë përpunimi dhe nxjerrja e të dhënave statistikore përkatëse të cilat janë raportuar.

Shkeljet e mësipërme sipas llojit, vlerave dhe subjekteve ku ato janë konstatuar, paraqitet si me poshtë:

1. Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan në vlerën 400 mijë lekë, për gjoba të pavendosura për mosdorëzim në afat të pasqyrave të llogarive financiare (bilancit), dhe deklaratës vjetore të tatim mbi fitimin.

2. Drejtoria Tarifave e Taksave Vendore, Bashkia Durres në vlerën 1 458 mijë lekë, detyrime tatimore dhe takse pasurie e papaguar.

3. Dega e Doganës Kapshticë në vlerën prej 1 263 mijë lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për mos zbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm, në vlerë 479 mijë lekë.

- *Detyrime dhe penalitete të pa vendosura për subjektet që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv, në vlerë 784 mijë lekë.*

4. Dega e Doganës Elbasan, me vlerë 1 978 mijë lekë , ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për mos zbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm, me vlerë 1 978 mijë lekë.

5. Dega e Doganës Qafë Thanë me vlerë 11 131 mijë lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për mos zbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm, me vlerë 2 698 mijë lekë

- Detyrime dhe penalitete të pa vendosura për subjekte që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv, me vlerë 1 561 mijë lekë

- Detyrime doganore të papaguara për diference në peshë me atë të deklaratës doganore në vlerën 6 767 000 lekë.

- Penalitete të pavendosura për mospagim të TVSH-së me vlerë 105 000 lekë.

6. Dega e Doganës Kakavijë me vlerë 8 918 000 lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për mos zbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm, me vlerë 4 192 000 lekë.

- Detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e autoveturave dhe motoçikletave në vlerën prej 4 726 000 lekë.

7. Dega e Doganës Durrës me vlerë 142 811 000 lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importin e mallrave, me vlerë 141 817 000 lekë

- Detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e autoveturave dhe motoçikletave me vlerë 799 000 lekë.

- Kamatevonesa të pallogaritura në skemën e shlyerjes së TVSH-së në vlerën 195 000 lekë.

8. Dega e Doganës Vlorë me vlerë 5 872 000 lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për mos zbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm, me vlerë 1 067 000 lekë;

- Detyrime dhe penalitete të pa vendosura për subjekte që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv, me vlerë 4 552 000 lekë dhe detyrime të tjera me vlerë 253 000 lekë.

9. Dega e Doganës Shkodër me vlerë 7 967 000 lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importin e mallrave, me vlerë 3 542 000 lekë.

- Detyrime dhe penalitete të pa vendosura për subjekte që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv, me vlerë 4 066 000 lekë

- Kamatevonesa te pallogaritura në likuidimin e detyrimeve jashtë afatit ligjor në vlerën 359 000 lekë.

10. Dega e Doganës Lezhë me vlerë 481 000 lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për mos zbatim të procedurave të zhdoganimeve në importin e disa artikujve të ndryshëm, me vlerë 349 000 lekë

- Detyrime doganore te papaguara në zhdoganimin e automjeteve me vlerë 132 000 lekë.

11. Dega e Doganës Korçë me vlerë 2 995 000 lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për mos zbatim të procedurave të zhdoganimeve në importin e disa artikujve të ndryshëm, me vlerë 887 000 lekë

- Detyrime dhe penaltete te pa vendosura për subjekte që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv, me vlerë 2 108 000 lekë.

Bazuar në Ligjin Nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet në Ligjin Nr. 8599, datë 01.06.2000, për të metat, parregullsitë dhe shkeljet e ndryshme të ligjshmërisë dhe ato financiare me pasojë dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit, të konstatuara nga kontrollet e ushuara gjatë vitit 2011, dhe dërguar zyrtarisht subjekteve të kontrolluar raportet përfundimtare të kontrollit së bashku me rekomandimet për përmirësimin e gjendjes, konkretisht:

1. Masat me karakter organizativ:

Janë rekomanduara gjithsej 139 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 61 prej tyre, janë në proces 34 masa, nuk ka informacion për 35 masa dhe pa zbatuar 9 masa.

2. Masat për shpërblimin e dëmit ekonomik:

Nga 17 kontrollet e evaduara në 11 prej tyre janë rekomanduar masa shpërblimi me vlerë **185 274** mijë lekë. Bazuar në informacionet e ardhura dhe

kontrolli i zbatimit të detyrave konstatohet se, deri në fund të vitit 2011 janë nxjerrë urdhërat përkatës për shpërblim dëmi dhe janë në proces arkëtimi **18 550** mijë lekë, ose në masën 10% të vlerës gjithsej të rekomanduar.

3. Masat administrative dhe disiplinore:

Bazuar në ligjin organik të KLSH-së, me ndryshime në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, në “Kodin e punës” e etj, për parregullsitë dhe shkeljet e ndryshme të konstatuara me apo pa dëm ekonomik, ndajë punonjësve shkaktarë të subjekteve të kontrolluara janë rekomanduar masa administrative dhe disiplinore, si më poshtë:

Rekomanduar gjithsej 60 masa disiplinore për punonjësit e 9 subjekteve, nga të cilat;

- për 3 punonjës masa *“Largim nga shërbimi civil”*.
- për 12 punonjës masa *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë”*.
- për 14 punonjës *“kalim në një nivel me të ulët”*.
- për 13 punonjës masa *“Vërejtje me shkrim”*.
- për 18 punonjës masa *“Vërejtje me paralajmërim”*.

Sipas informacioneve të ardhura rezulton se, nga 60 masa disiplinore të rekomanduara janë zbatuar 19 masa ose 32 %, janë në proces 14 masa dhe nuk ka informacion për 27 masa.

Nga kontrolli i zbatimit të detyrave në Drejtorinë e Tarifa e Taksave Vendore, Bashkia Tiranë, rezulton se megjithëse nuk janë rekomanduar masa disiplinore për shkeljet e konstatuara nga KLSH-ja, nga Drejtoria e Tarifave e Taksave Vendore janë dhënë masa administrative për 14 punonjës *“Vërejtje me shkrim”* dhe për 39 punonjës *“Vërejtje me paralajmërim”*.

Gjithashtu janë bërë dhe dy kallëzime penale për Drejtorët e Drejtorive Rajonale Tatimore të Elbasanit dhe Durrësit, për “shpërdorim detyre”, mos dhënie dokumentacioni për kontroll dhe pengim të procesit të kontroll.

4. Propozime për përmisime ligjore, në fushën e sistemit fiskal

Gjatë ushtrimit të veprimtarise kontrolluese në vitin 2011, nga departamenti janë përegatitur dhe dërguar në strukturat respektive një propozim për ndryshim apo përmirësim të dispozitave ligjore në fuqi, konkretisht;

- në tatime (kontrolli në DPT) në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008

“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Kreu XIV “Sanksionet”, neni 113 “Mosdeklarimi në afat”, të shtohet një paragraf me përmbajtje:

Tatimpaguesi i cili nuk paraqet deklaratën tatimore të Tatimit mbi fitimin si dhe pasqyrën e llogarive financiare (bilancin) së bashku me anekset e tij, brenda afatit të përcaktuar në Ligjin Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat Personale”, neni 29 “Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit”, paragrafi 1, dhe në kushtet e nenit 66 “Zgjatja e afatit për dorëzimin e deklaratës tatimore’ paragrafi 1, i Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, tejkalon afatin 30 ditë kalendarike, dënohet me gjobë 10 mijë lekë për çdo muaj vonesë deri në 6 (gjashtë) muaj pas afatit ligjor. Pas kësaj, ndaj subjektit të ushtrohen masa të tjera shtërnguese ligjore.

Nga verifikimi i bërë në vend, rekomandimi rezulton i pazbatuar, pasi me shkresën nr. 8150/28, datë 27.09.2011 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sqarohet se të drejtën për përmisime ligjore e ka Drejtoria e Politikave Makroekonomike dhe Fiskale në Ministrinë e Financave.

5. Marrëdhëniet me institucionet objekt kontrolli

Mardhëniet e bashkëpunimit midis KLSH-së (Dep.Kont.Ardh.B.SH) dhe institucioneve objekt kontrolli nuk kanë qenë i mirë, kjo kryesisht me administratën Tatimore.

Këto mardhënie nuk kanë qenë në përputhje me nenin 163 të Kushtetutës së RSH dhe Ligjin Nr. 8270, datë 23.12.1997, me ndryshiem në Ligjin Nr. 8599,

datë 01.06.2000 “Disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8270, datë 23.12.1997, për KLSH-së”, neni 16 dhe 17 i tij.

Si rezultat i këtyre mardhënieve, bën që disa kontrolle të planifikuara për periudhën shtator – tetor 2011, në Drejtoritë Rajonale Tatimore Lezhë, Korçë dhe Sarandë mos evadohen, kjo për mungesë paraqitje dokumentacioni për kontroll.

6. Mangësitë e konstatuara.

Krahas arritje për kontrollet e kryera gjatë vitit 2011, u paraqitën dhe probleme të cilat duhet të reflektohen gjatë vitit 2012, konkretisht:

Mos mbyllja në afat e programeve të kontrollit, kryesisht të Raportit Përfundimtar të Kontrollit, në disa raste duke kaluar në periudha të gjata.

Hartimi i programeve të kontrollit, jo sipas manualit të funksionit të KLSH-së.

Mos paraqitja e mendimit të Kryekontrollorit dhe juristit të departamentit në materialet e kontrollit.

Dhënia e rekomandimeve jo të sakta dhe të bazuara këto në dokumentacion e kontrolluar, gjë e cila ka bërë që niveli i zbatimit të tyre të jetë 9%.

Mungesa e trajnimit të kontrollorëve, kjo referuar sfidave të kohës, ku dy institucionet (tatime e dogana), aktivitetin e tyre kryesorë e kanë sipas sistemeve të IT.

Kryerja formale dhe në kohë të shkurtër e kontrolleve të performancës, dhe jo sipas manualit të performancës.

- Niveli i ulët i kallzimeve penale.
- Dhënia e marasa disiplinore tepër të ulta për ounonjësit që i kryejnë ato.

9. Objektivat e vitit 2012.

Me gjithë arritjet për periudhën që analizojmë, duke i ballafaqur ato me materialin “PROJEKT-IDE” të paraqitur nga Kryetarit i KLSH-së Dr.Bujar Leskaj në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, lind e nevojshme të punohet më shumë në drejtim të:

- *Pregatitjes së bazës metodologjike bashkohore të veprimtarisë së Departamentit, ku të përcaktohen procedurat standarte të punës së kontrollorit, duke kthyer vëmendjen tek auditi i performancës, krahas atij financiar.*
- *Thellimi i misionit të KLSH-së në luftën kundër korrupsionit, nëpërmjet analizës së riskut dhe kontrolleve të bazuara mbi këtë analizë.*
- *Vlerësimi i materialitetit dhe riskut, gjatë gjithë procesit të kontrollit.*
- *Do synohen kontrole bazuar në sisteme IT, meqënsë dhe vetë administrata të dhënat i ka në sisteme, kjo do të arrihet nga njohja e mirë e sistemeve mbi mënyrën e funksionit të tij për analizimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave statistikore që administrojnë administratën.*
- *Menazhimi dhe administrimi i të ardhurave tatimore, ekonomicitetit, eficientia dhe efektivitetin e tyre, nga auditi i performancës.*
- *Rritja e cilësisë së veprimtarisë, duke zbatuar standartet e punës që nga programi vjetor dhe deri në përgatitjen e raportit përfundimtar të kontrollit dhe rekomandimeve.*
- *Përqëndrimi i vëmendjes tek auditi i performancës, krahas auditit financiar.*
- *Njohja dhe shfrytëzimi më i mirë i praktikave të aplikuara nga SAI, në fushën e kontrollit të të ardhurave.*
- *Njohjen sa më mirë e mënyrës së organizimit dhe funksionit të strukturave të administratës fiskale, procedurave dhe praktikave dokumentare të miratuara dhe të përdorura nga organet tatimore e doganore etj, me synim zbulimin e shkeljeve në punën e administratës tatimore dhe doganore, me qëllim minimizimin e tyre, si faktor që ndikon në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit*
- *Shkëmbimi i informacionit, jo vetëm ndërmjet agjensive të zbatimit të ligjit, por të çdo organi shtetëror që luan rol dhe ka përgjegjësi në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, i cili synon shkëmbimin e informacionit, jo si pjesë e detyrimit dhe përgjegjësisë ligjore e institucionale të zakonshme, por mbi baza funksionale, proaktive dhe me periodicitet më të shpejtë.*

- Kualifikim e trajnimin më të mirë të kontrollorëve në nivel të parametrave të kërkuar nga INTOSAI, dhe në përputhje me sfidat intreguse të vendit.
- Informim të gjitha ndryshimeve të legjislacionit tatimor dhe doganor, udhëzimeve përkatëse në zbatim të tyre dhe ligjit unik të Buxhetit të Shtetit.
- Përqëndrimin e vemendjes në dhënien e rekomandimeve për përmiresime ligjore, me qëllim parandalimin e shkeljeve dhe minimizimin e vakumin në plotësimin dhe interpretimin e akteve ligjore në zbatimin praktik të tyre.
- Zbatimin e Kodit Etik të KLSH-së.

Në këtë material, paraqitëm në mënyrë të përmbledhur punën e Departamentit tonë për vitin 2011, të bindur se diskutimet dhe propozimet tuaja do e pasurojnë dhe do të kontribuojnë në përmisimin e punës, rritjen e angazhimit tonë për periudhën në vazhdim, për realizimin e detyrave dhe numrit të kontrolleve të programuara për vitin 2012, duke synuar për një konceptim më të mirë nga pikpamja cilësore, afateve, efektivitetit dhe efikasitetit të kontrolleve, si dhe të objektivave të parashtruara në planit strategji të KLSH-së.

Tiranë, më 19.01.2012

DISKUTIM NË ANALIZËN VJETORE 2011 TË DEPARTAMENTIT



Marjola Lleshi,
Kontrollore e Lartë
Departamenti i Kontrollit të Investimeve dhe
Projekteve me Financime të Huaja
Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit

I nderuar zoti Kryetar,

Departamenti ynë gjatë veprimtarisë kontrolluese të investimeve me financim të huaj ka synuar si objektiv të vetin dhënien e një opinionit të qartë mbi përdorimin me efektivitet dhe sipas qëllimit për të cilin janë akorduar huatë apo grantet.

Menaxhimi dhe administrimi i projekteve me financime të huaja, me gjithë ecurinë në rritje që ka pasur, vazhdon të shfaq mangësi në drejtime të ndryshme. Si në përfitimin e shërbimeve me kosto të ulët dhe me cilësinë e duhur, si në zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimin e kontratave, shkalla e realizimit të objektivave të përcaktuara në marrëveshjet e huasë, si dhe realizimi i projekteve të punimeve a shërbimeve sipas grafikëve, duke identifikuar shkaqet për diferencat eventuale.

Megjithatë ndodhemi para faktit të realizimit në jo në afat të projekteve me financime të huaja, shoqëruara me nivele të ulëta disbursimi në krahasim me programin e marrëveshjes, shpesh të shoqëruara me kosto shtesë në pagesën e përqindjes për kredinë e pa tërhequr, si dhe vonesa në realizimin e objektivave. Ministritë dhe institucionet e tjera përgjegjëse nuk marrin masa dhe nuk analizojnë shkaqet dhe kostot dhe nuk mundohen të gjejnë rrugët e duhura me donatorët për ecurinë e projekteve.

Gjatë zbatimit të kontratave kemi cilësi të dobët të shërbimit të supervizionit, formate të komplikuar kontratash që në shumicën e rasteve janë në favor të kontraktoreve të cilat konkretizohen me zgjatje pafund të kohës së kontratave dhe kosto shtese. Këto subjekte kanë krijuar një lloj statukuaje dhe iu shmangen detyrimeve fiskale për tatimin në burim dhe pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore për pjesën e punëdhënësit.

Fenomen i shpeshte i cili është pengese serioze gjate auditimit dhe realizimit te programit janë dokumentacioni lidhur me prokurimet , sidomos me prokurimet e konsulences te cilët përgjithësisht kontraktohen nga Bankat dhe nuk ekziston asnjë dokument tjetër përveç kontratës, hartohen kontrata pa objektiva të matshëm dhe pa sanksione në rastet e mos arritjes së treguesve;; mos aplikim të penalteteve gjatë zbatimit të kontratës bazë; zgjatje të paargumentuara të afatit të punimeve etj.

Zoti Kryetar duke ju referuar pasqyrës së mësipërme mbi punën e bërë dhe gjetjet e konstatuara, ne jemi përpjekur të eidentojmë dhe marrim masa si në aspektin organizativ, masave administrative apo penale në rastet kur janë hasur por, mendoj se ,ka ardhur momenti të dalim nga kontrollet rutinë dhe të fokusohemi drejt kontrolleve vlerësues. Pra të jemi në gjendje ti themi Qeverisë apo pushtetit vendor , që një kredi e caktuar e ka arritur 3E e mësipërme (eficence+efektivitet+ ekonomikitet)apo thjesht ka renduar barrën e borxheve?.

Departamenti ynë për shkak të punës specifike të auditimit të Marrëveshjeve financiare na vendos para një fakti dhe problemi i cili kërkon një zgjidhje të menjëhershme për dokumentat standarde të punës, të cilat në kontratat ndërkombëtare na vendosin në vështirësi, pra duhet gjetur një formë e re për eidentimin e një zbulimi lidhur me kontrollin në këto kontrata dhe marrjen e masave.

Kërkojmë trajnime dhe bashkëpunim me donatoret dhe homologet tanë , lidhur me kontrollet për të rritur kapacitete e kontrolloreve dhe së fundmi,

-Kam përshtypjen se lidhur me nr e kontrolleve të performancës po tregohemi me euforik se duhet. Kjo pasi duhet të analizojmë qartë mundësitë tona dhe kapacitet intelektuale të cilat janë domosdoshmëri në këto lloj kontrollesh, dhe mendoj së bashkangjitur grupeve të kontrollit duhet të kemi specialite inovativ , për të kryer një kontroll performance në standarde të kërkuara.

Tiranë, më 18.01.2012

DISKUTIM NË ANALIZËN VJETORE 2011 TË DEPARTAMENTIT



Gjovalin Preçi,

Kontrollor i Lartë

Departamenti i Kontrollit të Investimeve dhe
Projekteve me Financime të Huaja
Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit

I nderuar zoti Kryetar,

Pavarësisht se gjate vitit të kaluar në aktivitetin kontrollues jam angazhuar në kontrollin e jo vetëm të investimeve dhe projekteve me financime të huaja, por dhe të shoqërive publike, jo vetëm të kontrolleve të ligjshmërisë, rregullshmërisë financiare por edhe të certifikimit të llogarive, parashtrimi i disa problemeve të konstatuara në fushën e investimeve e financimeve të huaja, mbi bazën dhe të përvojës së mëparshme kontrolluese në KLSH, gjykoj se do t'i shërbejnë përmirësimit të punës në të ardhmen.

Menaxhimi dhe administrimi i projekteve me financime të huaja nga njësitë e menaxhimit, me gjithë ecurinë në rritje që ka pasur, vazhdon të shfaq mangësi në drejtime të ndryshme. Parë në tërësi problematika e konstatuar në kontrollin e investimeve e projekteve me financime të huaja, konsiston kryesisht në:

a. Pavarësisht se rritja e kapaciteteve të administratës publike në tërësi ka ndikuar në rritjen sasiore të fondeve të thithura nga donatorët, projektet me financime të huaja vazhdojnë të vuajnë mungesën e realizimit në afatet e parashikuara që tek ciklet e planifikimit të projekteve, hartimit e miratimit të marrëveshjes dhe deri në bërjen efektive të kontratës së punimeve a

shërbimeve dhe përfundimin e saj. Një tregues i tille ka shkaktuar pasojat e veta si ne zvogëlimin sasisë se përfitimeve publike, ashtu edhe me rritjen e kostos se tyre, shoqëruar me ritme te ulëta te disbursimeve.

b- Koha e gjate midis hartimit te Projekteve, pa marre ne konsiderate mangësitë e hartimit tyre, deri ne zbatimin e tyre ka bere qe gjate periudhës se zbatimit, projektet te pësojnë ndryshime te konsiderueshme me pasoja ne rritjen e kostos se tyre dhe uljen e efektivitetit, kjo edhe si rezultat i ndryshimeve ekonomike ne përgjithësi. Përgjithësisht vonesat ne fillimin e zbatimit te marrëveshjes se huasë, sjellin shpërpjesëtime në strukturën e shpenzimeve ne favor te atyre administrative dhe në dëm të investimeve.

c. Është konstatuar se subjektet kontraktore të huaja i shmangen pagimit te tatimeve dhe kontributit te sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nëpërmjet marrëveshjeve tatimore për shmangien e tatimit te dyfishtë me vendet e origjinës.

d. Veprimtari e dobët mbikëqyrëse gjate zbatimit te projekteve, ka sjelle si pasojë jo vetëm vonesat por dhe mungese cilësie ne realizmin e investimeve, pasi ka raste që nuk arrihen parametrat teknike të përcaktuar në marrëveshje për punimet e reja apo rehabilituese, duke rënë në ujdj me kontraktorin, për pasojë bie cilësia e punimeve dhe ligjërohen padrejtësisht vonesat në zbatimin e projektit.

e. Megjithëse objektet e projekteve me financime të huaja janë të kushtueshme, vërehet se subjektet shtetërore përfituese, nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur marrjes në dorëzim dhe administrimit të tyre. Po ashtu edhe kontabilizimi, inventarizimi dhe arkivimi i dokumentacionit të projekteve lë shumë për të dëshiruar. Mungesa e bashkërendimit të kohës së përfundimit të projektit, me përgatitjen dhe kualifikimin e personelit të nevojshëm për të vënë në zbatim investimet e kryera, kanë zvogëluar efektivitetin e projekteve kryesisht në fushën e shëndetësisë.

Niveli dhe cilësia e zbulimeve, rekomandimet dhe pranimi nga ana e subjekteve të kontrolluara janë inkurajuese për përmirësimin e punës sonë në të ardhmen.

Kontrrolli i përdorimit me efektivitet të investimeve të huaja, behet me i domosdoshëm dhe jo vetëm për faktin se vendi ynë, si rezultat i rritjes ekonomike ka kaluar në fazën marrjes së huave me interesa në kushtet e tregut, dhe jo me kredi të buta, por dhe si rezultat i krizës aktuale financiare, që padyshim do të ketë ndikimet e veta në ekonominë e vendit tonë.

Baza e arritjeve të deritanishme, si dhe vizioni i ri KLSH, gjykoj se veprimtaria jonë audituese në të ardhmen ka nevojë të përmirësohet dhe fuqizohet në mënyrë të vazhdueshme disa drejtime:

1. Janë të gjitha mundësitë që në kontrollet e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së investimeve të huaja të zërë vend me të gjere dhe trajtim me cilësor vlerësimi i projekteve lidhur me realizimin e objektivave, duke realizuar deri në një nivel të caktuar **performancën** e zbatimit të projekteve, si dhe duke përfshirë projektet me financime të huaja **në auditimet e performances;**

2. **Intensifikimi i veprimtarisë kontrolluese në dy drejtime:** - Kontrolli gjatë fazës zbatimit të projektit, për projektet me nivel të lartë financimi, do të shërbejë parandalimit dhe zvogëlimit të mundësisë së abuzimit, si dhe përmirësimit të ritmeve të zbatimit të këtyre investimeve.

- Në këtë kuadër, gjykoj se në fazën përmblyëse të investimit të behet e mundur kontrolli i një numri sa më të madh i projekteve, pavarësisht nivelit të investimit dhe disbursimit. Në të dy rastet përparësia do të jete mbi bazën e riskut, si dhe duke ekonomizuar burimet e kontrollit. Në këtë mënyrë përdoruesit dhe përfituesit publik të investimeve të huaja, do të rrisin besimin se të gjitha fondet i nënshtrohen kontrollit të shtetit.

3. **Krijimi i një modeli standart të dokumentacionit të kontrollit** që kërkohet për subjektet objekt auditimit, duke i paraqitur ato ne dokumentin e njoftimit, mendoj se do te rrisë efektivitetin e veprimtarisë kontrolluese. Në këtë kuadër, mendoj se dhe disa **dokumente te institucionit tonë, kanë nevojë për përditësim**, pasi Rregullorja e brendshme ka dale në shkurt te vitit 2006 dhe detyrat nuk përputhen me strukturën aktuale, ose legjislacioni qe i referohet Kodi etik, etj.

4. Zhvillimi ekonomik afatgjatë i qëndrueshëm dhe i balancuar, si dhe integrimi i ekonomisë shqiptare në BE, sjellin nevojën e maksimizimit të efikasitetit dhe te fondeve me burim financimi nga BE. Marrja nga Shqipëria e statusit te vendit kandidat, do te rrisë akoma me shume financimet e Bashkimit Evropian për vendin tone duke kaluar gradualisht ne përpjesëtime me te mëdha per investime. **Shtrirja e kontrollit mbi financimet e BE jo vetëm do të rriste besimin në miradministrimin dhe efikasitetit të tyre.**

Tiranë, më 18.01.2012

DISKUTIM NË ANALIZËN VJETORE 2011 TË DEPARTAMENTIT



Pullumb Beqiraj,

Kontrollor i Parë

Departamenti i Kontrollit të Investimeve dhe
Projekteve me Financime të Huaja
Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit

I. Për drejtimet e punës për vitin 2012, dakord, por ne nuk jemi njohur me programin e punës vjetor.

II. Mendime në drejtim të organizimit dhe drejtimit të punës në Departamentin tonë.

1. Mungon bashkëpunimi ndërmjet Departamenteve për të organizuar dhe koordinuar planin e kontrolleve brenda institucionit, në mënyrë që në një Ministri ose në një Organ të Pushtetit Vendor të shkojë vetëm një grup kontrolli kompleks dhe jo 2-3 kontrolle në vit nga Departamente të ndryshëm duke krijuar mbivendosje, fakt që tregon për mungesë koordinimi dhe rakordimi të programeve të kontrollit ndërmjet Departamenteve.

- Kontrollat komplekse të ushtrohen mbi bazën e grupeve të punës ku të jenë kontrollorët më të mirë nga Departamentet përkatëse.

Për këtë mendoj:

- Të rakordohen programet e punës së Departamenteve dhe në çdo ministri të hartohet programi i përbashkët me grupin kontrolli kompleks.

- Kontrollat komplekse të ushtrohen mbi bazën e tematikave specifike sipas Departamenteve dhe në grupet e punës të jenë kontrollorët më të mirë.

2. Mungon bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës me Drejtoritë e Auditëve të Ministrive për koordinimin e planit të kontrolleve të vitit ushtrimor, kjo për faktin se në disa subjekte brenda vitit ka patur kontrolle nga auditët e ministrive dhe nga KLSH-ja.

Ky bashkëpunim duhet të kryhet edhe në zbatim të nenit 90, të Marrëveshjes se Stabilizim Asociimit. i cili përcakton shprehimisht:

“Bashkëpunimi për auditimin dhe kontrollin financiar. Bashkëpunimi mes Palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushat e kontrollit financiar të brendshëm publik (KFBP) dhe auditimit të jashtëm. Palët bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar një sistem efikas të KFBP (Kontrolli Financiar i Brendshëm Publik) dhe sisteme të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuar botërisht si edhe me praktikat më të mira të BE-së”.

3. Në hartimin e programit të punës vjetore të Departamentit **nuk** merret mendimi i gjithë inspektorëve të Departamentit, njëkohësisht nuk bëhet i ditur ky program.

Programet e kontrollit për çdo subjekt të hartohet nga P/Grupit por në bashkëpunim edhe me kontrollorët (të ketë afat një javor). P/grupit duhet të nxiti pjesëmarrjen e tyre në hartimin e pjesëve të veçanta të programit të kontrollit dhe në përcaktimin e standardeve që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me punën e tyre.

Gjithashtu P-grupit duhet të dëgjojë me kujdes vërejtjet dhe sugjerimet e tyre e të bëjnë adoptime kur ato janë racionale.

Në këtë mënyrë punonjësit (kontrollorët) e ndiejnë veten “**Bashkëpunëtorë**” të programit të kontrollit e do ta pranojnë atë si të drejtë dhe të arsyeshëm.

Nëpërmjet këtij bashkëpunimi përmirësohen më tej marrëdhëniet e grupit.

4. Objektivat në drejtim të kontrollit mund të diferencohen sipas nivelit ku ato përcaktohen, sipas fushës së veprimtarisë së tyre, sipas kohës së shtrirjes dhe madhësisë së specifikimit të tyre.

Është e rëndësishme të kuptohet se prioriteti i tyre mund të ndryshojë gjatë vitit. Në një moment kohe dominon një objektiv, ndërsa më vonë në plan të parë mund të dalë një objektiv tjetër.

5. Teknika e grupeve të kontrollit.

Teknika e grupit, që në fakt është një teknikë ndërhyrjeje, ka të bëjë me një grup të tërë kontrollorësh, të cilët punojnë bashkërisht për realizimin e një programi kontrolli.

-Që një grup i tillë të jetë me të vërtetë efektiv, ai duhet të plotësojë disa kushte:

Së pari: Formimi i grupit me specialistë që ti përshtaten objektivave të kontrollit, dhe sidomos grupimi i aftësive individuale.

Së dyti: Gjithë ekipi duhet të punojë për arritjen e objektivave të përbashkëta.

Së treti: Ekipi duhet të ketë përgjegjësi unike për arritjen e objektivave.

Së katërti: Përcaktimi i detyrave të grupit, i roleve të anëtarëve të tij, në mënyrë individuale.

Së pesti: Kryerja e detyrave duhet të mbështetet në punën dhe eksperiencën e secilit si dhe në besimin reciprok ndaj çdo anëtari të grupit.

Së gjashti: Anëtarët e grupit duhet të kenë status të njëjtë dhe ngarkesë pune përafërsisht të barabartë.

6. Debati në problemet e dala në grup.

Ndër efektet pozitive të debatit mund të përmendim:

Së pari: Debati çon në rritjen e shkallës së motivimit të punonjësve.

Së dyti: Debati nxit daljen në sipërfaqe të problemeve të "Padukshme".

Së treti: Debati nxit kreativitetin dhe gjenerimin e ideve të reja.

Së katërti: Morali dhe kohezioni i grupit ka tendencë që të rritet kur njerëzit trajtojnë e debatojnë bashkërisht problemet e kontrollit.

Së pesti: Kur madhësia e debatit është e pranueshme, performanca ka tendencë të rritet.

7. Çdo ndërhyrje që bëhet në materiale të lihet gjurmë (nga P-Sektorëve; Drejtorët; Kontrolli i cilësisë etj.

8. Burimet njerëzore (të kontrollorëve).

- Të evidentohen kontrollorët sipas profesioneve, vjetërsisë në punë, shkallës së atestimit, nivelit kualifikues individual profesional, aftësitë komunikuese, menaxhuese, interpretative etj, për të bërë një formim sa më profesional të grupit dhe grupet mundësisht të jenë në nivel të barabartë dhe të kombinohen kontrollorët e vjetër me të rinj.

9. Shpërndarja e grupeve sipas objekteve të kontrollit.

Deri tani në Departament nuk ka patur një gjykim dhe qëndrim të drejtë në drejtim të shpërndarjes së grupeve. Vlen të theksohet se edhe shpërndarja e grupeve në distanca mbi dhe nën 100 kilometra bëhet në mënyrë miqësore dhe të padrejtë. Ky fakt vërtetohet me dietat e marra nga çdo inspektor, ku drejtori i Departamentit nuk i trajton të gjithë inspektorat në mënyrë të barabartë. Për tre vjetët e fundit ka mundësi që raporti i dietave ndërmjet inspektorave të jetë 1 me 10.

10. Vlerësimi ndaj punës së grupit dhe vlerësimi individual.

- Vlerësimi deri më sot është bërë shumë formal, pa lexuar materialet, vlerësim i cili lë shumë për të dëshiruar dhe që ka influencuar shumë negativisht në mbarëvajtjen e punës. KLSH është sot institucioni më i dobët dhe më formali në drejtim të vlerësimit të punës së punonjësve në krahasim me Institucionet e tjera.

i. Vlerësimi vjetor, do të ishte më efikas sikur ky vlerësim të bëhej në periudha më të shkurtra, mujore dhe tremujore dhe vlerësimi vjetor të bëhet i përmbledhur me gjithë kontrollet e vitit.

ii. Vlerësimi të jetë në formën e një raporti të arsyetuar ku të analizohen qëllimi i përgjithshëm dhe arritja e objektivave;

iii. Ky vlerësim duhet të marrë në konsideratë kryesisht eksperiencën dhe cilësinë e shërbimit, por edhe elementë të tjera si vlerësimi në grup, marrëdhëniet ndër personale, aftësitë shprehëse me shkrim dhe me gojë (për arsye se në përfundim të kontrollit është e mirë që materiali të mbrohet në grupin e cilësisë së drejtorisë që mendoj të ngrihet për çdo departament. Vlerësimi të jetë i formatizuar në formën e një kartelet (dy kopje) nga të cilat një kopje ti bashkëngjitet raportit përfundimtar të kontrollit dhe të arkivohet dhe një kopje në departament për vlerësimin vijtor.

11. Veçoria më themelore e këtij Institucioni, është sidomos efektiviteti dhe forca e rekomandimeve të tij

- Rekomandimet e dërguara nga ana e jonë, vërejmë së në të shumtën e rasteve pranohen në heshtje, duke ndërmarrë veprime të ngadalta dhe jo konkludente dhe për më tepër duke mos përmbushur detyrimin ligjor të dhënies së prononcimit zyrtar.

- Kontrolli i zbatimit të rekomandimeve të kryhet nga grupi që ka ushtruar kontrollin, i cili të formohet prej jo më shumë se dy kontrollorë.

- Në këtë mënyrë del dhe përgjegjësia e kontrollorëve të grupit si për dhënien ashtu dhe zbatimin e rekomandimeve.

12. Në këtë drejtim na del për detyrë që në zbatim të Direktivës 2008/99/EC të Parlamentit dhe Këshillit Europian të propozojmë disa ndryshime për përmirësime ligjore “Për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal”.

Përvoja tregon se sistemi ekzistues i ndëshkimeve nuk ka qenë i mjaftueshëm për të siguruar respektimin e plotë të ligjeve, ku si pasojë e moszbatimit të tyre ka krijuar pasoja të pariparueshme në mbrojtjen e mjedisit. Respektimi i këtyre ligjeve mund dhe duhet forcuar nëpërmjet dënimeve penale, të cilat demonstronjë një mospranim nga shoqëria të një natyre cilësisht të ndryshme në krahasim me dënimet administrative apo mekanizmin e kompensimit sipas ligjit civil.

Kjo për arsye se edhe ligji nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nuk ka përmirësim të ndjeshëm në zbatimin e sanksioneve ligjore ndaj akteve të kundërligjshme.

13. Mungesa e Gjykatës Administrative ka influencuar mjaft negativisht në zbatimin e ligjit të mësipërm për vetë faktin e zvarritjes së vendimeve të Gjykatave dhe në shumë rrethe vendimet e gjykatave favorizojnë në mënyrë jo të drejtë individin dhe subjektet private.

14. Duke thithur gjithë mendimet e kontrollorëve të rikompozohet rregullorja e brendshme e KLSH-së.

Projektidetë e Kryetarit do të mundohem t'i zbatojë në mënyrë rigoroze me ndihmën e koordinuar me konsultë, rrahje mendimesh dhe çështë më kryesorja me intensitet të lartë në punë, bazuar në kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë sipas ligjit organik të Institucionit tonë.

- Rritja e shkallës së përkushtimit ndaj detyrës.
- Rritja më tej e shkallës së përgjegjësisë në punën time, shkallën e përkushtimit, zbatimin e ligjshmërisë në mënyrë rigoroze, zbatimin e standardeve dhe kodin etik.
- Rritja e autoritetit në mënyrë individuale, shpirtin e veprimit dhe të kërkesës së llogarisë ndaj vetes.
- Studimi i ligjshmërisë dhe rritjen e aftësive profesionale.
- Të gjitha këto do të konvergojnë në rritjen e aftësive individuale si kontrollor dhe kontributin në grup, për faktin se në sektorin e kontrollit luan rol të madh individualiteti.
- Ridimensionimi i organizimit të punës brenda grupeve.

Tiranë më 18 janar 2012

DISKUTIM NË ANALIZËN VJETORE 2011 TË DEPARTAMENTIT



Artan Topiana,

Kontrollor i Lartë

Departamenti i Kontrollit të Investimeve dhe
Projekteve me Financime të Huaja Shoqërive
Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit

I Nderuar Zoti Kryetar:

Gjatë kontrollit të projekteve dhe investimeve me financime të huaja, ndeshemi me disa probleme të cilat kanë ndikuar negativisht në mbarëvajtjen e tyre.

Së pari

Nga kontrollet e ushtruara ka rezultuar se projektet e zbatimit nuk marrin në konsideratë zgjidhjet më të mira. Në këto kushte në jo pak raste

kërkohen ndryshime të projekteve, si pasojë e të cilave kërkohet një proces i ri shpronësimi. Realizimi i këtij procesi kërkon një kohë relativisht të gjatë, e cila ndikon në futjen në eficiencë në kohë të projektit, por edhe kosto shtesë. Duke qenë se realizimi i shpronësimeve është problematik pothuajse në të gjitha projektet që realizohen, **në një projekt nga donatori është vendosur kushti i mos realizimi të asnjë pagese pa përfunduar më parë ky proces.** Në këto kushte institucioni përkatës është penalizuar me interesin e vonesës së pagesave. Por nuk është vetëm kjo, pasi nga vështirësitë e hasura në këtë proces, **ka patur vonesë të cilat janë shoqëruar me vonesa në përfundimin e kontratave dhe kosto shtesë, për ndërprerje të punimeve si pasojë e bllokimit të kontratave nga qytetarë pretendent për pronësinë.**

Së dyti

Që në fazën e hartimit të projekteve të zbatimit nuk merren në konsideratë sic duhet nevoja për ndërhyrje në rrjetet e telefonisë, të ujit të pijshëm apo të energjisë elektrike, kjo edhe për faktin e vështirësive të vetë shoqërive të cilat administrojnë këto rrjete për identifikimin e tyre, pra nuk ka një bashkëpunim të mirë mes tyre dhe konsulentëve që përzgjidhen për realizimin e këtyre projekteve. Kjo ka shkaktuar në mjaft raste nevojën e hartimit të urdhër ndryshimeve, të cilat kërkojnë një kohë të konsiderueshme për mobilizim, identifikim etj, madje duke rritur edhe koston e projektit, pasi në bazë të kushteve të kontratës FIDIC, për punime të paparashikuara dhe për zëra punimesh që nuk janë pjesë e preventivit, çmimet bazohen në ato të tregut në momentin e ndërtimit dhe jo atë të përfituara nga konkurrimi në tender.

Së treti

Performancë e ulët e punës së kontraktorëve,

Gjatë kontrolleve ka rezultuar se në përgjithësi kontraktorët pa lidhjes së kontratave, nuk zbatojnë programin e punimeve. Kanë angazhim të pamjaftueshëm të mjeteve, mekanizmave, pajisjeve por edhe të fuqisë punëtore. Pothuajse në të gjitha projektet e kontrolluara në realizimin e 80 % të kohës së punës punimet realizohen në masën 20-30 %. Në këto kushte në jo pak raste kërkohen programe të rishikuara, për avancimin e punimeve të cilat hartohen por nuk realizohen.

Ka rezultuar se Kontraktorët nënkontraktajnë punime të cilat arrijnë edhe deri në 95 %, të punimeve, duke shfrytëzuar edhe klauzolat e kontratës FIDIC, ku nuk ka përcaktim të qartë për sasinë punimeve që nënkontraktohen por kufizohet që jo gjithë punimet e kontratës mund të nënkontraktohen. Në këto kushte kontraktorit nënkontraktajnë një sasi të konsiderueshme të punimeve duke u bërë hallkë ndërmjetëse ndërmjet nënkontraktorëve dhe investitorit. Pavarësisht këtyre vonesave të cilat vijnë si pasojë e mos realizimit të saktë të grafikut të punimeve, rezulton se nga ana e konsulentëve

nuk bëhen lajmërimi me detaje për vonesa si dhe penalitete që përcakton kontrata në raste të tilla.

Në disa raste ka rezultuar se punimet e realizuara, pësojnë defekte shumë më parë se periudha parashikuar e qëndrueshmërisë.

Shërbimet e konsulentëve të përzgjedhur për mbikëqyrjen e punimeve, kanë rezultuar jo në performancën e duhur.

Këtu i shtohet edhe mos angazhimi sic duhet i stafit të njësisë së zbatimit/ menaxhimit apo koordinimit të projekteve.

Në përgjithësi në kontratat e konsulentëve nuk përfshihet asnjë sanksion për performancë të dobët të tyre.

Në shumë raste nuk ndiqet si duhet vlerësimi i pretendimeve të ndërsjella investitor kontraktor, por lihen për vlerësim në fazën përmbyllëse të projekteve. Edhe shërbimet e ofruara nga stafi lokal i konsulentëve, nuk ka qenë në nivelin e duhur, duke bërë që punimet të realizohen pa mbikëqyrjen e duhur dhe të saktë. Nga kontrollet e realizuara në disa projekte ka rezultuar që raportohen punime të cilat nuk janë realizuar sipas specifikimeve teknike, madje jo në sasinë e përcaktuar në vizatime, për të cilat janë rekomanduar masa zhdëmtimi.

Së katërti

Mbi marrëdhëniet ndërinstucionale.

Nga kontrolli ka rezultuar se në disa raste nuk ka një bashkërendim të punimeve për kontrata publike të ndryshme.

Si mungesë i këtyre bashkëveprimeve, ka patur raste të mbivendosjes së punimeve për kontrata të ndryshme si psh, shtrimi i linjave të ujësjes në rrugë të sapo ndërtuara, për më tej ka rezultuar mbivendosje punimesh edhe për kontrata të cilat administrohen nga i njëjti institucion. Mos bashkërendimi ndërmjet institucionesh ka rezultuar edhe për vepra shumë të rëndësishme

Për përmirësimin e procesit të kontrollit, për rritjen e eficiencës së procesit të kontrollit, mendoj se puna jonë krahas të tjerave duhet të marre në konsideratë edhe sa më poshtë:

Mendoj se, në lidhje me problematikën e parë, do të ishte më mirë që në kuadër të projektit procesi i shpronësimeve të kontrollohej paralelisht me projektin ose nga grupi i kontrollit që kontrollon projektin dhe jo në kuadër të institucionit siç bëhet realisht tani.

Mendoj se procesi kontrollues krahas zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, duhet të përqendrohet në vlerësimin e zbatimit të projektit, si një kontroll i përafërt me atë të performancës, për projekte të cilat kontrollohen para dhe pas përfundimit të tyre. Do të kontrollohet dhe do të kërkohet aplikimi i standardeve më të mira të kohës.

Mendoj se duhet bërë më shumë në lidhje me kërkesën për informacion nga njësitë e Zbatimit, Koordinimit apo Menaxhimit të projekteve, madje edhe kopje të raportit vjetor të progresit të projektit, me anë të cilave mund të përcaktohet më mirë risku, si dhe zbatimi i rekomandimeve, kur projektet kontrollohen në zbatim e sipër.

Mendoj se krahas kontrolleve periodike të projekteve me investime të huaja, për vepra publike të rëndësishme dhe të rezultuara me mangësi të theksuara sidomos në zbatimin e kontratave, krahas kontrollit për verifikimin e rekomandimeve të dhëna mund të verifikohet jetëgjatësia e dhe përputhshmëria e cilësisë së punimeve, sidomos në periudhën e përfundimit të garancisë së tyre.

Tiranë më 18 janar 2012

DISKUTIM NË ANALIZËN VJETORE 2011 TË DEPARTAMENTIT



Agron Maksutaj,

Kontrollor i Parë

Departamenti i Kontrollit të Investimeve dhe
Projekteve me Financime të Huaja Shoqërive
Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit

I nderuar Zoti KRYETAR!

Të nderuar kolegë!

Departamenti i Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit, krahas auditimeve të ushtruara në projektet me financime të huaja, shoqëritë publike kryen dhe auditime në fushën e mjedisit,

Gjatë kësaj periudhe janë ushtruar auditime në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë dhe vlerësues si dhe auditime të performancës. Kryesisht auditimet janë ushtruar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave si dhe në agjencitë në vartësi të kësaj ministre, si në Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit në qarqe, ku jemi fokusuar në lidhje me zbatimin e paketës ligjore në fushën e mjedisit. Nga kontrollet e ushtruara janë konstatuar mangësi në hartimin e kuadrit të plotë ligjor në këtë fushë si dhe mos përputhje në zbatimin e akteve ligjore në fuqi.

Është konstatuar mungesë koordinimi midis Ministrisë së Mjedisit, me institucionet e tjera shtetërore në lidhje më zbatimin e strategjisë ndërsektoriale për mbrojtjen e mjedisit.

Mungesa e një sistemi evidencash ka bërë që të mos pasqyrohen në vazhdimësi arritjet dhe mangësitë në zbatimin e strategjisë mjedisore, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, si dokumenti bazë që parashtron politikat shtetërore në fushën e mjedisit.

Nga auditimet janë konstatuar se strukturat përkatëse për mbrojtjen e mjedisit në veprimtarinë e tyre kanë mospërputhje të veprimtarisë me legjislacionin e miratuar, si në procesin e dhënies së lejeve mjedisore, në kontrollin dhe monitorimin e subjekteve që gjenerojnë mbetje të ngurta, të lëngëta e të gazta etj. apo në dëmtimin e mjedisit gjatë përdorimit të tij,

Është konstatuar se legjislacioni mjedisor ka qenë me mangësi dhe i paplotësuar me akte nën ligjore, më e theksuar kjo për agjencitë zbatuese të legjislacionit mjedisor si Agjencitë Rajonale të Mjedisit, dhe Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, të cilat ende funksionojnë me legjislacion të pa plotësuar.

Kuadri ligjor për mjedisin nga ana e ministrisë së mjedisit është punuar dhe po punohet për tu përshtatur me standardet e legjislacionit të Bashkimit Europian. Në këtë kuadër mund të përmendim miratimin e disa ligjeve: si ligji “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligji “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ligji “Për lejet mjedisore”, ligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe janë në proces miratimi i akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, në të cilat janë pasqyruar edhe rekomandimet e dhëna nga ana jonë për ndryshime apo përmirësime ligjore në fushën e mjedisit.

Departamenti ynë ka kryer dhe ka rritur cilësinë e auditimeve të performancës si një praktikë e re auditimi. Ne kemi kryer një sërë auditimesh mjedisore në bashki mbi mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit urban ku janë audituar menaxhimi i mbetjeve urbane dhe mbetjeve të tjera, menaxhimi i sipërfaqeve të gjelbërta, të ajrit urban, zbatimit i koeficienteve të ndërtimit, në raport me sipërfaqen e gjelbërt si dhe probleme të tjera sipas përkatësive të bashkive etj. Në këto auditime është konstatuar se menaxhimi i mjedisit urban edhe pse ka tendencë përmirësimi, si në menaxhimin mjedisor të mbetjeve urbane, përmirësimin e cilësisë të ajrit urban, tendencën në rritje të sipërfaqeve të

gjelbëruara, mbulimi i kostos së shërbimeve nëpërmjet tarifave të mbledhura nga komuniteti dhe bizneset, duke zvogëluar subvencionet shtetërore, përsëri është vërejtur se në bashkitë respektive të audituara, ka pamjaftshmëri në menaxhimin e mjedisit urban pasi kanë munguar strukturat e mirëfillta për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit urban, si pasojë kanë munguar apo nuk janë zbatuar strategjitë dhe planet e veprimit, për mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet dhe dëmtimet, si rezultat edhe përdorimi i burimeve njerëzore dhe materiale nuk ka qënë në eficaçë të plotë për arritjen e standardeve mjedisore me qëllim rritjen e cilësisë të jetesës së qytetarëve.

Për sa më lart nga ana jonë janë dhënë rekomandime dhe mesazhe të cilat organet e pushtetit vendor i kanë marrë në konsideratë.

-Për rritjen e nivelit auditues në auditimet e performancës mjedisore propozoj që të ketë një kombinim midis departamenteve për ngritjen e grupeve të përbashkëta të kontrollit për të shmangur kontrollet nga disa departamente në të njëjtin subjekt.

-Njëkohësisht jam e mendimit se auditimi i performancës duhet të aplikohet edhe në shoqëritë anonime, investimet e huaja, si dhe në institucione të tjera të cilat kanë lidhje me arritjen e objektivave mjedisore.

Në programet e kontrollit të auditohen programe të cilat kanë si synim arritjen e objektivave mjedisore si mbrojtja e tokës së punueshme nga erozioni, mbështetja e bujqësisë, mbrojtja e brigjeve të lumenjve si dhe e bregut të detit, menaxhimi i mbetjeve urbane etj.

-Shpreh mendimin se në auditime të specializuara dhe të ngushta, në një fushë të caktuar të aktivizohen edhe specialistë të jashtëm me eksperiencë në fushës përkatëse që do të auditohet me qëllim rritjen e performancës së auditimit.

Njëkohësisht ne kemi kryer performancë në Ministrinë e Shëndetësisë me temë:

“Vlerësimi dhe menaxhimi i mbetjeve spitalore në sistemin e shëndetësisë” në të cilin u konstatua:

MSH nuk kishte një strukturë të mirëfilltë mjedisore të ngarkuar për menaxhimin e mbetjeve spitalore dhe të ngjashme me to, si rezultat nuk kishte gjetur zbatim në shkallë kombëtare rregullorja e përbashkët “Për administrimin e mbetjeve spitalore” e hartuar midis dy institucioneve.

MSH nuk kishte të hartuar planet dhe programet si dhe rregulloret e nevojshme për të bërë të mundur administrimin mjedisor të këtyre mbetjeve.

MESAZHI

“Përdorimi me efikasitet jo të plotë i burimeve njerëzore, financiare apo burimeve të tjera që përfshijnë ekzaminimin e sistemeve të planifikimit dhe të informacionit, masat e monitorimit dhe procedurave të ndjekura nga Ministria e Shëndetësisë për korrigjimin e mangësive të identifikuara ka bërë që menaxhimi mjedisor i Mbetjeve Spitalore të jetë në nivele të ulta.

MSH për përmirësimin e mangësive të vërejtura dhe për një menaxhim sa më efikas të mbetjeve spitalore të ngrejë strukturën për mbrojtjen e mjedisit në qendër dhe në bazë si në sektorin publik dhe privat, të hartojë planet dhe programet për menaxhimin mjedisor të mbetjeve spitalore dhe të ngjashme me to si dhe të rrisë efektivitetin dhe efincencën në drejtim të monitorimit dhe zbatimit të programeve dhe planeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve spitalore.

Mesazh i cili u mirëkuptua dhe gjeti zbatim nga MSH.

Ju faleminderit!

Tiranë më 18 janar 2012

DISKUTIM NË ANALIZËN VJETORE 2011 TË DEPARTAMENTIT



Sali Agaj

Kontrollor i Parë

Departamenti i Kontrollit të të Ardhurave të Buxhetit
të Shtetit

1. Mendoj që KLSH duhet të ketë një strukturë bashkëkohore, e organizuar në Departamente të Auditimit Financiar dhe Departamente të Auditimit të Performancës.

Në këtë strukturë do të përfshihej edhe Mbikëqyrja e **Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm** si një detyrë e kohës për SAI-t e përparuara, ku pjesë e këtij sistemi janë **strukturat e auditimit të brendshëm**, të cilat duhet të ndihmojnë drejtuesit në ngritjen e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe t'i verifikojnë e kontrollojnë ato duke dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

2. Duhet të vendoset **një trainimi** serioz dhe i qendrushëm, duke hequr dorë nga formalizimi i deritanishëm, dhe që nisur nga mundësitë financiare dhe burimet që ka KLSH, mund të përfshiheshin edhe audituesit e brendshëm publikë.

3. Duhet të vleresohen auditimet e brendshme jo vetëm duke mos e parë si të huaj por duke shmangur edhe dublimet e panevojshme

4. Duhet të sigurohet administratë e qendrushme dhe vleresimi aftësive dhe karrieres brenda institucionit

5. Duhet të përmiresohet kontrolli i cilësive brenda departamentit konform standardit dhe rregullores, duke filluar që nga puna paraprake për njohjen e

subjektit, zbatimin e afateve per dergimin e proces verbaleve, project raportit, apo raportit perfundimtar, etj, te cilat duhet te shqyrtohen me pergjegjesi nga pergjegjesi i grupit

6. Duhet të rishikohet sistemi i pagave mbi bazën e një politike fikse ku të motivohen kontrolloret në pune dhe të promovohen në karrier duke menjanuar emertime fiktive dhe paga e shpërblime të padenja

7. Duhet të merren masat që krahas auditimeve duke përdorur **programet e IT (using IT tools)** e cila përdoret gjerësisht nga SAI-t e vendeve të përparuara, në kushtet që shërbimet e organeve ekzekutive perdorin shërbimet e-government, duhet te kalohet në auditimin e vetë teknologjisë së informacionit të këtyre subjekteve **(IT Audit)**, **qe** është një sfidë e madhe për KLSH.

Po keshtu KLSH duhet te njoh dhe perdor shërbimin online per tatim paguesit qe aplikon DPT dhe DPD, per te cilen inspektoret duhet te përvetesojne programin IT sidomos programin IDEA.

8. Në kuadër të një rindërtimi të qëndrueshëm të Institucionit merr rëndësi **rikonceptimi i mardhënieve me jashtë**, që pervec perfitimit profesional ato percjellin edhe “fytyren” e Institucionit tone në botë.

Për këtë arsye përvec perzgjedhjes së punonjesve për këtë gjë, duhet të mireperdoren me korrektese fondet, duke selektuar dhe marre pjesë në takime të rëndesishme të fushes së institucionit tonë.

Tiranë më, 20 janar 2012

DISKUTIM NË ANALIZËN VJETORE 2011 TË DEPARTAMENTIT



Bexhet Zeqiri

Kontrollor i Parë

Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të

Pushtetit Vendor, Administrimit dhe

Privatizimit të Pronës Publike

Llojet e auditimit.

Mendoj se është e domosdoshme të hartohen manualët dhe të ushtrohen kontrole audituese si më poshtë:

A-Auditimi mbi bazë sistemi.

1 -Auditimi i performancës dhe përputhshmërisë .

-Auditimi i performancës e përputhshmërisë përfaqëson ekzaminimin e vlerësimit e veprimtarive të subjektit, në procesin e realizimit të objektivave, në këndvështrimin e përputhjes së tyre me ligjet dhe rregullat me kursimin, dobinë dhe frytshmërinë..

2 -Auditimet financiare.

-Auditimet financiare kryhen për të vlerësuar saktësinë dhe plotësinë e regjistrimeve dhe gjendjeve të llogarive. Auditimet financiare përdorin teste thelbësore, rishikime analitike dhe procedura të tjera vlerësimi të cilat mund të përfshijnë ose të mos përfshijnë testet funksionale apo rishikime të transaksioneve. Ato financiare përcaktojnë nëse informacioni financiar i subjektit publik paraqet në mënyrë të besueshme pozitën financiare, rezultatet

e operacioneve dhe shmangiet e subjektit të audituar në përputhje me SNK dhe SKK.

3 -Auditimet e Teknologjisë së Informacionit (TI).

Në kuadrin e zhvillimit që kanë marë zhvillimet e internetit komunikimet elektronike mendoj së është e domosdoshme të hartohet manuali i auditimit të teknologjisë dhe informacionit(TI)

-Ky lloj auditimi mund të përfshijë auditimin e të gjithë kontrolleve të sistemit të TI në një organizatë ose vetëm të një fushe të organizatës, si për shembull, **të fushës së llogarisë, thesari, (nuk mund të mendohet certifikimi i buxhetit pa auditimin dhe certifikimin e thesarit (Oracle) prokurimet, doganat. tatimet, etj.**

4-Auditimi i certifikimit të pasqyrave financiare.

-Ky lloj auditimi mund të përfshijë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të konsoliduara, të organizmave publike, shërbimet e kontabilitetit dhe dhënies së sigurisë për informacionet financiare kur auditimi detyrohet nga ligji ose kërkohet nga subjektet publike.

Mendoj se ky lloj auditimi do kërkojë edhe ndryshime në ligjin e KLSH në qoftë se mendohet se mund të kryhet nga KLSH e cila duhet të marë atributet e (expertit kontabël).

Por mund të mos hartohet një manual tjetër por të shkrihet me manualin e auditimit financiar duke shtuar dhe certifikimin.

B-Për dokumentin elektronik viti 2010

-Mendoj se duhet të krijohen dhe të funksionojnë adresat e komunikimit elektronik të KLSH, “*Kjo dhe në funksion të ligjit për nënshkrimin elektronik*) ku i gjithë dokumentacioni të qarkullojë në mënyrë elektronike në të gjithë strukturën e KLSH. Psh. bexhetzeqiri@klish.org

Kjo do evitonte lëvizjen shkresore të materialeve dhe do riste aftësinë komunikuese dhe përgatitjen e materialit më saktë.

Shërbimi i internetit është formal pasi vetëm nga “*speedtest*” mund të konstatosh se shpejtësia shkon deri 300 kbps kur sot çdo familje ka internet me shpejtësi 2Mbps.

Me një limit të tillë nuk mund të shkarkosh asnjë dokument ligjor të cilët janë kryesisht në formatin PDF.

Mendoj se është e domosdoshme që të paktën grupet e punës të pajisjen me një kompjuter “laptop” pasi po hasim probleme gjatë kontrollit në subjekte.

C-Arkiva elektronike

Mendoj se është e domosdoshme krijimi i arkivës elektronike e cila do krijonte komoditet në përdorimin e materialeve kuptohet nga personat e caktuar për akses.

Mendoj se është e domosdoshme të arkivohen në formatin PDF:

-Raporti përfundimtar.

-Vendimi.

-Pasqyrat

D-Auditimi financiar

-Të respektohen edhe afatet e përgatitjes së letrave të punës për të përcaktuar nëse do të vazhdojë auditimi ose jo.

-Të auditohen subjekte me risk të madh dhe materialitet jo vetëm Prefektura dhe Këshilla qarqesh ose bashki me fonde minimale.

Në qoftë se auditimi financiar është detyrim atëherë duhet të planifikohen të gjitha auditimet në këtë format.

Kontrollet po kryhen në bazë të rregullores dhe dokumenteve standarte të KLSH të cila në një pjesë të konsiderueshme bien në kundërshtim me manualet (financiar dhe performancës) *programet, letrat e punës, projektraporti, raporti përfundimtar.*


Mendoj që rregullorja e KLSH duhet të amendohet, ajo nuk duhet të marrë atributet e një manuali kontrolli por vetëm rregullore e institucionit pasi për

mënyrën e auditimit dhe dokumentet standarte janë manualet e miratuar dhe ata që do të miratohen si dhe dokumentet standarte sipas manualeve.

* Diskutim i mbajtur në analizën e Departamentit

Tiranë më, 17.01.2012

DISKUTIM NË ANALIZEN VJETORE 2011



Ing. Xhemal LUKA

Kontrollor i Parë

Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të

Pushtetit Vendor, Administrimit dhe

Privatizimit të Pronës Publike

Në Kontrollin e Lartë të Shtetit punoj që nga vitit 2006 e në vazhdim, me detyrën e kontrollorit të parë, me profesion inxhinier ndërtimi, diplomuar në vitin 1974.

Gjatë vitit 2011 kam ushtruar kontroll në 9 (nëntë) subjekte gjithsej, nga të cilat 7 në Bashki dhe 2 në Drejtoritë e Aluiznit Fier dhe Tiranë Qendër.

Në zbatim të programeve të kontrollit, në përbërje të grupeve të punës kam ushtruar kontroll në fushën e zbatimit të kontratave të sipërmarrjes për punë publike, të hartimit të projekteve dhe preventivave të zbatimit të punimeve të ndërtimit, të mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit si dhe në zbatimin e ligjshmërisë për hartimin e dokumentacionit tekniko-ligjor në fushën e legalizimit të objekteve të zonave informale.

Në çdo subjekt dhe në veçanti për çdo objekt të kontrolluar janë evidentuar shkelje ligjore, përpilim dhe administrim me mangësi të dokumentacionit teknik të zbatimit të punimeve dhe legalizimit të objekteve, situacionim dhe përfitim më tepër në vlerë të punimeve të pa kryera nga operatorët ekonomik sipërmarrës, etj. për të cilat, me personat përgjegjës, janë mbajtur

procesverbalet përkatëse për shkeljet ligjore dhe dëmin ekonomik të shkaktuar.

Problematika e hasur në kontrollet e ushtruara konsiston si më poshtë :

1. Në përgjithësi, hartimi i detyrave të projektimit nga organet investitor bëhet i thjeshtuar dhe i përgjithshëm, pa pasur parasysh kërkesat teknike dhe ekonomike të objektit për të cilin kërkohet të investohet dhe jo në përputhje me kushtet teknike të projektimit, të zbatimit dhe Eurokodet.
2. Lidhja e kontratave të shërbimit për hartimin e projekteve dhe preventivave të zbatimit të punimeve të ndërtimit bëhet pa zhvilluar më parë konkurs projektimi për fazën e projekt idesë, me qëllim përcaktimin e ofertës më të mirë teknike dhe ekonomike, gjë e cila në disa raste ka sjellë hartimin jo të plotë e të detajuar të projekteve të zbatimit dhe preventivit për përcaktimin e fondit limit, me pasojë ndryshime të herë pas hershme të projektit dhe të volumeve të punës në ofertën e kontraktuar, rritje të pa argumentuar të fondeve për investime dhe vështirësi në kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.
3. Studimet urbanistike dhe ato pjesore të qendrave të qyteteve janë hartuar të pjesshme dhe jo në përputhje me detyrat e projektimit, kushtet teknike të projektimit dhe Eurokodet. Fondi limit për kryerjen e shërbimit në studimet urbanistike përcaktohet si në kontratë për punë publike dhe jo sipas kërkesës së ligjit të prokurimit publik për shërbim konsulence, gjë e cila ka sjellë mos përcaktim të saktë të fondeve për kryerjen e shërbimeve të tilla.
4. Studimet për ndërtimet e reja dhe mbylljen e vendgrumbullimeve ekzistuese të mbetjeve urbane janë hartuar jo në përputhje me detyrat e projektimit, kushtet teknike të projektimit dhe Eurokodet, duke marrë në dorëzim nga investitori projekte dhe preventiva jo të plota dhe me kosto të pa argumentuar për zbatimin e tyre.

5. Procesi i legalizimit të objekteve dhe shitja e parcelave ndërtimore të zëna në zonat informate është kryer në papajtueshmëri me ligjin për legalizimin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, të trajtuara në materialet e kontrollit të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Aluiznit të Qarkut Fier dhe Drejtorinë Qendrore të Aluiznit Tiranë.

Pjesëmarrja në grupet e kontrollit e specialistit inxhinier ndërtimi, ka rritur në nivel më të lartë efektshmërinë e zbulimit të shkeljeve ligjore në fushën e kontrollit dhe të disiplinimit të punimeve të ndërtimit, të urbanistikës, inspektoratit ndërtimor si dhe në procesin e legalizimit të objekteve në zonat informale.

Në kontrollet e ushtruara, bashkëpunimi në mes kontrollorit të prokurimeve publike me inxhinierin e ndërtimit ka dhënë rezultate pozitive në përcaktimin e riskut dhe evidentimin e shkeljeve me dëme ekonomike.

Për sa më sipër, përfshirja në grupet e kontrollit e specialistit inxhinier ndërtimi ka dhënë rezultatet e duhura, prandaj mendoj që në përbërje të grupeve të kontrollit, në subjektet me investime që paraqesin risk të shtuar, pjesëmarrja e specialistit inxhinier ndërtimi është e nevojshme.

Në programet për vitin 2012 kam mendimin që kontrolli në fushën e ndërtimit të përqendrohet në :

- Kontrollin për hartimin e detyrës së projektimit nga investitori duke marrë parasysh kërkesat teknike dhe ekonomike të objektit në zbatim të kushteve të projektimit, të zbatimit dhe Eurokodet.
- Kontrollin për zbatimin e procedurës ligjore për hartimin e projekteve dhe preventivave të zbatimit të punimeve të ndërtimit, duke zhvilluar më parë konkursin e projektimit si shërbim konsulence për fazën e projekt idesë, me qëllim përcaktimin e ofertës më të mirë teknike dhe ekonomike për lidhjen e kontratës së shërbimit të projektimit.

- Kontrollin për zbatimin e kontratave të sipërmarrjes për punë publike dhe në veçanti ato me shtesë kontrate me qëllim rritjen e efektshmërisë së zbulimit të shkeljeve me dëm ekonomik.

- Kontrollin për zbatimin e procedurës ligjore për përzgjedhjen shoqërive të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, përlllogaritjen e vlerës së shërbimit, lidhjen dhe zbatimin e kontratës mes palëve.

- Kontrollin për zbatimin e procedurës ligjore për mbajtjen e dokumentacionit teknik të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit me qëllim evidentimin e zbatimit të volumeve të punimeve në përputhje me projektin e zbatimit, preventivin e ofertës dhe kushtet teknike të zbatimit.

* Diskutim i mbajtur në analizën e Departamentit dhe në Analizën Vjetore 2011 të KLSH.

Tiranë më, 17.01.2012

DISKUTIM NË ANALIZEN VJETORE 2011



Niko NAKO

Kontrollor i Lartë

Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të

Pushtetit Vendor, Administrimit dhe

Privatizimit të Pronës Publike

Në diskutimin tim dua të bëj një prezantim të kontrollit dhe administrimit të taksave dhe tarifave vendore në shkallë Departamenti për vitin 2011 dhe disa mendime për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe më konkretisht:

Sipas planit vjetor të kontrollit për vitin 2011 kontrolli i administrimit të taksave dhe tarifave vendore, 5-6 Bashkitë e Kategorisë së parë, pra më të mëdhatë janë kontrolluar dhe raportuar nga Departamenti i Të Ardhurave Fiskale, përkatësisht, Bashkitë: Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë, etj.

Ndërsa nga Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Publike, kontrolli i administrimit të taksave është përqendruar në disa Bashki dhe Komuna të Kategorisë dytë, **nga ku ka rezultuar si më poshtë:**

Mbi arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe Tarifat vendore.

1. Nuk ka një parashikim të saktë të programit të të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore, duke mos kryer një inventarizim të gjithë subjekteve të cilët duhet të paguajnë, si personat fizikë dhe qytetarët (sipas llojeve të taksave), mungojnë të dhënat fizike, për sipërfaqen, të cilat kanë pakësuar ndjeshëm të ardhurat e Njësive të Qeverisjes Vendore, ku përmendim: bashkinë Ballsh, Koplik, komunën Dushk, Lushnjë, etj.

a-Taksa e Fjetjes në Hotel.

Mungojnë të dhënat për kapacitetet,numrin e dhomave të shtretërve sipas të dhënave të Zyrave të Pasurive të paluajtshme si,

b -Tarifa e Pastrimit.

Në bashkinë Koplik për taksën e pastrimit janë debitorë 2148 familje në vlerën 2.082 mijë lekë. Në bashkinë Gjirokastër nuk është paguar taksa e pastrimit në vlerën 2124 mijë lekë. Në bashkinë Patos, nuk paguajnë taksën e pastrimit 2646 familje në vlerën 582 mijë lekë, po kështu nuk paguajnë taksën e pastrimit edhe 19 Institucione në vlerën 1.154 mijë lekë.

c- Taksa e tabelës.

Në komunën Ndroq,Tiranë, ku ka me dhjetëra subjekte që kanë vendosur tabelën, ndërkohë paguan taksën e tabelës vetëm 1 subjekt.

d-Taksa e tokës bujqësore.

Në disa njësi të qeverisjes vendore,nuk ka rakordim midis zyrës së bujqësisë dhe zyrës së taksave vendore për sipërfaqen e tokës bujqësore.

e-Taksa e banesave. Taksa e banesave nuk është parashikuar mbi të dhëna të saktë për banesat sipas të dhënëve të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ose me komision të ngritur për verifikimin e tyre.

2. Në disa Njësi të qeverisjes vendore, nga zyrat e taksave tatimeve, për saktësimin e detyrimeve vendore, nuk janë bërë verifikime dhe kronometrimë në vend, nuk janë shfrytëzuar të dhënat e importit,apo të Degëve të Thesarit në rrethe.

Ky problem është drejt zgjidhjes pasi në subjekte janë vendosur kasa fiskale dhe për mjetet taksimetrat.

3. Nga Zyrat e Taksave dhe Tarifave vendore, megjithëse janë konstatuar subjekte biznesi të cilët nuk kanë paguar taksat vendore apo nuk janë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ndaj tyre nuk janë llogaritur detyrimet nga zyra, nuk vendosur sanksione, nuk u është kërkuar Bankave

bllokimi i llogarive bankarë apo vendosja e barës siguroese të mjeteve të transportit apo pasurive të paluajtshme, sipas përcaktimeve në ligjin e Procedurave Tatimore.

Megjithëse në të gjitha Bashkitë dhe Komunat janë krijuar Strukturat e Policisë Bashkiake apo të Komunës, me nga 2-3 inspektorë Policie dhe në bashkitë e mëdha me më shumë punonjës policie në disa Njësi ato nuk janë efektive.

Nga ana e KLSH për këto raste janë rekomanduar masa disiplinore ndaj Inspektorëve të Policisë,ndërkohë u është rekomanduar edhe propozimi pranë këshillave bashkiake apo komunale, për hartimin dhe miratimin e paketës me llojet dhe masat e gjobës bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010”Për kundrvajtjen administrative”

4. Nga ana e disa zyrave të Taksave vendore nuk janë hapur Regjistrat e Tatim paguesve,nuk janë dërguar në fund të çdo viti lista e debitorëve në zyrat e financës për tu ndjekur si debitorë në vazhdimësi.

Na KLSH në të gjitha rastet janë evidentuar debitorët u është rekomanduar Njësitë të Qeverisjes Vendore,dërgimin e listave të debitorëve në Zyrat e financës të cilat kanë kryer regjistrimet në kontabilitet duke u llogaritur edhe penalitetet përkatëse.

Gjatë vitit 2011 janë rekomanduar edhe mjaft detyra organizative për ndjekjen e debitorëve të prapambetur gjë e cila ka dhënë rezultate në ngritjen e nivelit të arkëtimit. Por ky problem u ndërpre me daljen e ligjit nr 10.418, datë 21.04.2011”Për Legalizimin e Kapitalit dhe Faljen e një pjese të Borxhit Tatimor dhe Doganor” deri më datën 31.12.2010.

Në kushtet e mësipërme nga Departamenti ynë për vitin 2012 i del detyrë të përmirësojë programet e kontrollit në pikën e administrimit dhe kontrollit të taksave vendore, duke kërkuar zbatimin e ligjit të Legalizimit kapitalit dhe

udhëzimeve të dala në zbatim të tij, si ngritja e komisioneve përkatëse, hartimi i procesverbaleve dhe listave të sakta dhe përgatitja e Akt-Faljeve, etj.

Pavarësisht sa sipër, kontrolli i administrimit të taksave të kryera nga KLSH, ka shërbyer edhe si një shkëmbim eksperience dhe përvoja si nga subjektet e kontrolluara dhe auditet e ndryshme, ku gjatë verifikimit të zbatimit të detyrave ka rezultuar se janë zbatuar si: Hapja e Regjistrave të Tatim Paguesve, Informatizimi i tyre, Njohja me Legjislacionin përkatës dhe rritjen e masave shtrënguese me pasojë rritjen e nivelit të arkëtimit.

Por një impakt negativ ka dhënë prishja e ekuilibrave të vendosura nëpërmjet zgjedhjeve, pasi një pjesë e pushtetarëve të rinj, kanë emëruar në zyrat e taksave punonjës jo profesionalë, gjë që ka dëmtuar punën e zyrave të taksave vendore.

Nga ana e KLSH në të ardhmen për mos grumbullim të taksave vendore do kërkojmë që ndaj personave përgjegjës të bëhet kallëzim penal dhe po kështu do veprohet edhe ndaj subjekteve të cilat nuk paguajnë në afat taksat vendore.

Disa Mendime të tjera:

1) Për vitin 2012 të parashikohen më tepër Kontrolle tematike, në një fushë të caktuar si p.sh. në fushën e prokurimeve publike, blerjeve në vlera të vogla, etj.

Në të ardhmen kam mendimin që të kryhen kontrole për zbatimin e një ligji të veçantë apo një problemi me risk. Kështu do të ishte e nevojshme kontrolli i funksionimit të Inspektoratit Qendror Urbanistik në lidhje me kontrollet në zonat turistike, pasi megjithëse ndërtimet pa lejë janë mbyllur në vitin 2006, përsëri nga mos kontrolli apo favorizimi prej tyre ndërtimet pa lejë janë prezent, madje edhe këtu në Tiranë.

2. Megjithëse Rregullorja e brendshme e KLSH, ka shërbyer si një akt nënligjor, për funksionimin e KLSH, ajo ende ka nevojë për përmirësime, si në

shtesën e Projekt Raportit edhe një Kapitull” Rezultatet e Kontrollit” çka do të bëjë prezent shkeljet apo arritjet dhe do na shërbejë për një rekomandim cilësor dhe objektiv të rekomandimeve si për shpërblim dëmi apo masave përkatëse.

3.Në planin e kontrollit të vitit 2012 të shmangim shkuarjen 2 kontrole të KLSH, brenda vitit si nga Departamentet e tjera në lidhje me Taksat vendore apo kontrolli i mjedisit nga Departamenti i Investimeve të huaja, sidomos në bashkitë e mëdha.

4. Në përcaktimin e grupeve të kontrollit të bëhet kujdes pasi të bëhet një kombinim ndërmjet kontrollorëve me përvojë dhe të rinj,apo specializimi për kontrole të një fushe, pasi kjo rrit cilësinë e kontrollit. Secili grup mendoj se duhet të mbulohet edhe nga inxhinieri i ndërtimit,në se ka investime.

5. Kam mendimin që efektiviteti i kontrollit të lidhet me zbulimet dhe marrjen e masave, për aq sa është e mundur.

6. Në se është e mundur të krijohen mundësi për informatizimin të dhënave për rezultatet e kontroleve të kryera, sidomos të masave disiplinore, pasi ka raste që për 2 kontrole radhazi jepen për të njëjtët persona e njëjta masë disiplinore. Po kështu është mirë që nëpërmjet një buletini të brendshëm të KLSH të njihet kontrollorët edhe me rezultatet e kontroleve në Departamentet e tjera,duke mësuar nga përvoja dhe korrigjuar gabimet e njëri tjetrit. etj.

Tiranë më, 17.01.2012

DISKUTIM NË ANALIZËN VJETORE 2011



Halil Isufi

Kontrollor i Parë

Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të

Pushtetit Vendor, Administrimit dhe

Privatizimit të Pronës Publike

Gjatë vitit 2011 kam ushtruar kontrolle në 8 (tetë) subjekte gjithsej, nga të cilat 1 (një) në Këshillin e Qarkut Durrës, 5 (pesë) në bashki dhe 2 (dy) në komuna. Nisur nga përvoja e punës dhe konstatimet e bëra gjatë kontrolleve të ushtruara për vitin 2011, në programet e kontrollit për vitin 2012 kam mendimin që vëmendja të përqëndrohet edhe në:

Në fushën e prokurimeve publike.

Në fushën e planifikimit dhe realizimit të buxhetit.

Në fushën dokumentimit, administrimit dhe privatizimit të pronës publike.

Në fushën e administrimit të vlerave materiale e monetare.

Në fushën e mjedisit, administrimit të aseteve, pyjeve dhe kullotave.

Në fushën e taksave dhe tarifave vendore.

Në kontrollet e ushtruara është konstatuar se akt-rakordimet me Degën e Thesarit për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave vendore nuk paraqesin realitetin dhe e deformojnë atë për faktin se:

Në planifikimin e të ardhurave nuk janë marrë parasysh detyrimet e prapambetura nga vitet e mëparshme për taksat dhe tarifat e pa paguara.

Në realizimin në fakt pasqyrohen gjoba, arkëtime nga akt-kontrollet dhe detyrime të tjera, garancitë e punimeve të ndërtimit, etj. të cilat nuk janë të parashikuara në plan.

Në realizimin në fakt pasqyrohen arkëtimet për taksat vendore të detyrimeve të prapambetura të cilat nuk i përkasin vitit ushtrimor.

Propozime për organizimin e brendshëm.

Për organizimin më të mirë të punës, nisur nga fenomenet e padëshiruara të ndodhura gjatë periudhës së kaluar në këtë departament dhe institucion, për eliminimin e tyre dhe përmirësimin e punës në të ardhmen. mendoj që në rregulloren e brendshme të institucionit të shtohen:

- Nga ana e drejtorëve të departamenteve, në caktimin e grupeve të punës sipas subjekteve të kontrollit, në ndarjen e tyre, të mbahet parasysh mënyra e trajtimit të barabartë të punonjësve, kjo me qëllim jo vetëm përfitimi të barabartë të të gjithë punonjësve pa dallim por edhe për pakësimin në maksimumim më të mundshëm të shpenzimeve operative për udhëtim e dieta.

- Mundësisht *“grupi i kontrollit”* në përbërje duhet të jetë i pandryshuar gjatë gjithë vitit, kjo edhe në zbatim të standardeve të kontrollit, pasi kjo i shërben më mirë përfundimit të raporteve të kontrollit dhe dorëzimit të tyre në arkivin e institucionit si dhe i njëjti grup të mos programohet për kontroll dy herë radhazi në të njëjtin subjekt.

Për rritjen e mëtejshme të nivelit profesional dhe ligjor të kontrollorëve dhe ngritjen në stadin e kërkuar të cilësië së kontrollit kërkohet një angazhim më i madh në drejtim të bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare dhe vendore sidomos :

Propozime në fushën e bashkëpunimeve:

- Bashkëpunimi me Prokurorinë
- Bashkëpunimi me Auditin e Brendshëm Financiar dhe Departamentin e Antikorrupsionit.
- Bashkëpunimi me Kontrollin e Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Autoritetin e Kokurencës.
- Bashkëpunimi me IEKA. Dhe OJF.
- Bashkëpunimi me SIGMA.

- Bashkëpunimi me Projektin e Bashkëpunimit me Bankën Botërore dhe me Agjensinë e Kërkimit Shkencor.

Propozime në fushën e trajnimeve:

- Mbi buxhetin e pushtetit vendor, auditimin financiar, prokurimet publike elektronike, sistemin e taksave dhe tarifave vendore.

Propozime në fushën e përmirësimeve ligjore:

1. Mbi bazën e argumentimit logjik, për shmangien e evazionit fiskal dhe rritjen e treguesve në arkëtimin e të ardhurave vendore, në bazë të konstatimit të kontrollorëve të KLSH, të kërkohet ndryshimi i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”*, Udhëzimin e përbashkët të MB dhe MF nr. 655/1, datë 06.02.2007 *“Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”* dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore”*, të ndryshuara, pasi :

Niveli i ulët në arkëtimin e taksës mbi pasurinë prej rreth 20 vitesh radhazi, (taksën e ndërtesës dhe taksën e tokës bujqësore) megjithë masat e marra nga qeveria dhe njësitë e qeverisjes vendore për uljen e masës së taksimit dhe faljen totale të këtyre detyrimeve, dikton edhe marrjen e masave shtrënguese në këtë drejtim.

- Institucioni apo njësia e qeverisjes vendore të detyrohet që për personat që nuk paguajnë rregullisht taksat vendore, pas argumentimit logjik dhe ligjor, të propozojë pranë organeve kompetente, vënien në efikasitet të masës së sekuestros, kjo fillimisht të prodhimeve bujqësore e blegtorale në vlerën e detyrimit vjetor dhe kur ky detyrim është mbartur prej vitesh dhe arrin në vlerë të madhe deri në konfiskimin e plotë të pasurisë së paluajtshme.

2. Mbi bazën e argumentimit logjik, për shpenzimet e telefonisë celulare të personave juridikë publikë, në institucionet shtetërore dhe konstatimeve të kontrollorëve të KLSH, të kërkohet ndryshimi i kriterëve të përcaktuara me pikën nr. 11 të VKM nr.864, datë 23.07.2010 *“Për pajisjen me numër celular të personave juridikë, publikë”* pasi :

- Sipas pikës 11 të këtij vendimi, drejtuesit e organeve të pushtetit vendor, kanë të drejtë të pajisin me numër telefoni celular personat zyrtar të administratës deri në masën 2% të totalit të shpenzimeve vjetore të miratuara për blerje mallra dhe shërbime.

Përcaktimi i pikës 11 bie në kundërshtim me lidhjet nga nr.1 deri në nr.6 bashkëngjitur vendimit të mësipërm.

3. Mbi bazën e argumentimit logjik, për auditimin financiar të çertifikimit të nxjerrjes së llogarive vjetore në institucionet shtetërore dhe saktësisë së pozicioneve të bilancit kontabël, në bazë të konstatimit të kontrollorëve të KLSH, të kërkohet ndryshimi i ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 *“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”*; kjo vetëm për kontrollorët ekonomistë dhe sidomos me profesionin e financierit pasi :

-Në auditimet financiare të ushtruara në institucionet shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për mbajtjen e kontabilitetit dhe paraqitjen e bilancit kontabël vjetor kontrollorët e KLSH me specialitetin financiar vazhdimisht e kanë patur në programin e kontrollit dhe e kanë realizuar një gjë të tillë duke vlerësuar edhe saktësinë e çertifikimit të ekspertit kontabël.

Për këtë qëllim në periudhën e mëparshme kontrollorët specialistë financiarë të KLSH kanë kryer edhe specializimin përkatës dhe në atë kohë nga drejtuesit e institucionit dhe të komisionit të specializimit na është thënë që jeni të çertifikuar si *“ekspertë kontabël”* por pa ndonjë dokument ligjor, (dëshmi) por një profesion i tillë do ushtrohet nga ana juaj vetëm pas ndërprerjes së mardhënieve të punës me institucionin e KLSH, gjë e cila në fakt duhet sanksionuar me akt ligjor.

Sigurisht që në situatën e krizës ekonomike globale rajonale dhe në stadin e zhvillimit që po kalojmë, kontrollet për vitin 2012 detyrojnë institucionin tonë të jetë më ambicioz prandaj në këtë kuadër nga ana jonë si kontrollor kërkohet një impenjim më i madh në përmbushjen me sukses të detyrave të ngarkuara.

Tiranë më, 17.01.2012

R A P O R T

ANALIZA MBI AKTIVITETIN E DREJTORISË PËR VITIN 2011



Elvana Tivari

*Drejtoresh e Drejtorisë Juridike dhe
Kontrollit të Cilësisë*

Qëllimi i përgjithshëm i punës, në kryerjen e detyrave gjatë vitit 2011, ka qenë si vijon:

- Dhënia e asistencës dhe konsulencës juridike për cilësinë dhe bazueshmërinë ligjore të projektvendimeve dhe të Raporteve Përfundimtare të Kontrollit të KLSH. Kjo mbështetje me asistencë juridike, i ka shërbyer Kryetarit të KLSH për të vlerësuar gjatë procesit të vendimmarrjes bazueshmërinë ligjore të zbulimeve dhe konkluzioneve, të pasqyruara në Raportin Përfundimtar, bazueshmërinë ligjore dhe proporcionalitetin e rekomandimeve, si dhe zbatimin korrekt të procedurave dhe standarteve të kontrollit.
- Komunikimi me Prokurorinë dhe institucionet e interesuara e Gjykatat, respektivisht për kallëzimet penale të depozituara nga KLSH dhe çështjet e përcjella në Gjykata.
- Hartimi dhe ndjekja e strategjisë dhe kriterëve që lidhen në mënyrë analitike me zbatimin e kërkesave ligjore e standarteve në procesin kontrollues, duke synuar të krijohen baza sa më të qëndrueshme, objektive dhe racionale për një sistem të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë sa më efektiv dhe sa më afër standarteve bashkëkohore.

- Kontribuimi për realizimin e detyrimeve të marra përsipër nga KLSH në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe raportimi për masat e marra.
- Përfaqësimi sipas autorizimit të Kryetarit të KLSH, i institucionit në nismat dhe përpjekjet kombëtare antikorrupsion.

Në mënyrë më analitike, gjatë kësaj periudhe, nga Drejtoria Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, duke u bazuar dhe në Rregulloren e Brendshme të KLSH-së janë realizuar si më poshtë këto detyra:

I. KONSULENCA JURIDIKE

- Është dhënë mendimi juridik për rreth 152 dosje kontrolli, prej tyre janë shqyrtuar 140 dosje të kontrollit të ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe vlerësues, 10 auditime financiare, 1 auditim performance si dhe për herë të parë është dhënë mendimi për 1 çertifikim të llogarive të kryer në Gjykatën Kushtetuese.

Viti	Mendime të dhëna	Mendime të ligjshmërisë rregullshmërisë dhe vlerësues	Mendime për Auditimet Financiare	Mendime për Auditimet e Performancës	Mendime për Certifikimin e llogarive
2011	152	140	10	1	1

Për çdo dosje të kontrollit, para dhënies së mendimit juridik, është kontaktuar me grupet e kontrollit përkatëse duke kërkuar sqarimet konkrete nga ana jonë për paqartësitë apo saktësimet në rastet e vëçanta. Në mjaft raste grupeve të kontrollit i është dhënë mendimi verbalisht për përmirësimet apo ndryshimet që duheshin bërë dhe për rastet e tjera ku nuk kemi rënë dakort është dhënë mendimi me shkrim.

Duhet theksuar se mbi 98 % e mendimeve të dhëna nga ana jonë, janë marrë në konsiderate dhe janë reflektuar në materialet e kontrollit, ndërsa 2 % e tyre kanë vazhduar më tej me procesin e evadimit duke kaluar tek Drejtori i Përgjithshëm e më pas tek Kryetari.

Mendimet e dhëna nga ne të cilat i janë përcjellë Departamenteve përkatëse, për ndryshime apo përmirësime të Raporteve Përfundimtare të Kontrollit dhe Projekt Vendimeve, kryesisht kanë konsistuar në korrigjime të referencave të gabuara të akteve ligjore e nënligjore.

Ka pasur raste dhe është dhënë mendim për ndryshime në materialet e kontrollit, kur grupi i kontrollit nuk ka marrë në konsideratë dhe për pasojë nuk kanë reflektuar observacionet e ardhura nga subjektet e kontrollit, të cilat kanë rezultuar të nevojshme për ndryshim.

Në kryerjen e kësaj detyre, është synuar dhënia e mendimeve sa më efektive mbi cilësinë dhe bazueshmërinë ligjore të materialeve të kontrollit si dhe respektimi i afatit të përcaktuar në rregulloren e brendshme të KLSH. Në këtë mënyrë, Drejtoria Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, ka shërbyer si një filtër i rëndësishëm në procesin e evadimit të materialeve të kontrollit, duke rritur në një shkallë të konsiderueshme sigurinë për saktësinë, cilësinë dhe bazueshmërinë ligjore të konkluzioneve dhe rekomandimeve të kontrollit. Gjatë evadimit të materialeve të kontrollit gjatë vitit 2011 në verifikimin e bazueshmërisë ligjore të materialeve të kontrollit i është kushtuar kujdes i veçantë evidentimit të akteve të reja ligjore e nënligjore të reja të hyra në fuqi, të cilat për hir të së vërtetës në këtë periudhë kanë qënë të shumta. Në këtë mënyrë duhet pasur kujdes në ndarjen e drejtë të periudhave në të cilat këto akte aplikohen, duke qënë se ky është pikërisht momenti kur mund të krijohet konfuzion me periudhat e kontrolluara (të kihet parasysh legjislacioni i ri për prokurimet publike, kontabilitetin, regjistrimin e pasurive të paluajtëshme, koncensionet dhe administrimi i pronës publike etj).

- Në vazhdimësi është mbajtur kontakt me Prokurorinë e Përgjithshme si dhe kemi marrë pjesë në takimet e kryera në kuadrin e taskës forcës të ngritur në organin e Prokurorisë, gjithashtu janë mbajtur kontakt me Prokuroritë pranë gjykatave të rretheve në lidhje me ecurinë e procedimeve të filluara në vijim të kallëzimeve penale. Për vitin 2011 janë përgatitur dhe dërguar në organin e Prokurorisë 3 kallëzime penale.

Si niveli sasior dhe cilësia e marrëdhënieve me Prokurorinë nuk kanë qenë më të mirat e mundshme, por tashmë që Kryetari i KLSH ka shprehur vullnetin për rigjallërim të raporteve të bashkëpunimit, kjo marrëdhënie do të marrë angazhim maksimal.

- Drejtoria Juridike ka qenë e përfshirë në punën për ndjekien dhe zbatimin e Planit Strategjik 2009 – 2012, vecanërisht për reformën ligjore, por ka kontribuar me ekspertizë edhe për komponentët e tjerë veçanërisht për praktikën e kontrollit.

- Brenda vitit 2012, në kuadër të detyrimeve të KLSH në procesin e integritit evropian, parashikohet të përfundohet projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8270 datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" me ndryshimet përkatëse. Ky projektligj, do të synohet të jetë në përputhje me Deklaratën e Limës, Standardet e Auditimit të INTOSAI-t dhe praktikën më të mirë Evropiane. Fushat kryesore dhe çështjet konkrete ku parashikohen të bëhen përmirësime në ligjin "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" përfshijnë:

- Rregullimin në mënyrë përfundimtare të pavarësisë së institucionit, nëpërmjet :

Sigurimit të pavarësisë së tij financiare;

Sigurimit të pavarësisë së tij funksionale dhe organizative.

- Konceptimin modern të të drejtave dhe detyrave për KLSH, nëpërmjet:

Forcimit të marrëdhënieve të KLSH me Kuvendin;

Dhënies së komenteve mbi projektlegjisacionin ekonomik e financiar të përgatitur nga Qeveria;

Udhëheqjes metodologjike dhe vlerësimit të punës së auditimit të brendshëm si dhe vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik.

- Rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH nëpërmjet:

Institucionalizimit të marrëdhënieve të KLSH me subjektet e sektorit publik të audituara, për të bërë të mundur ndjekjen sistematike të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga KLSH.

Konsolidimit e institucionalizimit të marrëdhënieve me organet e drejtësisë, veçanërisht me organet e Prokurorisë, auditimin e brendshëm, inspektimin financiar etj. për arritjen e rezultateve të synuara në parandalimin e korrupsionit në sektorin publik.

- Rritien e kapaciteteve administrative të KLSH nëpërmjet:

Percaktimeve për stafin e KLSH dhe qartësimin e statusit të tij; (duke marrë për referencë statusin aktual të Nëpunësit të Shërbimit Civil si dhe format e përdorura për këtë qëllim nga disa SAI homologe).

- Saktësimin e së drejtës KLSH të auditojë fondet e akorduara nga BE-ja për Shqipërinë, deri tek përdoruesi i fundit.

- Saktësimin e së drejtës KLSH të certifikojë llogaritë financiare.

- Specifikimit si pjesë të mandatit të KLSH edhe dhënien e opinioneve kualifikuese mbi llogaritë e Qeverisë, Ministrive të linjës dhe të subjekteve publike, si pjesë e veprimtarisë audituese për zbatimin e buxhetit të shtetit.

- Me autorizim të Kryetarit të KLSH, janë ndjekur proceset gjyqësore ku KLSH ka qënë palë dhe konkretisht në gjykatën e shkallës së parë në Durrës është kërkuar prishja e vendimit të mosfillimit nr. 6413 Prot. datë, 22.04.2011 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjithashtu pjesëmarrja në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për çështjen civile me paditës z. Sajmir Mani për të cilën gjykata dha vendimin në favor të KLSH-së.

- Në rastet kur ka qënë i nevojshëm interpretimi ligjor janë asistuar Departamentet e kontrollit në trajtimin e korrespondencës së natyrave të ndryshme me institucione dhe qytetarë dhe në mjaft raste kjo korrespondencë është trajtuar nga vetë Drejtoria Juridike.

- Vëmendje e veçantë i është kushtuar njohjes dhe përditësimit të vazhdueshëm me dispozitat ligjore e nënligjore të kontrollorëve si kusht i domosdoshëm për njohjen e vlerësimit e veprimtarisë së subjekteve të kontrollit, argumentimin e zbulimeve, nxjerrjen e konkluzioneve, përgjegjësi dhe rekomandimeve përkatëse. Për këtë qëllim është përgatitur paketa “baza

ligjore e përditësuar“ mbi dispozitat kryesore ligjore e nënligjore në shërbim të punës kontrolluese. Në kuadër të kësaj pune janë vënë në dispozicion të kontrollorëve 80 akte te reja ligjore e nënligjore, të shoqëruara edhe me konsulta për probleme të ndryshme të dala gjatë auditimeve.

II. ANGAZHIMI I KLSH PER INTEGRIMIN EUROPIAN

- Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit të Cilësisë, ka përgatitur përgjigjet e KLSH, për pyetjet e Pyetësorit të BE duke mbajtur marrëdhënie intensive me Ministrinë e Integritit, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë. Përgjigjet e pyetësorit për kapitujt 1, 22, 23 dhe 32 janë plotësuar dhe dërguar, sipas metodologjisë së kërkuar në ministritë përkatëse, brenda afateve që ishin kërkuar. Gjithësej nga KLSH janë dhënë përgjigje për 7 pyetje. Në vijim është bashkëpunuar për hedhjen e të dhënave në portalin përkatës dhe për verifikimin e korrektesës së versionit anglisht të këtyre përgjigjeve.

- Nga ana e Drejtorisë është bërë në mënyrë sistematike koordinimi, mbledhja dhe sistemimi i informacionit përkatës dhe raportimi mujor në Ministrinë e Integritit, si dhe janë mbajtur kontaktet dhe është kryer raportimi për çështje të veçanta në lidhje me proceset e integritit europian me Ministrinë e Integritit dhe partneret ne Komisionin Europian, si p.sh kontributi për përditësimin e PKZMSA për periudhën 2010 – 2014, pjesëmarrja dhe raportimi në takimet e Nënkomitetit ECOFIN Shqipëri – BE etj.

III. SIGURIMI DHE KONTROLLI I CILËSISË

- Është organizuar puna dhe është përgatitur raporti mbi sigurimin e cilësisë së kontrollit i cili hartohet një herë në vit. Konkluzionet u bënë pjesë e Raportit të aktivitetit të KLSH për vitin 2010. Në mënyrë konstante është punuar për hartimin e kriterëve, dhe strategjisë që do të përdoren në procesin e kontrollit të cilësisë. Për këtë qëllim i jemi referuar praktikave të organeve homologe, standarteve ndërkombëtare të kontrollit të përpunuar dhe miratuar nga

INTOSAI dhe kriterëve të përcaktuara në deklaratën e Limës. Gjithashtu këtij qëllimi i kanë shërbyer rekomandimet dhe seminarët e organizuara nga SIGMA pranë KLSH-së, udhëzuesit mbi kontrollin dhe sigurimin e cilësisë, të miratuar në mbledhjen e Presidentëve të SAI-ve të vendeve të Europës Qendrore e Lindore, Gjykatës Europiane të Kontrollorëve dhe SIGMA-s, të zhvilluar në Letoni në mars të vitit 2004, si dhe eksperiencia e fituar nga projekti i binjakëzimit me NAO e Britanisë së Madhe dhe Gjykatën e llogarive të Mbretërisë së Hollandës. Bazuar në këto praktika nga ana e KLSH-së janë hartuar e miratuar formularët përkatës që përdoren për shqyrtimin e sigurimit të cilësisë të auditimeve të kryera. Në bazë të kësaj strategjie dhe kriterëve që lidhen në mënyrë analitike me zbatimin e kërkesave ligjore e standarteve në procesin kontrollues synohet të krijohen baza sa më të qëndrueshme, objektive dhe racionale për një sistem të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë sa më efektiv dhe sa më afër standarteve bashkëkohore. Disa nga konkluzionet e nxjerra gjatë shqyrtimeve për sigurimin e cilësisë në procesin auditues janë:

1. Megjithëse vazhdimisht është vënë në dukje mungesa e dokumentimit të ndarjes së detyrave për çdo kontrollor sipas pikave të programit, kërkesë kjo e përcaktuar në Rregulloren e Brendshme dhe Standartet e Auditimit, si faktor i rëndësishëm jo vetëm për përdorimin racional të burimeve njerzore, por edhe për rritjen e përgjegjshmërisë për kryerjen me cilësi të punës audituese dhe vlersimin e punës të kontrollorve, përsëri kjo mangësi u vu re në disa prej auditimeve të shqyrtuara.

2. Me qëllim që grupi i auditimit të ndërgjegjësohet për zbatimin e programit, shmangien e konfliktit të interesit, si dhe të rritë efektivitetin e punës të ekspertëve të jashtëm të aktivizuar me kontratë, në zbatim të Standardeve të Kontrollit, me urdhërin e brendshëm nr.16, datë 23.04.2008, në vazhdim të formularve standard, është miratuar dokumenti për deklarimin e mungesës së konfliktit të interesave, i cili duhet të plotësohet para fillimit të auditimit nga grupi i kontrollorëve dhe ekspertëve të jashtëm të aktivizuar në auditim. Gjatë

shqyrtimit të dosjeve rezultoi se ky dokument nuk është plotësuar për disa nga auditimet e shqyrtuara.

3. Drejtuesit e departamenteve gjatë shqyrtimit të auditimeve në të gjitha fazat e zhvillimit të tij, duhet të kërkojnë me rigorozitet zbatimin e afateve, pasi respektimi i tyre gjatë kryerjes së auditimeve sipas programeve të miratuara dhe çdo ndryshim i tij, është detyrim institucional i përcaktuar në Manualet e Auditimit, Rregulloren e Brendshme dhe në Standardet e Kontrollit, ku drejtuesit e departamenteve mbajnë përgjegjësi për zbatimin e këtyre afateve dhe çdo ndryshim në afatin e kryerjes së auditimit duhet të shoqërohet me kërkesë me shkrim dhe miratim nga Kryetari. Ndonëse në krahasim me vitin e kaluar vihet re përmirsim në zbatimin e afateve të qëndrimit në subjekt, në 4 auditime të shqyrtuara u konstatuan tejkalime afatesh në procedurat e evadimit, të përgatitjes së projektraportit dhe raportit përfundimtar, për të cilët jepen shpjegime verbale, por jo të dokumentuara sipas kërkesave të Rregullores së Brendshme. E njëjta gjë duhet të zbatohet edhe për rastet e ndryshimeve në përbërjen e grupeve të auditimit, pasi në ndonjë auditim është shtuar një kontrollor në përbërjen e grupit, për të cilin miratimi përkatës është marrë me vonesë.

4. Nga kontrollorët në ndonjë rast nuk mbahen parasysh kërkesat e Manualeve të Auditimit, Rregullores së Brendshme, dhe Standardeve të Kontrollit, për zbatimin dhe dokumentimin e tyre për problemet që kanë të bëjnë me ballafaqimin e shkeljeve, shqyrtimin e observacioneve dhe pasqyrimin e tyre në raportin përfundimtar, duke u shprehur me argumenta ligjor për reflektim ose jo ndaj observacioneve për projektraportin.

Në disa raste përdoren shprehje tip “observacionet nuk qëndrojnë, pasi ato nuk kanë mbështetje ligjore”, pa përshkruar observacionet ashtu siç janë bërë, apo në mënyrë të përmbledhur dhe pa shpjeguar me argumente ligjore pse nuk pranohen.

5. Kujdes më i madh duhet treguar për mbikqyrjen e strukturave të auditit të brendshëm me qëllim që këto të forcohen e të rritin efektivitetin e punës së

tyre dhe të bëhen sa më të besueshme konkluzionet e rekomandimet e auditimeve të kryera nga ana e tyre. Referuar Ligjit, Rregullores së Brendshme dhe Standardeve të Auditimit, një ndër detyrat e KLSH-së është të shqyrtojë funksionimin dhe efektivitetin e punës të strukturave të Auditit të Brendshëm si dhe t'i propozojë drejtuesve të subjekteve masa për përmirësimin e punës të këtyre strukturave, me qëllim që këto të forcohen dhe të ndikojnë në mirëadministrimin e pronës publike, parandalimin e veprimeve të kundraligjeshme, rritjen e forcës goditëse dhe të besueshmerisë së konkluzioneve e rekomandimeve. Ashtu siç ka raste të trajtimit me përgjegjësi të organizimit e funksionimit të këtyre strukturave, të shoqëruara edhe me rekomandimet përkatëse në auditimet e kryera, konstatohen edhe raste të një trajtimi jo të thelluar ose të mos parashikimit që në program të vlersimit të efektivitetit të punës të këtyre strukturave në disa subjekte të audituara.

6. Konstatohet një praktikë pune që ka të bëjë me dorëzimin e të gjithë procesverbaleve e aktverifikimeve në zyrat e protokollit në ditët e fundit ose në përfundim të afatit të qëndrimit në subject të kontrollorëve dhe jo dora dorës gjatë periudhës së auditimit, për t'i dhënë mundësi personave të atakuar e që janë në mardhënie pune për tu ballafaquar e shprehur objeksionet gjatë periudhës së auditimit. Si rezultat i kësajë praktike, në dosjet e auditimit në përgjithësi këto dokumente arkivohen vetëm me shënimet e numrave të protokollit dhe firmat e kontrollorëve, por pa firmat e personave të atakuar, ku jo të gjithë bëjnë observacione dhe pa një konfirmim nga zyrat e protokollit për dorëzimin e këtyre dokumenteve ose vënien në dijeni të personave përkatës, për të shmangur ndonjë pretendim për mos marrje dijeni për përmbajtjen e këtyre dokumenteve dhe shmangie ndaj përgjegjësisë të personave të atakuar.

Në mënyrë që zbulimet, konkluzionet e rekomandimet e kontrollit të përshkruhen objektivisht, me vërtetësi, në mënyrë preçize dhe të argumentuara me dispozitat ligjore, është e domosdoshme mbajtja e dokumentacionit të kontrollit, procesverbaleve e aktverifikimeve konform

rregullores së brendshme, standardeve të kontrollit dhe dokumenteve standarde. Nga verifikimi i dosjeve që iu nënshtruan vlersimit të sigurimit të cilësisë, rezulton se përmbajtja e këtyre dokumenteve është në përputhje me rregullat e brendshme, por dorzimi i gjithë atyre dokumenteve në rrugë protokollare, nuk është praktika më e mirë e mundshme, pasi një praktikë e këtillë aplikohet për personat që nuk pranojnë të marrin në dorëzim e të firmosin dhe ato që janë të larguar, që megjithëse janë njoftuar për t'u paraqitur e dhënë sqarime, nuk paraqiten. Gjithashtu, kontrollorët duhet të jenë më kreativë, për të mbajtur letra pune në përshtatje me Manualet e Auditimit si dhe me rrethanat specifike që mund të paraqesë cdo auditim.

IV. Konkluzione

Në përfundim do të konkludonim, se në përgjithësi Drejtoria ka qenë në përpjekje të vazhdueshme jo vetëm për të përmbushur në mënyrë sa më korrekte detyrat që i takojnë sipas Rregullores së Brendshme të KLSH, por edhe për ti ofruar institucionit sa më shumë shërbime të dobishme në funksion të forcimit të sigurisë për mbështetjen ligjore të konkluzioneve të kontrolleve si dhe bërjen sa më efektive e në përputhje me standartet të procesit kontrollues.

Sidoqoftë duhen vecuar disa momente të cilat mund të konsiderohen si pika të dobëta dhe që meritojnë vëmendje gjatë vitit 2012.

Një problem i hasur gjatë ushtrimit të funksioneve nga Drejtoria, ka qenë mungesa në Drejtorinë Juridike e një stafi juristësh të kualifikuar që ti përgjigjet cilësisht kërkesave për mbikëqyrjen sa më cilësore të bazueshmërisë ligjore të materialeve të kontrollit. Kjo ka ardhur për dy arsye kryesore: Së pari numri i vogël i juristëve në dispozicion të Drejtorisë Juridike në raport me volumin e punës që duhet të përballohet dhe së dyti rekrutimi i juristëve duke i punësuar në KLSH me afat të shkurtër që nuk i ka ofruar atyre siguri të mjaftueshme për vendin e punës.

Lëvizshmëria e shpeshtë e juristëve të Drejtorisë, nuk ka lejuar që ata të jenë të fokusuar dhe të motivuar në misionin e tyre, si dhe e ka bërë pothuajse të pamundur kualifikimin e vijueshëm të tyre.

Një tjetër pikë e dobët ka qenë edhe mosmbulimi i mjaftueshëm me burime njerëzore i funksionit të kontrollit të cilësisë brenda Drejtorisë Juridike. Këtë funksion e ka mbuluar dhe e mbulon vetëm 1 person, por kjo nuk është e mjaftueshme, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që ka funksioni i kontrollit dhe sigurimit të cilësisë për procesin auditues. Kjo dobësi është shoqëruar edhe me vështirësi të stafit të Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë për të prodhur lista të vecanta verifikimi për secilin lloj auditimi që kryhet nga KLSH, apo për të pasuruar ato ekzistueset, vecanërisht në lidhje me auditimet e performancës.

Një tjetër dobësi ka qenë mungesa e mbështetjes me programe kompjuterike që lehtësojnë aksesin në aktet ligjore dhe nënligjore të përditësuara. Këto programe janë një zgjidhje e zgjuar, pasi në këtë epokë të aksesit në teknologji nuk kushtojnë shumë, por nga ana tjetër lehtësojnë punën dhe kursejnë kohën jo vetëm të juristëve por të gjithë stafit auditues. Gjithashtu, nëse programe të tilla do të ishin në përdorim të gjerë nga stafi auditues, do të krijoheshin kushtet që si juristët e Drejtorisë Juridike edhe drejtuesit e KLSH të kishin kërkesë më të madhe llogarie ndaj audituesve për saktësinë e referencave ligjore në materialet e kontrollit.

Së fundi, duhet përmendur se dobësi janë vërejtur edhe në funksionin e kontrollit të cilësisë brenda Departamenteve të Kontrollit. Hallkat brenda Departamenteve të Kontrollit si Krykontrollorë, apo juristë që realizojnë kontrollin e cilësisë, nuk janë mjaftueshëm të forta për të përmbushur si duhet këtë funksion.

V. Objektiva për vitin 2012

Meqënëse, kemi marrë edhe mbështetjen e Kryetarit të KLSH, për përmirësimin e dobësive të vërejtura, mund të formulojmë të sigurtë objektivat në vijim për vitin 2012

- Përsheptimi i punës për reformën ligjore, shoqëruar kjo me angazhim në rishikimin e Rregullores së Brendshme, në bashkëpunim me Drejtorinë e BNJ&M, si dhe me Drejtorinë e re të Kërkimeve e Zhvillimit Institucional.
- Forcimi i funksionit të konsulencës dhe asistencës juridike, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të stafit, rekrutimeve cilësore dhe kualifikimit të vijueshëm.
- Përmirësim dhe forcim i aksesit të stafit në aktet ligjore dhe nënligjore të përditësuara vazhdimisht, nëpërmjet programeve të TI.
- Forcimi i funksionit të kontrollit të sigurimit të cilësisë, duke pasuruar listat verifikuese të kriterëve të cilësisë dhe duke u thelluar me shqyrtime në llojet e vecanta të auditimeve, vecanërisht ato të performancës.
- Angazhim për rigjallërimin dhe diversifikimin e Marrëdhënieve me organet e Prokurorisë, duke rritur në këtë mënyrë rolin e KLSH në parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit dhe abuzimeve.

Tiranë më 20.012012

DISKUTIM MBI RAPORTIN E SIGURIMIT TË CILËSISË



Bashkim SPAHIJA

Specialist

Drejtoria Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë

Diskutimin tim po e përqëndroj në konkluzionet e dala nga raportin i sigurimit të cilësisë, duke ritheksuar rëndësinë e tij.

Duke patur parasysh kërkesat për auditim dhe mundësitë që ka institucioni përse i përket burimeve njerzore e materiale, duhet të tregohet një kujdes më i madh në përzgjedhjen e auditimeve të prioritetit sa më të lartë, duke përdorur për këtë qëllim argumenta sa më të plota, kërkesa këto të parashikuara në nenin 19.1.1 të rregullores së brendshme dhe pikave 2.1.3 dhe 3.1 të standardeve të kontrollit.

- Për mbarvajtjen e punës audituese, shkurtimin e afatit të auditimit dhe përdorimin rracional të burimeve njerzore e materiale, në nenin 19.2.3 të rregullores së brendshme është parashikuar njoftimi i subjektit 2 javë para fillimit të kontrollit. Drejtuesit e departamentit duhet të tregojnë kujdes për dergimin në kohë të njoftimit, pasi ka për qëllim vënjen në dispozicion të dokumentacionit për marrjen e informacionit paraprak, sigurimin e ambjenteve e paisjeve për një punë normale të kontrollorve, si dhe kërkesa të tjera në vartësi të specifikave dhe natyrës së auditimit apo subjektit, që në fund të fundit influencojnë në përfundimin në afat dhe me cilësi të auditimit.

- Me qëllim që grupi i auditimit të ndërgjegjësohet për zbatimin e programit, në zbatim të pikës 3.2.1. dhe 3.5 të Standardeve të Kontrollit, është miratuar dokumenti 2.1, i cili të plotsohet para fillimit të auditimit nga grupi i

kontrollorve. Plotsimi i këtj dokumenti nuk duhet nënvleftësuar, pasi ka të bëjë me pranimin e programit dhe detyrave për çdo kontrollor, me deklarimin për zotrimin e aftësisë profesionale dhe shmangien e konfliktit të interesit.

- Gjatë shqyrtimit u konstatua se në procesin e përdorimit të teknikave për grumbullimin e provave, kontrollorët janë përqëndruar kryesisht në ato dokumentare (procesverbale e aktverifikime), duke mos përdorur teknika të tjera si: inspektimi, vëzhgimi, intervista dhe konfirmimi, vizuale etj, të parashikuara këto në pikën 3.9.1,4 të standardeve të kontrollit.

- Drejtuesit e departamentit gjatë shqyrtimit të auditimeve në të gjitha fazat e zhvillimit të tyre, duhet të kërkojnë me rigorozitet zbatimin e afateve, pasi respektimi i tyre sipas programeve të miratuar dhe çdo ndryshim i tyre me miratim të Kryetarit, është detyrim ligjor institucional i përcaktuar në nenin 19.1 të Rregullores së Brendëshme dhe pikës 3.5 e Standardeve të Kontrollit, ku drejtuesi i departamentit mbanë përgjegjësi për zbatimin e këtyre afateve dhe çdo ndryshim në afatin e kryerjes së auditimit duhet të shoqrohet me kërkesë me shkrim dhe miratim nga Kryetari. Theksojmë se nuk mjafton vetëm respektimi i afatit të qëndrimit në subjekt, i cili fiksohet në programin e kontrollit dhe zbatimi i tij ndiqet si nga drejtuesit e departamentit ashtu dhe të subjektit. I njëjti kujdes duhet treguar në të gjitha fazat e evadimit, te cilat gjithashtu janë detyrim ligjor institucional për tu zbatuar, pasi kontrolli quhet i përfunduar vetëm atëherë kur është miratuar nga Kryetari.

- Konstatohet një praktikë pune që ka të bëjë me dorëzimin e gjithë procesverbaleve e aktverifikimeve në zyrat e protokollit të subjekteve në ditët e fundit, në përfundim të afatit të qëndrimit në subjekt të kontrollorve, mbas përfundimit të afatit përcaktuar në program dhe jo dora dorës gjatë periudhës së auditimit, për t'i dhënë mundësi personave të atakuar e që janë në mardhënie pune për t'u ballafaquar e shprehur objeksionet gjatë periudhës së auditimit. Si rezultat i kësajë praktike, në dosjet e auditimit në përgjithësi këto dokumente arkivohen vetëm me shënimet e numrave të protokollit dhe firmat e kontrollorëve, por pa firmat e personave të atakuar, ku jo të gjith bëjnë

observacione dhe pa një konfirmim nga zyrat e protokollit për dorzimin e këtyre dokumenteve ose vënien në dijeni të personave përkatës, për të shmangur ndonjë pretendim për mos marrje dijeni për permbajtjen e këtyre dokumenteve dhe shmangie ndaj përgjegjësisë të personave të atakuar. Në mënyrë që zbulimet, konkluzionet e rekomandimet e kontrollit të përshkruhen objektivisht, me vërtetësi, të preçizuar dhe të argumentuara me dispozitat ligjore, është e domosdoshme mbajtja e dokumentacionit të kontrollit, konform rregullores së brendshme e standardeve të kontrollit. Dorzimi i dokumenteve në rrugë protokollare siç thamë më lart, është në kundërshtim me nenin 20.2.a,b/8,9,10 të Rregullores së Brendshme, pasi një praktikë e këtillë aplikohet për personat që nuk pranojnë të marrin në dorëzim e të firmosin dhe ato që janë të larguar, që megjithëse janë njoftuar për t'u paraqitur e dhënë sqarime, nuk paraqiten.

- Pa mohuar punën e bërë nga grupet e kontrollit, përsëri vrehen të meta e mangësi në trajtimin më të plotë të problemeve që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe vlersimin e observacioneve, shpjegimeve të subjektit, dokumentimin e rezultateve të takimeve ballafaqese me subjektin e kontrollit dhe pasqyrimin e tyre në raportin përfundimtarë, kërkesa këto të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 6 të ligjit organik të KLSH-së, nenet 20.2.c.8 e 20.2.d.1,4 të rregullores së brendshme dhe në pikën 4.2.2 e standardeve të kontrollit. Në dosjet e shqyrtuara, në raportet përfundimtare të auditimit nuk jepen sqarimet e plota për observacionet e bëra, dhe ndonëse nga kontrollorët e drejtuesit e departamenteve pretendohet se takimet ballafaqese janë bërë, nuk rezultojnë të jenë dokumentuar në dosje këto ballafaqime me subjektin për problemet e trajtuara në raport, gjë që do të rriste sigurinë e besueshmerinë e konkluzioneve e rekomandimeve të kontrollit dhe eliminimin e observacioneve të panevojshme mbas dergimit të raportit përfundimtar në subjekt. Sipas raporteve të kontrollit rezultojnë se observacionet e subjekteve të kontrolluara shqyrtohen nga grupet e kontrollit, por për t'i dhënë të kuptohet subjektit se ato janë shqyrtuar, nuk mjaftojnë një përgjigje standarde që ndeshet

shpesh, se "observacionet nuk kanë bazë ligjore dhe si të tilla nuk merren në konsideratë", por kontrollorët duhet të përshkruajnë shkurt thelbin e përmbajtjes së observacionit dhe të argumentojnë me dispozita ligjore pse nuk merren në konsideratë, gjë që do të përforconte konkluzionin e kontrollorve për shkeljet e konstatuara. Rëndësia dhe domosdoshmeria e ballafaqimit është parashikuar edhe në nenin 19.3, pika 4 të rregullores së brendëshme, ku grupi i kontrollit gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese për parregullsitë e shkeljet ligjore është i detyruar të bëjë ballafaqimin me të gjithë personat përgjegjës të subjektit të kontrolluar.

- Menaxhimi rracional kërkon që burimet njerzore të vlersohen në mënyrë të atillë, që në kontroll krahas numrit të caktohet stafi me aftësit e arsimit e duhur dhe me eksperiencë, në mënyrë që cilësia e aftësive të grupit t'i përgjigjet kompleksitetit të kontrollit, kërkesa këto të përcaktuara në pikat 2.1.1 , 2.2.3 dhe 2.2.4.1 të standardeve të kontrollit.

- Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve kërkon vlersim më të madh dhe të mos konsiderohet një punë rutinë sepse ka të bëjë direkt me besueshmerinë dhe efektivitetin e punës së institucionit, prandaj dhe masat ndaj atyre subjekteve që nuk i zbatojnë ato duhet të jenë më të ashpra. Pikrisht për këtë arsye në nenin 20.2.h të rregullores së brendshme kërkohet që ky proces të bëhet në mënyrë të panderprerë gjatë gjith vitit nga departamentet e kontrollit, pamvarsisht se kontrolli i zbatimit të rekomandimeve organizohet në fund të vitit.

Konkluzionet e shqyrtimit të paraqitura më lart janë të trajtuara në materialin konstatuese të grupit të shqyrtimit të cilësisë bashkëlidhur raportit, ndaj të cilëve kërkohet që nga ana e departamentit të kontrollit të reflektohet në të ardhmen.

Tiranë më 20.012012

R A P O R T

ANALIZA MBI AKTIVITETIN PËR VITIN 2011

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë



Edlira SAKO

Drejtoresh e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore
dhe Metodologjisë

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë gjatë vitit 2011 ka zbatuar me përpikmëri të gjitha detyrat e përcaktuara në “Programin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2011”. Në vijim po paraqesim ecurinë e drejtorisë sipas sektorëve përkatës.

-Burimet Njerëzore

Gjatë vitit 2011 sektori i burimeve njerëzore ka kryer të gjitha detyrat të cilat rrjedhin nga Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH-së dhe “Programi i veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2011”.

Është kryer përditësimi i të dhënave për çdo punonjës, përpilimi i kontratave dhe hapja e dosjeve të reja për personelin e rekrutuar rishtas. Është përpunuar dhe sistemuar regjistri themeltar i punonjësve, si dhe është bërë hedhja e të dhënave për lëvizjen e personelit dhe plotësimin e dosjeve përkatëse të tyre.

Është hartuar një database, i cili shërben për nxjerrjen e të dhënave kryesore për secilin punonjës të KLSH.

Është kryer plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për deklarimin e pasurisë të nëpunësve civil të nivelit të lartë, të mesëm e të ulët drejtues dhe ky dokumentacion është dorëzuar në ILDKP brenda afateve të përcaktuara.

Në muajin Qershor është mbyllur procedura për punonjësit që kanë qenë në periudhë prove dhe në bashkëpunim me drejtorët e departamenteve dhe drejtorive përkatëse është përgatitur dokumentacioni i nevojshëm për vlerësimin e tyre.

Në muajin Nëntor në bashkëpunim me drejtorët e departamenteve dhe drejtorive është kryer vlerësimi vjetor i stafit të KLSH-së. Formularët e vlerësimeve vjetore më pas janë vendosur në dosjet përkatëse të personelit.

Protokoll-Arkiva

Zyra e Protokoll- Arkivës gjatë vitit 2011, ka kryer detyrat e saj duke u bazuar në Rregulloren e Brendshme të KLSH-së dhe në ligjin Nr.9154, datë 06.11.2003 “ Për Arkivat”.

Gjatë vitit 2011 kanë qarkulluar 3000 dokumenta të brendshëm e të jashtëm. Janë kryer veprimet për pranimin, evidentimin (Protokollimin), shpërndarjen dhe nisjen e korrespondencës zyrtare, duke bashkërenduar veprimet në strukturat e tjera në KLSH.

Disa nga detyrat që janë kryer në mënyrë të vazhdueshme dhe që përbëjnë volumin kryesor të punës së protokoll-arkivës kanë qenë:

Evidentimi (protokollimi) i korrespondencës zyrtare me institucionet e tjera duke respektuar rregullat përkatëse të korrespondencës zyrtare. I është kushtuar vëmendje trajtimit të dokumentave që krijohen nga institucioni, plotësimi me elementët përkatës (emrin, mbiemrin, firmën e hartuesit, datën dhe numrin, si dhe vulën e institucionit) të cilët depozitohen menjëherë në arkivë.

Protokollimi i gjithë dokumenteve të brendshme, duke respektuar klasifikimin e tyre dhe elementët përkatës që e përbëjnë atë.

Pranimi nga Departamentet e kontrollit i dosjeve të kontrollit në arkivë, kundrejt firmës së titullarit. Është treguar kujdes që dosja të përmbajë: të

gjithë elementët e Modelit Nr.6. Gjithashtu është kërkuar që dosjet të pajisen me inventarin e brendshëm të dokumenteve i cili hartohet nga përgjegjësi i grupit të kontrollit dhe kryeinspektori dhe që dokumentet që hyjnë në arkivë të përmbajnë edhe vulën e institucionit. Shfrytëzimi i dokumenteve në emër të institucionit apo për llogari të institucioneve të tjera dhe fotokopjimi i tyre është bërë vetëm me autorizim me shkrim të titullarit. Gjatë vitit 2011 është zbatuar me korrektësi praktika e dokumentimit në një kartelë të veçantë të dhënies dhe marrjes në dorëzim të dokumentave për çdo rast.

Ka përfunduar sistemimi (klasifikimi) i dokumentave të krijuara gjatë vitit 2011. Gjithsej janë krijuar 133 dosje kontrolli dhe 7 nëndosje, rreth 50 dosje me dokumenta me korespondenca të ndryshme me institucione ndërkombëtare e kombëtare, vendime, urdhëra, raporte analiza, buletine, programe, etj.

Është përfunduar inventari i dosjeve me dokumenta me “Rëndësi Historike Kombëtare” për vitin 2010 sipas ligjit “Për Arkivat” Nr.9154, datë 06.11.2003, sipas Modelit Nr.7 (Hartuar sipas Nenit 30 “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”).

Në zbatim të Urdhërit të Brendshëm të Kryetarit Nr.5 datë 28.01.2011 “Për hartimin e Raportit të Sigurimit të Cilësisë viti 2010”, janë përgatitur të gjitha dosjet e kontrollit sipas departamenteve të cilat janë dorëzuar në Drejtorinë Juridike për rishikim.

Gjatë gjithë vitit në mënyrë të vazhdueshme janë marrë masat për ruajtjen fizike të dokumenteve.

Aktualisht zyra e protokoll-arkivit e KLSH, ruan dhe administron dokumente duke filluar nga viti 1992 e në vazhdim. Këto dokumente janë të klasifikuara (sistemuara) dhe të inventarizuara sipas viteve të krijimit.

Metodologjia

Metodologjia dhe trajnimi kanë parashikuar dhe implementuar metodika dhe mënyra të ndryshme trajnimi, duke synuar zhvillimin e burimeve njerëzore

nëpërmjet plotësimit të objektivave të matshëm lidhur me kualifikimin profesional të punonjësve.

Azhurnimi i Standardeve të auditimit dhe formularëve standard

Në bashkëpunim me specialistin e trajnimeve, ka përfunduar rishikimi i udhëzimeve dhe standardeve të INTOSAI. Më konkretisht janë përkthyer:

- Deklarata e Limës.
- Parimet themelore në Auditimin e Njësive Publike;
- Standardet e Përgjithshme të Auditimit Shtetëror;
- Standardet e Fushës së Auditimit Shtetëror;
- Standardet e Raportimit në Auditimin Shtetëror.

Është realizuar përkthimi e përshtatja e standardeve të sipërcituara me një terminologji sa më të saktë në gjuhën shqipe. Aktualisht ky proces është në fazën e redaktimit të materialeve.

Një risi për vitin 2011 ka qënë hartimi i disa formularëve standard për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare për institucionet buxhetore. Këto formularë do të studiohen për të parë nëse janë të zbatueshëm nga audituesit. Për këtë qëllim do të duhet të kryhen disa auditime pilote. Nëse rezultojnë se këto formularë janë të thjeshtë për audituesit dhe mbulojnë të gjitha proceset e punës, më pas do të vendosen në manualin e auditimit financiar.

Një proces tjetër i rëndësishëm i metodologjisë dhe trajnimit është dhe njohja e personelit të KLSH me standardet dhe metodikat e auditimit. Ky proces kryhet me anë të trajnimeve mbi tema të ndryshme.

Një pjesë e temave të trajnimeve është mbuluar dhe referuar nga specialisti i metodologjisë. Në "Programin e trajnimeve të punonjësve për vitin 2011" është referuar në temat:

- Auditimi Financiar;
- Auditimi i Performancës;
- Vlerësimi i riskut dhe materialitetit;
- Azhurnimi me rregulloren e brendshme, standardet dhe kodin etik.

Trajnimi i stafit të KLSH

Numri i Trajnimeve rezulton shume i ulët

Trajnimi i punonjësve, veçanërisht i stafit kontrollor, ka qenë dhe mbetet një ndër objektivat prioritare.

Në fillim të vitit 2011 u monitoruan të gjithë pyetësorët të cilët ishin plotësuar nga stafi i KLSH-së në fund të vitit 2010. Në bazë të përgjigjeve të dhëna u hartua “Programi i trajnimit të punonjësve për vitin 2011”.

Në zbatim të programit të trajnimit është kryer përgatitja, zhvillimi dhe monitorimi i trajnimeve të ndryshme. Në këtë program ishin planifikuar 16 tema trajnimesh nga të cilat janë realizuar 11 tema: auditimi financiar; auditimi i performancës; programi IDEA; njohja me IT; prokurimi publik; materialiteti dhe risku; kontabiliteti publik; urbanistika; njohjen me rregullat e brendshme, standardet dhe kodin etik të KLSH etj.

Temat: sistemi doganor; ofrimi i përditësimeve teorike mbi studimin e kontratës FIDIC; mësimi i programeve financiare (Financa 5 dhe programeve të doganave); Programi Alpha; Mësimi i Programit Oracle, nuk janë realizuar për arsye objektive.

Në vitin 2011 për herë të parë u hartua “Programi i trajnimit të punonjësve të rinj në KLSH për vitin 2011”. Ky program kishte si qëllim trajnimin intensiv të punonjësve të rinj me tema të ndryshme si: njohja e institucionit të KLSH, proceset e punës që kryen KLSH, dokumentet standarde të KLSH, llojet e auditimit, riskun dhe materialitetin.

Të gjitha temat e “Programit për trajnimin e punonjësve të rinj në KLSH për vitin 2011” janë referuar,

Në zbatim të programit të lartpërmendur, u krye trajnimi i 5 punonjësve të rinj. Këtë vit u aplikua një mënyre e re e përcaktimit të personelit që do të trajnohej në zbatim të “Programit të trajnimit të punonjësve për vitin 2011”. Procesi i përzgjedhjes së personelit është kryer në bashkëpunim me drejtorët e departamenteve.

Gjithashtu është hartuar dhe një database që përcaktonte personat të cilët duhen të trajnoheshin gjatë vitit 2011.

Në total janë trajnuar:

- 160 ditë/njerëz nga programi i trajnimit të punonjësve për vitin 2011;
- 27 ditë/njerëz nga programi i trajnimit të punonjësve të rinj në KLSH për vitin 2011.

Pra kemi një total 187 ditë/njerëz të trajnuar ndërsa numri i të trajnuarve të planifikuar tek të gjitha trajnimet ishte 157 ditë/njerëz.

Në dhjetor të vitit 2011 është hartuar, miratuar dhe shpërndarë pyetësori për nevojat e stafit KLSH për trajnim, rezultatet e të cilit do të shërbejnë për hartimin e Programit të trajnimit të punonjësve për vitin 2012.

Bashkëpunimi me ekspertët të jashtëm për trajnimin e stafit të KLSH

Që kontrollorët të jenë të azhurnuar me proceset edhe ndryshimet që APP po bën, më datë 07.07.2011 është kryer trajnimi me ekspertë të huaj dhe të Agjencisë së Prokurimit Publik, për trajnimin e stafit të KLSH me temat si në vijim:

- koncesionet për shërbimet dhe punët – legjislacioni Evropian,
- marrëveshja kuadër,
- kriteret e dhënies së kontratës me theks të veçantë mbi tenderin ekonomikisht më të favorshëm,
- Prokurimi elektronik në Shqipëri.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur korrespondencat me Ministrinë e Financave për trajnimin e stafit të KLSH mbi “Sistemin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm”. Trajnimi i stafit u krye në zyrat e KLSH. Trajnimi kishte si qëllim dhënien e informacionit mbi:

-Letër Politikave për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik

-VKM 640, datë 11.06.2009.

-Ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010, për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK).

-Ligjin nr. 9720 i ndryshuar me Ligjin nr 10318,“Për Auditimin e Brendshëm”, datë 16.09.2010.

-Ligjin nr. 10294, datë 1.07.2010, për Inspektimin Financiar Publik.

-Manuali për MFK (miratuar me Urdhër nr. 54, datë 15.7.2010, të Ministrit të Financave).

-Risite e Ligjit Nr.10296, për MFK, etj.

Gjithashtu janë zhvilluar korrespondencat e para me Bankën Botërore për trajnimin e stafit të KLSH në fusha të ndryshme të auditimit.

Objektivat e Drejtorisë për vitin 2012

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Metodologjisë për vitin 2012 përveç detyrave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të KLSH, Pnanin Strategjik të Zhvillimit dhe Programit të veprimtarisë së KLSH për vitin 2012 , synon të sjellë disa risi në sektorin e burimeve njerëzore, metodologjisë dhe trajnimeve. Më konkretisht:

Burimet Njerëzore:

- Bashkëpunimi me IT për hapjen e një e-maili elektronik i cili do të shërbejë për të qenë një pikë kontakti për rekrutimin e stafit të KLSH.
- Aplikimi për marrjen e një programi të licencuar për burimet njerëzore.
- Përgatitja e infrastrukturës së nevojshme për organizimin e procedurave për rekrutimin e personelit sipas ligjit Nr. 8549 datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”
- Mbajtjen e një regjistri të veçantë për evidentimin sistematik të Memo -ve apo shkresave të brendshme.

Metodologjia dhe trajnimi:

- Konsultimi me grupet e auditimit mbi problematika të ndryshme që mund të hasin gjatë raportimit ose plotësimit të dokumenteve standardë. Ky konsultim me grupet e reja të auditimit do të shërbejë për standardizimin e raportimit.
- Redaktimin e standardeve të përkthyer gjatë vitit 2011 dhe konsultimi me Drejtorin e Përgjithshëm.

- Bashkëpunimi me grupet e auditimit për dhënien e opinioneve të pasqyrave financiare për institucionet buxhetore dhe nëse ato janë të zbatueshme të bëhet miratimi dhe vendosja e tyre në manualin e auditimit financiar.
- Mbulimi i kërkesave dhe nevojave të ndryshme që audituesit kanë dhe zgjidhja e tyre duke hartuar dhe siguruar strukturën e raportimit me anë të dokumenteve dhe formularëve standard që nxirren nga INTOSAI, EUROSAI për të lehtësuar punën dhe gjykimin e tyre.
- Rishikimi i efikasitetit dhe efektivitetit të standardeve të brendshme dhe procedurave të KLSH.
- Programi vjetor i trajnimit të hartohet në sinkron me programin vjetor të kontrolleve.
- Zhvillimi i mëtejshëm i kontakteve për bashkëpunim me institucione të tjera (Fakulteti i Ekonomisë në Universitetin e Tiranës, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik, ITAP etj) për realizimin e disa temave të trajnimit.
- Hartimi i një plani strategjik afatgjatë për trajnimet ku të përcaktohen objektivat e trajnimeve, nevojat për trajnim, vendosja e përparësive të trajnimeve sipas institucionit dhe më pas sipas personelit, mënyra e dhënies së trajnimeve, bashkëpunimi me departamentet e kontrolleve për pjesëmarrjen e stafit që do trajnohet dhe vlerësimi i efektivitetit të trajnuarve pas trajnimit.
- Në bashkëpunim me departamentet e kontrollit të hartohet dhe të mbahet regjistri i aftësive profesionale, ku të përshkruhet për çdo kontrollor arsimimi, kategoritë, detyrat e kryera, kualifikimet dhe trajnimet, sektorët në të cilët kanë eksperiencë pune, etj.
- Vlerësimi / monitorimi i stafit të KLSH pas trajnimit mbi aftësitë e fituara gjatë temave të ndryshme që janë kryer në KLSH.
- Hartimi i pyetësorëve për vlerësimin e trajnuesve që do të plotësohet në fund të çdo trajnimi nga personat e trajnuar dhe specialisti i kualifikimeve dhe trajnimeve.

- Mendojmë të hartohet një kërkesë tip e cila do të plotësohet nga punonjësit të cilët janë te interesuar për të marrë pjesë në trajnime me tema të ndryshme.
- Përditësimi i database-it të trajnimit të personelit të KLSH-së për vitin 2012.

Tiranë më 13.1.2012



Kozma Kondakçiu

Specialist i Lartë

Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë,
Publikun dhe Teknologjisë së Informacionit

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar të ftuar,

Të nderuar kolegë,

Në diskutimin tim do përpiqem të jem realist e të përqendrohem kryesisht në të metat e rrugët për daljen e Teknologjisë së Informacionit nga gjendja aktuale.

IT në KLSH, për vitin 2011 ka njohur stanjacion, si rezultat i zhvillimit me hope e jo harmonik të burimeve njerëzore e infrastrukturës IT .

Stafi IT është përpjekur të zhvillojë një luftë imagjinare për të frenuar kohën e amortizimit të pajisjeve, e cila si rezultat i politikave të ndjekura në vite ka akumuluar probleme jo të vogla.

Ambienti në të cilin zhvillohet kjo teknologji informacioni, si rezultat i mungesës totale të hapësirave së ambienteve, ndrydh e deformon edhe ato investime që janë kryer vite më parë, ku pa dyshim, mungesa e një dhome për serverët, pasja e një rrjeti kompjuterik të amortizuar fizikisht edhe moralisht (i para 10 vitesh) dhe pa parametrat e standardet e përcaktuara nga AKSHI përbëjnë një pengesë të pakalueshme e të pakompesueshme nga ndikimi pozitiv i faktorëve të tjerë.

Zhvillimi i burimeve njerëzore në KLSH në fushën e IT gjatë vitit 2011, lë për të dëshiruar. Sasia e trajnimeve për stafin IT ka qenë e pakët dhe ato pak trajnime që janë organizuar nga institucionet homologe dhe ato të përfituara nga suporti i dhënë nga Qeveria në kontekstin e e-gov nuk janë shfrytëzuar si dhe sa duhet, duke çuar për trajnim edhe personel me kontratë të përkohshme në KLSH, që më pas janë larguar, duke çuar dëm investimin e kryer (trajnimet e qendrës SEMOS për administrimin e rrjetit), ndërkohë që ky staf IT, edhe pse i vogël në numër, gjen mundësinë për të zhvilluar pjesën specifike më të madhe të trajnimeve të brendshme të kryera gjatë vitit 2011.

KLSH jo vetëm nuk ka bërë përpjekje të mëdha për thithjen e financimeve e donacioneve në drejtim të zhvillimit të sektorit IT, por edhe nuk ka shfrytëzuar sa duhet burimet financiare të vëna në dispozicion për këtë qëllim.

Ndikim negativ në zhvillimin e IT ka sjellë mosstabiliteti i strukturave IT, të ndërtuar para 13 vitesh në nivel sektori pranë kabinetit të Kryetarit, me lëvizje të ndryshme me të njëjtin status, duke arritur formën me të lartë të organizimit në atë të drejtorisë deri para 6 vitesh, kohë nga ku ka ardhur në një proces mosvlerësimi, duke kryer uljen shkallë-shkallë nga organizim si drejtori, në sektor e deri në formën me të ulët të organizimit sot, atë të dy punonjësve pjesë e sektorit të marrëdhënieve me jashtë, në mospërputhje me rekomandimet e AKSHIT për strukturat e IT në administratën publike një formë të tillë organizimi. Janë shpenzuar vlera të konsiderueshme financiare e njerëzore për futjen e teknologjisë së informacionit në kontroll, nëpërmjet programit të Auditimit IDEA, por deri më sot shkalla e përdorimit në praktikë mbetet e limituar edhe si rezultat i mos koordinimit e mosfunksionimit si dhe sa duhet të strukturave përkatëse.

Shkalla e përdorimit të faqes së internetit të KLSH si mjet komunikimi me faktorët kryesore, ka qenë e ulët, botimi i materialeve në të është kryer pa dinamizëm.

Kjo ishte një panoramë e gjendjes së IT-së në KLSH për te cilën të gjithë ne kemi përgjegjësi.

Nuk duhet të kemi ndrojtje për të thënë gjera ashtu siç janë, konstatim pa të cilin nuk mundet të gjejmë zgjidhjet për përmirësimin e gjendjes e me pas çuarjen e këtij komponenti në pararojë.

Ne jemi të vendosur të përmbysim gjendjen dhe të përdorim teknologjinë e informacionit si:

- Një nga mjetet më të dobishme për rritjen e transparencës, eficientës e performacës së institucionit.
- Një mjet kryesor ndihmës në drejtim të aktivitetit kryesor, atë të kontrollit.

Intensifikimi i përdorimit të metodave bashkëkohore të teknologjisë së informacionit do të jetë një nga instrumentet bazë të rritjes së performancës së punës së KLSH dhe do të lehtësojë kontrollet e kryqëzuara të transaksioneve financiare. Ky përafrim duhet të jetë në fokus të punës së përditshme të KLSH me mediat dhe organizatat jo-fitimprurëse që luftojnë korrupsionin.

KLSH ka nevojë të fitojë akses në publik dhe për këtë i duhet:

- a) Të transformojë rrënjësisht faqen e tij në internet, duke siguruar një ndryshim rrënjësor në drejtim të transparencës dhe furnizimin periodik me informacion të rrjeteve të mediave elektronike dhe të shtypit të përditshëm, të interesuara për mirëmenaxhimin e pronës publike.
- b) Të zhvillojë burimet njerëzore të KLSH në nivelin e parametrave të kërkuar nga INTOSAI dhe në përputhje me sfidat integruese të vendit Për të arritur këtë duhet të shfrytëzohen të gjitha burimet e mundshme, të brendshme e të jashtme, ku pa dyshim forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional e veçanërisht ai shkëmbimit të eksperiencave me ZAP e Kosovës do të shërbejë, veç të tjerash, në këtë drejtim.
- c. Të rrisë aksesin e buletinit periodik të KLSH në aktorët kryesorë të opinionit publik, si mediat, opinionistët dhe OJF-të e angazhuara kundër korrupsionit dhe/ose të interesuara për bashkëpunim.

KLSH ka nevojë parësore për një investim të plotë për përmirësimin e imazhit aktual.

Për këtë është e nevojshme të përgatisim një strategji komunikimi 2012-2015, që të synojë rritjen e aksesit dhe kuptimin e plotë në publik të misionit dhe rolit të KLSH, si luftues dhe parandalues i korrupsionit dhe i abuzimeve me pronën shtetërore, si dhe të rolit të tij orientues dhe ndreqës në performancën e institucioneve publike që kontrollojnë.

Një strategji e tillë do të pajiset me një plan konkret veprimi 2012-2015.

Në përfundim shpreh angazhimin personal por edhe të kolegeve për t'ju përgjigjur me përkushtim detyrave dhe sfidave të zhvillimit të institucionit.

Tiranë më 20.012012

PROBLEMATIKA E KLSH PËR VITIN 2011, NËN NJË VËSHTRIM

TEJET KRITIK



Muhamed Kavaja

Kontrollor i Parë

Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të

Pushtetit Vendor, Administrimit dhe

Privatizimit të Pronës Publike

dhe

Kryetar i Lidhjes së Kontrollorëve të

Shqipërisë

Problematika

Kundër Vendimit të ish Kryetarit të KLSH për emërimin tim si kontrollor i kategorisë së parë pranë Departamentit ku vazhdoj punën kam depozituar ankim pranë Komisionit të Shërbimit Civil i cili u shpreh me vendim se gëzoja statusin e Përgjegjës të Sektorit që nga viti 2000.

I vetëm nuk mund të vazhdoja të kërkoja ndonjë të drejtë në këtë institucion, ku ligji “Për Statusin e Nëpunësit Civil” si dhe neni 20 i ligjit “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” as që ekzistonin.

Ku puna shkoj deri aty sa dhe pagën duhej ta merrje vesh nga bankomati se sa ishte për çdo muaj me teorinë: nëse i pëlqente kryetarit të KLSH kontrolli të ipte pagën nëse nuk i pëlqente të ipte më pak. Humor ky në kufijtë e veprës penale por e vërtetë.

Në këtë institucion ku kishte kontrollor të kategorisë së parë por kishte dhe Superkontrollor me pagesa speciale.

Ku njerëz të punësuar me kontrata vendoseshin si drejtues grupesh kontrolli. Ku prishej Departamenti i Kontrollit komplet gjoja me ristrukturim vetëm për të ndryshuar rezultatin e kontrollit në procedurë përfundimi me zbulime kolosale.

Ku shkarkoheshin njerëz se po kërkonin të denonconin vepra penale (si në rastin e kontrollit në QSU Nënë Tereza Tiranë viti 2008- 2009).

Ku dërgoheshin njerëz për kontroll në skaje të Shqipërisë pa dieta dhe disa të tjerë ushtronin kontroll në bulevardin e qytetit të tyre me dieta.

Ku procesverbalet nga ndonjë drejtues i lartë konsideroheshin letra me vlerë për tu tregtuar.

Në këtë institucion ku certifikatat e marra si drejtues komponenti të projektit të binjakëzimit (siç me qëlluj të isha dhe unë deri në fund vitit 2008) të lëshuara nga NAO Angli apo dhe Shqipëri dhe trajnimet e bëra për profesion brenda dhe jashtë vendit nga unë dhe të tjerë, shërbenin vetëm për të ngritur pak humorin.

Në këtë institucion ku puna shkoj deri aty sa po të punoj mund të të tallnin, i mirë ishte ai që kishte mik Kryetarin.

Në këtë institucion ku edhe kaq sa po shkruaj disa nga drejtuesit e lartë mendoj se do të ishin të lumtur se nuk po shkruaj më shumë.

Në këtë institucion ku i vetmi parim (kur nuk mund të të hiqnin dot) ishte mos fol nuk të ngasim.

Ku një pjesë e mirë e nëpunësve kishin kujtuar se ishin Audit por me keqardhje nga fundi i mandatit të ish kryetarit po kuptonin se ishin thjesht Autik.

Ku institucioni filloj ti ngjante një përralle kur njëherë familja e qyqeve i dërgoi ftesë gjithë shpendëve të pyllit në të cilën thuhej : “Jemi të nderuar t’ju ftojme familjarisht për darkë me rastin se pas një pune të mundimshme e plot pasion, arritëm që zogjtë tanë të cilët lindën të bardhë kanë arritur të nxihen plotësisht për ditë e më shumë”. U shtrua darka e ngritën gosti gjatë gjithë natës e pinë aq shumë prindërit e qyqeve , sa kur u larguan në mëngjes nuk mundën më të ktheheshin pranë të vegjëlve të tyre. Kur zbardhi dita e ndriçoj dielli lart në qiell disa nga zogat e qyqeve që kishin mbetur, për efekt kohe, akoma ngjyrë gri, filluan të mburreshin e krekoseshin se ishin biond.

- Por megjithatë ka edhe arritje .

Arritja më e madhe është se, KLSH me një grup nga më të zgjedhurit (*jo të gjithë për hir të së vërtetës*) me drejtor, superkontrollor, kontrollor e inxhinjer mundi, për herë të parë pas kaq vitesh eksperiencë, të kalojnë institucionin nga kontrolli i administrimit të atyre që quhen tre “e”-t (efektivitet, efikasitet, ekonomikitet) në tre “p”-t (Pushtet, para, pisllek).

Arritje tjetër është që ky grup, **kontrollin** e kthyen në **kontrull** si i thotë populli i luajtën truallin.

A janë të vërteta këto apo jo? Përgjigjen do ta gjeni në faqen e internetit (**kukuku.cek_lek_lom&orgji.mon**). Kujdes më parë duhet të regjistroheni por nuk është e lehtë më besoni!!.

Prita dhe ato (drejtuesit) ishin të ndërgjegjshëm se një pjesë e mirë po prisnin, mbarimin e mandatit të ish Kryetarit. Por njëkohësisht u organizuam. Që nga Nëntori 2011 krijuam me një grup nismëtarësh shoqatën “Lidhja e Kontrollorëve Shqiptarë” në të cilën unë jam Kryetar që nga data 14.11.2011 e vendimit të Gjykatës. Ne synojmë që në mos ndonjë gjë të madhe, një tullë ta vendosim siç duhet për të mirën tonë e të këtij institucioni, brenda për brenda si dhe në marrëdhëniet me shoqërinë civile apo organizma homologe ndërkombëtare.

PASQYRIMI NË MEDIA I ANALIZËS VJETORE TË KLSH-së (JANAR 2012)

Media vizive

20 janar 2012

Televizionet RTSH, "Klan", "Top Channel", "Vizion Plus", "News 24", "ABC News", "Ora News", "Scan", etj. si dhe televizionet lokale të qytetit të Vlorës pasqyruan në edicionet e lajmeve analizën vjetore të KLSH për vitin 2011, të zhvilluar më datën 20 janar në Pallatin e Kongreseve.

Radiot "Tirana", "Top Albania", "Scan" etj. pasqyruan po ashtu analizën vjetore 2011 të KLSH.

Gazetat

17 Janar, 2012

Gazeta "Shqip"

"KLSH: Leskaj: Prova të forta në Prokurori. Analiza vjetore e punës Me mijëra shkelje në tendera. Demi, 420 milion lekë", nga Ard Kola, fq. 12.

18 Janar, 2012

Gazeta "Telegraf"

"Analiza e KLSH/ Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të Shtetit. Bujar Leskaj: Tolerancë zero dhe kallëzime". "Kontroll Pushtetit Vendor, Administrimit dhe privatizimit të Pronës Publike". "Ndëshkime penale për abuzuesit e pasurisë shtetit", fq. 16- 17.

Gazeta "Shqip"

"Leskaj: Të rihetohet Bashkia e Tiranës"... Dosja e 2006, kryetari i KLSH: Verifikim zbatimit të tre kallëzimeve penale, nga Ard Kola fq. 11.

Gazeta "Ekonomia"

"Leskaj: Të luftohet korrupsioni, të rriten kallëzimet penale".fq. 7.

Gazeta "Koha Jonë"

"KLSH: Pushteti vendor, miliona lekë dëme më 2011" Leskaj: Tolerancë zero për shkeljet në urbanistikë nga Englantina Nasi, fq. 11.

Gazeta “**Tema**”

“Bujar Leskaj e nis punën duke kontrolluar dosjet e vjetra të Bashkisë së Tiranës” fq.5.

19 Janar, 2012

Gazeta “**Ekonomia**”

“Leskaj: KLSH heq dorë nga zbulimet hipotetike të korrupsionit” fq. 7.

21. Janar, 2012

Gazeta “**Ekonomia**”

“KLSH: Dëmi ndaj fondeve publike është 7 miliard lekë”, fq. 7.

Gazeta “**Ekonomia**”

“Pak! Shumë pak! Dobët për të gjithë ne”, fq. 6.

Gazeta “**Panorama**”

“KLSH: Zbuluam 70 milionë abuzime nga administrata”, fq. 4.

Gazeta “**Gazeta Shqiptare**”

“KLSH: Kemi zbuluar 7 miliard lekë dëme

Gazeta “**Shekulli**”

“KLSH: Armo dhe CEZ i kanë shtetit 58 milion USD borxh. ... Kontrolli: doganat nuk mblodhën 1.8 mln dollarë”, fq. 5

Gazeta “**Shekulli**”

“Administrata mori 1.5 milion USD shpërblime të paligjshme”... Institucionet nuk mbledhin qiratë e pronave shtetërore, privatët nuk paguajnë për shërbimet e marra”, nga Emirjon Senja, fq. 10

Gazeta “**Shqip**”

“KLSH kallëzon 13 zyrtarë për vjedhje”, fq. 8

Gazeta “**Shqip**”

“Në 2011 firuan 7 miliardë lekë”, nga Ard Kola, fq. 8

Gazeta “**Mapo**”

“KLSH: Shpërdorimi i zbuluar më 2011, 7mld lekë”, fq. 6

Gazeta “**Mapo**”

“Leskaj: Një libër gri për punonjësit e korrumpuar të administratës”, fq. 6

Gazeta “**Telegraf**”

“Leskaj: Korrupsioni do të luftohet në çdo Bashki dhe Komunë, pavarësisht partisë”, fq. 8

Gazeta “**Standard**”

“KLSH, luftë kundër korrupsionit dhe ndëshkim ndaj përgjegjësve”, nga Bujar Leskaj.
“KLSH- Dëmi ekonomik gjatë vitit 2011 ishte 7 miliard lekë” nga Teuta Shamku ”fq. 20-21.

Gazeta “**Metropol**”

“Leskaj: Forconi luftën ndaj fenomeneve të korrupsionit”, fq. 11

Gazeta “**Koha Jonë**”

“Sfidat e Kontrollit të Shtetit”, nga Bujar Leskaj fq. 8

Gazeta “**Koha Jonë**”

“Analiza e kontrollit të lartë i Shtetit publikon rezultatet e kontrollit KLSH: Shkeljet financiare në 2011, dëmi 7, 27 mld lekë... Nga 1605 masa të rekomanduara, vetëm 1093 janë zbatuar”, nga Eglantina Nasi, fq. 9

Gazeta “**Shqiptarja.com**”

KLSH: Alpetrol e OST, dem ekonomik 55 milion USD... Administrata shpërdoroi 7 miliard lekë të reja....Ndëshkimet: Demshpërblimi realizohet 9 përqind”, nga Genci Kondi, fq. 9.

Gazeta “**55**”

”Do të punojmë për një institucion të lartë auditimi dhe rritje të transparencës” nga Bujar Leskaj, fjala e mbajtur në Analizën Vjetore të KLSH për 2011, fq. 10-11.

Gazeta “**Sot**”

“KLSH, ja institucionet që kanë grabitur më shumë taksapaguesit shqiptarë”, fq. 6

Gazeta “**Sot**”

“Leskaj : Korrupsioni nuk është as i kuq, as blu, por i zi”, fq. 7.

Gazeta “**RD**”

“Leskaj :Do të ndëshkojmë shkelësit e ligjit”... Kryetari i KLSH tha se , abuzuesit do të largohen nga puna dhe do të paditen në Prokurori...Gjatë vitit 2011 u zhvilluan 152 kontrole, ku u morën 1605 mas administrative, nga të cilat u zbatuan 1108”, fq. 8.

Gazeta “**Republika**”

“Analiza vjetore e KLSH-së, Leskaj kritikon vartësit:më shumë denoncime në Prokurori”, fq. 5.

Gazeta “**Ballkan**”

“Leskaj i pakënaqur me kallëzimet penale të Kontrollorëve të KLSH-së”, fq. 4

23 Janar, 2012

Gazeta “**Metropol**”

“Vizioni i ri i Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga Fatmir Libohova, fq. 23.

24 Janar, 2012

Gazeta “**Zëri i Popullit**”

”KLSH: Administrata Berisha vjedh 7 miliard lekë” ... kontrollorët e KLSH-së kanë zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare në të ardhurat dhe shpenzimet e kryera”, nga Klajdi Haxhija, fq. 4.

Gazeta “**Metropol**”

”Dëmi ekonomik mbi 6 milion lekë të reja. KLSH kërkon zhëmtimin.”... “Financimet e huaja, zbulohen shkelje dhe abuzime me projekte”, nga Brikena Dervishaj, fq. 7.

10 Shkurt, 2012

Revista “**Klan**”

“Lufta ime” Intervistë me Kryetarin e KLSH nga Renato Kalemi fq.1,fq.18 -19.

Faksimile nga artikujt e botuar në shtypin e përditshëm

Panorama
E PREMIERË 20 JANAR 2012

SOCIALE

Analiza e Denarimentimit për të Ardhurave

Kontrolli i Lartë i Shtetit

KLSH, Leskaj: Më shumë zbulime të korrupsionit në Dogana dhe Tatime

Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka kritikuar dhe denigruar taktikën e Kontrollit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit pranë institucionit që ai drejton, duke kërkuar që të rritet niveli i zbulimit të korrupsionit. Në analizën për punën 2011-s të këtij departamenti rezultati që ikin zhvilluar të kontrollit në subjekte të ndryshme, kryesisht drejtojnë dogana të Tائمه dhe Doganave me një vlerë 185 milionë lekë. "Në analizën tuaj shoh zbulime të ulëta të korrupsionit në Dogana dhe Tائمه dhe masha shumë të lehta ndalojnë në", tha Leskaj. Ai kërkoi që të rritet niveli i zbulimit të korrupsionit në këto dy organe që janë kyçe në krijimin e të ardhurave. Leskaj vuri theksin në rëndësinë që ka adrehtimi i stafit me programet dhe teknologjinë e fundit me të cilin operojnë ato institucionet që kontrollohen, në mënyrë që të puna të jetë efektive. Sakaq, ai nuk anashkaloi dhe çështjen e kalifikimeve në Prokurori, e cila sipas tij, shfaqë rëndësi dhe një nga mënyrat më të shpejta që shkelin ligjin të shkellet për Drejtësi. Lidhur me problematikën e herashme që ka krijuar me KLSH-së dhe Tائمه për çështjen e kontrollit të kondicionale të të drejtave, nga ana e Leskaj u bëri thirrje se do të arrihet në një zgjidhje të këtij rregulli. "Korrupsionit më Tائمه do të rregullohet sipas asaj që përcaktojnë ligjet. Nëse ligji dhe standardet janë të cilat në operojnë të lejojnë kontrollin e subjekteve tائمه, në nuk do të kemi në të kundërt, do të vijohet me punën", tha Leskaj.

ekonomi
E KËMBË 17 JANAR 2012

Korrupsioni

KLSH, Leskaj: Prova të forta në prokurori

Analiza e punës 1-vjeçare. Me mijëra shkelje në tenderë. Dëmi, 420 milionë lekë

ANALIZA

Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka kritikuar dhe denigruar taktikën e Kontrollit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit pranë institucionit që ai drejton, duke kërkuar që të rritet niveli i zbulimit të korrupsionit. Në analizën për punën 2011-s të këtij departamenti rezultati që ikin zhvilluar të kontrollit në subjekte të ndryshme, kryesisht drejtojnë dogana të Tائمه dhe Doganave me një vlerë 185 milionë lekë. "Në analizën tuaj shoh zbulime të ulëta të korrupsionit në Dogana dhe Tائمه dhe masha shumë të lehta ndalojnë në", tha Leskaj. Ai kërkoi që të rritet niveli i zbulimit të korrupsionit në këto dy organe që janë kyçe në krijimin e të ardhurave. Leskaj vuri theksin në rëndësinë që ka adrehtimi i stafit me programet dhe teknologjinë e fundit me të cilin operojnë ato institucionet që kontrollohen, në mënyrë që të puna të jetë efektive. Sakaq, ai nuk anashkaloi dhe çështjen e kalifikimeve në Prokurori, e cila sipas tij, shfaqë rëndësi dhe një nga mënyrat më të shpejta që shkelin ligjin të shkellet për Drejtësi. Lidhur me problematikën e herashme që ka krijuar me KLSH-së dhe Tائمه për çështjen e kontrollit të kondicionale të të drejtave, nga ana e Leskaj u bëri thirrje se do të arrihet në një zgjidhje të këtij rregulli. "Korrupsionit më Tائمه do të rregullohet sipas asaj që përcaktojnë ligjet. Nëse ligji dhe standardet janë të cilat në operojnë të lejojnë kontrollin e subjekteve tائمه, në nuk do të kemi në të kundërt, do të vijohet me punën", tha Leskaj.

Prokurori i shtetit

Analiza e punës 1-vjeçare

Me mijëra shkelje në tenderë. Dëmi, 420 milionë lekë

ANALIZA

Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka kritikuar dhe denigruar taktikën e Kontrollit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit pranë institucionit që ai drejton, duke kërkuar që të rritet niveli i zbulimit të korrupsionit. Në analizën për punën 2011-s të këtij departamenti rezultati që ikin zhvilluar të kontrollit në subjekte të ndryshme, kryesisht drejtojnë dogana të Tائمه dhe Doganave me një vlerë 185 milionë lekë. "Në analizën tuaj shoh zbulime të ulëta të korrupsionit në Dogana dhe Tائمه dhe masha shumë të lehta ndalojnë në", tha Leskaj. Ai kërkoi që të rritet niveli i zbulimit të korrupsionit në këto dy organe që janë kyçe në krijimin e të ardhurave. Leskaj vuri theksin në rëndësinë që ka adrehtimi i stafit me programet dhe teknologjinë e fundit me të cilin operojnë ato institucionet që kontrollohen, në mënyrë që të puna të jetë efektive. Sakaq, ai nuk anashkaloi dhe çështjen e kalifikimeve në Prokurori, e cila sipas tij, shfaqë rëndësi dhe një nga mënyrat më të shpejta që shkelin ligjin të shkellet për Drejtësi. Lidhur me problematikën e herashme që ka krijuar me KLSH-së dhe Tائمه për çështjen e kontrollit të kondicionale të të drejtave, nga ana e Leskaj u bëri thirrje se do të arrihet në një zgjidhje të këtij rregulli. "Korrupsionit më Tائمه do të rregullohet sipas asaj që përcaktojnë ligjet. Nëse ligji dhe standardet janë të cilat në operojnë të lejojnë kontrollin e subjekteve tائمه, në nuk do të kemi në të kundërt, do të vijohet me punën", tha Leskaj.

ekonomia, 18 Janar 2012

Analiza

Leskaj: Të luftohet korrupsioni, të rriten kallëzimet penale

BEKTE zhvilluar analiza vjetore të Drejtësisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë si dhe Drejtërisë së Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë, ka mori pjesë Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj dhe Drejtori i Përgjithshëm, z.Robert Opini. Në diskutimin e saj me aktivistët dhe veprimtarët e kësaj Drejtore, Drejtoriaha më zhvilluan Tائمه theksor në qëllimin i përgjithshëm i punës në kryerjen e detyrave gjatë vitit 2011, ka konsultuar në dhënien e asistencës dhe konsulentëve juridike për cilësinë dhe bazueshmërinë ligjore të projektvendimeve dhe Raportave Përfundimtare të Kontrollit, si dhe komunikimin dhe mbajtjen periodike të marrëdhënieve me Organin e Akuzës, institucionet e interesuara dhe Qykatat, respektivisht për kallëzimet penale të depozituara nga KLSH. Një tjetër moment i rëndësishëm për këtë Drejtore, ka qenë kontrolli i dëmit në realizimin e detyrimeve të marra përparësi nga KLSH në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilitetit - Asociimit dhe raportimit për masat e marra.

Vendime e veçantë gjatë kësaj

partishë i është kushtuar një pjesë dhe zbatimit të vendimeve të disponuara ligjore dhe ndërligjore të kontrollorëve si kusht i domosdoshëm në argumentimin e zbulimeve dhe trajtimit e korrupsionit.

trollorëve, në tematikë të ndryshme si auditim financiar, auditim i performancës, programi IDREA, kontabiliteti publik, etj. Një objektivat dhe synimet kryesore për këtë drejtore për vitin 2012, do të jenë: Zhvillimi i kontakteve dhe bashkëpunimit me institucionet të tjera si Fakulteti Ekonomik në UT, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik, ITAF, etj. Gjithashtu, dhe hartimi i një plani strategjik afatgjatë për trajtimin ku të përcaktohen objektivat dhe prioritetet për çdo departament.

Kryetari Leskaj, sap ardhur raportimet dhe diskutimet e të dy Drejtorëve theksor nevojën në marrjen e masave respektive e ndërprerive me Prokurorin dhe organizatë të tjera shtetërore,

në thellimin e luftës ndaj fenomenit të korrupsionit, përkatohet një ulje e numrit të kallëzimeve penale, që që duhet të na angazhojë fuqimisht në si institucion, por veprimtari Drejtorin Juridike që në bashkëpunim dhe sinchronizim me këto institucione të rritim impaktin tonë ligjor ndaj parandalimit të këtyre fenomeneve. Po kësisht, u nënvizua fakti se duhet punuar akoma më tepër në hartimin e kritereve dhe strategjive që do të përdoren në procesin e sigurimit të kontrollit të cilësisë nga ana e kësaj Drejtore.

Gjithashtu, z.Leskaj kërkoi nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë, zbatimin rigoros të Kodit të Etikës nga ana e sipërmuajt të KLSH-së dhe ndjekjen në ecuri të të gjithë procesit. Në këtë kontekst, u kërkua kujtesë maksimale në procedurat e rekrutimit të personelit, si dhe angazhim të rritshëm nga ana e kontrollorëve në përvojë në dretim të trajnimeve dhe specializimeve të ndryshme, të cilat do t'i shprehin rritjen e kapaciteteve kontrolluese dhe veçantisht në zbatimin e kontrollorëve të rinj.

Analiza vjetore e KLSH 2011, janë zhvilluar 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative, ku vetëm 1108 janë zbatuar

Leskaj: "Korrupsioni do të luftohet në çdo bashki e komunë, pavarësisht partisë"

Kryetari i Komitetit të Lartë të Etikës dhe Leskaj bëri analizën vjetore të punës së institucioneve të tij dhe theksoi se në 2011 janë bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative. Ai vlerësoi se puna është kryer me sukses dhe se institucioni ka bërë kontribute të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe të vijoi me efektive. "Në vitin 2011 kemi bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative, nga të cilat 1108 janë zbatuar", tha Leskaj.



Me njëligjësi dhe përpjekje të mëdha për të reduktuar nivelin e korrupsionit dhe detyrat e veta në vend, Leskaj si ndërhyrës në cilësinë e punës ka lënë për të diskutuar. Analizimi i tij për punën e kryer nga institucioni dhe nga bashkitë e komunat dhe ka marrëveshje me bashkitë profesionale në zbatim të masave të financiar dhe korrupsionit.

“Në vitin 2011 kemi bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative, nga të cilat 1108 janë zbatuar”, tha Leskaj. Ai theksoi se institucioni ka bërë kontribute të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe të vijoi me efektive. “Në vitin 2011 kemi bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative, nga të cilat 1108 janë zbatuar”, tha Leskaj. Ai theksoi se institucioni ka bërë kontribute të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe të vijoi me efektive. “Në vitin 2011 kemi bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative, nga të cilat 1108 janë zbatuar”, tha Leskaj. Ai theksoi se institucioni ka bërë kontribute të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe të vijoi me efektive.

ME KONKRETEZET: “Vite të mëdha të punës së institucioneve të tyre në luftën kundër korrupsionit dhe të vijoi me efektive. “Në vitin 2011 kemi bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative, nga të cilat 1108 janë zbatuar”, tha Leskaj. Ai theksoi se institucioni ka bërë kontribute të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe të vijoi me efektive. “Në vitin 2011 kemi bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative, nga të cilat 1108 janë zbatuar”, tha Leskaj. Ai theksoi se institucioni ka bërë kontribute të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe të vijoi me efektive.”

me ndërhyrjet dhe të vijoi me efektive. “Në vitin 2011 kemi bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative, nga të cilat 1108 janë zbatuar”, tha Leskaj. Ai theksoi se institucioni ka bërë kontribute të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe të vijoi me efektive. “Në vitin 2011 kemi bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative, nga të cilat 1108 janë zbatuar”, tha Leskaj. Ai theksoi se institucioni ka bërë kontribute të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe të vijoi me efektive.”

Kryetari i KLSH tha se, abuzuesit do të largohen nga puna dhe do të paditen në Prokurori

Leskaj: "Do të ndëshkojmë shkelësit e ligjit"

Gjatë vitit 2011 u zhvilluan 152 kontrolle, ku u morën 1605 masa administrative, nga të cilat u zbatuan 1108

Kryetari i Komitetit të Lartë të Etikës dhe Leskaj bëri analizën vjetore të punës së institucioneve të tij dhe theksoi se në 2011 janë bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative. Ai vlerësoi se puna është kryer me sukses dhe se institucioni ka bërë kontribute të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe të vijoi me efektive. “Në vitin 2011 kemi bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative, nga të cilat 1108 janë zbatuar”, tha Leskaj.



Jane kryer 30 kontrolle, nga te cilat 10 ne projekte me investime te huaja, 14 ne shperbime publike, 5 ne cent mjedisor, si dhe 1 kontrolle nd zbatimim e detyrave, ku eshte konstatuar ng dem ekonomik mbi 6 milione lek te reja, per te cimen KLSH ka kerkuar qe te zhdmetohet

Jane kryer 30 kontrolle, nga te cilat 10 ne projekte me investime te huaja, 14 ne shperbime publike, 5 ne cent mjedisor, si dhe 1 kontrolle nd zbatimim e detyrave, ku eshte konstatuar ng dem ekonomik mbi 6 milione lek te reja, per te cimen KLSH ka kerkuar qe te zhdmetohet

si detyrat, si dhe kritikë që shprehën në lidhje me punën e kryer nga institucioni. Leskaj theksoi se institucioni ka bërë kontribute të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe të vijoi me efektive. “Në vitin 2011 kemi bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative, nga të cilat 1108 janë zbatuar”, tha Leskaj.

“Në vitin 2011 kemi bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative, nga të cilat 1108 janë zbatuar”, tha Leskaj. Ai theksoi se institucioni ka bërë kontribute të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe të vijoi me efektive.

me ndërhyrjet dhe të vijoi me efektive. “Në vitin 2011 kemi bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative, nga të cilat 1108 janë zbatuar”, tha Leskaj. Ai theksoi se institucioni ka bërë kontribute të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe të vijoi me efektive.”

me ndërhyrjet dhe të vijoi me efektive. “Në vitin 2011 kemi bërë 152 kontrolle dhe janë marrë 1605 masa administrative, nga të cilat 1108 janë zbatuar”, tha Leskaj. Ai theksoi se institucioni ka bërë kontribute të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe të vijoi me efektive.”

opinion

Korrupsioni nuk është as i kuq, as blu, por i zi

Nga Bujar LESKAJ*

Një gjë e përbashkët, duket mënyrën për të qenë korrupsioner në KLSH, është që të jesh në shërbim të shtetit. Në të kundërt të kësaj, në shtetin 2010-2011, i qenë këtu, në KLSH, të shpesh që korrupsionerit ka bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin. Nëse korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin, atëherë korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin. Nëse korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin, atëherë korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin.



“
Të gjithë duhet të kuptojmë se, nuk ka korrupsioner pa ndërmjetësi. Është e rëndësishme që ne të kuptojmë njëen e kontrollimit qeveritar dhe të aftë që abuzon me detyrimin. Çfarë bën për abuzim joq tërësisht për abuzim nga puna të personave shërbetërisht përfaqësues të detyrimit të korrupsionerit. Përndryshe, korrupsionerit nuk ka nevojë, nuk duhet të jetë kuq, as blu, por është zi.”

Nëse korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin, atëherë korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin. Nëse korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin, atëherë korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin. Nëse korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin, atëherë korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin.

Nëse korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin, atëherë korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin. Nëse korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin, atëherë korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin. Nëse korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin, atëherë korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin.

Nëse korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin, atëherë korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin. Nëse korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin, atëherë korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin. Nëse korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin, atëherë korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin.

Nëse korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin, atëherë korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin. Nëse korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin, atëherë korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin. Nëse korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin, atëherë korrupsionerit është bërë të mundur të jetë korrupsioner në dritën e bashkëpunimit me shtetin.

*Kryetar i KLSH

TemA

16 Janar, 2012 | Postuar në: Aktualitet,Ekonomia,Kryesore | Shkruar nga: TemA

Bujar Leskaj e nis punën duke kontrolluar dosjet e vjetra të Bashkisë së Tiranës

Sapo ka nisur punën, kryetari i ri i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka piketuar menjëherë se ku duhet të gërmojë. Siç njofton e përditshmja Shqip, Bujar Leskaj ka vendosur të rihetojë dosjet e bashkisë së Tiranës, në kohën kur ajo drejtohej nga Edi Rama. Gazeta thotë se kjo duket si një hakmarrje ndaj votës së Ramës. Në fakt mund të duket më shumë si një sinjal ndaj Berishës se e ka nën shërbimin e tij KLSH-në.

“Nga dosjet e hetimit kemi një mori shkeljesh me dëm ekonomik rreth 76 milion lekë, të kryera në disa sektorë, kryesisht të disiplinës financiare dhe urbanistike. Për këto abuzime, KLSH kërkoi marrjen e masave disiplinore për 13 punonjës të bashkisë dhe kallëzuan në prokurori 3 zyrtarë të lartë. Për të parë nëse rekomandimet tona janë marrë në konsideratë apo jo, do të urdhëroj shumë shpejt nisjen e kontrollit,” iu drejtua Leskaj vartësve të tij.

"KLSH, rol themelor në luftën kundër korrupsionit - do ketë mbështetjen e qeverisë"

25-01-2012 / Gazeta 55



Kryeministri Sali Berisha pret kreun e ri të KLSH, Bujar Leskaj

Kryeministri Sali Berisha theksoi gjë në takimin me kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Bujar Leskaj se lufta kundër korrupsionit dhe transparencës e qeverisë, janë gurë themel në një shtet demokratik. Duke e urrear Bujar Leskaj për detyrën e re, kryeministri Berisha garantoi mbështetje të plotë të qeverisë për institucionin e KLSH-së, të cilin e cilësoi si institucion themelor në luftën kundër korrupsionit.

Kryeministri sugjeroi besimin se KLSH do të shpërtojë gjithë me rigorozitet dhe objektivitet maksimal në përfutje me ligjin, ndërsa theksoi se kontrolli të ketë si objektiv të gjitha institucionet si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor.

Në të tjerë, Kryeministri theksoi se është e nevojshme dhe shumë e rëndësishme që vepërmataria e KLSH të përqendrohet në shtratin e saj ligjor që të përcaktohet qarta Kushtetuta dhe ligjet.

"Me punën tuaj, të përqendri të forconi besimin e publikut tek këto institucione si dhe të përcillesh një përzgjedhësi sa më të lartë për zbatimin e ligjit", u shpreh kryeministri Berisha.

Kryeministri theksoi se Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, pranë Këshillit të Ministrave, dhe të gjitha institucionet e tjera të kontrollit janë të gatshme të bashkëpunojë me KLSH-në.

Nga ana e tij, kryetari i KLSH-së, Bujar Leskaj falenderoi kryeministrin Berisha për prirjen dhe besimin e treguar nga mazhoranca për mandatinin e tij në këtë detyrë, duke theksuar se misioni i tij në krye të KLSH është zbatimi i Kushtetutës dhe ligjit.

Bujar Leskaj theksoi se strategjia e re e KLSH do të jetë në sintoni me Strategjinë Antikorrupsion të qeverisë të miratuar në vitin 2008 duke siguruar nga ana tjetër se do të synojë në një zbatim profesional dhe efikas të ligjit jashtë çdo interes tjetër.

Në këtë kontekst, Bujar Leskaj vlerësoi masat e ndërmara nga kryeministri Berisha për mbështetjen e vepërmatrisë së KLSH-së, si dhe vlerësoi angazhimin e tij për bashkëpunim me strukturat shtetërore të kontrollit dhe të zbatimit të ligjit.

Klan

E përjavshme Informative

Lufta ime



Në rrefimin e tij të parë në media pas emërimit në krye të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Bujar Leskaj, flet për projektet që do t'i japin një tjetër hov punës së këtij institucioni dhe si e pritë propozimin e Topit

Renato Kalemí

E Premte, 10 Shkurt 2012

Në zyrën e Bujar Leskajit je i rrethuar nga gjithfarë pikturash origjinale, a thua se aty nuk punon kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, por ndonjë artist. Megjithatë, ai njihet si dashamirës i artit, çka e ka shfaqur edhe kur mbante postin e ministrit të Kulturës në vitet 2005-2007. Në veçanti, i pikturës dhe skulpturës. Emra të njohur varen në katër muret që e zyrës: Ali Oseku, Zihni Veshi, Ardian Isufi apo Genc Përmeti. Në tavolinë mban një skulpturë të Ibrahim Rugovës, ndërsa në njërin cep atë të Ismail Qemalit, të dyja punë të skulptorit kosovar Luan Mulliqi. Por, kur bëhet fjalë për detyrën e re që i është ngarkuar, Bujar Leskaj nuk heziton të të përqendri me dashamirësi për ato çfarë je përgatitur ta pyesësh. Ndonëse ka pak ditë që ka mbushur muajin në krye të KLSH-së e nis rrefimin me qetësi, me tonin e zërit dhe theksin prej vlonjati, duke këmbëngulur fort kur bëhet fjalë për luftën ndaj korrupsionit. "Çdo hap mbrapa që do të bëjë Shqipëria në renditjen për nivelin e korrupsionit, unë e kam konsideruar dhe do ta konsideroj si punë të dobët të institucionit që tani drejtoj", thotë ai.

- Zoti Leskaj, ende nuk janë plotësuar dy muaj nga marrja e detyrës tuaj të re si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit. A e prisnit t'ju besohej një post i

Përmbajtja

	faqe
• Projekt-Ide “KLSH-Institucioni më i Lartë i Kontrollit Ekonomiko-Financiar të vendit”.....	3
• Fjala e Kryetarit në Analizën vjetore të KLSH për vitin 2011	29
• Përshëndetja e z. Adriatik Llalla, Inspektor i Përgjithshëm i ILDKP,	41
• Përshëndetja në emër të një grupi OJF. (Nga av. Altin Goxhaj drejtor i ZMK).....	43
• Raport-analizë e KLSH për vitin 2011(mbajtur nga Drejtori i Përgjithshëm R.Gjini).....	45
• Diskutime në analizën vjetore të KLSH (Z. Kepi, L.Nano, P. Beleshi, B.Arizaj).....	121-140
• Raport –analizë e Departamentit të Kontrollit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Kontrollit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.....	141-148
• Raport –analizë e Departamentit të Kontrollit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Publike.....	149-164
• Raport –analizë e Departamentit të Kontrollit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.....	167-189
• Raport –analizë e Departamentit të Kontrollit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.....	191-201
• Diskutime në Analizën Vjetore të Departamentit (M. Lleshi, Gj. Preçi, P. Beqiraj, A. Topiana, A. Maksutaj, S. Agaj, Xh. Luka, N. Nako, H. Isufi)	203-244
• Raport- analizë mbi aktivitetin e Drejtorisë Juridike dhe të Kontrollit të Cilësisë.....	243-254
• Diskutim mbi Analizën Vjetore të KLSH (B. Spahija).....	255-258
• Raport- analizë mbi aktivitetin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë (mbajtur nga Drejtoresha e drejtorisë E . Sako).....	259-266
• Diskutim mbi Teknologjinë e Informacionit (K. Kondakçiu).....	269-273
• “Vështrim tejjet Kritik” (nga M.Kavaja).....	273-276
• Pasqyrimi në media e analizës vjetore të KLSH gjatë janarit 2012.....	277-283

seria : botime KLSH- 01/2012

ISBN: 978-9928-159-01-4



Kontrolli i Lartë i Shtetit
Bulevardi " Dëshmorët e Kombit", nr. 3,
Tiranë Tel./ Fax. 04/ 228485, Tel. 04/ 251267
Web-site: www.klsh.org.al, E-mail: klsh@klsh.org.al